



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I HISTORISË

Disertacion për Gradën “DOKTOR” në Marrëdhënie Ndërkombëtare

POLITIKA E JASHTME E SHBA-VE DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE

(1989-1999)

Punoi

Urtak HAMITI

Udhëheqëse shkencore

Prof. Dr. Valentina DUKA

Tiranë, 2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I HISTORISË

Disertacion për Gradën “DOKTOR” në Marrëdhënie Ndërkombëtare

POLITIKA E JASHTME E SHBA-VE DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE

(1989-1999)

Mbahet më dt. 2015 para jurisë:

1. Kryetar
2. Anëtar (oponent)
3. Anëtar (oponent)
4. Anëtar
5. Anëtar

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	i
HYRJE.....	1

KAPITULLI I

SHBA-TË DHE SHQIPËRIA 1989-1997	12
I.1 Sistemi politik i SHBA-ve - faktorët që krijojnë dhe zbatojnë politikën e jashtme	12
I.2 Raportet SHBA - Shqipëri para dhe pas luftës së ftohët 1917-1989	23
I.3 Roli i SHBA-ve në përkrahjen e institucioneve demokratike në Shqipëri	35
I.4 Tranzicioni i vështirë politik, demokratik dhe social 1995-1996	52

KAPITULLI II

SHBA-TË DHE KOSOVA 1989-1997	66
II.1 Kosova nën Serbinë 1912-1988	66
II.2 Roli dhe ndihma e SHBA-ve në krijimin e pluralizmit demokratik në Kosovë	81
II.3 Kosova gjatë luftërave në ish-Jugosllavi - konferenca e Dejtonit.....	96
II.4 Konferenca e Dejtonit dhe implikimet për Kosovën.....	117

KAPITULLI III

SHBA DHE NDRYSHIMET E MËDHA NË KOSOVË DHE NË SHQIPËRI.....	135
III.1 Ndërrimi i qeverisë në Shqipëri	135
III.2 SHBA-të dhe lufta në Kosovë 1998-1999	144
III.3 SHBA-të dhe Konferenca e Rambujesë	160

III.4 Operacioni <i>Allied Force</i> , ecuria e bombardimeve dhe Shqipëria gjatë krizës humanitare	168
--	-----

KAPITULLI IV

FUNDI I INTERVENIMIT TË NATO-S DHE GJENDJA POST-NATO.....	180
---	-----

IV.1. Përpjekjet diplomatike amerikane dhe ruse për përfundimin e bombardimeve	180
--	-----

IV.2 Intervenimi i NATO-s në Kosovë 1999 dhe ndryshimi i rolit të fuqisë ushtarake në politikën e jashtme të SHBA-ve në shekullin XXI.....	186
--	-----

IV.3 SHBA-të, intervenimi i NATO-s, perspektiva për Shqipërinë dhe Kosovën .	201
--	-----

PËRFUNDIME.....	215
-----------------	-----

BIBLIOGRAFIA	219
--------------------	-----

PARATHËNIE

Ky punim ka në fokus analizën e politikës së jashtme amerikane dhe çështjen shqiptare në vitet 1989-1999 duke pasur si qëllim kryesor zbardhjen e qëndrimeve amerikane ndaj çështjes shqiptare mbi bazën e dokumenteve të deklasifikuara apo të hapura për publikun, të Departmentit të Shtetit të SHBA-ve, Raporteve të Kongresit të SHBA-ve, dokumenteve nga Bibliotekat Presidenciale të Presidentëve të kohës, Clinton dhe Bush, Bibliotekës së Kongresit Amerikan, dhe dokumenteve të deklasifikuara të Agjencionit Qendor të Inteligjencës - CIA.

Po ashtu, në këtë punim janë marrë parasysh edhe botimet e pjesëmarrësve autentikë të këtyre ngjarjeve historike për shqiptarët, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, autobiografite e tyre, intervistat me ta, shkrimet e autorëve të tjerë për punën e akterëve kryesorë. Kjo gamë interesimi është ndermarrë për faktin se shikuar në kontekstin historic kemi pasur zhvillime të vrullshme, të dendura, në Shqipëri dhe Kosovë, një dhjetëvjeçar historik ku për pasojë ishin të shumta ndryshimet rrënjësore që pësuan këto dy vende e bashkë me to edhe populli shqiptar në veçanti.

Si pjesëmarrës aktiv në zhvillimet në Kosovë gjatë periudhës së respresionit serb, pastaj si pjesë e ekipit televiziv amerikan CNN, nga marsi i vitit 1998 e deri në shkurt të viti 2001, kam pasur interes të veçantë të merrem me këtë trajtesë. Intensiteti i ndryshimeve të kohës, të cilën po e jetonim, pastaj motivimi i fuqishëm nga madhështia e gjithë popullit shqiptar në Kosovë dhe në Shqipëri, pra homogjenizimi nacional për të vepruar kundër politikës dhe makinerisë serbe, e cila mëtonte të shkatërronte qenien shqiptare në Kosovë, më shtynë mëpastaj t'i rrekem punës për të trajtuar pikërisht këtë periudhë të ndryshimeve të mëdha historike. Sepse homogjenizimi i tillë nacional, i shtyrë nga atdhedashuria për Kosovën dhe Shqipërinë, shpeshherë në kufi të nacionalizmit të hapur, nuk ishte parë në shekullin e XX as në Luftërat Ballkanike e as në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore. Si një lloj krahasimi interesant vlen fakti se shumë gjëra janë ende të pasqaruara rreth rolit dhe

raporteve të elementeve komuniste në krye me Lëvizjen Nacional Çlirimtare në krye me Partinë Komuniste të Shqipërisë në njërin anë dhe të Ballit Kombëtar si dhe të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare në anën tjetër. Ndërsa, në Luftën e Kosovës, vetëdijësimi i elitave politike në Tiranë dhe në Prishtinë kishte arritur përputhshmërinë complete sa që për vrojtuesit amerikanë të mediave, flas për CNN-in, veprimet e shqiptarëve në planin diplomatik dhe ushtarak nuk njihnin kufinjë dhe kishin axhendë të qartë.

Këtu dëshiroj të shpjegoj se me termin “çështja shqiptare” në fakt fokusohem te raportet që SHBA-të ndërtuan me shqiptarët e Shqipërisë dhe ata të Kosovës. Ishte qëndrimi amerikan ai i cili definoi pse duhen trajtuar shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës. Nga hulumtimet që kam bërë dhe dokumentet që kam hasur rezulton se SHBA-të zgjodhën të përkrahin shqiptarët nga këto dy vende për të siguruar dominimin gjeostrategjik me partnerë të sigurtë afatgjatë. SHBA-të janë të interesuara për stabilitet në Evropën Juglindore dhe kanë vlerësuar saktë se pa marrëdhënie me shqiptarët, apo pa i trajtuar çështjet e shqiptarëve, ky stabilitet gjithnjë do të jetë fragjil sepse shqiptarët janë faktor i rëndësishëm dhe janë të pranishëm në disa shtete të Evropës Juglindore. Pra, sintagma “çështja shqiptare” është përdorur për t’i ikur përdorimit të termeve identifikuese gjeografike Shqipëri dhe Kosovë dhe nuk ka konotacion tjetër. Tema e shqyrtuar në punim ka të bëjë me politikën e jashtme të SHBA-ve në raport me Shqipërinë dhe Kosovën, që rezulton të jetë përkrahëse për ty vendet në kontinuitet.

Natyrisht, kjo dukuri e paparë dhe e papërsëritur ishte një shtyerje shtesë për të hulumtuar këtë periudhë të zhvillimit të çështjes shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë dhe njohjen dhe rinjohjen e elitave politike dhe shoqërore e ushtarake, por edhe kullore e sociale në mes të shqiptarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, të cilat, për shkak të diktaturave të sistemeve komuniste dhe socialiste në Shqipëri dhe Jugosllavi, deri atëherë, nuk kishin arritur të bashkëpunojnë si komb në tërësi.

Interesimi tjetër shtytës ishte sprovimi që të gjej, apo thënë më mirë, të ndriçoj arsyet e implikimit aq të mëdha të SHBA-ve në këtë pjesë të Evropës Juglindore dhe në dobi të shqiptarëve. Dokumentet zyrtare të deklasifikuara si dhe veprat e analistëve të

marrëdhëniet ndërkombëtare dhe atyre ushtarake tregojnë se SHBA-të kanë pasur doktrinën të qartë të zëvendësimit të sistemeve komuniste dhe socialiste në Shqipëri dhe në Kosovë dhe se nuk i janë shmangur as mjeteve të dhunës për ta arritur këtë qëllim. Në aspektin social SHBA-të kanë arritur qëllimet e tyre për instalimin e demokracisë në Shqipëri dhe në Kosovë dhe për të zgjeruar fushën e dominimit ushtarak, dukë futur të dyja vendet nën ombrellën e NATO-s, Shqipërinë si anëtare fuqiplote, ndërsa Kosovën në formën e protektoratit ushtarak.

Duke vepruar në këtë mënyrë, SHBA-të ndikuan në doktrinën e Aleancës Veriatlantike NATO-s për të arritur qëllimin e lëvizjes së saj jashtë kufijve të vendeve anëtare “out of theatre operations” duke përdorur presedanin e ndërhyrjes ushtarake për të mbrojtur popullin e Kosovës, pa rezolutë eksplicite të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe duke vepruar në Afganistan dhe Irak me anë të koalicioneve të definuara nga qëllimet e misioneve ushtarake e jo anasjelltas.

Pas rënies së Murit të Berlinit, më 1989, dhe pushimit të ekzistimit të BRSS-së më 1991, bashkësia ndërkombëtare në mënyrë gati euforike e proklamoi mposhtjen e komunizmit dhe të socializmit si dhe mundësinë për të krijuar një rend të ri shoqëror botëror që do të ishte më i mirë dhe ku resurset do të distribuoheshin në zhvillimin e shoqërisë, pasi që bota tashmë hynte në një moment, (tani mund të përkufizohet si moment jo faze), unipolar me SHBA-të si fuqi globale dhe e pakontestueshme. Megjithatë, dezintegrimi i dhunshëm i Jugosllavisë vendosi para vendimmarrësve evropianë dhe amerikanë sfida të reja të sigurisë që ishin rrjedhojë e konflikteve etnike apo konfrontimeve të popujve të tjerë kundër hegjemonisë serbe të përkrahur nga mekanizmat dhe potenciali i jashtëzakonshëm ushtarak i Armatës Popullore të Jugosllavisë që u vu në shërbim të nacionalizmit dhe hegjemonisë serbe. Lëshimet diplomatike që tregoi Bashkimi Evropian dhe fillimisht edhe administrata amerikane, rezultuan në problem më të madh në politikën e jashtme të SHBA-ve duke marrë parasysh edhe ashpërsinë e konflikteve në Jugosllavi dhe nivelin përdorimit të armatimit konvencional. Pra, përpjekjet diplomatike për të futur palët ndërluftuese në procese negociatore aspak nuk e ndalën hovin e forcave të armatosura në terren që

përpos luftimeve bënin edhe pastrime etnike të popullatës, të ngjashme me veprimet naciste dhe të programit “Final Solution” për çështjen hebreje.

Në territorin e krizave të Ballkanit, SHBA-të janë të pranishme në mënyrë aktive, qoftë me mjete diplomatike dhe ushtarake për rreth njëzet vjet. Në zgjidhjen e problemeve të krizave dhe të stabilizimit të rajonit, në kontinuitet, kanë zbatuar një sistem të instrumenteve diplomatike, politike dhe ushtarake. Intensiteti i implikimit të SHBA-ve varej nga madhësia e krizave, e në një masë edhe nga interesimi i administrave që janë udhëhequr nga paineresimi fillestar i Presidentit George H. Bush (1989-1993), drejt interesimit dhe lidhshimit të Presidentit Bill Clinton në dy mandate (1993-1997; 1997-2001), e deri te George W. Bush, i cili në dy mandatet e tij (2001-2005; 2005-2009), në kushte të unilateralizmit amerikan, e përfundoi procesin e dekompozimit të Serbisë me pranimin e Malit të Zi dhe Kosovës si shtete të pavarura dhe pranimin e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë si anëtare fuqiplota të NATO-s. Pa marrë parasysh mënyrën dhe stilin e veprimit të të tre Presidentëve amerikanë, pa dyshim, mund të konstatojmë se ata vepruan me një kontinuitet politik kundrejt Evropës Juglindore në të cilën, përgjatë destabilitetit njëzetvjeçar, kanë vendosur dominim të fortë rajonal, të bazuar në angazhimin ushtarak me anë të së cilit përfunduan konfliktet, ndërsa si pasojë ndodhi edhe të ndikimi i fuqishëm në vendet e rajonit të papërfshira drejtpërsëdrejti në konflikte.

Kjo përpjekje e disertacionit të doktoratës shqyrton aspektet kryesore të veprimit diplomatik dhe ushtarak të SHBA-ve në Evropën Juglindore, me Shqipërinë dhe Kosovën në veçanti, si dhe nivelin e ndikimit të SHBA-ve përgjatë periudhës së tranzicionit nga njëri sistem qeverisës në tjerin. Qëllimi i politikës së SHBA-ve ka qenë ndryshimi i formës qeverisëse në rajon, duke cytur sa më shumë angazhimin e BE-së në të njëjtin qëllim, por që shpeshherë kishte vepruar me kujdes për shkak të implikimeve dhe aleancave të mëhershme historike.

Nëse analizohet qartë dezintegrimi i Jugosllavisë, atëherë roli amerikan ishte i pazëvendësueshëm dhe vendimtar duke filluar prej Marrëveshjeve bilaterale për shfrytëzimin hapësirës ajrore dhe detare me Republikën e Shqipërisë, vendosjen e forcave ushtarake parandaluese në Maqedoni, veprimeve të drejtpërdrejta ushtarake

në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë, pastaj përpjekjet për stabilizimin dhe demokratizimin e vendeve të Evropës Juglindore duke i integruar në NATO dhe BE. Kështu që, në këtë punim jam përpjekur të dëshmoj se udhëheqja amerikane ka vendosur mënyrën e zgjidhjes së konflikteve në pjesën e ish-Jugosllavisë, ndërsa ka ndikuar në stabilizimin e rajonit përgjatë procesit të tranzicionit ekonomik dhe politik në rastet e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë.

Përderisa Ballkani Perëndimor apo Evropa Juglindore si emërtim politik janë konstruksion i byrokracisë së Bashkimit Evropian, politika amerikane, për shkak të interesave gjeopolitike globale, këtë rajon e pranon më gjerësisht, duke pranuar dallimet që kanë popujt dhe vendet si dhe mirëkupton vështirësitë për vendosjen e reformave politike dhe ekonomike në këtë hapësirë. Me anë të këtij disertacioni kam provuar të hulumtoj sa më shumë jo vetëm mënyrën se si konceptohet politika zyrtare amerikane për rajonin në përgjithësi e Shqipërinë e Kosovën në veçanti, por jam fokusuar në një moment historik (1989-1999) duke e cilësuar si më të rëndësishmin për studim.

Natyrisht, kjo është vetëm përpjekje sepse fusha e studimit dhe hulumtimit nuk është shterruar edhe për faktin se arkivat zyrtare, që reflektojnë politikën e jashtme amerikane dhe përpjekjet diplomatike, nuk janë aq të hapura dhe duhet të pritët edhe më tej për të pasur një tablo më të gjerë dhe më të qartë. Prandaj, kjo temë edhe për shumë kohë do të jetë interesante për studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare, të diplomacisë, të veprimeve ushtarake dhe politike, dhe, me hapjen e arkivave do të kompletohet e vërteta historike për zhvillimet turbulente për Shqipërinë dhe për Kosovën në fund të shekullit XX, por edhe të rajonit të Evropës Juglindore.

Qëllimi i tezës së disertacionit dhe i punës ishte vrojtimi i rolit të politikës së jashtme të SHBA-ve dhe hetimi se si u reflektua ajo në çështjet, shpresat, përpjekjet shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë në fund të shekullit XX. Duke marrë parasysh se agjendat amerikane të stabilizimit, ndërrimit të sistemeve qeverisëse dhe promovimit të tregut të lirë, u përcollën me periudha të konflikteve të përgjakshme civile dosmosdoshmërisht kërkohej rikalibrimi i raporteve diplomatike me Rusinë, por edhe me aleatët në Bashkimin Evropian. Analistët pranë administratave amerikane e kishin

detyrë permanente për të hulumtuar çështjet dhe fuqinë gjeopolitike, gjeostrategjike dhe gjeoekonomike të vendeve të Evropës Juglindore, pastaj rolin e SHBA-ve në rendin e ri botëror, raportet me Rusinë dhe BE-në në kontekstin unipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare, qëllimet e vendeve të rajonit dhe aftësitë e tyre për të miratuar reformat demokratike dhe ekonomike për t'u përafshuar me standardet dhe vlerat civilizuese të vendeve të rrethit euroatlantik.

Qëllimi kryesor analizues në këtë disertacion përmbahet në elaborimin e ndikimit amerikan në përfundimin e konflikteve pranë Kosovës dhe Shqipërisë, pra në ish-Jugosllavi, krijimit të marrëveshjeve paqësore, stabilizimit dhe transformimit të rajonit përgjatë veprimit njëzetvjeçar diplomatik, politik dhe ushtarak në Evropën Juglindore.

Punimi ka një hipotezë kryesore që bazohet në supozimin se SHBA-të kanë marrë rolin udhëheqës të proceseve në rajonin e Evropës Juglindore në vitin 1993 pasi Bashkimi Evropian dhe instrumentet e tij nuk ishin në gjendje të frenojnë tendencat nacionaliste për shtrirje të konflikteve përtej kufijve të shteteve të dala nga Jugosllavia. Me anë të veprimeve ushtarake dhe diplomatike, që kanë qenë vendimtare për përfundimin e konflikteve, duke kërkuar gjithnjë zgjidhje paqësore, duke u përpjekur të stabilizojnë rajonin dhe duke formësuar proceset e tranzicionit në ish-Jugosllavi dhe shtetet e dala nga kjo Federatë si dhe në Shqipëri, SHBA-të, me këto metoda që kompletin njëra-tjetrën, kanë ndikuar edhe në veprimin e Qeverive të shteteve të reja, të krijuara më dezintegrimin e Jugosllavisë, por edhe vendeve të tjera të rajonit. Me analizën e hipotezës është bërë përpjekja për ta vërtetuar atë dhe për të vërtetuar se zhvillimet e politikës së SHBA-ve kanë ndikuar në rajon, por edhe kanë ndryshuar në rastet jashtë rajonit, gjithnjë si pasojë e mësimave nga angazhimi në rajonin e Evropës Juglindore.

Hipoteza themelore degëzohet:

- 1. Për shkak të prioriteteve të tjera të politikës së jashtme, administrata e Presidentit George H. Bush ka treguar izolacionizëm, pasivitet dhe ka humbur rastin që të marrë rol udhëheqës gjatë procesit të dezintegrimit të Jugosllavisë*

që në fillim të krizës. Konfliktet e nisura në vitin 1991 nuk u morën si prioritet nga kjo administratë, e cila fillimisht ishte shprehur pro integritetit territorial të RSFJ-së. Iniciativa diplomatike u la nën udhëheqjen e BE-së dhe strukturave të OKB-së. Kështu, kjo administratë merr një masë përgjegjësie për lejimin e përhapjes së konflikteve të armatosura, që filluan në Kosovë në vitin 1989, por që furishëm shënohen në vitin 1991

- 2. Qëndrimi krejt i ndryshëm i Presidentit Bill Clinton ka qenë pikë kthese në krizën në Jugosllavi. Duke i përkrahur veprimet diplomatike me force, Presidenti Clinton kishte hapur rrugën e stabilitetit të rajonit dhe rritjes së ndikimit gjeopolitik të SHBA-ve në rajon.*
- 3. Liderhipi amerikan në Bosnjë dhe Hercegovinë si dhe sukcesi i operacioneve luftarake në Kosovë, ishin baza e ndryshimeve demokratike në Kroaci, pas vdekjes së Presidentit Tudjman si dhe në Serbi, me mposhtjen e Presidentit Millosheviq.*
- 4. Duke mos ndryshuar strategjinë e “intervenimeve humanitare” të patentuar nga Presidenti Clinton, Presidenti George W. Bush vazhdoi “të përfundojë punët” në Ballkanin Perëndimor duke njohur Malin e Zi dhe Kosovën si shtete të pavarura dhe duke inkuadruar Shqipërinë dhe Kriacinë në NATO, përderisa Maqedonia ende është një ndër prioritetet e politikës së jashtme amerikane në rajon.*
- 5. Pasi siguria energjetike po bëhet prioritet i vendeve evropiane, rëndësia e Evropës Juglindore si pjesë e pakalueshme e projekteve energjetike që vijnë nga Kaukazi dhe Azia Qendrore, rritet çdo herë. Besohet se për këtë shkak edhe administrat e Presidentit Obama, por edhe pasardhësit e tij do ta ruajnë balansin dhe do t'i mbrojnë dhe ndihmojnë aleatët në këtë pjesë të Evropës, ku hyjnë edhe Shqipëria dhe Kosova.*

Metodologjia e punës në këtë punim është integrale apo e përgjithshme, e cila aplikohet në hulumtimet në shkencat shoqërore duke i adaptuar ato në qëllimet

kryesore për zhvillim e hipotezës dhe pjesëve të saj. Në kuadër të kësaj analize është përdorur:

- 1. Metoda deskriptive, pra përshkrimi i situatave, fakteve, dukurive, ngjarjeve, proceseve, ligjshëria e tyre, lëvizjet shkak-pasojë, të cilat janë standarde të përgjithshme në hulumtimin e kësollojshme. Pikërisht me përshkrimin e situatave dhe akterëve, prejardhjen e tyre historike dhe politike, më lehtë shpjegohen veprimet e tyre në kontekstin e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore*
- 2. Metoda e analizës paraqet metodën kryesore që është zbatuar në të gjithë kapitujt e punimit. Me analizën strukturale të ngjarjeve dhe proceseve, të përmbajtjes së dokumenteve zyrtare apo të raporteve nga takimet, të paraqitjeve publike të akterëve kryesorë të jashtëm dhe lokalë, shpjegohet ndikimi në kohë të secilës administratë të SHBA-ve në zhvillimet në Evropën Juglindore, në Shqipëri dhe në Kosovë në veçanti. Poashtu, analizohen raportet SHBA, BE, Rusi që kanë qenë domethënëse në zhvillimet në rajon. Burim i rëndësishëm janë analizat dhe punimet e publikuara më parë, të cilat prekin temën e zgjedhur në këtë punim. Poashtu, me vëmendje janë të analizuar raportet diplomatike dhe ato mediale.*
- 3. Metoda e analizës komparative ndihmoi që faktet e gjetura në punimet dhe shkrimet e huaja t'i krahasojmë me ato që i kemi gjetur për t'i përafëruar me hipotezat e shtruar në punim*
- 4. Metoda e provës dhe kundërshtimit është përdorur disa herë me qëllim të theksimit të disa segmenteve, nganjëherë të cytura nga agjenda personale, të politikës së jashtme amerikane ndaj rajonit, Shqipërisë dhe Kosovës, që kanë qenë vendimmarrëse për stabilizimin dhe tranzicionin e Evropës Juglindore.*
- 5. Me metodën e parashikimit janë trajtuar zhvillimet e ardhshme, jo vetëm të vendeve të rajonit, Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe vetë SHBA-ve si dhe doktrinat e NATO-s për të ardhmen.*
- 6. Metoda e sintezës është treguar e suksesshme për të vërtetuar faktet dhe proceset, të cilat janë hulumtuar në vazhdimësi të këtij punim. Posaçërisht kjo metodë është përdorur në kapitullin e fundit ku jemi përpjekur të japim*

konkludimet që bazohen në trendet zhvillimore të rajonit, Shqipërisë dhe Kosovës.

Ky punim, në strukturën e tij, ka katër kapituj. Në kapitullin e parë janë shqyrtuar raportet SHBA-Shqipëri prej viteve 1989-1997, por paraprakisht, në kronologjinë e ngjarjeve para kësaj periudhe, janë përmbledhur raportet që prej krijimit të shtetit shqiptar e deri para rënies së sistemit komunist. Në këtë kapitull po ashtu përshkruhet një ecje jostabile e Shqipërisë edhe në raport me rrethanat e brendshme, por edhe me SHBA-të dhe kapitulli mbyllet me zgjedhjet e vitit 1996, pasojat e tyre dhe fillimin e krizës tragjike në Shqipëri që do të ndodhë një vit më vonë. Ndonëse mbulon një hapsirë relativisht të madhe kohore shtjellohet pozita e Shqipërisë, që në atë kohë ishte nwn ndikimin, apo pjesë e agjendave imperialiste Perëndimore dhe Lindore. Në te njëjtën kohë vetë Shqipëria po kalonte një tranzicion të madh socio-kulturor, të fillemeve të para të industrializimit, lëvizjeve dhe partive politike me qëndrime krejtësisht të ndryshme. Në këtë kapitull fokusi është më shumë në raportet e SHBA-ve kundrejt zhvillimeve politike dhe ekonomike në Shqipëri se sa tranzicioni nga një shtet i sapoformuar, në një monarki autoritative drejt diktaturës komuniste. Në këtë kapitull theksohet ndihma që SHBA-të i dhanë pakursyeshëm Shqipërisë në ndërrimin e sistemit politik njëpartiak në sistem të demokracisë parlamentare. Kjo ndihmë ishte dydrejtimëshe: në njërin anë SHBA-të ndihmonin krijimin dhe nryshimin e klimës investuese në Shqipëri për të ngritur ekonominë e saj, ndërsa në anën tjetër e ndihmonin fuqimisht Shqipërinë në ngritjen e imazhit të saj ndërkombëtar dhe përafrimit me strukturat e NATO-s dhe BE-së.

Në kapitullin e dytë janë shqyrtuar raportet e Kosovës me SHBA-të në të njëjtin aspekt kohor, për të vazhduar me ndihmën në krijimin e partive dhe organizatave humanitare si dhe përpjekjet e diplomacisë së SHBA-ve që të evitojnë luftën e hapur në Kosovë. Në këtë kapitull pasqyrohen raportet shqiptaro-serbe në shekullin e XX në mënyrë që lexuesi apo studjuesit potencialë të kuptojnë gjenezën e problemit të dy kombeve. Studjuesit e shumtë kryesisht ndërkombëtarë problemin e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Serbisë e thjeshtësojnë me sintagmën “urrejtja qindvjeçare shqiptaro-serbe”. Ky vlerësim natyrisht është sipërfaqësor dhe simplifikim i

problemit. E vërteta është se shqiptarët e Kosovës kanë qenë viktime të planeve të kalkuluar serbe për eliminimin fizik të tyre, shpërnguljen nga Kosova, dhe kolonizimin e saj me serbë nga viset e tjera për të ndërruar strukturën demografike të Kosovës në mënyrë që lidhja gjeostrategjike me Greqinë, përmes Maqedonisë, të jetë e sigurtë. Në këtë kapitull shpjegohet ndikimi i drejtëpërdrejtë i SHBA-ve në krijimin e partive të para politike në Kosovë me platforma anti-komuniste si dhe marrja graduale e Kosovës nën protektoratin ushtarak dhe diplomatik amerikan. Në këtë kapitull shtjellohet rezistenca paqësore e shqiptarëve të Kosovës, organizimi i institucioneve shtetërore të shërbimeve esenciale si policia, mësimi në të gjitha nivelet, përkujdesja shëndetsore të gjitha të financuara nga sistemi i mbledhjes së taksave individuale dhe nga bizneset të mbledhura në mënyrë vullnetare. Poashtu, në këtë kapitull trajtohen veprimet paradiplomatike të Kosovës e cila arriti të jetë e përfaqësuar dhe e mbështetur në kërkesat e saj nga Washingtoni dhe Brukseli e deri në Selinë e Shenjtë. Në këtë kapitull shpjegohet edhe qëndrimi i Kosovës në raport me luftërat 1991-1995 në ish-Jugosllavi. Qëllimi nuk ka qenë vetëm të shpjegohet se pse shqiptarët e Kosovës nuk kanë arsye të përfshihen në luftën serbo-kroato-boshnjake, por të shpjegohet verimi i politikës së jashtme të SHBA-ve gjatë kësaj periudhe. Sepse, e njëjta administratë nga pasojat e veprimeve apo mosveprimeve na kohë të duhur kundër hegjemonisë serbe, do të jetë më vigjilente në rastin e Kosovës. Ky kapitull përfundon me filltet e krizës Post-Dejtoniane dhe paraqitjen e elementeve që pretendonin luftën e armatosur si mundësi për arritjen e kërkesave të shqiptarëve për liri dhe pavarësi në Kosovë.

***Në kapitullin e tretë** bashkëdyzohen lëvizjet në Shqipëri dhe në Kosovë, shpërthimi i revoltës popullore në Shqipëri, organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kosovë dhe jashtë saj, dështimi i përpjekjeve diplomatike në Rambuje dhe Paris dhe fillimi i bombardimeve të NATO-s mbi Serbinë. Në këtë kapitull shpjegohen arsyet e përkeqësimit të raporteve të qeverisë së Shqipërisë me SHBA-të, revolta popullore që nga shumë analistë konsiderohet si luftë civile, në vitin 1997, për shkak të numrit të lartë të viktimave dhe rënies gati totale të institucioneve shtetërore, posaçërisht atyre të sigurisë. Si rezultat erdhi ndërrimi i qeverisë së Shqipërisë dhe përmirësimi i raporteve me SHBA-të. Në rastin e Kosovës, në këtë kapitull shpjegohet korrelacioni i*

ngjarjeve të Shqipërisë 1997 me fillimin e luftës në Kosovë, që intensitetin më të madh e kishte në vitet 1998-1999. SHBA-të e kishin të njohur problemin e Kosovës, zgjidhjen e të cilit qëllimisht e kishin lënë jashtë Konferencës së Dejtonit. Ky kapitull fokusohet në veprimet diplomatike dhe ushtarake të aleatëve, në krye me SHBA-të për të ndalur një konflikt që po shëndërrohej nga një konflikt i pastërt shqiptaro-serb në konflikt ballkanik. Në këtë kapitull shpjegohen rrjedhat dhe prapaskenat e Konferencës së Rambujesë, rivalitetet politike brenda shqiptare, rivalitetet politike brenda amerikane, si dhe përkrahjet teza me fakte të mjaftueshme se SHBA-të janë përpjekur për zgjidhje diplomatike, por janë bërë gati për bombardimin e Serbisë. Ky operacion ushtarak i koduar “Operation Allied Force” shqyrtohet në detaje në këtë kapitull. Poashtu, në këtë kapitull shpjegohet vendosshmëria e administratës së SHBA-ve që të shkojë deri në fund në largimin e forcave serbe, që kishin kryer krime monstruoze në Kosovë, largimin e administratës së instaluar të Beogradit për të qeverisur Kosovën edhe me kusht të përkeqësimit të raporteve me Rusinë.

Në kapitullin e katërt, pasqyrohen përpjekjet më pak të njohura diplomatike për t'i dhënë fund bombardimeve, por edhe pretendimeve serbe mbi Kosovën. Në këtë kapitull shqyrtohen edhe ndryshimet që kanë pasuar në politikën e jashtme të SHBA-ve dhe ndërrimet e doktrinave të NATO-s për vendosjen e forcave jashtë vendeve anëtare si dhe më e rëndësishmja: perspektiva që u hap për Kosovën dhe Shqipërinë për të qenë pjesë e organizatave prestigjioze dhe vitale për ekzistencën e dy vendeve ende në tranzicion me ekonomi fragjile, por anëtare të NATO-s (Shqipëria fuqiplote, Kosova de-facto) si dhe në Bashkimin Evropian ku rruga e trasuar vetëm duhet të ndiqet nga elitat politike në Tiranë dhe në Prishtinë.

Në përfundim, por jo nga rëndësia, dua të falenderoj Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Filologjisë dhe Historisë, që ka shprehur besimin në mundësitë e mia për ta shqyrtuar një temë kaq të rëndësishme dhe më ka vënë në dispozicion të gjitha kushtet më të mira të mundshme për të bërë një hulumtim apo përpjekje të sukseshme. Një falenderim të veçantë ia dedikoj udhëheqëses së punës sime përgjatë gjithë kohës, Prof. Dr. Valentina Duka, e cila me përkushtimin, qasjen profesionale, pastaj me urtësi dhe mençuri ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, bregat dhe nevojat e mia duke e

bërë idenë time themelore më të saktë, më precize, më të kompletuar dhe më të formësuar, më depërtuese dhe më të vlefshme në aspektin pedagogjik dhe profesional. Një falenderim të veçantë e kam për Prof. Dr. Ilira Çausi, e cila më ka inkurajuar jo vetëm të vazhdoj me këtë punim, por edhe të vazhdoj që përqëndrimin dhe talentin për hulumtime dhe krahasime të vazhdoj ta zhvilloj edhe më shumë përgjatë karrierës pedagogjike dhe ta komplementoj me vepra studimore e hulumtuese. Së fundi një ndihmë të çmueshme më ka dhënë Profesor Dr. Petrit Nathanailli i cili me dashamirësi dhe profesionalizëm më ka orientuar më ka korrigjuar për të realizuar një punim sa më cilësor.

HJRJE

Në të gjitha hulumtimet që bëjnë ekspertët e kompanisë me renome ndërkombëtare për hulumtime Gallup International¹ shqiptarët, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, me vite të tëra, dalin populli më pro-amerikan në këtë pjesë të Evropës, ndërsa përkrahja për politikën e jashtme amerikane kapërcen shifrën 90% pro. Në kohën kur në botë mbizotëron një formë e kriticizmit të çdo gjëje amerikane, posaçërisht në Amerikën Latine, por edhe disa pjesë të Evropës, shtrohet pyetja nëse kjo përkrahje është vazhdimësi e përkrahjes që Shqipëria e dikurshme e kishte për BRSS-në e Kinën si superfuqi apo tashmë ekzistim një sentiment tjetër gjykuar edhe nga fakti se rezultatet janë gati identike edhe në Kosovë, ku elementet nacionaliste anti-jugosllave dhe anti-komuniste kanë ekzistuar edhe në kohëra të represionit të madh serb. Një gjë është e vërtetë, ndonëse në shikim të parë duket konstatim i vrazhdë se shqiptarët kanë shumë arsye të mos u besojnë fuqive evropiane dhe Ruisë për shkak të historisë që e ka përcjelluar krijimin e shteteve të dominuara nga shqiptarët, Shqipërisë dhe Kosovës. Të dy këto entitete shtetërore janë krijuar dhe njohur pas luftërave të përgjakshme me fqinjët pa ndihmën evropiane, bile-bile në raste ka pasur ndihmë për palët e tjera që i dëshironin tokat shqiptare, por pa shqiptarë. SHBA-të në fillim dhe fund të shekullit XX, në dy rastet vendimtare, ishin faktori themelor për ngritjen e shtetësisë së Shqipërisë dhe çlirimin e Kosovës, të cilën në shekullin XXI e drejtuan drejt pavarësisë që e gëzon sot.

Edhe në periudhën pas Luftës së Ftohtë, ishin shqiptarët të parët që përqaftuan, qoftë deklarativisht, qoftë në vepër, sentimentin pro-amerikan në organizimin shtetëror dhe promovimin e demokracisë në Shqipëri, si dhe në krijim e partive të para demokratike në bllokun e Lindjes, siç ishte rasti me Lidhjen Demokratike të Kosovës, të krijuar në dhjetor 1991². Pas zhytjes së Ballkanit në luftëra të reja, të cilat motivet i kishin të

¹ <http://www.gallup-international.com> (16.03.2013)

² Jusuf Buxhovi, *Kthesa historike-Vitet e Gjermanisë dhe Epoka e LDK-së*, (Prishtinë: Faik Konica 2008), f. 226

vjetra dhe të njohura për popujt e Ballkanit, dhe përkushtimit diplomatik dhe ushtarak amerikan për përfundimin e tyre, rezultati final shqiptarët i nxori fitimtarë dhe prej atëherë sentimentin pro-amerikan nuk ka pasur rënie, ndërsa kredibiliteti i politikës së jashtme ka pasur ngritje edhe më të madhe në sytë e shqiptarëve. Pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 populli shqiptar reagoi me empati ndaj humbjeve amerikane. Republika e Shqipërisë, pa mëdyshje, u shpreh se do të bashkëpunojë me SHBA-të në koalicionin kundër terrorizmit, duke dërguar forca që edhe tani shërbejnë në fushëbetejat e Irakut dhe Afganistanit. Së fundi, edhe Kosova dhe Shqipëria janë zotuar se do të përbëjnë koalicionin e ndërtuar për të parandaluar rritjen dhe në fazën tjetër eliminin e Shtetit Islamik që është shpallur në territorin e Irakut dhe të Sirisë.

Përkrahja e shqiptarëve ndaj SHBA-ve daton me përpjekjet e tyre për të krijuar shtetin shqiptar me rënien e Perandorisë Otomane në Ballkan. Shqipëria u shpall shtet nga shqiptarët në vitin 1912, por, në të vërtetë, u deshën edhe tetë vite të tjera dhe një Konferencë Ndërkombëtare që ajo të ketë të gjitha garancionet dhe kufijtë e saj të jenë të paprekur. Pasi që dolën nga Lufta e Parë Botërore si vendi me prodhimin më të lartë në botë, larg shkatërrimeve që kishin goditur kontinentin dhe e udhëhequr nga Presidenti Vudro Villson, SHBA-të hynë në skenën ndërkombëtare si element i pakalueshëm në vendimmarrje. Gjatë Konferencës së Parisit, Presidenti Villson promovonte parimet e lirisë dhe të vetëvendosjes për popujt që kishin daluar nga rënia e tri Perandorive: Otomane, Austro-Hungareze, Ruisë-Cariste. Edhe më pare, ai kishte shprehur idetë e tij për lirinë, duke kritikuar imperializmin evropian që tërë Luftën e Parë Botërore e kishte bërë për interesa të Monarkive. Presidenti Villson paraqiti në Kongres, më 22 janar 1917, në fjalimin e tij, konceptin “paqe pa fitues”³, dhe një vit më vonë, më 8 janar 1918, në të cilin i renditi 14 pika bazë që duhej të respektoheshin për të mos pasur më konflikte ndërkombëtare. Tezat kryesore ishin: Lidhja e Kombeve, liria dhe vetëvendosja për popujt dhe vendet e vogla që nuk kanë nevojë më për patronat të një superfuqie, por bëhen pjesë e konceptit të sigurisë kolektive ndërkombëtare duke flakur marrëveshjet bilaterale dhe aleancat e fshehta që

³ Për më shumë, Knock, Thomas *To end all wars: Woodrow Wilson and the Quest for a New World Order*, (Princeton: University Press. Reprint 1995)

kishin mbizotëruar në Evropë për gati dy shekuj. Ky plan ishte në favor të Shqipërisë, por më e rëndësishmja ishte në disfavor të fqinjëve të saj që donin ta copëtonin territorialisht.

Për shkak të pozitës së volitshme gjeografike, Shqipëria gjithnjë ka qenë e rrezikuar nga pushtues të ndryshëm dhe ka një histori të gjatë të dominimit të të huajve.⁴ Ballkani përherë ka qenë rajon jostabil dhe Shqipëria nuk ishte përjashtim, por ishte cak i sulmeve të parreshtura të fqinjëve edhe pas shpalljes së pavarësisë së saj.⁵ Menjëhërë pas shpalljes në Vlorë, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, maj 1913, nën presionin e fqinjëve të Shqipërisë, punimet e Konferencës u mbyllën në dëm të saj. Marrëveshja e Londrës la territore të shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore nën sundimin e Serbisë, ndërsa jugun e Shqipërisë e mori Greqia. Serbia kishte për qëllim daljen në Detin Adriatik në portin e Durrësit. Por, për fat, kjo nuk iu mundësua, ngase Austro-Hungaria dhe Italia ishin në dijeni se një port i tillë do të ishte port rus në Adriatik. Në janar të vitit 1920, në Konferencën e Parisit, fuqitë evropiane, në mungesë të negociatorëve amerikanë, vendosën ta ndajnë Shqipërinë në mes të Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë. Shqiptarët u organizuan për të mos pranuar asesi një ndarje të tillë dhe krijuan Asamblenë Kombëtare Shqiptare, në Kongresin e Lushnjës, ku përpos ndarjes proporcionale të përfaqësimit, u caktua edhe një vend deputeti për komunitetin Shqiptaro-Amerikan që ishte mjaft i numërt në SHBA. Presidenti Villson vendosi që në mars të vitit 1920 ta pranojë Shqipërinë në kufijtë ekzistues duke sfiduar Marrëveshjen e Parisit dhe evropianët. Të njëjtën gjë e bëri edhe Lidhja e Kombeve në dhjetor 1920 dhe me këtë filloi një epokë e re e raporteve Shqipëri-SHBA. Ato u jetësuan në formë diplomatike në vitin 1921, kur delegacioni shqiptar u takua me Ambasadorin e SHBA-ve në Romë, ku përpos të tjerash kompanive amerikane u mundësohej hulumtimi dhe e drejta e koncesionit për rezervat e naftës në Shqipëri. Sekretari i Tregtisë, Hoover udhëzoi Sekretarin e Shtetit

⁴ Për më shumë, Stefanaq Pollo dhe Arben Puto: *The History of Albania - From Its Origins to the Present Day*, (London: Routledge 1981)

⁵ Paul Lendvai, *Eagles in Cobwebs: Nationalism and Communism in the Balkans*, (Garden City New York: Double Day Company), 1969

të marrë parasysh këto zhvillime dhe të merret në mbrojtje preferenciale Shqipëria pikërisht për shkak të bashkëpunimit ekonomik.⁶

Më 28 korrik 1922, SHBA-të e pranuan edhe de-jure Shqipërinë duke dërguar emisarin U. Grant-Smith në Tiranë duke filluar marrëdhëniet bilaterale në mes të dyja vendeve. Në të njëjtën kohë, Ahmet Zogu u caktua Kryeministër i Shqipërisë. Por, këto nuk ishin edhe kohëra të stabilitetit politik. P.sh. prej korrikut e deri në dhjetor 1921, Shqipëria kishte ndërruar pesë kryeministra. Një seri rrethanash negative, vrasja e dy turistëve amerikanë, më 6 prill 1924, në pjesën veriore të Shqipërisë, vrasja e Avni Rrustemit, politikan prominent, më 5 maj të po atij viti, krijoi kushtet e një revolucioni, i cili e solli Fan S. Nolin, Peshkopin Ortodoks të shkolluar në Harvard, në krye të Shqipërisë, ndërsa Zogun e dërgoi në ekzil. Por, qeveria e tij llogaritej kuazi-e majtë dhe apeli i tij drejtuar Ruisë Sovjetike nuk ishte i mirëseardhur as i mirëpritur për SHBA-të. Ato mbajtën raportet me Shqipërinë, por sipas qëndrimeve të Sekretarit të Shtetit Hughes “nëse nuk ndërrohet kreu i Qeverisë, çështja e njohjes së Shqipërisë mbetet e hapur.”⁷ Para Krishtlindjeve, Zogu u kthye nga ekzili së bashku me përkrahësit e tij dhe me mbi 1000 forca të rregullta jugosllave dhe ruse e rrëzoi Qeverinë e Nolit. Më 1 shkurt 1925, Zogu u bë President i Shqipërisë dhe duke e ditur rëndësinë e SHBA-ve e dërgoi emisar në SHBA Faik Konicën, një lider prominent të Lëvizjes Kombëtare. Konica ishte zyrtari i parë shtetëror në SHBA dhe ndonëse ende pa përfaqësi të fiksuar diplomatike zhvillonte aktivitetet e tij pa ndaluar.

Më 1 shtator 1928, Zogu e proklamoi Shqipërinë Monarki dhe nën instruksionet dhe presionet italiane u kurorëzua Mbret i Shqipërisë. Këtë ndërrim e njohën SHBA-të si vullnet të vetë shqiptarëve duke hequr mëdyshjet e fqinjëve të Shqipërisë. Përfaqësuesi i SHBA-ve në Shqipëri, Hart, e dërgoi këtë mesazh për Mbretin, por edhe e njoftoi Departmentin e Shtetit për përkrahjen e madhe që gëzojnë SHBA-të në

⁶ Dokumenti i Sekretarit Hoover për Departmentin e Shtetit, Nr. 875.6363/21 26 Prill 1922 *Foreign Relations of the United States, 1922 Vol I f. 596*

⁷ Letra e Sekretarit Hughes për të dërguarin Grant-Smith. Document Nr. 875.01/243. Qershor 24, 1924. *The Foreign Relations of the United States, 1924 vol I 1943 f. 311*

Tiranë.⁸ Në këtë periudhë Shqipëria nënshkroi disa marrëveshje tregtare bilaterale me SHBA-të⁹. Në të njëjtën kohë fashizmi në Itali ishte në kulminacionin e zhvillimit dhe Shqipëria kishte qenë gjithërë në planet e Musolinit si tokë që duhej pushtuar. Ai e realizoi këtë në prill të vitit 1939. Një ditë para invazionit italian, Mbreti Zog, së bashku me familjen braktisën Shqipërinë dhe shqiptarët.¹⁰

Sulmi italian u denoncua nga Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, Cordell Hull përmes një deklaratë për shtyp.¹¹ Pas pushtimit italian në Tiranë u instalua një qeveri kukull fashiste, Monarkia shqiptare u shpërnda ndërsa fronti i Shqipërisë iu ofrua Mbretit Italian Victor Emmanuelit për të realizuar edhe formalisht Bashkimin Itali-Shqipëri më 16 prill 1939. Si reagim, SHBA-të më 12 qershor 1939 mbyllën përfaqësinë diplomatike në Tiranë dhe si rezultat u mbyll edhe ajo e Shqipërisë në SHBA. SHBA-të nuk i shkëputën anjëherë marrëdhëniet me Mbretin Zog, por edhe nuk e njohën Qeverinë në ekzil. Italia e përdori Shqipërinë për ta sulmuar Greqinë dhe së bashku me Gjermaninë naziste korrën fitore në Greqi dhe në Jugosllavi. Në maj 1941, Gjermania ia dorëzoi kontrollin mbi Kosovën Italisë dhe pjesët e Greqisë Veriore me popullatë shumicë shqiptare. Është ironike se ëndrra e shqiptarëve për bashkimin e trojeve të tyre u realizua përmes Fuqive të Boshtit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore raportet SHBA-Shqipëri morën një dimension tjetër me kryengritjen e shqiptarëve të armatosur, nën udhëheqjen e Lëvizjes Nacional-çlirimtare. SHBA-të ishin pro lëvizjeve të armatosura kundër forcave të Boshtit dhe prapë e shpëtuan Shqipërinë nga një kërkesë e çuditshme që erdhi nga Qeveria Greke për aneksimin e Shqipërisë Jugore (për grekët Vorio Epiri) të cilën Nën-Sekretari i Shtetit, Sumner Wells e refuzoi menjëherë si të pabazë.¹² Në Shqipëri kishte dy fraksione të armatosura që kishin dallime ideologjike: Balli Kombëtar - nacionalist

⁸ Letra e diplomatit Hart për Departmentin e Shtetit, Shtator 27, 1928. *The Foreign Relations of the United States 1928, 1943*

⁹ Marrëveshjen e Arbitraritetit, 1928 Marrëveshjen e Mirëkuptimit 1928, Marrëveshjen e Naturalizimit 1932, Marrëveshjen e Ekstradimit 1933

¹⁰ Stanley G. Payne, *A History of Fascism 1914-1945*

¹¹ New York Times, 9 prill, 1939

¹² *US Foreign Relations, 1942, Vol II, fq828-829*

dhe Lëvizja Nacionalçlirimtare - komuniste. Dallimet e tyre ideologjike ishin në plan të dytë për SHBA-të dhe aleatët e tjerë që ishin të interesuar për ta mposhtur Boshtin. SHBA-të në Shqipëri dërguan agjentët e OSS, organizatës paraardhëse të CIA-s, për të ndihmuar luftën kundër forcave fashiste dhe naziste. Kryesisht edhe agjentët anglezë kishin hyrë në Shqipëri me të njëjtin qëllim, por ata iu afruan më shumë partizanëve të LNÇ-së, sepse këta ishin më konkretë. Gjatë viteve 1943 dhe 1944 mbi 50 oficerë britanikë dhe disa amerikanë operonin në Shqipëri në ndihmë forcave që luftonin forcat e Boshtit.¹³ Pasi u bindën që Balli Kombëtar nuk ishte kooperativ, në verën e vitit 1943, SHBA-të ndërprejnë programin e furnizimit me armë, ndërsa oficerët anglezë u tërhoqën nga Shtabi i Ballit Kombëtar. Britanikët, në mes të vitit 1944 e inkurajuan udhëheqësin e partizanëve, Enver Hoxhën që të fillojë së krijuari Këshillin Çlirimtar Kombëtar dhe të bëhet gati për qeverisjen e Shqipërisë pas Luftës. Në tetor 1944, nga ky Këshill, pas intervenimit të Titos nga Jugosllavia, u emërua Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Hoxha kërkoi nga aleatët ta njohin qeverinë e tij. Në nëntor 1944, nga partizanët Shqipëria dhe u kërkua njohja formale nga SHBA-të. SHBA-të kishin shpresuar se edhe me këto zhvillime do të arrihej pajtimi në mes të forcave nacionaliste dhe atyre komuniste, por ajo nuk ndodhi. Udhëheqësit e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit braktisën Shqipërinë dhe fillimisht u vendosën afër portit të Brindisit në Itali. Hoxha kërkonte t'i dorëzoheshin atij, sepse i quante “kriminelë lufte”, por forcat amerikane në Itali nuk morën parasysh një kërkesë të tillë me arsyetimibn se çështja e “kriminelëve të luftës” duhej të vërtetohej e mëpastaj të rregullohej ekstradimi me marrëveshje të posaçme.¹⁴

Marrëdhëniet me regjimin e Hoxhës gjithmonë kanë qenë të ndieshme për amerikanët dhe gjithnjë ka ekzistuar një atmosferë e mosbesimit të ndërsjellë. Megjithatë, SHBA-të ishin më të kujdeshme se Britania e Madhe dhe nuk donin të krijonin mendim për forcën qeverisëse të Hoxhës pa e parë në vepër. Për dallim prej tyre, britanikët që

¹³ Që në vitin 1940 anglezët kishin krijuar ekipin “Special Operation Executive” me qëllim që të inkurajojnë forcat anti-Bosht në Shqipëri. Për më shumë Julian Amery *Sons of the Eagle: A study in Guerilla War.* (London: MacMillan 1948)

¹⁴ *US Foreign Relations, 1945, Vol IV, f. 42*

kishin qenë më afër Hoxhës i kishin parë ndikimet sovjetike dhe jugosllave në pikëvështrimet e tij dhe ishin tani pro largimit të tij nga pushteti edhe me mjete dhune.

Më 4 tetor 1945 u mbajt një takim konsultativ në Londër në “Foreign Office”, ndërmjet përfaqësuesve të Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve për të vendosur rreth pranimet të Shqipërisë dhe Qeverisë së Hoxhës. Ata u dakorduan që ta pranojnë Shqipërinë pas mbajtjes së zgjedhjeve të lira në vend. Mirëpo, veprim të kundërt bëri Bashkimi Sovjetik, i cili njohu Shqipërinë në krye me Hoxhën më 10 nëntor 1945. SHBA-të kishin edhe kushte të tjera përpos zgjedhjeve: që Shqipëria të respektojë marrëveshjet që kishte arritur Mbreti Zog me SHBA-të si dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike të varej nga hapat e parë të Hoxhës. Hoxha pranoi kushtin për zgjedhjet, të cilat do të monitoroheshin nga shtypi i lire, por pas fitores në zgjedhje në Shqipëri me rreth 93% të përkrahjes ai nuk pranoi të zbatonte marrëveshjet e Mbretit Zog.

Kështu, dalngadalë, Shqipëria rrëshqiti në Bllokun Sovjetik. Sepse vetë Britania e Madhe ishte më e përqëndruar të jetë e pranishme në Greqi, ndërsa SHBA-të, në politikën e jashtme të pasluftës, fare apo aspak nuk mendonin për Ballkanin sepse kishin zotime në Gjermani dhe në Japoni, që për ta ato ishin të rëndësishme vitale. Edhe ekonomikisht Shqipëria nuk ishte e vlefshme, sepse SHBA-të kishin më shumë tregti me Jugosllavinë, Bullgarinë dhe Rumaninë.¹⁵

Në vitet në vijim, Shqipëria më shumë mori kursin e Jugosllavisë dhe të Bashkimit Sovjetik kundrejt SHBA-ve. Gabime janë bërë edhe nga ana e SHBA-ve me neglizhimin e zhvillimeve në Shqipëri. Periudha 1945-1947 u tregua të jetë kruciale për Shqipërinë, sepse e vendosi në sferën sovjetike të influencës dhe automatikisht raportet me SHBA-të u ngrinë. Ato do të mbesin të tilla për dyzet vjet deri në rënien e komunizmit në vitet 1991-1992.

¹⁵ Bilanci tregtar me Shqipërinë në vitin 1939 ishte 280.000 USD, me Jugosllavinë 9 milionë USD, me Rumaninë 12 milionë USD sipas kartës së tregtisë së kohës Geir Lundestad *US Trade Assets in Eastern Europe before the war*, f. 478-479

Çështja e Kosovës, përkatësisht raporteve të acaruar shqiptaro-serbe ka rrënjë në pjesën e dytë të shekullit XIX. Edhe shqiptarët edhe serbët kanë pikëvështrimet e tyre kundërshtuese mbi atë se kush e ka të drejtën mbi Kosovën. Disa analistë problemin e analizojnë si një paralelë në mes të palestinezëve dhe hebrenjve apo luftë ndërmjet dy popujve për një territor.¹⁶ Kosova dikur ka qenë qendër e shtetit serb në mesjetë në kulminacionin e tij. Në këtë periudhë janë ndërtuar objektet më të rëndësishme kulturore dhe fetare serbe. Në vitin 1389 në Fushë të Kosovës janë ndeshur ushtria otomane me koalicionin kristian të dominuar nga serbët në betejën që otomanët e kanë fituar. Por, megjithë humbjen e shtetit të tyre dhe hyrjen në vasalitet me otomanët, kjo ngjarje është element i rëndësishëm i identitetit nacional serb.¹⁷ Në anën tjetër Kosova historikisht ka qenë hapësirë e dominuar nga shumica shqiptare. Nuk ka shënime të sakta se sa ka qenë raporti i popullatës shqiptare me atë serbe në mesjetë, edhe pse edhe atëherë shqiptarët ishin shumicë. Por, dihet pa dyshim se në kohën e Perandorisë Otomane shqiptarët ishin shumicë dominuese në Kosovë. Me dobësimin e Perandorisë Otomane dhe rritjen e apetiteve të vendeve të Ballkanit për t'u shkëputur nga kjo Perandori edhe shqiptarët artikulojnë qëllimet e tyre në Lidhjen e Prizrenit, të krijuar në vitin 1878. Nga perspektiva e sotme qëllimi themelor i Lidhjes ishte bashkimi i të gjithë shqiptarëve në një entitet, qoftë vilajet apo shtet i pavarur. Perandoria Otomane mposhti shqiptarët. Aneksimi i Kosovës nga Serbia ka ndodhur pas Luftës së parë Ballkanike ku përpos okupimit forcat serbe dhe malazise kanë kryer krime dhe kanë shpërngulur me dhunë popullatën civile shqiptare.¹⁸ Pas lirisë që erdhi si rezultat i okupimit të Serbisë nga Austr-Hungaria në vitin 1918 përkundër vullnetit të shumicës së popullatës Kosova ju bashkua Mbretërisë Srbe-Kroate-Slllovene. Për serbët ky akt ishte çlirim i Kosovës, ndërsa për shqiptarët ky ishte okupim klasik serb. Dhe, prej atëherë, marrë parasyh edhe programet shtetërore serbe për eliminimin e shqiptarëve nga Kosova, u bë e qartë se në Kosovë ballafaqohen dy nacionalizma që nuk do të lënë hapësirë për bashkëjetesë. Sipas disa analistëve serbë dhe kroatë prej atëherë ky

¹⁶ Tim Judah, *War and Revenge*, Yale University Press, (New Heaven 2000), fq.80

¹⁷ Millosh Knezheviq, *Ciklusi Kosovskog Mita, Nova Srpska Politicka Misao*, viti IV, (Beograd 1999), fq172

¹⁸ Noel Malcolm, *Kosovo: A short History*, (Pan Books 1998) , ff249-250

konflikt është konflikt permanent ndëretnik.¹⁹ Kosova nën pushtetin serb në mes të luftërave botërore ka përjetuar represion të jashtëzakonshëm, ndalimin e përdorimit të gjuhës shqipe, fushatën e kolonizimit serb, fushatën e shpërnguljes së shqiptarëve kryesisht drejt Turqisë. Qëllimi i Beogradit ishte thyerja e strukturës tradicionale shqiptare dhe ndryshimi i pasqyrës demografike të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës kanë rezistuar në fushatën që njihet si “Lëvizja Kaçake” që u mposht nga serbët në vitin 1924 ku besohet se janë vrarë deri në 10.000 shqiptarë kryengritës.²⁰ Lufta e Dytë Botërore dhe kapitullimi i Jugosllavisë ishte në favor të Kosovës. Me marrëveshjen e 22 prillit 1941 Kosova u nda në tri zona: gjermane, italiane, bullgare. Pjesa nën kontrollin italian ju bashkangjiti asaj gjermane në vitin 1943 duke unifikuar tokat shqiptare dhe veprimin e shqiptarëve në territorin e Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë vit filloi edhe fillimi i bashkangjities së shqiptarëve të Kosovës Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, ndonëse shumica kishin bindje anti-jugosllave.²¹ Në fund të këtij viti dhe në fillim të vitit 1944, në “Konferencën e Bujanit” Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës mori vendimin që Kosova të bashkohet me Shqipërinë. Ky vendim u kundërshtua nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, por e vërtetoi se pa marrë parasysh se a janë pjestarë të Ballit Kombëtar apo LNÇ-së shqiptarët e Kosovës kanë qëllim bashkimin e tokave shqiptare në një entitet.²² Kryengritjen e pasluftës në Kosovë, kryesisht në rajonin e Llapit dhe Drenicës, e udhëhoqi “Balli Kombëtar” dhe kjo kryengritje u shua nga forcat partizane serbo-malazeze përfundimisht në fillim të viteve 1950. Menjëherë pas shuarjes së rezistencës shqiptare Jugosllavia socialiste ndërmoi të njëjtën politikë të represionit ndaj shqiptarëve të Kosovës si edhe Jugosllavia e Parë. Në vitin 1953 Jugosllavia dhe Turqia nënshkruan Marrëveshjen për shpërnguljen e shqiptarëve drejt Turqisë. Historia e shqiptarëve të Kosovës në Jugosllavinë socialiste, pa marrë parasysh pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm të tyre në strukturat qeverisëse, ishte histori e kryengritjes dhe kërkesës për vetëvendosje. Demonstratat masive të vitit 1968, 1981, 1989 patën kërkesa gati

¹⁹ Dushan Janjiq, *Nacionalni identitet, pokret i nacionalizam Srba i Albanaca*, (Subotica: Otvoreni Univerzitet 1994), fq 111 dhe Dario Malnar, *SAD i stvaranja drzave Kosovo*, (Sveuciliste u Zagrebu 2012), fq 13

²⁰ Dario Malnar, *SAD i stvaranja drzave Kosovo*, (Sveuciliste u Zagrebu 2012), fq 14

²¹ Dr. Ferdo Culinovic, *Okupatorska Podjela Jugoslavije*, Vojnoizdavacki Zavod, (Beograd 1970) ff 527-529

²² Konferenca e Bujanit u mbajt në Bujan, në veri të Shqipërisë nga 31.12.1943 deri më 02.01.1944 dhe rezultati i saj i dha goditje udhëheqësisë partizane në Jugosllavi dhe në Shqipëri

identike-kërkesën për Kosovën Republikë dhe përdorimin e flamurit shqiptar. Në shuarjen e demonstratave të vitit 1981 kishte ndërhyrë edhe Ushtria Popullore e Jugosllavisë, për herë të parë në çështje të brendshme shtetërore, duke sjellur si rezultat mosbesimin dhe urrejtjen edhe më të madhe të shqiptarëve të Kosovës për UPJ-në. Vetë udhëheqësit e ushtrisë jugosllave, kuadri komandues i së cilës ishte i dominuar nga serbët, më vonë ka pranuar se kishte vepruar pa vendimin e strukturave udhëheqëse të Jugosllavisë.²³ Udhëheqësia jugosllave pas këtyre demonstratave zhvilloi politikë represive ndaj shqiptarëve si dhe diferencuese edhe ndaj kuadrave shiptarë në strukturat e Jugosllavisë socialiste. Si rezultat, këto zhvillime sollën homogjenizimin dhe radikalizimin edhe më të madh të shqiptarëve që do të vazhdojë duke u forcuar deri në fillimin e luftës së armatosur në fund të viteve 90-ta. Ardhja e Sllobodan Millosheviqit në krye të pushtetit në Serbi, duke luajtur kartën e nacionalizmit serb, me ndihmën e Kishës Ortodokse Serbe dhe Akademisë së Shkencave të Serbisë, solli një dimension të vjetër të dhunës ndaj shqiptarëve me një formë të re, tani institucionale. Millosheviqi më 28 qershor 1989, në Fushë Kosovë, mbajti fjalimin historik në përvjetorin e Betejës së Kosovës duke theksuar se serbët përsëri gjenden para sfidave dhe se betejat e tjera nuk përjashtohen.²⁴ Po atë vit Serbia anuloi autonominë e Kosovës duke rishkruar Kushtetutën e re të Serbisë të amadamentuar në mënyrë të tillë që Kosova të humbë gati të gjitha kompetencat që kishte deri atëherë. Po atë vit u themelua Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila në krye me Dr. Ibrahim Rugovën, do të fillojë rezistencën politike ndaj okupimit serb dhe internacionalizimin e problemit të shqiptarëve të Kosovës. Në vitin 1989 ra komunizmi në Evropën Lindore dhe fillimisht administrata e Presidentit George H. Bush ka përkrahur demokratizimin dhe unitetin e Jugosllavisë Socialiste. Situata në terren zhvillohej drejt dezintegritit të Jugosllavisë dhe Presidenti Bush, në fund të mandatit të tij i dërgoi Millosheviqit dhe serbëve, në atë që njihet si Porosia e Kërshëndellave, që të mos veprojnë me forcë ndaj Kosovës përndryshe SHBA-të do të ndërhyjnë me forcë. Ishte ky hap i rëndësishëm dhe tregues se SHB-të për Kosovën kishin interes më specifik se që njihej botërisht. Zhvillimet kyçe për Kosovën kanë

²³ Branko Mamula, *Slučaj Jugoslavija*, (Podgoricë:2000, CID) ff 38-40

²⁴ Dusan Bilandzic, *Hrvatska Moderna Povijest*, (Zagreb:1999, Golden Marketing) fq 765

ndodhur gjatë Presidencës së Bill Clintonit dhe administratës së tij. Kjo administratë e angazhoi NATO-n për të mbrojtur shqiptarët e Kosovës, për ta çliruar nga regjimi i Millosheviqit, me çdo kusht edhe pa Rezolutë eksplicite të OKB-së dhe përkundër kundërshtimeve të Ruisë. Raportet speciale të krijuara në mes të SHBA-ve dhe shqiptarëve të Kosovës u kurorëzuan më 17 shkurt 2008, me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe njohjen gati të përnjëhershme nga SHBA-të dhe aleatët e saj duke e ndarë një herë e përgjithmonë nga Serbia. Për disa analistë ndërkombëtarë çlirimi dhe njohja e shtetit të Kosovës nga aleatët perëndimorë në fund të shekullit XX ishte përmirësim i gabimit të bërë në fillim të këtij shekulli, përkatësisht lejimit të Serbisë ta pushtonte Kosovën në vitin 1912. Për disa analistë dhe historianë politika e SHBA-ve ndaj Kosovës, e vështruar në aspektin kohor 1989-1999 e më vonë ka tri momente kyçe nga tre Presidentë të ndryshëm të SHBA-ve, por që i lidhë kontinuiteti i përkrahjes së shqiptarëve të Kosovës në qëllimet e tyre për liri, pavarësi dhe demokraci.²⁵ Këto momente janë:

-Qëndrimi i SHBA-ve i shprehur nga Presidenti George H. Bush, në prag të shpërbërjes së Jugosllavisë proces të cilin e konsideronte problem evropian, si kërcënim ndaj Millosheviqit për Kosovën proces të cilin e konsideronte problem amerikan.

-Vendimi i Presidentit Bill Clinton për intervenim ushtarak ndaj Serbisë dhe natyra e intervenimit përmes koalicionit ushtarak NATO

Politika pro-pavarësisë së Kosovës e Presidentit George W. Bush që rezultoi me Kosovën e lirë, të pavarur, dhe demokratike

²⁵ Dario Malnar, *SAD i stvaranje drzave Kosovo*, (Sveuciliste u Zagrebu:2012), ff22-23

KAPITULLI I

SHBA-TË DHE SHQIPËRIA 1989-1997

I.1 Sistemi politik i SHBA-ve - faktorët që krijojnë dhe zbatojnë politikën e jashtme

Për të analizuar plotësisht politikën e jashtme amerikane duhet studiuar faktorët dhe institucionet e sistemit politik që caktojnë caqet dhe krijojnë politikën e jashtme, mekanizmat e formësimit të kësaj politike, të cilat janë nën ndikimin e proceseve të brendshme politike, si dhe raportet në bashkësinë ndërkombëtare. Sistemi politik i SHBA-ve është i definuar me Kushtetutën e SHBA-ve, të miratuar më 17 shtator 1787²⁶, e cila përcakton përgjegjësitë e qeverisë federale në fushat e punëve të jashtme dhe të mbrojtjes. Sistemi politik i SHBA-ve është i krijuar si sistem presidencial me rol të theksuar të Presidentit, ndërsa tri degët e qeverisjes janë të ndara dhe veprojnë sipas përgjegjësi: ligdhënëse që është Kongresi, ekzekutive që është Presidenti dhe gjyqësore që është Gjykata Supreme.

Politika e jashtme e SHBA-ve është aktivitet i organizuar i SHBA-ve nëpërmjet së cilit SHBA-të përpiqen që të arrijnë qëllimet në raport me vendet e tjera dhe me subjektet që veprojnë në hapësirën e jashtme. Politika e jashtme formëson qëllimet strategjike si dhe veprimet me anë të të cilave këto qëllime mund të përmbushen. Krijimi, zhvillimi dhe drejtimi i politikës së jashtme është më së shumti nën ndikimin e zhvillimeve të brendshme të SHBA-ve si dhe politikat dhe sjelljet e vendeve të tjera në afërsi të SHBA-ve apo në bashkësinë ndërkombëtare. Diplomacia është mënyra e veprimit të politikës së jashtme. Përpos saj, SHBA-të mund të përdorin edhe shërbimet sekrete, veprimet subverzive si dhe luftën për të avancuar dhe mbrojtur

²⁶ The Constitution of the United States of America, USIA (14.11.2012)

<http://www.archives.gov/exhibits/charters/constitution.html>

interesat shtetërore si qëllim i politikës së jashtme.²⁷ Politika e jashtme e SHBA-ve, që nga themelimi i vetë SHBA-ve, ka fituar gjithnjë e më shumë rëndësi në raport me bashkësinë ndërkombëtare. Këtë e ka mundur pozita gjeografike, resurset e mëdha materiale dhe njerëzore, rregullimi i sistemit shoqëror dhe politik, niveli i lartë i zhvillimit ekonomik dhe teknologjik, stabiliteti ekonomik dhe uniteti i brendshëm.

SHBA-të janë vendi i katërt në botë për nga sipërfaqja, me afër 315 milionë banorë, që me ndikimin politik dhe kulturor si dhe fuqinë ekonomike ka arritur të bëhet vendi udhëheqës në botë. SHBA-të disponojnë me armatimin më të sofistikuar (nuklear, konvencional, biologjik dhe kimik) dhe kanë rolin më të rëndësishëm në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe në Aleancën Veriatlantike - NATO. Po ashtu, SHBA-të kanë rol udhëheqës me veprimtarinë e institucioneve të shumta ndërkombëtare siç janë Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata Botërore e Tregtisë, etj.

Koncepti qendror i analizës së politikës së jashtme të SHBA-ve është fuqia politike që mund të definohet si: kontrolli i resurseve, raporti sipas së cilit një shtet ndikon në tjetrin me anë të kërcënimit apo përdorimit të mjeteve të dhunës, arritja e vendimit për të ndryshuar vlerat e një grupi tjetër të njerëzve dhe aftësia për t'i arritur këto caqe.²⁸ Çështja e interesave kombëtare të shtetit, që mund të definohen edhe si një grup i kërkesave, të cilat janë themelore për vendimmarrësit e politikës së jashtme gjatë marrjes së vendimeve dhe gjetjes së alternativave, përcakton qëllimet e politikës së jashtme.

Fuqia ushtarake është instrumenti kryesor i ndikimit global të SHBA-ve, që shërben për maksimalizimin e vlerave dhe interesave amerikane. Pas Luftës së Dytë Botërore është vërejtur tendenca e militarizimit të politikës së jashtme amerikane, sepse për zgjidhjen e shumë çështjeve dhe problemeve ndërkombëtare është aplikuar rruga e gjetjes së zgjidhjeve ushtarake. Kjo ndodhi ngase udhëheqësit civilë pranonin këshillat

²⁷ Encyclopedia Britannica eb.com; <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/213380/foreign-policy> (16.11.2012)

²⁸ TL Brewer, L. Teitelbaum, "American Foreign Policy: A Contemporary Introduction", (New Jersey: Simon and Schuster 1991) 12.

e udhëheqësve ushtarakë për zgjidhjen e problemeve politike. Vetëm pas Luftës në Vietnam (1 nëntor 1955-30 prill 1975) dhe disfatës së dhimbshme që patën SHBA-të, planifikuesit e politikës së jashtme filluan të ndajnë fuqinë ushtarake nga ndikimi politik në arenën ndërkombëtare.²⁹ Militarizimi i politikës së jashtme të SHBA-ve është vërejtur edhe në qëndrimet dhe retorikën e liderëve të SHBA-ve që shpeshherë kanë theksuar dhe përsëritur se qëllimi i forcës ushtarake është arritja e sigurisë, mbrojtja e interesave amerikane dhe shtrirja e ndikimit ndërkombëtar. Industria ushtarake në SHBA, posaçërisht në periudhën e “Luftës së ftohtë”, ka pasur edhe role të tjera, ka shërbyer edhe për ngritjen e ekonomisë dhe vendeve të punës, por edhe për shterjen e fondeve të Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij në garën e armatimit.

Elementet kryesore që përcaktojnë politikën e jashtme të SHBA-ve mund të ndahen në: burimet e jashtme - sistemi ndërkombëtar politik dhe ekonomik; burimet sociale - vlerat kombëtare, opinioni publik, zgjedhjet presidenciale, mediet; burimet qeveritare - Presidenti, administrata ekzekutive, Kongresi dhe agjencionet.

Politikani dhe diplomati i famshëm, Henry Kissinger thekson se elementet përcaktuese të politikës së jashtme të SHBA-ve burojnë nga pozita e saj specifike gjostrategjike.³⁰ Të vendosura në mes të dy oqeanëve dhe e kufizuar territorialisht me fqinjë shumë më të dobët, SHBA-të kanë ndërtuar konceptin e “jashtëzakonshmërisë”, të bazuar në vlerat, idetë dhe idealet që Amerikanët kanë për shoqërinë e tyre dhe në besimin e jashtëzakonshmërisë së institucioneve amerikane si dhe parimeve të politikës demokratike.³¹

Burimet e jashtme

Marrëdhëniet politike ndërkombëtare janë shumështrësore dhe karakterizohen me ndryshime në periudha të ndryshme, varësisht nga fuqia dhe ndikimi i shteteve.

²⁹ Lidija Kos, “*Vojne Komponente Američke Vanjske Politike*”, Zagreb: Polemos nr. 3 (2000), 112-113

³⁰ Kissinger Henry: A i duhet Amerikës Politika e Jashtme, Golden Marketing Zagreb, 2003, f.15

³¹ Presidentët amerikanë shpeshherë veprimet e tyre i kanë arsyetuar me qëllime të mbrojtjes së demokracisë dhe parimeve morale. P.sh. Presidenti Clinton intervenimet në ish-RSFJ i ka arsyetuar me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndërsa Presidenti George W Bush intervenimin në Irak e arsyetoi me luftën kundër terrorizmit dhe instalimit të demokracisë si vlerë universale në Irak.

Akterët kryesorë në planin ndërkombëtar janë shtetet, organizatat ndërkombëtare qeveritare (OKB dhe aleancat e tjera), organizatat joqeveritare, organizatat ekonomike, korporatat multikombëtare, lëvizjet e ndryshme religjioze, etj.

Burimet sociale

Vlerat kombëtare të SHBA-ve janë të ndërlidhura me kulturën politike që është krijuar nga vlerat politike, idetë dhe idealet që kanë amerikanët për shoqërinë e tyre dhe zhvillimet politike në vend. Një ndër vlerat më të rëndësishme është tradita e lirisë dhe liridashjes që buron nga periudha e luftës kundër Britanisë së Madhe, Luftës së Pavarësisë (1775-1784) dhe Deklaratës së Pavarësisë (4 korrik 1776). Parimet e lirisë individuale, barazisë para ligjit, vetëvendosjes, ndërmarrjes së lirë, qeverisjes së shumicës, të drejtave të pakicës, lirisë së shprehjes, të drejtave të barabarta për të marrë pjesë në punët publike dhe sundimi i ligjit janë vlerat tradicionale themelore që potencohen në SHBA. Për të mobilizuar opinionin publik të brendshëm dhe për të pasur përkrahje për veprimet jashtë SHBA-ve, politikanët amerikanë shpeshherë i paraqesin vendimet me retorikën e perceptimeve ideologjike. Për dekada me radhë, sidomos në shekullin e XX, ka mbizotëruar bindja apo perceptimi i “jashtëzakonshmërisë amerikane”, i kombit amerikan si të ndryshëm nga të tjerët, pikërisht për shkak të vlerave të lartpërmendura. Megjithatë, përkundër konceptit që garanton barazinë, në përcaktimin e drejtimeve në politikën e jashtme të SHBA-ve, angazhim dhe rol më të madh kanë grupacionet dhe organizatat që janë të specializuara për krijimin dhe trajtimin e politikës së jashtme në përgjithësi. Grupi më me ndikim është “Council on Foreign Relations”³², i cili është entitet privat që ndërlidh elitën amerikane me qeverinë amerikane, që ka pasur rolin vendimtar në krijimin e politikës së kontrollimit [“containment policy”] ndaj Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij, NATO-s, Planit Marshall, Bankës Botërore, FMN-së etj. Grupacionet e tjera janë: “Brookings Institute”³³, “The Committee for Economic Development”³⁴, “American Enterprise Institute”³⁵, “RAND”³⁶, etj. Po ashtu, grupe të

³² <http://www.cfr.org/>

³³ <http://www.brookings.edu/>

³⁴ <http://www.ced.org/>

fuqishme të interesit janë edhe lobistët që përfaqësojnë ta zëmë kompleksin industrial ushtarak, apo të etniteteve të organizuara si “AIPAC - American Israeli Public Affairs Committee”³⁷ që përfaqëson interesat hebreje.

Kur flitet për opinion publik dhe politikën e jashtme të SHBA-ve mund të konstatohet se amerikanët në përgjithësi nuk janë edhe aq të interesuar për zhvillimet ndërkombëtare. Në përgjithësi, amerikanët janë më të interesuar për problemet e brendshme. Qëndrimet rreth çështjeve të politikës së jashtme zakonisht fitohen në bazë të anketave kryesisht të bëra nga mediet elektronike, ndërsa, në dekadën e fundit, edhe në internet. Në periudhën e fushatës presidenciale kandidatët shpalosin programet dhe prioritetet e politikës së jashtme, por kryesisht këto programe, bashkë me sigurinë kombëtare, kanë shumë ngjashmëri por gjithsesi fokusi është në çështjet e brendshme. Mediet luajnë rol të rëndësishëm në procesin e formulimit të politikës së jashtme të SHBA-ve, sepse ato ndikojnë në krijimin e qëndrimeve të vendimmarrësve me informatat të cilat i publikojnë. Në rastin e luftës në Kosovë (1998-1999) dhe fushatës së bombardimeve të Republikës Federale të Jugosllavisë (mars-qershor 1999) mediet elektronike dhe të shkruara amerikane kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm në përkrahjen e vendimit për fushatën e bombardimeve të NATO-s, pikërisht me raportimin e tyre nga terreni dhe me mbulimin e ngjarjeve në Kosovë dhe jashtë saj.³⁸

Burimet qeveritare

Presidenti i SHBA-ve

Presidenti i SHBA-ve bashkon detyrën e udhëheqësit të shtetit dhe qeverisë amerikane si dhe është institucioni kryesor për krijimin dhe arritjen e caqeve dhe prioriteteve të politikës së jashtme të SHBA-ve. Presidenti i SHBA-ve ka dy role në marrëdhëniet ndërkombëtare: ai është arkitekt i politikës së jashtme amerikane dhe personalitet me

³⁵ <http://aei.org/>

³⁶ <http://www.rand.org/>

³⁷ <http://www.aipac.org/>

³⁸ Babak Bahador, “*The CNN effect in Action*“, New York: Palgrave MacMillan 2007

status botëror, i cili mund të iniciojë apo të përkrahë veprime të rëndësishme globale.³⁹ Presidenti udhëheqë me degën ekzekutive të pushtetit, merr vendime ekzekutive, emërimet dhe shkarkimet të zyrtarëve të administratës, cakton ambasadorët dhe konsujt, mban kontaktet me qeveritë e huaja, ka përgjegjësi të mëdha në veprimet ushtarake dhe në komandimin e forcave ushtarake si dhe në arritjen e marrëveshjeve paqësore. Presidenti e ka Zyrën Ekzekutive, ndërsa përgjegjës për fushën e politikës së jashtme janë:

Shtabi i Shtëpisë së Bardhë (Executive Office of the President), që është në dispozicion të Presidentit në ndërlidhje me organizatat dhe agjencionet që merren me punët e jashtme.⁴⁰ Shtabi posedon ekipet e posaçme të specializuara për lëmitë e ndryshme politike dhe aktivisht bashkëpunon me Departamentin e Shtetit, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjencionin Qendror të Inteligjencës.

Këshilli për Sigurinë Kombëtare (National Security Council) është trupi kryesor koordinues për politikën e jashtme të SHBA-ve. NSC është themeluar në vitin 1947 dhe përveç Presidentit, anëtarët e Këshillit përbëhen nga Zëvendës-presidenti, Sekretari i Financave, Sekretari i Mbrojtjes, Sekretari i Departamentit të Shtetit, Drejtori i CIA-s dhe Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Brenda NSC-së funksion të rëndësishëm ka Udhëheqësi i Shtabit të Përhershëm Bashkëpunues të NSC-së. Rol të posaçëm në Këshill ka gjithashtu Këshilltari Special për Çështjet e Sigurisë Kombëtare, të cilin e emëron Presidenti nga radhët e ekspertëve jopartiakë dhe që është i ngarkuar me çështjet e sigurisë kombëtare, por këto shpeshherë janë të ndërlidhura me punët e jashtme.⁴¹ Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, roli i këtij këshilltari është zvogëluar dhe si i tillë tani është më i lidhur me Departamentin e Shtetit.

³⁹ Ksenija Jurišić, *“Uloga Predsjednika SAD u stvaranju američke vanjske politike”*, Zagreb: Politička Misao Vol. 35 Nr. 4 (1998), 185

⁴⁰ Jurgen Hartmann: *Sistemet politike të Britanisë së Madhe, SHBA-ve dhe Francës*, Policka Kulura, Zagreb 2006, f. 111

⁴¹ Jurgen Hartmann: *Sistemet politike të Britanisë së Madhe, SHBA-ve dhe Francës*, Policka Kulura, Zagreb 2006, f.116

Departamenti i Shtetit, i themeluar më 1789, që në fakt është Ministria e Punëve të Jashtme, që ka për detyrë të analizojë, të përcjellë dhe të vlerësojë zhvillimet politike dhe ekonomike në vendet dhe rajonet me rëndësi për SHBA-të, në bazë të së cilave jep këshilla dhe propozime për Presidentin në fushën e politikës së jashtme. Departamenti i Shtetit është themeluar më vitin 1789 dhe në krye të tij është Sekretari i Shtetit që ka disa role: Ministër i Punëve të Jashtme, këshilltari kryesor për punë të jashtme i Presidentit, diplomati kryesor në negociatat dhe raportet me vendet e tjera, koordinatori kryesor i veprimeve në punët e jashtme që SHBA-të ndërmarrin përmes agjencioneve dhe këshilleve të ndryshëm.

Departamenti i Mbrojtjes që është Ministria e Mbrojtjes me seli në Pentagon, e themeluar në vitin 1947, ka përgjegjësinë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare të SHBA-ve dhe të interesave kombëtare. Ky Departament numëron 1,4 milionë të punësuar në detyrë aktive ushtarake, 1,1 milionë pjestarë të Gardës Nacionale dhe Forcave Rezervë si dhe 718.000 punëtorë që shërbejnë si personel civil. Për shkak të madhësisë, fuqisë dhe pranisë globale, Departamenti i Mbrojtjes ka rol të rëndësishëm në krijimin e politikës së jashtme të SHBA-ve.⁴²

Agjencionet e Inteligjencës - Në SHBA ekzistojnë disa agjencione të inteligjencës që përbëjnë komunitetin e inteligjencës në krye të së cilës është Drejtori apo “Director of Central Intelligence” që është edhe udhëheqës i Agjencionit Qendror të Inteligjencës apo “Central Intelligence Agency” [CIA]. Qëllimi i CIA-s është të mbledhë shënime dhe t’i analizojë ato nëse kanë lidhje me sigurinë kombëtare të SHBA-ve. Vlerësimet e sigurisë që kryen CIA kanë ndikim të drejtpërdrejtë në caqet e politikës së jashtme të SHBA-ve dhe në realizimin e tyre kudo në botë. CIA nuk ka përgjegjësi autonome për politikë të jashtme, por mund të thuhet se Presidenti nuk merr vendim në punët e jashtme pa konsultim me këtë agjencion. CIA është trashëgimtare e agjencionit Zyra e Shërbimeve Strategjike apo “Office of Strategic Services – OSS” dhe është themeluar në vitin 1947. Edhe Departamenti i Mbrojtjes ka agjencionin e inteligjencës “Defence Intelligence Agency - DIA”.

⁴² <http://www.defense.gov/about/> (18.03.2012)

Kongresi i SHBA-ve

Sipas nenit të parë të Kushtetutës së SHBA-ve, të gjitha përgjegjësitë legislative i takojnë Kongresit, i cili është trupi legjislativ që përbëhet nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati. Funkcionet kryesore të Kongresit janë miratimi i ligjeve dhe rezolutave, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe emërimeve që i bën Presidenti, trajtimi i zyrtarëve të lartë në raste të dyshimeve për korrupsion apo për veprime të tjera të pandershme. Sipas Kushtetutës së SHBA-ve, Kongresi ka përgjegjësi të caktuara juridike në krijimin e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes së SHBA-ve. Kongresi mund të shpallë luftë dhe të miratojë ligje të posaçme nga fusha e mbrojtjes, të ratifikojë marrëveshjet me vendet e tjera, të miratojë mjetet financiare për zbatimin e programeve të politikës së jashtme dhe të mbrojtjes.⁴³ Një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të Kongresit, në fushën e punëve të jashtme, është mundësia e mocionit për kërkimin e dorëheqjes së Presidentit të SHBA-ve (impeachment), si dhe iniciativave për ndërrimin e Sekretarëve të fushave të ndryshme të Kabinetit të Presidentit dhe zyrtarëve të tjerë të lartë. Kongresi ka fuqinë e ngritjes së Komisioneve hetimore për çdo veprimtari që ushtrojnë strukturat qeveritare si dhe ka fuqinë e konfirmimit apo jo të të nominuarve të Presidentit për pozita të larta dhe ambasadorët e SHBA-ve në botë si dhe miraton marrëveshjet ndërkombëtare të SHBA-ve me dy të tretat e shumicës.

Për arritjen e caqeve dhe qëllimeve të politikës së jashtme, SHBA-të përdorin teknika dhe instrumente të ndryshme. Këto mund të ndahen në katër grupe:

- a) politike, e cila nënkupton diplomacinë e hapur apo sekrete, propagandën dhe opinionin ndërkombëtar publik;
- b) ekonomike, e cila nënkupton raportet normale si ndihma ndërkombëtare ekonomike, teknologjike, ushtarake, marrëveshjet tregtare apo raportet e tendosura si implementimi i tarifave, kuotave, bojkotit, embargo ekonomike, ndërprerja e ndihmave dhe kredive;

⁴³ Anton Grizold, "Militarizacija in Vojaško Industrijski Kompleks", Lubjanë: Časopis za Kritiko Znanosti (1990), fq.97

- c) ushtarake, e cila nënkupton konfliktet e intensitetit të ulët, të mesëm dhe të lartë;
- d) zhvillimit të demokracisë, e cila nënkupton demokracinë liberale, tregun e lirë, të drejtat e njeriut.⁴⁴

Mjetet politike si diplomacia dhe propaganda kanë qenë të shprehura mjaft shumë në periudhën e “Luftës së ftohtë”, ndërsa intervenimet ekonomike janë gjithmonë në shërbim të planeve të politikës së jashtme. Në radhë të parë, SHBA-të nuk hezitojnë të përdorin embargo ekonomike dhe ndërprerjen e marrëdhënieve tregtare me vendet e tjera (rasti i ish-Jugosllavisë në vitet 90-ta të shekullit XX dhe Koresë Veriore, Sirisë, Iranit në shek. XXI).

Ndihma ushtarake është instrument që SHBA-të e përdorin shumë shpesh në politikën e jashtme. Në vitin 1961 është miratuar “Foreign Assistance Act”, ligj sipas të cilit SHBA-të u zotuan të ndihmojnë në rritjen e aftësisë ushtarake të partnerëve të SHBA-ve për t’u mbrojtur nga agresioni i mundshëm. Gjithashtu, rrisin kohezionin dhe fuqinë e aleatëve, zhvillojnë raportet ushtarake në mes të SHBA-ve dhe partnerëve në përkrahjen e strategjisë diplomatike të SHBA-ve, zgjerojnë bazat ushtarake të SHBA-ve jashtë vendit për të rritur lëvizshmërinë e trupave ushtarake, forcojnë ekonomitë e vendeve kyçe aleate, përkrahin demokracitë dhe institucionet demokratike.⁴⁵ Gjatë periudhës së “Luftës së ftohtë”, SHBA-të implementuan doktrinën e kontrollimit sipas së cilës duhej forcuar aftësitë e aleatëve për t’u përballur me Bashkimin Sovjetik dhe vendet komuniste. Kështu, rol të posaçëm kishin Aleanca Veriatlantike “North Atlantic Treaty Organization – NATO” dhe Aleanca e Azisë Juglindore “South East Asia Treaty Organization – SEATO”, si dhe vendeve fqinje me vendet komuniste me të cilat ishin arritur marrëveshje bilaterale dhe ushtarake. Sipas doktrinës së Presidentit Richard Nixon, SHBA-të janë të obliguara që të sigurojnë ndihmën ekonomike dhe ushtarake për të gjithë aleatët në mënyrë që të jenë në gjendje të mbrojnë vetveten. Shumat më të mëdha janë dhënë në Lindjen e Mesme, p.sh. vetëm

⁴⁴ Lidija Kos, “Vojne Komponente Ameriçke Vanjske Politike”, Zagreb: Polemos nr. 3 (2000), 125-126

⁴⁵ Ch. W. Keagley and E. R. Wittkopf, “*American Foreign Policy-Pattern and Process*”, (New York: San Martins’s Press, 1991), f. 123

në vitet 1998/1999 ndihma ushtarake amerikane ishte: Izraeli 1,8 miliardë dollarë, Egjipti 1,3 miliardë dollarë. Ndërsa si ndihma ekonomike: për Izraelin 1,2 miliardë dollarë kurse për Egjiptin 815 milionë dollarë.⁴⁶ Ndihma ushtarake në formë të mjeteve ushtarake, shërbimeve dhe trajnimeve shpërndahet përmes mekanizmit “Military Assistance Program – MAP”, ndërsa ndërlidhja me vendet aleate bëhet përmes programit “Foreign Military Sales – FMN”.⁴⁷

SHBA-të i kanë përdorur shumëherë mjetet ushtarake si instrumentin kryesor për të ndikuar globalisht. Konfliktet e intensitetit të ulët, sipas autorëve amerikanë, janë konflikte politiko-ushtarake të përmasave të kufizuara që për qëllim kanë arritjen e caqeve politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike. Konflikti i intensitetit të ulët është me karakter afatgjatë dhe është manifestuar në mënyra të ndryshme si në presionet diplomatike, ekonomike dhe psikologjike, por edhe ndaj veprimeve terroriste dhe kryengritjeve.⁴⁸ Nën ndikimin e strukturave të SHBA-ve në mënyrë të drejtpërdrejtë është ndikuar te vendet me sa vijon: tek Irani, në vitin 1953, është rrëzuar qeveria e Kryeministrit Mohammad Mosaddegh; Guatemala, në vitin 1954 është rrëzuar qeveria e Jacobo Arbenz Guzman; Kuba, në vitin 1961 është tentuar të rrëzohet qeveria e Fidel Castros; Kili, në vitin 1973 është rrëzuar qeveria e Salvador Allende; Nikaragua, në vitin 1979 është tentuar rrëzimi i qeverisë; Afganistan, në vitin 1980 janë armatosur ushtarët muxhahedinë kundër forcave të Bashkimit Sovjetik.

Konflikt i intensitetit të mesëm janë intervenimet ushtarake dhe përdorimi i mundësive ushtarake në vendet e tjera për arritjen e qëllimeve të politikës së jashtme. SHBA-të kanë dërguar forcat dhe ndihmën ushtarake në disa raste si në: Kore, në vitin 1950-1953; Republikën Dominikane në vitin 1965; në Liban 1983-1984; në Grenada 1983; në Salvador 1983; në Panama 1989; në Nikaragua 1989; në Kuvajt 1991; Në Bosnjë dhe Hercegovinë 1995; në RFJ 1999 në mbrojtje të të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës.

⁴⁶ “*Military Balance 1998/1999*” (London: The International Institute for Strategic Studies), fq17

⁴⁷ Lidija Kos, *Vojne Komponente Američke Vanjske Politike*, (Zagreb: Polemos nr. 3 2000), fq126

⁴⁸ Siniša Tatalović, *Strategija obrane i rat u Hrvatskoj*, (Zagreb: Politička Misao nr. 1 1994) fq116

Konflikt i intensitetit të lartë është lufta e hapur dhe e gjatë. SHBA-të kanë ndihmuar Vietnamin Jugor, që ishte në konflikt me Vietnamin Verior komunist, nga viti 1955 në fillim me vëzhgues dhe asistencë ushtarake për të vazhduar me zbarkimin dhe rritjen e numrit të personelit ushtarak në fillim të viteve 60-të dhe për më shumë se dhjetë vjet kanë qenë të angazhuara në luftë të hapur me vietnamezët veriorë.

SHBA-të janë shteti kryesor nga bota perëndimore që përhap një formë të kulturës universale perëndimore madje për mbrojtjen e demokracisë është e gatshme të përdorë edhe forcën ushtarake. Pas përfundimit të “Luftës së ftohtë” dhe paraqitjes së doktrinës së Presidentit George H. Bush “new world order”⁴⁹ apo doktrinës së rendit të ri botëror, SHBA-të ndërmoren një mori veprimesh ushtarake që për rezultat kanë pasur rrëzimin e sistemeve politike diktatoriale dhe jodemokratike dhe zëvendësimin e tyre me institucionet e zgjedhura nëpërmjet zgjedhjet të lira. Kjo mënyrë e veprimit u pa në operacionet kundër Irakut, në Bosnjë dhe Hercegovinë, bombardimet e RFJ-së. Kundërshtarët e politikës së përhapjes aktive të sistemit demokratik, edhe me anë të veprimeve ushtarake, i akuzojnë SHBA-të për kritere të dyfishta për arsye se thuhet se veprojnë kundër regjimeve të caktuara, ndërsa tolerojnë regjimet si ato në Arabinë Saudite, ku nuk ka demokraci dhe shkelen të drejtat e njeriut.

⁴⁹ <http://www.presidency.ucsb.edu/ws/?pid=19253> (17.02.2012)

I.2 Raportet SHBA - Shqipëri para dhe pas luftës së ftohët 1917-1989

Që nga shpallja apo themelimi i shtetit shqiptar raportet e Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pasur ndryshime dhe kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të ndryshimeve politike brenda në Shqipëri. Ndryshimet në raportet në mes të dyja vendeve kanë ndodhur varësisht prej asaj se cila forcë politike dhe ideologjike ka qenë në pushtet apo në vendimmarrje në Shqipëri. Pikënisja e raporteve të prekshme në mes të Shqipërisë dhe SHBA-ve, nga shumë historianë dhe analistë, merret qëndrimi që SHBA-të kishin në vitin 1917, përkatësisht Presidenti Woodrow Wilson, për t'u larguar nga doktrina e izolacionizmit dhe për të marrë përsipër rolin ndërkombëtar që SHBA-të duhej pasur në rrjedhat pas Luftës së Parë Botërore. Presidenti Wilson kishte mbajtur fjalimin e tij para Senatit të SHBA-ve, më 22 janar 1918, për të paraqitur doktrinën e re të veprimit ndërkombëtar të SHBA-ve, e cila nënkuptonte edhe veprime ushtarake kundër Gjermanisë dhe aleatëve të saj ku edhe formalisht lufta do të shpallej më 6 prill 1917. Në fjalimin e tij ai theksoi: "Propozoj që kombet duhet të pranojnë doktrinën e Presidentit Monroe⁵⁰ si doktrinë botërore: asnjë komb të mos ushtrojë qeverisje mbi një vend apo komb tjetër, por kombet të vendosin vetë për mënyrën e qeverisjes së tyre, zhvillimit të tyre, të papenguar, të pakërcënuar, pa frikë, të vegjlit pranë të mëdhenjve dhe të fuqishmëve".

Vetëvendosja e kombeve dhe mbrojtja e vullnetit të tyre, të cilën e promovonte Presidenti Wilson, në radhë të parë, ndihmonte kombet që ishin pjesë e Perandorisë Otomane dhe Mbretërisë së Austro-Hungarisë, që në luftë ishin aleatë krahas Gjermanisë, e që synonin të krijonin shtetet e tyre kombëtare. Shqipëria kishte shpallur pavarësinë më 28 nëntor 1912, por kishte qenë e pafuqishme që të mbrojtë territorin e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore, si dhe pjesë të jugut, ndaj pretendimeve të Serbisë dhe të Greqisë gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Në Luftën e

⁵⁰ Doktrina e Presidentit William Monroe ishte publikuar më 2 dhjetor 1823 dhe theksonte që çdo veprim i vendeve evropiane për të kolonizuar apo për t'u përzier në vendet e Amerikës Veriore dhe Jugore do të konsiderohen akte të agresionit që kërkojnë si reagim intervenimin e SHBA-ve

Parë Botërore, ushtritë e Serbisë dhe të Malit të Zi, Greqisë dhe të Italisë kishin pushtuar Shqipërinë, ndërsa pas sulmeve të ushtrisë austro-hungareze dhe bullgare trupat serbe ishin evakuuar në Greqi, me ndihmën e ushtrisë franceze, ndërsa 2/3 e territorit kontrolloheshin nga Austro-Hungaria dhe trupat bullgare. Në vitin 1915, Italia nënshkroi Marrëveshjen e Londrës me Aleancën e Antantës, ku ndër të tjera, mori premtimin se do të mund të aneksonte qytetin e Vlorës me rrethinë. Po ashtu, Serbisë dhe Malit të Zi iu premtua veriu i Shqipërisë, ndërsa Greqisë jugu i territorit shqiptar. Italia, në pikën gjashtë të Marrëveshjes, merrte rolin e protektoratit mbi Shqipërinë apo "përfaqësonte shtetin e Shqipërisë në raport me Fuqitë e Mëdha". Në shtator 1918, forcat e Aleancës së Antantës depërtuan në pjesën e Frontit të Selanikut dhe me këtë filloi tërheqja e trupave të Austro-Hungarisë nga Shqipëria. Në nëntor 1918, ushtria italiane pushtoi shumicën e territorit të Shqipërisë, Serbia pjesët veriore, Greqia pjesët në jug, forcat franceze Korçën dhe Shkodrën.

Në Konferencën e Paqes në Paris, të mbajtur në janar 1920, përfaqësuesit e Francës, Britanisë së Madhe dhe të Greqisë kishin arritur marrëveshje për të ndarë Shqipërinë ku pjesët e saj do t'i takonin Mbretërisë së Serbëve-Kroatëve-Sllovenëve, apo Jugosllavisë së parë, Italisë dhe Greqisë, ndonëse Presidenti Wilson në takim me Kryeministrin e Britanisë së Madhe David Lloyd George dhe atë të Francës George Clemenceau, më 6 maj 1919, ishte shprehur qartë se "Shqipëria duhet të jetë e pavarur"⁵¹. Më 23 janar 1920, në Kongresin e Lushnjës, përfaqësuesit e shqiptarëve zgjodhën Këshillin e Lartë, që në mbledhjen inauguruese dërgoi mesazh: "Falënderim të përzemërt Presidentit Wislon për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Jemi të bindur që Republika e madhe Amerikane do të vazhdojë të përkrahë kërkesat e drejta kombëtare".⁵² Në mars të vitit 1920, Presidenti Wilson intervenoi për të bllokuar zbatimin e marrëveshjeve të Konferencës së Paqes në Paris duke mos lejuar ndarjen e Shqipërisë. Në dhjetor të vitit 1920, Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve dhe me këtë u vërtetua edhe sovraniteti i saj. Shqipëria kërkoi zyrtarisht vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-të në dhjetor të vitit 1921 kur një delegacion i

⁵¹ Foreign Relations of the United States: *The Paris Peace Conference*

⁵² Tajar Zavalani, *Nationalism in Eastern Europe*, (Seattle: University of Washington Press, (1969).

shtetit shqiptar kontaktoi Ambasadorin e SHBA-ve në Romë.⁵³ SHBA-të njohën zyrtarisht Shqipërinë më 28 korrik 1922 dhe Presidenti Warren G. Harding emëroi Ulysses Grant-Smith emisar për Shqipërinë duke filluar marrëdhëniet bilaterale në mes të dyja vendeve në kohën kur Kryeministër i Shqipërisë ishte zgjedhur Ahmet Zogu. Marrëdhëniet në mes të SHBA-ve dhe Shqipërisë u intensifikuan me përpjekjet e kompanive nga SHBA-të për të siguruar të drejtat e shfrytëzimit të burimeve të naftës në Shqipëri. Në vitin 1924, nën udhëheqjen e Fan Nolit u krijua qeveria e re e Shqipërisë, ndërsa Zogu u largua në ekzil. Marrëdhëniet me SHBA-të patën rënien e parë kur Sekretari i Shtetit, Charles Evans Hughes refuzoi të njihte Qeverinë e Fan Nolit, të cilën e konsideronte si qeveri që rezultoi nga revolucioni. Pas kthimit të Zogut në pushtet synimet kryesore të Shqipërisë në fushën e punëve të jashtme ishin ndërtimi i raporteve miqësore me Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene dhe Greqinë në rajon, e posaçërisht me SHBA-të, në planin ndërkombëtar. Për këtë qëllim Kryeministri Zogu emëroi Faik Konicën, dijetarin, shkrimtarin dhe publicistin e madh, si përfaqësuesin e parë diplomatik të Shqipërisë në Uashington. Më 1 shtator 1928, Zogu shpalli Shqipërinë monarki dhe veten "Mbret të të gjithë shqiptarëve". SHBA-të e njohën Shqipërinë si monarki dhe Zogu vazhdoi të ndërtonte marrëdhëniet bilaterale në mes të dyja vendeve. Në këtë periudhë, SHBA-të dhe Shqipëria, nënshkruan katër marrëveshje bilaterale dhe njëmbëdhjetë marrëveshje multilaterale. Por, Shqipëria, në këtë periudhë, rrezikohej nga Italia fashiste. Udhëheqësi i Italisë, Benito Mussolini, ishte i vendosur për të pushtuar pjesë të Shqipërisë dhe për të jetësuar Traktatin e Londrës. Pas një periudhe të presioneve ndaj Shqipërisë dhe përgatitjeve ushtarake, forcat e Italisë, më 7 prill 1939 e sulmuan Shqipërinë. Një ditë më parë, më 6 prill 1939, Mbreti Zog ishte larguar nga Shqipëria, ndërsa qeveria ishte shpërndarë. Sekretari amerikan i Shtetit, Cordell Hull dënoi sulmin italian ndaj Shqipërisë.⁵⁴ Në Shqipëri u instalua qeveria lojale ndaj Italisë, ndërsa interesat e Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare i mori përsipër Italia. Për këtë arsye, në korrik të vitit

⁵³ Korrespondencë e Ambasadorit Child me Sekretarin e Shtetit, dokumenti nr. 875.01/158, *The Foreign Relations of the United States 1992*, vol 1, dhe në Dhimitër Binaj *An Analysis of the United States-Albanian Security Relations in the light of the war on terrorism*, (Naval Postgraduate School Monterey California 2004), fq8.

⁵⁴ *New York Times*, 9 prill 1939

1939, SHBA-të vendosën të mbyllin përfaqësinë diplomatike të Shqipërisë në Washington, konsullatën në Nju-Jork dhe në Boston. Fillimi i Luftës së Dytë Botërore solli ndryshime dramatike për Shqipërinë dhe shqiptarët. Italia dhe Gjermania sulmuan dhe pushtuan Mbretërinë Jugosllave dhe Greqinë duke ia bashkangjitur Shqipërisë territorin e Kosovës, pa veriun e saj, si dhe pjesën veriore të Greqisë të banuar nga shqiptarët.

Në këtë periudhë në Shqipëri fillon organizimi i luftës kundër okupatorëve italianë që në vitin 1941 shndërrohet në kryengritje të armatosur. Më 10 dhjetor 1942, Sekretari amerikan i Shtetit, Cordell Hull kishte deklaruar se SHBA-të përkrahin Shqipërinë e lirë dhe se po konsideronin ndihmën ushtarake për guerilët që po luftonin kundër forcave italiane në Shqipëri.⁵⁵ Në mesin e grupeve të armatosura u veçuan dy lëvizje kryesore me dallime të mëdha ideologjike, Balli Kombëtar dhe Lëvizja Nacional Çlirimtare. Balli Kombëtar bashkonte nacionalistët shqiptarë që kishin për qëllim çlirimin e të gjitha tokave shqiptare, ndërsa Lëvizja Nacional-Çlirimtare buronte nga Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila, në fakt, ishte krijuar me ndihmën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Dallimet ideologjike kaluan në luftë të hapur për pushtet dhe gati luftë civile në Shqipëri. Në gusht të vitit 1943, përfaqësuesit e Ballit Kombëtar, u takuan me përfaqësuesit e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare me qëllim të bashkimit të forcave dhe krijimit të Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë dhe arritën marrëveshje sipas së cilës në Komitet do të kishin përfaqësim të barabartë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë e refuzoi këtë marrëveshje dhe më 8 gusht dërgoi një qarkore në të cilën kërkonte ndërprerjen e bashkëpunimit me Ballin Kombëtar.⁵⁶

Në vitin 1943, në Shqipëri, forcat italiane numëronin rreth 100.000 ushtarë, ndërsa forcat partizane të LNÇ-së rreth 10.000 së bashku me 20.000 vullnetarë të njëjësive

⁵⁵ *New York Times*, 11 dhjetor 1942

⁵⁶ Reginald Hibbert, *Fitorja e Hidhur - Lufta Nacional Çlirimtare në Shqipëri*, (Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve), f. 93

territoriale.⁵⁷ Pas kapitullimit të Italisë, në shtator të vitit 1943, rreth 57.000 trupa gjermane pushtuan Shqipërinë.

SHBA-të nuk ishin të interesuara për të hapur front në pjesën e Ballkanit, ndërsa pjesën e koordinimit me lëvizjet antifashiste në këtë pjesë e kishin forcat e Britanisë së Madhe. Kështu që, oficerët britanikë u dërguan në vendet e Ballkanit, si pjesë e planit "Special Operations Executive", ndërsa në vitin 1943 u vendosën edhe te Balli Kombëtar dhe partizanët e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Kishin raporte të posaçme me Lëvizjen e Legalitetit, pasi Mbreti Zog kishte gjetur strehim në Britaninë e Madhe. Raportimi i oficerëve britanikë se Balli Kombëtar bashkëpunonte me forcat gjermane, rezultoi me pezullimin e përkrahjes së SHBA-ve për Ballin Kombëtar si dhe Lëvizjen e Legalitetit. Sipas raporteve britanike, Balli Kombëtar kishte agjendën e vet dhe ruante forcat për një kryengritje të përgjithshme në fazën finale të humbjes gjermane. Balli Kombëtar kërkonte nga aleatët që të ruhet Shqipëria e Madhe. Pakti i bashkimit me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare nuk pati sukses për shkak të dallimit të qëndrimeve rreth Kosovës.⁵⁸

SHBA-të kishin prezencë ushtarake në Shqipëri që prej 18 nëntorit 1943, kur një grup oficerësh u vendos në Shqipërinë jugore. Në gusht të vitit 1944 numri u rrit në 25 oficerë që kryesisht vepronin si ndërlidhje me ushtrinë partizane të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Misioni amerikan ishte më i pranueshëm për LNÇ-në dhe udhëheqësin Enver Hoxha, që kishte mosbesim ndaj britanikëve për shkak të raporteve të afërta të tyre me Lëvizjen e Legalitetit.⁵⁹

Në nëntor të vitit 1944, në bazë të analizave të britanikëve dhe deklaratave të Abaz Kupit, udhëheqësit të Lëvizjes së Legalitetit, amerikanët konkluduan se: "1. Lëvizja Nacional-Çlirimtare është forcë dominuese në gjysmën e Shqipërisë dhe shumë shpejt do ta dominojë të tërën. 2. Kjo do të arrihet me forcë të pamëshirshme ose kërcënim për përdorimin e forcës dhe me eliminimin e oponentëve politikë pasi tani është e njohur se këtë organizatë e përkrahin edhe sovjetikët edhe britanikët. 3. Qeveria do të

⁵⁷ Çështje të Strategjisë Ushtarake, (Tiranë: QSHBU 2002,) fq172 dhe 207

⁵⁸ Jason Tomes, *King Zog Self Made Monarch of Albania*, (2003), fq261

⁵⁹ Pëllumb Qazimi, *Albania The Military and the Foreign Influence 1912-1991*, (Zagreb: Tipomat (2012), 103

kontrollohet nga komunistët dhe do të vazhdojë vijën e Titos për Ballkanin jugor“.⁶⁰ Kështu që, SHBA-të ishin të vetëdijshme se në Shqipëri do të krijohet një shtet komunist dhe kjo ishte e paevitueshme. Në Konferencën e Potsdamit, korrik-gusht 1945, ku u takuan Presidenti Harry S. Truman, Kryeministri Winston Churchill dhe udhëheqësi sovjetik Josif Stalin për të vendosur për të ardhmen e botës pas Luftës së Dytë Botërore, çështja e Shqipërisë nuk u diskutua fare.⁶¹ Më 20 tetor 1944, Enver Hoxha u bëri thirrje aleatëve të njohin Qeverinë e tij të krijuar nga Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar. Ai, poashtu, bëri kërkesë për të dërguar një përfaqësues ushtarak në Washington për të koordinuar veprimet e përbashkëta në mes të SHBA-ve dhe Shqipërisë, një përfaqësues financiar për të koordinuar ndihmat nga SHBA-të dhe remitencat e shqiptarëve të Shqipërisë që jetonin në SHBA për të afërmit e tyre. Qeveria e SHBA-ve këto kërkesa i cilësoi si të hershme, pasi ende nuk ishin krijuar raportet formale shtetërore. Më 28 nëntor 1944, përfaqësuesit e misioneve britanike, amerikane, sovjetike dhe jugosllave ishin të pranishme në ceremoninë e shënimit të hyrjes së forcave partizane në Tiranë. Në manifestimin në Tiranë, Enver Hoxha në fjalimin e tij lavdëroi veprimet e partizanëve si dhe ndihmën e aleatëve në luftën kundër okupatorëve gjermanë. Ai posaçërisht theksoi ndihmën e Ushtrisë së Kuqe sovjetike dhe partizanëve jugosllavë, dhe, ndonëse misionet ushtarake britanike dhe amerikane kishin qenë në Shqipëri më gjatë, nuk u përmendën. ”Shqipëria duhet të jetë aleat i Titos“ kishte deklaruar Hoxha dhe në këtë moment kishte treguar hapur orientimin për të ardhmen e Shqipërisë, që nuk do të shikonte kah perëndimi por do të ishte në orbitën e influencës së Titos dhe Stalinit. Këtu filloi edhe ngrirja e raporteve në mes të misioneve britanike dhe amerikane me qeverinë e re të Hoxhës.

Udhëheqësit e Ballit Kombëtar dhe të Lëvizjes së Legalitetit ishin evakuuar nga Shqipëria dhe gjendeshin në kampin Santa Maria di Lucca, afër qytetit të Brindisit në Itali, ndërsa Enver Hoxha kërkonte dorëzimin e tyre për t'u gjykuar për ”krime të

⁶⁰ Raport i z. Alexander C. Kirk, këshilltar politik, Shtabi i Forcave Aleate, për Sekretarin e Shtetit, 13 nëntor 1944, *Foreign Relations of the United States, Diplomatic Papers, 1944, vol III, The British Commonwealth and Europe*, (1965), 287

⁶¹ Alan Axelrod, *The Real History of the Cold War, A New Look at the Past*, (Sterling 2009), fq 57.

luftës“. Udhëheqësit e lëvizjeve nacionaliste, Midhat Frashëri dhe Sali Muftija, më parë, kishin kërkuar nga qeveria e SHBA-ve që të mos e njohin qeverinë e Hoxhës, duke e argumentuar këtë me faktin se regjimi komunist i Hoxhës nuk përfaqëson vullnetin e popullit shqiptar, por është i imponuar me forcë dhe terror.⁶² Po ashtu, Frashëri, në një letër tjetër të dërguar në prill 1944, kishte kërkuar të organizohet dhe të mbahet plebishit ”në rajonet që u takojnë shqiptarëve etnografikisht, sepse Shqipëria nuk do të duhej të ndahej në dy pjesë për shkak të imperializmit dhe padrejtësisë”.⁶³ Por, ata ishin jashtë Shqipërisë dhe ishin të pafuqishëm për të ndikuar në zhvillimet në vend. Problemet kryesore të konfliktit që vuri përballë Shqipërinë dhe Anglo-Amerikanët në vitet 1945-1946 dhe më pas Shqipërinë dhe Jugosllavinë më 1948 janë mjaft mirë të dokumentuara në arkivat diplomatike të Quai d’Orsay, megjithëse në konfliktin Perëndim-Lindje, në këtë pjesë të Evropës, Franca vendosi të mbetet neutrale.⁶⁴

Më 8 maj 1945, SHBA-të tërhoqën misionin ushtarak nga Shqipëria duke e zëvendësuar me mision civil që nuk kërkonte status diplomatik dhe udhëhiqej nga Joseph E. Jacobs që ishte diplomat karriere. Më 18 korrik 1945 në Shqipëri u vendos misioni ushtarak sovjetik i udhëhequr nga Koloneli Sokollov, që ishte oficer ndërlidhjeje me komunistët e vendeve të rajonit. Në prill të vitit 1946, Britania e Madhe tërhoqi misionin ushtarak dhe nuk e zëvendësoi me mision civil. Raportet me Britaninë e Madhe u vështirësuan edhe më shumë pas incidentit të Korfuzit, kur, më 22 tetor 1946, dy luftanije britanike hasën në mina dhe 44 marinarë humbën jetën, për të cilin Britania e Madhe akuzoi Shqipërinë në Gjyqin Ndërkombëtar të Drejtësisë në Hagë dhe fitoi rastin. Shqipëria nuk pranoi përgjegjësinë për incidentin. Britania e Madhe dhe SHBA-të morën vendim që të mos e njohin qeverinë e Hoxhës pa përmbushjen e disa kushteve të caktuara.⁶⁵ Për Anglo-Saksonët, Shqipëria, megjithëse vend i vogël në Ballkan, kishte rëndësi për arsye të pozitës së saj strategjike në hyrje

⁶² Letër dërguar Sekretarit të Shtetit, “*Foreign Relations of the United States 1945*”, Vol IV, 7.

⁶³ Letër dërguar Sekretarit të Shtetit, “*Foreign Relations of United States 1945*”, Vol IV, 22).

⁶⁴ Dr. Petrit Nathanaili, “Disa çështje të pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë (1944-1946)”, fq 27

⁶⁵ Peter Lucas, “*Misioni Amerikan në Shqipëri, Operacionet sekrete të OSS-it dhe bashkëpunimi me Partizanët Komunistë gjatë Luftës së Dytë Botërore*”, Tiranë: Bota Shqiptare (2008) dhe Pëllumb Qazimi, “*Albania the Military and Foreign Influence 1912-1991*”, (Zagreb: Tipomat 2012), 106-107.

të Adriatikut (ngushtica e Otrantos edhe sot është vitale për operacionet e NATO Krahut Jugor me bazë në Napoli). Sipas gjykimit të shefit të Misionit Ushtarak Britanik në Tiranë, gjeneralit Hoxhson, ajo përfaqësonte një kartë të dorës së parë në lojën e aleatëve dhe të rusëve në Mesdhe.⁶⁶ Britanikët kështu ashtu kishin qenë më të pranishëm në Ballkan gjatë gjithë kohës së Luftës së Dytë Botërore, në një mënyrë apo tjetrën, në emër të Aleatëve dhe ishte e natyrshme që ata të ndanin zonat e interesit me sovjetikët në takimin tet-a-tet të Stalinit dhe Çerçillit, më tetor 1944. Çuditërisht, në këtë takim Shqipëria nuk u trajtua fare. Në memoaret personale të Çerçillit gjenden shënimet ku ai udhëzon Ministrin e Jashtëm A. Iden, më 11 tetor 1944 se “ për Shqipërinë duhet të këmbëngulim në një ndarje 50-50 me sovjetikët.”⁶⁷

Për amerikanët rëndësi kishte respektimi i marrëveshjeve bilaterale dhe zotimeve të tjera të qeverive shqiptare para ardhjes së komunistëve. Misioni amerikan në Shqipëri ishte i vetmi mision me karakter civil i drejtuar nga një diplomat profesionist. Problemi i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike SHBA-Shqipëri mbeti pezull për shkak të traktateve ta paraluftës. Qeveria e Hoxhës, në notën e saj të datës 13 gusht 1946 drejtuar palës amerikane pajtohej të respektonte traktatet në mes të dy vendeve sapo të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike.⁶⁸ Por, amerikanët përmes britanikëve kishin informata të plota për infiltrimin e agjentëve jugosllavë dhe sovjetikë në qeverinë e Hoxhës. Në fakt, SHBA-të vendosën që të mos e njohin Shqipërinë dhe bllokuan pranimin e saj në Kombet e Bashkuara për shkak të disa arsyeve: qeveria e re e Shqipërisë kishte vendosur të mos i respektonte marrëveshjet bilaterale ndërkombëtare që kishin nënshkruar qeveritë e tjera shqiptare para saj në periudhën e monarkisë. Regjimi i Partisë Komuniste ishte instaluar në Shqipëri pa zgjedhje të lira dhe demokratike. Regjimi po zbatonte terror ndaj oponentëve të tij, dhe pavarësia e Shqipërisë ishte komprometuar posaçërisht me këshilltarët jugosllavë dhe sovjetikë që vepronin në Shqipëri. Për këtë shkak, SHBA-të vendosën të tërheqin misionin civil në

⁶⁶ Dr. Petrit Nathanaili, “Disa çështje të pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë”, fq29

⁶⁷ Po aty, fq.31

⁶⁸ Po aty , fq.33

nëntor 1946. Në këtë periudhë, në Shqipëri, vepronin specialistë nga Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik, ku numri i tyre deri në vitin 1948 arriti në 3000 persona.⁶⁹

Mospranimi dhe mosnjohja e Shqipërisë nga SHBA-të dhe Britania e Madhe u la hapësirë elementeve pro-jugosllave dhe pro-sovjetike të fuqizohen në pushtet në Shqipëri. Kushtetuta e re e Shqipërisë ishte gati e njëjtë me atë të Jugosllavisë, ku shteti merrte nën kontroll industrinë, prodhimin, sistemin bankar, transportin, ndërsa në sistemin doganor u krijua një bashkim me doganat e Jugosllavisë që ishte hapi i parë drejt bashkimit me Federatën Jugosllave. Njësoj, në janar 1946, në Tiranë, u themelua misioni zyrtar civil sovjetik, ndonëse ende jo i plotë me të gjithë këshilltarët politikë, ekonomikë dhe ushtarakë.⁷⁰

Planet e SHBA-ve për periudhën e pasluftës në Ballkan, bazoheshin në pjesëmarrje sa më të vogël dhe përfshinin vendosjen e forcave ushtarake. Politika e SHBA-ve në këtë periudhë ishte e bazuar në interesat ekonomike dhe për këtë arsye interesimi ishte më i madh për Jugosllavinë, Bullgarinë, Rumaninë, ndërsa shumë i vogël për Shqipërinë. Bilanci i shkëmbimeve tregtare me Jugosllavinë në vitin 1939 kishte qenë 9 milionë dollarë, me Rumaninë 12 milionë dollarë, ndërsa me Shqipërinë vetëm 280.000 dollarë. Në vitin 1939, SHBA-të kishin asete në vlerë prej 11,8 milionë dollarësh në Bullgari, 50,3 milionë dollarësh në Jugosllavi, 66,1 milionë dollarësh në Rumani, ndërsa në Shqipëri vetëm 1,3 milionë dollarë.⁷¹

Misioni civil i SHBA-ve u mbyll më 2 nëntor 1946, pas disa mosmarrëveshjeve me autoritetet e Qeverisë Hoxha. Dallimet e mëdha ideologjike ishin një nga arsyet e prishjes së raporteve SHBA-Shqipëri, por ishte edhe çështja e pretendimeve territoriale që kishte Greqia ndaj Shqipërisë si një nga arsyet. Para mbajtjes së Konferencës së Paqes në Paris (29 korrik-15 tetor), më 19 shkurt 1946, Senatori Caule D. Pepper paraqiti një Rezolutë në Komitetin për Politikë të Jashtme të Senatit, në

⁶⁹ Pëllumb Qazimi, *“Albania the Military and Foreign Influence 1912-1991”*, (Zagreb: Tipomat 2012), 111.

⁷⁰ Dhimitër Binaj „*An Analysis of the United States-Albanian Security Relations in the light of the war on terrorism*“, Naval Postgraduate School Monterrey California, (2004), 32.

⁷¹ Geir Lundestad, *“The American Non-Policy Toward Eastern Europe 1943-1947”*, (New York: Columbia University Press, 1978) ff. 478-479.

përkrahje të kërkesave greke për të aneksuar jugun e Shqipërisë, qytetin e Korçës si dhe disa ishuj në Detin Egje, e cila u votua pro në Senatin amerikan. Gjatë Konferencës së Parisit pala greke, e përfaqësuar nga Kryeministri Konstantinos Tsaldaris, paraqiti një rezolutë për zgjidhjen e çështjes territoriale në mes të Shqipërisë dhe të Greqisë dhe kërkoi ndihmën e SHBA-ve. Kryeministri Hoxha në Konferencë refuzoi kërkesat greke dhe shtroi çështjen e çamëve të përndjekur nën akuzat se kanë bashkëpunuar me forcat nazifashiste. Në fund, presioni i sovjetikëve e detyroi palën greke ta tërheqë Rezolutën. Në Konferencë përsëri në ndihmë Shqipërisë i erdhën Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik; në pjesën dëgjimore kishin të drejtë të marrin pjesë edhe vendet që nuk ishin ende anëtare të OKB-së dhe Shqipëria u paraqit me ftesë të Bashkimit Sovjetik.⁷²

Raportet në mes të SHBA-ve dhe Bashkimit Sovjetik në periudhën 1945-1947 ndryshuan rrënjësisht dhe nga aleanca kundër nazifashizmit. Dy fuqitë e mëdha u kthyen në rivalë të vërtetë në përpjekjet për të dominuar botën pas Luftës së Dytë Botërore. Bashkimi Sovjetik, pas Konferencës së Potsdamit (17 korrik-2 gusht 1945) krijoi konfuzion rreth çështjes së dëmeve të luftës, refuzoi marrëveshjen për të mos e dominuar Poloninë, veprimi unilateralisht në të gjitha vendet e Evropës Lindore duke instaluar qeveritë pro-sovjetike, nuk pranoi të jetë pjesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar, shfaqti pretendime ndaj Turqisë, dhe refuzoi të tërhiqej nga Irani verior. Të gjitha këto veprime alarmuan SHBA-të dhe Presidenti Harry Truman mori vendim për të rishikuar çështjet e sigurisë kombëtare pas kërcënimeve sovjetike. Në Departamentin e Shtetit, anti-komunistët filluan të kenë më shumë ndikim në vendimmarrje. Një ndër ta ishte George F. Kennan, i cili tërhoqi vërejtjen për tendencat ekspansioniste të Bashkimit Sovjetik dhe këshilloi administratën e Presidentit Truman për t'i kundërshtuar hapur qëllimet sovjetike. "Presioni sovjetik ndaj institucioneve të lira të botës përëndimore është diçka që mund të përmbahet me zbatimin vigjilent dhe të shkathët të kundër-forcës në veprime të vazhdueshme kundër caqeve të caktuara të ndryshueshme gjeografike dhe politike". Presidenti Truman e zbatoi këtë doktrinë që u quajt "containment strategy" dhe për 42 vjet me radhë ishte

⁷² "Foreign Relations of the United States, 1945" vol II, 125-133.

baza e trajtimit të Bashkimit Sovjetik dhe satelitëve të tij.⁷³ Pas themelimit të Agjencionit Qendror të Inteligjencës -CIA, në shtator 1947, SHBA-të krijuan Zyrën për Koordinim të Politikave, që ishte organizatë e pavarur me qëllim të "kundërshtojë kërcënimin sovjetik në Evropë dhe në rajone të tjera, duke përdorur propagandën, sabotimin, luftën ekonomike dhe ndihmën paramilitare".

Prishja e raporteve në mes të Titos dhe Stalinit rezultoi me distancimin e Hoxhës nga Tito dhe kjo krijoi një situatë të re në vitin 1948. Elementet e shërbimit inteligjent të SHBA-ve e konsideruan këtë periudhë dhe Shqipërinë si "vend i përshtatshëm për të krijuar një forcë të armatosur nga rojalistët dhe lojalistët që ndodheshin në Romë dhe Athinë".⁷⁴ Ndërsa, britanikët vlerësuan se "zhvillimet kanë lënë Shqipërinë të izoluar gjeografikisht dhe duket rast i mirë për të zvogëluar Bllokun e Lindjes".⁷⁵

Britanikët dhe amerikanët kontaktuan disidentët shqiptarë dhe anti-komunistët në Greqi dhe Itali. Trajnimet ushtarake u kryen në ishullin e Maltës dhe në Gjermaninë Perëndimore. Komiteti për Shqipërinë e lirë, i sponsoruar nga Britania e Madhe dhe SHBA-të, i themeluar në Paris më 26 gusht 1949, kishte punuar në planin operacional për të hyrë në Shqipëri. Në vjeshtën e vitit 1949, 29 luftëtarët e parë u dërguan për të zbarkuar në bregdetin shqiptar afër ishullit të Korfuzit dhe të gjithë ose u vranë ose u zunë rob. Njësoj dështuan edhe disa operacione të tjera deri në vitin 1953 dhe rreth 300 agjentë patën fatin e njëjtë. Arsye për këtë dështim ishte dekonspirimi që u kishte bërë Kim Philby, pjesëtar i lartë i Shërbimit Inteligjent Britanik MI6, i cili kishte qenë agjent i dyfishtë dhe sovjetikëve ua kishte dhënë të gjitha informatat relevante për operacionet e organizuara në Shqipëri.⁷⁶

Pas dështimit të operacioneve, raportet e SHBA-ve dhe Shqipërisë për rreth tri dekada mbetën të ngrira. Shqipëria hyri nën sferën e ndikimit sovjetik e pastaj edhe atij kinez,

⁷³ Alan P. Dobson and Steve Marsh, *US Foreign Policy Since 1945*, (London: Routledge, fq24-25)

⁷⁴ Tim Weiner, *Legacy of Ashes, "The History of the CIA"*, (Penguin Books 2007), fq51.

⁷⁵ Jeffrey Keith, *MI6 The History of Secret Intelligence Service, 1909-1949*, (Bloomsbury Publishing 2010), fq. 712.

⁷⁶ Pëllumb Qazimi, *Albania the Military and Foreign Influence 1912-1991*", (Zagreb: Tipomat 2012), 113-114 dhe Nicholas Bethel, *The Great Betrayal The Untold Story of Kim Philby's Biggest Coup* (London: Hodder and Stoughton 1984).

ndërsa SHBA-të kishin vënë vijën ndarëse duke pasur Italinë dhe Greqinë në NATO. Shqipëria e udhëhequr nga Enver Hoxha zgjodhi rrugën e izolimit ndaj Perëndimit e pastaj edhe ndaj Lindjes për të vazhduar politikën e mbështetjes në vetvete, duke refuzuar marrëdhëniet diplomatike me SHBA-të si dhe me Bashkimin Sovjetik. Vdekja e Enver Hoxhës, më 11 prill 1985, nuk ndryshoi asgjë në Shqipëri, pasi që vendi ishte në gjendje të vështirë politike dhe sociale. Ndryshimet politike të vitit 1989, që do të përfshijnë të gjithë Evropën Lindore, do të ndikojnë në ndryshimet e brendshme politike në Shqipëri dhe në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

I.3 Roli i SHBA-ve në përkrahjen e institucioneve demokratike në Shqipëri

Viti 1989 ishte kyç sa i përket rirreshtimeve të mëdha në fushën gjeopolitike globale. Raportet në mes të SHBA-ve dhe BRSS-së ndryshuan me rënien e murit të Berlinit, respektivisht të diktaturave komuniste të vendeve të Evropës Lindore. BRSS kishte hyrë në proces të ndryshimeve të brendshme, për të revitalizuar ekonominë dhe për të decentralizuar pushtetin, ndërsa në Kinë ishin shtypur përpjekjet demokratike të udhëhequra nga studentët në Pekin.

Në rajon, dita ditës, po afrohej dezintegrimi i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe protestave të përgjakshme të muajit mars 1989, që rezultuan me fillimin e veprimit të organizuar politik jo-komunist të shqiptarëve të Kosovës në formën e partive politike me platformë pro-perëndimore .

Në vitin 1989, Presidencën e SHBA-ve e mori George H. Bush, që kishte fituar në zgjedhjet e vitit 1988, ndërsa më parë kishte ushtruar funksionin e Nënkrjetarit në administratën e Presidentit Ronald Reagan. George H. Bush fushatën parazgjedhore e kishte ndërtuar në premtimet për zvogëlimin e deficitit buxhetor, ndryshimin e sistemit arsimor dhe rritjen e përgjegjësisë shoqërore të qytetarëve në zgjidhjen e problemeve në komunitet.

Rënia e Murit të Berlinit, në nëntor 1989, në mënyrë simbolike, paralajmëroi fundin e "Luftës së ftohtë" dhe Evropës së ndarë në blloqe ushtarake dhe politike. "Lufta e ftohtë" kishte definuar për dekada politikën e jashtme të SHBA-ve dhe të aleatëve, pikërisht për shkak të konfrontimit ideologjik me Bashkimin Sovjetik, që më pas u zhvillua në të gjitha sferat e jetës.⁷⁷ Ndryshimet në Evropën Lindore u zhvilluan me shpejtësi të papritur. Brenda disa muajsh, në fund të vitit 1989, regjimet komuniste në Poloni, Hungari, Gjermaninë Lindore, Çekosllovakia, Bullgari dhe Rumani u përmbysën. Me bashkimin e Gjermanisë, një vit më vonë, dhe anëtarësimin e saj në

⁷⁷ Richard N. Haas: *Defining US Foreign Policy in Post-Post-Cold War World*, April, 2002 <http://2001-2009.state.gov/s/p/rem/9632.htm> (16.05.2012)

NATO dhe BE, që u bë me pajtimin e udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik, Mihail Gorbaçov, u hapën mundësi të mëdha për zgjerimin e ndikimit politik dhe ekonomik të perëndimit drejt lindjes në Evropë. Ndonëse, "Lufta e ftohtë" kishte zgjatur më shumë se katër dekada, regjimet komuniste u rrënuan mjaft shpejt duke krijuar një lloj befasi tek vendimmarrësit në SHBA. Në fakt, politika amerikane dhe veprimet e saj nuk kishin nxitur ndryshime të madhësisë së tillë çfarë ndodhën në Evropën Lindore në vitin 1989. Por, arsyen e vërtetë duhet kërkuar në përpjekjet e mëdha të udhëheqësve pro-demokratikë të vendeve të Evropës Lindore dhe qëndrimit të Mihail Gorbaçovit, që ndryshimet i legjitimoi duke mos përdorur mjetet e dhunës për të parandaluar apo rikthyer gjendjen para lëvizjeve demokratike.⁷⁸ Po ashtu, fitorja amerikane në "Luftën e ftohtë" nuk ishte meritë e një administrate, por rezultat i përpjekjeve të tetë administratave presidenciale, me theks në administratën e Presidentit Ronald Reagan, që me kombinimin e ideologjisë militante dhe fleksibilitetit diplomatik, të cilin e zbatoi në periudhën kur Bashkimi Sovjetik ishte në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, ka kontribuar më së shumti në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe rënien e regjimeve satelite në Evropën Lindore.⁷⁹ Kështu, SHBA-të u gjetën në situatën pas "Luftës së ftohtë" ku nuk ekzistonte më armiku i jashtëm dhe ideologjia kundërshtarë. Pas rënies së ndikimit të Bashkimit Sovjetik, nga Presidenti Bush, si udhëheqës i superfuqisë së vetme të kohës, kërkohej të formulonte politikën e re të jashtme të SHBA-ve, që do të merrte parasysh interesat vitale amerikane, interesat e vendeve aleate perëndimore dhe kërkesat e vendeve që kishin rrëzuar regjimet komuniste. Me ndryshimet demokratike të vitit 1989 në udhëkryq gjendej edhe Aleanca Veriatlantike NATO, që ishte ndërtuar për të mbrojtur vendet anëtare nga kërcënimi i Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij, që tani kishte nevojë për ridefinim të qëllimeve dhe konfigurimin e sigurisë së përgjithshme në Evropë. Po ashtu, për administratën e Presidentit Bush, ishte me rëndësi të përcaktohej se si do të trajtonte tranzicionin e vendeve të Evropës Lindore nga komunizmi në ndërtimin e sistemit politik të pluralizmit demokratik dhe sistemit ekonomik të tregut të lirë.

⁷⁸ Robert Hutchings, *American Diplomacy and End of Cold War*, (John Hopkins University Press 1997)

⁷⁹ Henry Kissinger, *Diplomacija*, (Zagreb: Golden Marketing 2000) ,fq753.

Presidenti Bush, rolin e SHBA-ve në marrëdhëniet ndërkombëtare e definoi në fjalimin e tij para Kongresit, më 11 shtator 1990, kur edhe promovoi qasjen "New World Order" apo Rendi i ri Botëror që raportet në bashkësinë ndërkombëtare i determinonte në disa pika themelore: forcimi i sigurisë kolektive, forcimi i autoritetit të organizatave ndërkombëtare, dhe krijimi i bashkësisë së popujve të lirë në botë. Presidenti Bush kishte deklaruar: "Nga këto kohëra të vështira mund të shfaqet një rend i ri botëror, një periudhë e re e liruuar nga kërcënimi i terrorit, më e fortë në kërkim të drejtësisë, më e sigurt në kërkim të paqes. Sot po lind një botë e re, e ndryshme nga ajo që e kemi njohur deri tani, një botë ku do të vlejné rregullat e ligjit, ku shtetet pranojnë dhe ndajnë përgjegjësinë për liri dhe drejtësi, ku të fortit respektojnë të drejtat e të pafuqishmëve."⁸⁰

Kështu, SHBA-të për herën e tretë në shekullin e XX, morën rolin udhëheqës në krijimin e rendit të ri botëror dhe të sigurisë ndërkombëtare dhe mundësinë për ta bërë këtë sipas vizionit të vet. Kjo përgjegjësi për SHBA-të erdhi në vitin 1990 me përfundimin e "Luftës së ftohtë", kur bota bipolare u bë unipolare me SHBA-të superfuqi të vetme. Por, dominimi amerikan i bazuar në forcën ushtarake, diplomatike, ekonomike dhe politike nuk garantonte domosdoshëm stabilitetin ndërkombëtar. Stabiliteti i tillë duhej ndërtuar me angazhimin e SHBA-ve në zgjidhjen e problemeve kudo në botë.⁸¹

Ky moment i ri për SHBA-të kërkonte edhe angazhim më të shtuar ndërkombëtar, ndërsa krijimi i rendit të ri botëror kërkonte largimin nga tendencat e izolimit dhe përqendrimit vetëm në interesat imediate amerikane. Për të arritur këtë, SHBA-të duhej të angazhoheshin në zgjidhjen e krizave kudo në botë ose do të rrezikonin pozicionin e fituar pas përfundimit të "Luftës së ftohtë".⁸²

⁸⁰ George H. Bush, Toward a New World Order, <http://www.sweetliberty.org/issues/war/bushsr.htm> (14.03.2012)

⁸¹ Charles Krauthammer, *The Unipolar Moment*, Foreign Affairs, Vol 70, Nr1, America and the World 1990/1991

⁸² Richard Haass, *The Reluctant Sheriff, The United States After the Cold War*, Council of Foreign Relations Press, 1998)

Politika e jashtme nuk ishte prioritet në agjendën e administratës së Presidentit Bush. Megjithatë, sipas dëshmive të këshilltarëve politikë, Bush ka shpenzuar rreth 75% të kohës së tij si Presidentit pikërisht në angazhimet në politikën e jashtme për shkak të angazhimeve diplomatiko-ushtarake amerikane në Panama, Irak, Somali si dhe përgatitjet për zgjerimin e NATO-s dhe ndryshimit të rolit të kësaj aleance.⁸³

Në ekipin e Presidentit Bush ishin: Brent Scowcroft, Këshilltar për Sigurinë Kombëtare, James Baker, Sekretar i Shtetit, Dick Cheney, Sekretar i Mbrojtjes dhe Gjenerali Collin Powell, Kryesues i Shefave të Shtabeve të Forcave të Armatosura. Presidenti Bush dhe ekipi i tij, mjaft me përvojë në punët e jashtme, kanë vepruar në mënyrë karakteristike konservative me një qasje shumë pragmatike, por në veprim me bindje dhe përkushtim të plotë.

Këtë duhet marrë parasysh për të kuptuar vendimin e administratës së Presidentit Bush për të ndihmuar forcat demokratike në Shqipëri si dhe përkrahjen e institucioneve të Shqipërisë pas fitores së Partisë Demokratike dhe aleatëve të saj në vitin 1992. Administrata e Presidentit Bush i takonte krahut konservativ republikan që si një ndër parimet e veprimit në politikën e jashtme në kontinuitet kishte përkrahjen e forcave demokratike kundër komunizmit kudo në botë.

Në të njëjtën kohë, Shqipëria, në vitin 1989, gjendej në një krizë të madhe shoqërore dhe ekonomike, ndërsa udhëheqësia e saj nuk ishte në gjendje më të zbuste problemet e brendshme pa ndihmën e jashtme financiare. Reformat e ndërmarra nga Ramiz Alia, Sekretar i Parë i KQ PPSH, ishin treguar të pamjaftueshme, ndërsa udhëheqësia e Shqipërisë me ngulm refuzonte pluralizmin politik si dhe ekonominë e tregut. Alia mbante qëndrimin se kryengritjet në Lindje nuk do të ndikojnë në Shqipërinë.⁸⁴ Ngjarjet e vitit 1989 në Evropën Lindore, presioni i brendshëm dhe rreziku i konfliktit të hapur në Kosovë, lëkundën udhëheqësinë shqiptare që filloi të ndiente presionin e madh. Për shkak të pozitës gjeostrategjike që kishte Shqipëria, ishte gjithmonë me

⁸³ M.J.Heale, *20th Century America Power and Politics in the United States 1900-2000*, (Arnold: London 2004), 298.

⁸⁴ *New York Times*, *Upheaval in the East, No change in Albania*, 01.02.1990

rëndësi për paktin e NATO-s, në veçanti të Flotës së VI të Forcave Detare të SHBA-ve, për shkak se gjendej në hyrje të Detit Adriatik.

Ndonëse në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, Shqipëria qeverisej nga Partia e Punës e Shqipërisë PPSH në krye me Ramiz Alinë, i cili nuk e kishte guximin e udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik, Mihail Gorbaçov për të ndryshuar qasjen në ekonominë e vendit, përmes ndryshimit të sistemit të vendimmarrjes.⁸⁵ Përkundrazi, udhëheqja e PPSH-së ndërmoi masa, kryesisht të bazuara në propagandë, për të minimizuar ndryshimet që kishin ndodhur në vendet e Evropës Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik. Në të njëjtën kohë, programi i "Zërit të Amerikës" shërbente si një ndër mjetet kryesore të informimit për shqiptarët, në valët e radios, që krijonte baraspeshën kundrejt vijës informative të Qeverisë.

Për të zbutur efektet e krizës dhe tensioneve në vend, Ramiz Alia, megjithatë u detyrua të ndërmarrë reforma më serioze, por edhe ishte i vendosur se nuk do të lejonte në Shqipëri vendosjen e pluralizmit politik dhe të demokracisë. Zhvillimet demokratike në Evropën Lindore, Ramiz Alia i quajti "lëvizje të popullit për të ndërruar ata që e shfrytëzojnë" për të shtuar se kjo kurrë nuk mund të ndodhte në Shqipëri, sepse në fuqi është "marksizmi i kulluar dhe populli nuk shtypej nga askush".⁸⁶ Në korrik të vitit 1989, në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, Ramiz Alia shtroi nevojën e reformimit të sistemit të drejtësisë sipas standardeve evropiane. Në atë mbledhje u propozua rikrijimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe shfuqizimi i nenit 55 të Kushtetutës, që ndalonte propagandën kundër pushtetit dhe veprimtaritë fetare.⁸⁷

Në janar të vitit 1990, në Plenumin e IX të Këshillit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Ramiz Alia shpalli reformat për ndërrime në shoqëri, që në fakt ishin të pjesshme dhe mëtonin zgjatjen e regjimit komunist në Shqipëri. Këto reforma ishin një lëvizje nga pushteti centralist dhe mundësonin edhe një lloj pavarësie më të madhe të gjykatave, rishikimin e kodit penal, krijimin e Ministrisë së Drejtësisë, ndryshimin e

⁸⁵ Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*, (Tiranë: AIIS 2011), 66.

⁸⁶ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), fq316.

⁸⁷ *Historia e Popullit Shqiptar 1939-1990 IV*, (Tiranë:Toena, 2008), fq 327.

votimit me më shumë kandidatë brenda PPSH-së, zvogëlimin e ndërhyrjes së organeve të shtetit në ndërmarrjet ekonomike, liberalizimin e kontrollit të çmimeve për prodhimet bujqësore etj.

Këto reforma nuk arritën qëllimin e zbutjes së kërkesave për demokraci dhe liri më të madhe. Po ashtu, gjendja ekonomike u përkeqësua edhe më tej. Momenti i kthesës ishte vendimi i qeverisë që lejonte lëvizjen e lirë të qytetarëve shqiptarë nga 1 korriku i vitit 1990. Më 2 korrik 1990 një grup i qytetarëve, rreth 300-400 persona, tentoi të strehohej në ambasadat e huaja duke i ikur dhunës së policisë në Tiranë. Të nesërmen mijëra të tjerë u vërsulën drejt ambasadave për të arritur numrin 6000.⁸⁸

Gjatë muajit korrik 1990, Qeveria vendosi të ndërmarrë lëvizje që synonin hapjen e Shqipërisë ndaj botës dhe vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit edhe me vende e me shtete që më parë kishin qenë të ndaluara me Kushtetutë. Kështu, më 30 korrik u nënshkrua protokoli për normalizimin e marrëdhënieve midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe BRSS-së. Ndërsa, në fund të shtatorit 1990, Ramiz Alia, në cilësinë e Kryetarit të Shtetit, mori pjesë në sesionin e 45-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku u prit nga Sekretari i Përgjithshëm, Peres De Kuelar. Në takimet ndërkombëtare Alia bëri të njohur se Shqipëria kishte hyrë në rrugën e reformave.⁸⁹

Këto reforma nuk kishin të bënin vetëm me marrëdhëniet ndërkombëtare, por edhe brenda rregullimit të Shqipërisë dhe PPSH-së. Në mbledhjen e posaçme të Komitetit Qendror të PPSH-së, në nëntor 1990, u propozua që organizatat si Fronti Demokratik, Bashkimi i Rinisë, Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Gruas, Lidhja e Shkrimtarëve, që njiheshin vetëm si formale, të kenë të drejtë të paraqesin kandidatët në zgjedhjet në organet partiake.⁹⁰ Në këtë mbledhje, Ramiz Alia shpalli shkëputjen e PPSH-së nga shteti duke i dhënë fund modelit të partisë-shtet.⁹¹ Në dhjetor të vitit 1990 u zhvilluan protestat e mëdha të studentëve, të cilëve iu bashkuan edhe shumë të rinj të tjerë, që

⁸⁸ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), fq.321.

⁸⁹ *Historia e Popullit Shqiptar 1939-1990 IV*, (Tiranë:Toena, 2008), fq. 333.

⁹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar 1939-1990 IV*, (Tiranë:Toena, 2008), fq.334.

⁹¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), fq.324.

kërkuan ndryshime rrënjësore dhe reforma të vërteta shoqërore. Më 18 dhjetor, Kuvendi Popullor miratoi sistemin e ri politik pluralist dhe filloi krijimi i partive politike. Partia kryesore rivale ndaj PPSH-së ishte Partia Demokratike në krye me Sali Berishën, që u krijua më 12 dhjetor 1990. Kjo parti, në programin e saj kërkonte ndryshimin e Shqipërisë në një shtet modern dhe demokratik, ndërtimin e shtetit të së drejtës, sigurimin e pronës private, depolitizim e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu, Sali Berisha atëkohë bëri të ditur se nuk do të qëndronte mospërfillës ndaj shqiptarëve të Kosovës.⁹²

Administrata e Presidentit Bush që në fillim e bëri të qartë se nuk do të vendosë marrëdhënie me Shqipërinë nën udhëheqjen e Ramiz Alisë nëse nuk respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe nëse nuk vendoset pluralizmi politik. Në dëshminë e vet para Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit, James Baker, Sekretar i Shtetit, kishte theksuar se SHBA-të do të kushtëzojnë vendosjen e marrëdhënieve me pranimin e pluralizmit politik dhe me lëvizjen e saj drejt ekonomisë së tregut.⁹³

Në shkurt të vitit 1991, rreth 700 studentë dhe pedagogë, filluan grevën e urisë duke kërkuar përmbushjen e premtimeve për liri më të madhe si dhe ndryshimin e planprogrameve mësimore duke larguar veprat e diktatorit Enver Hoxha. Pasi Ramiz Alia hodhi poshtë kërkesat e grevistëve rreth 10.000 demonstrues, në përkrahje të grevistëve, rrëzuan monumentin e Enver Hoxhës, i cili ishte i vendosur në qendër të Tiranës. U rrëzuan edhe monumente të tjera të Enver Hoxhës në qytetet e tjera të Shqipërisë.

Si pasojë, Ramiz Alia urdhëroi përdorimin e ushtrisë për të mbrojtur institucionet e vendit, ndërsa, në jug të Shqipërisë, PPSH organizoi grupe militantësh për të marshuar drejt Tiranës.⁹⁴ Trazirat në Tiranë vazhduan ku katër qytetarë u vranë nga forcat e rendit dhe si pasojë Ramiz Alia shkarkoi Kryeministrin Adil Çarçani dhe emëroi Fatos Nanon.

⁹²Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), fq328.

⁹³ Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*, (Tiranë: AIISS 2011), fq81.

⁹⁴ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 330.

Në mars të vitit 1991 u mbajtën zgjedhjet e para pluraliste që nga viti 1923; u fituan nga ish-komunistët, të cilët fituan 169 vende nga 250 sa numëronte Kuvendi i Shqipërisë. Partia Demokratike fitoi vetëm 75 vende. Këto zgjedhje nuk arritën të shtendosin gjendjen politike në Shqipëri. PPSH kishte arritur fitore, por opozita e udhëhequr nga Sali Berisha dhe PD-ja ishte e vendosur dhe kishte zgjedhur që të arrinte objektivat brenda sistemit.⁹⁵

Qeveria amerikane i cilësoi këto zgjedhje si "shumë larg prej zgjedhjeve të lira dhe të rregullta", por ftoi qytetarët e Shqipërisë që të përkrahin sistemin shumëpartiak.⁹⁶ Në fillim të vitit 1990 rregullimi i raporteve me SHBA-të përsëri ishte kthyer në agjendën e Qeverisë së Shqipërisë. Kontaktet e para në mes të diplomatëve amerikanë dhe të atyre shqiptarë u zhvilluan në muajin maj të vitit 1990. Megjithatë, diplomacia amerikane ishte e kujdesshme dhe qëndroi në distancë duke analizuar zhvillimet e brendshme në Shqipëri para se të rifillojë me raportet zyrtare diplomatike në mars 1991. Ministri i Punëve të Jashtme, Muhamet Kapllani dhe Ndihmës Sekretari për Çështje Evropiane dhe Kanadeze nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit pas 52 vjetësh ndërprerjeje të raporteve diplomatike.⁹⁷

Në të njëjtën kohë, PD-ja krijonte presion edhe jashtë institucioneve. Kështu, më 2 prill 1991 forcat e rendit vranë katër demonstrues në Shkodër. Më 15 maj 1991, mbi 350 mijë punëtorë, të ftuar nga Sindikatat e Pavarura dhe me miratimin e Partisë Demokratike, u hodhën në grevë duke kërkuar rritje të pagave për 50% dhe vënien para drejtësisë së autorëve të vrasjeve të 2 prillit.⁹⁸

Pas zgjedhjeve dhe krijimit të Qeverisë nën udhëheqjen e Fatos Nanos, i cili nuk arriti të qëndronte në këtë post më shumë se dy muaj, raportet SHBA-Shqipëri u përmirësuan dukshëm. Qeveria amerikane filloi të mbështeste Shqipërinë në kërkesat e saj për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare. Në maj të vitit 1991, udhëheqësi i opozitës, Sali Berisha dëshmoi para Kongresit të SHBA-ve duke kërkuar ndihmë të

⁹⁵ Sali Berisha, *Përfunduan zgjedhjet, Rilindja Demokratike*, 10 prill 1991,1.

⁹⁶ *New York Times*, US criticizes Albania Vote, But backs Multi party rules, 04 prill 1991, 7.

⁹⁷ *New York Times*, 13 mars 1991.

⁹⁸ Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*, (Tiranë: AIIS 2011), 155.

menjëhershme humanitare si dhe pjesëmarrje më të gjerë të SHBA-ve në rimëkëmbjen ekonomike të Shqipërisë.⁹⁹

Më 4 qershor 1991, Kryeministri Fatos Nano dha dorëheqje, ndërsa më 5 qershor 1991 u krijua Qeveria e Stabilitetit Kombëtar në krye me Ylli Bufin nga PPSH dhe Zëvendëskryeministër Gramoz Pashkon nga Partia Demokratike. Kjo qeveri kishte për detyrë përgatitjen e vendit për zgjedhjet e reja të planifikuara për fillimin e vitit 1992. Pak kohë pasi Kuvendi Popullor miratoi Qeverinë Bufi, Shqipëria u pranua në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe vendosi marrëdhënie me Bashkimin Evropian.

Më 22 qershor 1991, James Baker, Sekretar i Shtetit, vizitoi Shqipërinë i pritur nga qindra mijëra qytetarë në sheshin kryesor të Tiranës. Baker ofroi një ndihmë modeste ekonomike (6 milionë dollarë) krahasuar me nevojat e Shqipërisë, por vizita ishte me rëndësi të madhe për Shqipërinë, sepse ishte tregues i mundësisë së bashkëpunimit në të ardhmen. Sekretari Baker theksoi se ardhmëria e raporteve SHBA - Shqipëri do të varej nga përkushtimi i Shqipërisë në demokratizimin e vendit.¹⁰⁰ Në takim ndaras me opozitën e udhëhequr nga Berisha, Sekretari Baker u bëri thirrje që të punojnë së bashku për të fituar zgjedhjet e ardhshme parlamentare.¹⁰¹

Në nëntor të vitit 1991, Kryeministri Ylli Bufi vizitoi SHBA-të duke shënuar vizitën e parë të kësaj natyre në SHBA. Kryeministri Bufi u takua me Arnold Kanter-in, Nën-Sekretarin për Çështje Politike, anëtarët e Komisioneve për Punë të Jashtme të Kongresit dhe Senatit, zyrtarët e Departamenteve të Thesarit, Tregtisë, Bujqësisë si dhe zyrtarët e Bankës Botërore. Kryeministri Bufi nënshkroi marrëveshjen për mbrojtjen e investimeve amerikane me "OPIC" (Overseas Private Investment Corporation) që është parakusht që çdo shtet duhet të nënshkruajë para fillimit të investimeve nga kompanitë amerikane. Por, kjo vizitë nuk ishte vizitë zyrtare dhe

⁹⁹ "Rilindja Demokratike", 29 maj 1991.

¹⁰⁰ Minton F. Goldman, *Revolution and Change in Central and Eastern Europe: Political, Economic and Social Challenges*, (New York: M.E. Sharpe, 1997), 77.

¹⁰¹ *New York Times*, 23 qershor 1991, 1).

Kryeministrin Bufi nuk e pranoi Sekretari i Shtetit Baker dhe zyrtarët më të lartë shtetërorë duke qëndruar pranë vendimit se në Shqipëri duhej të ndërronte regjimi.¹⁰²

Në periudhën në vijim, Sali Berisha, vizitoi dy herë SHBA-të duke u takuar me zyrtarët e lartë të Kongresit dhe duke marrë përkrahjen e plotë të Qeverisë amerikane si dhe të komunitetit shqiptaro-amerikan. Me ftesën e Departamentit të Shtetit, më 15 mars 1991, Sali Berisha dhe Gramoz Pashko kishin vizituar Uashingtonin për të marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit me rastin e rivendosjes së marrëdhënieve amerikano-shqiptare. Ndërsa, më 20 mars 1991, David Swartz, udhëheqës i delegacionit të Departamentit të Shtetit, që kishte ardhur për të rihapur Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, në takim me liderët e opozitës theksoi drejtpërdrejt se SHBA-të do t'i japin ndihmën humanitare Shqipërisë, por ndihmën ekonomike do t'i japin vetëm nëse në pushtet do të vinin forcat demokratike.¹⁰³ Shqipëria ndodhej para krizës humanitare dhe bëri thirrje për ndihmë. Në shtator të vitit 1991, Zëvendëskryeministri Gramoz Pashko paraqiti kërkesën në mbledhjen e grupit “G-24”, njëzet e katër shteteve të industrializuara, që vendosi të ndihmojë Shqipërinë me ndihma në vlerë 150 milionë dollarësh. Italia organizoi operacionin “Pelikan” për shpërndarjen e ndihmave në Shqipëri që vinin nga vendet e tjera të Evropës si dhe SHBA-të, me përkrahjen e mbi 500 ushtarëve italianë.¹⁰⁴

Një nga arsyet e tjera, përveç ndihmës imediate për qytetarët dhe nevojat e tyre, ishte edhe ruajtja e stabilitetit të Shqipërisë pasi që në Jugosllavi kishin filluar konfliktet e para, ndërsa marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë ishin gjithnjë e më të tendosura.¹⁰⁵ Pas krizës qeveritare dhe tërheqjes së PD-së nga Qeveria, Ramiz Alia caktoi zgjedhjet e reja që do të mbaheshin më 22 mars të vitit 1992 dhe emëroi Kryeministër të Qeverisë së Përkohshme Vilson Ahmetin.

SHBA-të kishin vendosur të ndihmojnë ndryshimin e regjimit në Shqipëri dhe si shenjë përkrahjeje të drejtpërdrejtë, si rast gati unik në diplomaci, ambasadori i

¹⁰² Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*, (Tiranë: AHS 2011), 181.

¹⁰³ *Rilindja Demokratike* 23 mars 1991, 1,4).

¹⁰⁴ Miranda Vickers dhe James Pettifer, *Nga anarkia te një identitet Ballkanik*, (Tiranë: Toena 1998), 72.

¹⁰⁵ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 336.

SHBA-ve në Tiranë William Ryerson merrte pjesë në mitingjet e opozitës në përkrahje të Partisë Demokratike.

Ndërsa, Instituti Ndërkombëtar Republikan “National Republican Institute” NRI¹⁰⁶ nën drejtimin e ish-kongresmenit Jack Buechner punonte ngushtë me partitë e opozitës duke i këshilluar rreth fushatës dhe përgatitjeve për zgjedhje. INR ndihmoi Partinë Demokratike edhe me mjete logjistike (vetura, pajisje komunikimi, pajisje zyre, etj).¹⁰⁷ Në zgjedhjet parlamentare, të mbajtura më 22 mars 1992, krahu opozitar i udhëhequr nga Partia Demokratike fitoi bindshëm. Nga 100 zona zgjedhore, opozita fitoi 92 vende, Partia Socialiste vetëm 6. Sipas vëzhguesve të huaj zgjedhjet ishin të rregullta, ndërsa rezultatet u njohën nga socialistët. Më 4 prill 1992, Ramiz Alia dha dorëheqje nga pozita e Presidentit të Shqipërisë duke i dhënë fund periudhës pothuajse 50-vjeçare të qeverisjes komuniste. Më 9 prill 1992, Parlamenti i Shqipërisë zgjodhi Sali Berishën për President të shtetit, ndërsa Berisha emëroi Kryeministër Aleksandër Meksin që më 13 prill 1992 paraqiti kabinetin e tij qeveritar.¹⁰⁸ Në këtë periudhë, gjendja në Shqipëri ishte e rëndë me mbizotërim të ekonomisë së rrënuar, papunësisë së madhe dhe borxhit të madh të jashtëm. Midis viteve 1989-1992 bruto prodhimi i brendshëm (GDP) kishte rënë më shumë se 50%, prodhimi industrial dhe bujqësor kishte rënë 60% dhe 30%. Shqipëria nuk kishte rezerva të jashtme, ndërsa kishte borxh mbi 500 milionë dollarë amerikanë; inflacioni shënonte 237% në vit. Shqipëria ishte e varur nga ndihmat humanitare.

Masat ekonomike të zbatuara, që i kishte rekomanduar Fondi Monetar Ndërkombëtar si parakusht për pakon “stand by” të huasë, sollën rritjen e çmimeve të artikujve themelorë të konsumit duke lëkundur mbështetjen që kishte qeveria e re. Fuqia blerëse kishte rënë ndjeshëm, por ndihmohej nga remitencat që dërgonin mijëra shqiptarë që

¹⁰⁶ Organizatë Joqeveritare e themeluar në vitin 1983 nga Presidenti Ronald Reagan dhe që mbështetet nga Partia Republikane e SHBA-ve.

¹⁰⁷ Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*, (Tiranë: AIIS 2011), fq189.

¹⁰⁸ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), fq343-344.

punonin jashtë Shqipërisë, që vlerësoheshin në mbi 200 milionë dollarë amerikanë në vit.¹⁰⁹

Si rezultat, në zgjedhjet lokale të vitit 1992, PD humbi mbi 20% të zgjedhësve. Pas mosmarrëveshjeve të brendshme dhe shkarkimeve e përjashtimeve PD humbi edhe 2/3 e vendeve në Parlamentin e Shqipërisë që u pamundësonte miratimin e Kushtetutës së re. Në këtë periudhë Ramiz Alia u vu në arrest shtëpie.¹¹⁰

Në korrik 1993, do të arrestohej edhe Fatos Nano, që akuzohej për përvetësimin e 8 milionë dollarëve, ndërsa për akuzën e korrupsionit do të arrestohej edhe ish-Kryeministri Vilson Ahmeti. Ndërsa, Genc Ruli, Ministër i Ekonomisë dhe Financave dha dorëheqje pas akuzave për korrupsion.

Pas fitores së forcave demokratike, në krye me Partinë Demokratike të Shqipërisë, raportet SHBA-Shqipëri filluan të ndryshonin dhe bashkëpunimi u rrit dukshëm. Administrata e Presidentit Bush, pas përfundimit të Luftës së ftohtë, ishte treguar e gatshme të bashkëpunonte me të gjitha qeveritë e shteteve të Evropës Lindore që pasuan regjimet komuniste. Megjithatë, në rastin e Shqipërisë, interesimi ishte edhe më i shtuar dhe më i veçantë për shkak të konfliktit në Jugosllavi dhe pozitës së shqiptarëve të Kosovës. Në fakt, SHBA-të dhe NATO ishin mjaft të brengosura për skenarin e destabilizimit të përgjithshëm të Ballkanit, që e kishin paraparë në studimet gjeostrategjike, që do të mund të ndodhte lehtë nëse Shqipëria nuk përkrahej edhe në sferën e sigurisë dhe nëse shqiptarët e Kosovës lireshin të pambrojtur para forcave serbe të sigurisë. Kështu, përkrahjen e forcave demokratike, të udhëhequra nga Partia Demokratike, disa analistë e shpjegonin jo vetëm në prizmin e shpërndarjes së demokracisë në vendet ish-komuniste, por si përpjekje të planifikuara seriozisht për t'iu kundërvënë ndikimit politik të Serbisë, që mbështetej në lidhjet e ngushta me Rusinë.¹¹¹

¹⁰⁹ "The Economist Intelligence Unit, Country Report: Romania, Bulgaria, Albania" (London) 2nd quarter (1994), fq63)

¹¹⁰ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 347.

¹¹¹ Miranda Vickers dhe James Pettifer, *Nga anarkia te një identitet Ballkanik*, (Tiranë: Toena 1998), 89.

Për këtë arsye, Aleanca Veriatlantike e shpejtoi planin për integrimin e Shqipërisë në strukturat e sigurisë. Shqipëria edhe zyrtarisht paraqiti kërkesën për anëtarësim në NATO, ndërsa më vonë, në qershor 1992 edhe do të pranohej në Këshillin e Bashkëpunimit Veriatlantik. NATO kishte themeluar Këshillin e Bashkëpunimit Veriatlantik me qëllim të ofrimit të ndihmës shteteve dikur anëtare të Paktit të Varshavës në proceset e tyre demokratike si dhe në pranimin e ekonomisë së tregut. Presidenti Bush, në dhjetor 1992, përmes Ambasadës së SHBA-ve në Beograd, u dërgoi një porosi të qartë autoriteteve në Beograd se në rast të eskalimit të konflikteve në Kosovë, SHBA-të janë të gatshme të intervenojnë ushtarakisht edhe pa aleatët evropianë. Po të njëjtën porosi do ta përsërisin zyrtarët e administratës së Presidentit Bill Clinton vetëm disa javë pas inaugurimit të tij.¹¹²

Në vitin 1993, në Shtëpinë e Bardhë erdhi William Clinton dhe administrata e tij që kishte trashëguar gjendjen kur SHBA-të tani ishin superfuqia e vetme botërore. Bill Clinton kishte fituar zgjedhjet presidenciale mbi platformën e ngritjes ekonomike të SHBA-ve, ndërsa në plan të dytë kishte çështjet ndërkombëtare. Në ekipin e tij, në mandatin e parë, ishin Warren Christopher, Sekretar i Shtetit, Les Aspen, Sekretar i Mbrojtjes që më vonë do të ndërrohej nga William Perry, Anthony Lake, Këshilltar për Siguri Kombëtare dhe Gjenerali John Shalikashvili, Kryesues i Shefave të Shtabeve të Forcave të Armatosura. Në planin e marrëdhënieve ndërkombëtare, Presidenti Clinton aplikoi doktrinën e quajtur "doctrine of enlargement" (doktrina e zgjerimit) që parashihte zgjerimin e demokracive kudo në botë, tregtinë e lirë, krijimin e aleancave shumëkombëshe dhe forcave paqeruajtëse shumëkombëshe si dhe zotimin për intervenim në situata të krizës në rastet kur nuk rrezikoheshin ushtarët amerikanë dhe kur intervenimi i tillë ishte moralisht i arsyeshëm.

Presidenti Clinton kishte trashëguar nga Presidenti Bush një numër të madh krizash ndërkombëtare: në Irak, Lindje të Afërt, Haiti, Somali, shpërbërjen e Jugosllavisë, tranzicionin problematik të Rusisë dhe raportet e padefinuara me Kinën. Po ashtu, në momentin e marrjes së detyrës si President, forcat ushtarake amerikane ishin të

¹¹² Për më shumë për Kërcënimin e Krishtlindjeve *The New York Times*, Shkurt 1993.

angazhuara në shtete të huaja jashtë Amerikës si asnjëherë në historinë e ndërrimit të Presidentëve.¹¹³

Shtylla kryesore e politikës së jashtme të Presidentit Clinton, sidomos gjatë mandatit të parë, ishte ekonomia botërore, ndërsa qëllimi kryesor arritja e fuqisë globale të ekonomisë amerikane.¹¹⁴ Ekonomia e SHBA-ve pati një rritje të dukshme gjatë dy mandateve të Presidentit Clinton dhe ishte bazë e fuqisë politike dhe ushtarake e ndikimit global si dhe marrjes së iniciativës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Por, kishte edhe efektin kthyes pasi që angazhimi i SHBA-ve në botë hapte tregjet e reja pikërisht për këtë ekonomi. Me politikën e tij, Presidenti Clinton, zvogëloi deficitin amerikan, ringjalli ekonominë amerikane, zhvilloi suksesshëm negociatat me partnerët, duke nënshkruar mbi 300 marrëveshje ndërkombëtare për tregti të lirë, duke hapur tregjet për mallrat amerikane. Kjo strategji e politikës së jashtme rezultoi me mbi 22 milionë vende të reja të punës. Me këtë qasje gjeopolitika në këtë rast u zëvendësua më gjeoekonomi dhe SHBA-të patën ekspansionin më të madh në fushën e tregtisë dhe ekonomisë të shënuar ndonjëherë në histori.¹¹⁵ Ekspansioni i ndikimit ekonomik amerikan i arritur me depërtimin e fuqishëm diplomatik për shumë analistë ishte arritja më e madhe e Presidentit Clinton gjatë mandatit të tij të parë. Presidenti Clinton, përmes këtij modeli të politikës së jashtme, është përpjekur të arrijë caqet e politikës së brendshme. SHBA-të tani ishin model i udhëheqjes së suksesshme politike dhe diplomatike si dhe model për vendet e tjera.¹¹⁶ Sipas parimeve të politikës së jashtme të Presidentit Clinton, SHBA-të u bënë lideri kryesor në botë në promovimin e dinjitetit njerëzor dhe demokracisë si dhe të drejtave elementare të njeriut dhe për të arritur këtë qëllim SHBA-të asnjëherë nuk duhet të veprojnë si forcë e vetme dhe asnjëherë nuk duhet të veprojnë duke tejkalluar mundësitë e veta politike dhe ushtarake.

¹¹³ Lidija Čehuljić, *Demokracija i ljudska prava u posthladnoratovskoj americkoj i evropskoj politici*, (Politička Misao, Zagreb Vol.37 Nr2, 07/ 2000 .) fq 112.

¹¹⁴ Lidija Čehuljić, *Clinton i novi svjetski poredak*, (Politička Kultura, Zagreb 2001).

¹¹⁵ Lidija Čehuljić, *Clinton i novi svjetski poredak*, (Politička Kultura, Zagreb 2001), fq62.

¹¹⁶ Zbigniew Brzezinski, *Second Chance: Three Presidents and the Crisis of American Superpower*, (Basic Books 2008), fq131.

Bazuar në këto parime, SHBA-të intensifikuan ndihmën dhe përkrahjen për Shqipërinë pas zgjedhjeve të vitit 1992, posaçërisht në planin e sigurisë kombëtare dhe të përafrimit me aleancën veriatlantike.

Në janar të vitit 1993, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë arriti marrëveshjen e parë bilaterale me Komandën Evropiane të Forcave të Armatosura të SHBA-ve. Sipas kësaj marrëveshjeje një ekip i ushtarak i ndërlidhjes nga Garda Kombëtare e Karolinës Jugore do t'i bashkëngjitej Ministrisë së Mbrojtjes. Në tetor të vitit 1993, Safet Zhulali, Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, më ftesë të Les Aspenit, Sekretar i Mbrojtjes së SHBA-ve, vizitoi SHBA-të dhe po në tetor u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit që krijoi parakushtet për bashkëpunim edhe më të shtuar në fushën e sigurisë.¹¹⁷ Shqipëria ofroi aeroportin Gjadri për operacionet e vëzhgimit që kryheshin nga fluturaket pa pilot të ushtrisë amerikane dhe Agjencionit Qendror të Inteligjencës në përkrahje të forcave paqeruajtëse të OKB-së në Bosnjë dhe Hercegovinë. Me këtë bashkëpunim u shtua edhe numri i oficerëve amerikanë që vizitonin Shqipërinë në cilësi dhe detyra të ndryshme.¹¹⁸ Qëllimi i vërtetë ishte monitorimi i operacioneve luftarake në ish-Jugosllavi dhe vendimi i Shqipërisë për të ofruar aeroportin Gjadri erdhi pasi që Italia, anëtare e NATO-s, kishte refuzuar një kërkesë të ngjashme nga Agjencioni Qendror i Inteligjencës - CIA.¹¹⁹ Si pjesë e bashkëpunimit u zhvilluan trajnime të përbashkëta të forcave të ushtrisë së Republikës së Shqipërisë dhe SHBA-ve ku vetëm në vitin 1995 janë zhvilluar 12 trajnime të tilla. Po këtë vit, në shtator, Presidenti Sali Berisha kërkoi nga Presidenti Clinton edhe më shumë asistencë ushtarake për Shqipërinë dhe nga Sekretari i Mbrojtjes William Perry, në takimin e mbajtur në Pentagon, përkrahje për forcat detare të ushtrisë së Republikës së Shqipërisë. Në nëntor të vitit 1995, ekipe të këshilltarëve ushtarakë nga SHBA-të filluan të vizitojnë Shqipërinë rregullisht. Në vitin 1995, një kompani e ushtrisë së Shqipërisë u dërgua në Bosnjë dhe Hercegovinë si pjesë e forcës shumëkombëshe paqeruajtëse SFOR. Në muajin mars të vitit 1996, Shqipëria

¹¹⁷ *New York Times*, "US and Albania sign Military Agreement" 21 tetor 1993, 11.

¹¹⁸ Miranda Vickers dhe James Pettifer, *Nga anarkia te një identitet Ballkanik*, (Tiranë: Toena 1998), 218-219 dhe "Aviation Week and Space Technology", vol. 140 issue 5, 20.

¹¹⁹ *New York Times*, "US to base Balkans Spy Plane in Albania", 30 janar 1994, 13.

organizoi Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Evropës Juglindore, ku morën pjesë Ministrat e Mbrojtjes të Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë, Turqisë dhe SHBA-ve. Ndërsa, në verën e vitit 1996, në afërsi të Tiranës, u mbajt ushtrimi "Shqiponja Paqësore 96" me pjesëmarrje të forcave nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Turqia, Italia, Rumania dhe SHBA-të.¹²⁰

Përkrahja e SHBA-ve gjatë periudhës 1991-1996 ishte shumëdimensionale. Brenda kësaj periudhe SHBA-të i dhanë Shqipërisë 280 milionë dollarë ndihmë ekonomike si dhe krijuan Fondin e Ndërmarrjeve Shqiptaro-Amerikane (në vitin 1995 vlera e përgjithshme ishte 30 milionë dollarë) për të nxitur zhvillimin në sektorin privat.¹²¹ Ndihma amerikane u përqendrua në të gjitha segmentet e jetës në Shqipëri. SHBA-të, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë përmes USAID-it, ofruan mbështetjen në sektorin e industrisë, transportit dhe tregtisë, në fushën e ndërtimit dhe turizmit, në ngritjen arsimore, në fushën minerare dhe të burimeve energjetike, në bujqësi e në ngritjen e kapaciteteve të forcave të rendit.

Po ashtu, në pjesën e programeve përkrahëse afatgjate, SHBA-të mbështetën ndërtimin e institucioneve demokratike dhe procesin e reformës së tyre, krijimin e shtetit ligjor, pluralizmin politik, medien e lirë. Në periudhën 1991-1995, programet e USAID-it kishin përfshirë shumën prej 75 milionë dollarësh.¹²² Në këtë periudhë, gjendja në Shqipëri ishte e rëndë me ekonomi të rrënuar, papunësi të madhe dhe borxh të madh të jashtëm.

Në prill 1994, në një incident në kufirin Shqipëri-Greqi, afër fshatit Peshkopi, humbën jetën dy ushtarë shqiptarë, ndërsa organet e rendit arrestuan pesë anëtarë të organizatës greke "Omonia". Këta u dënuan prej 5 deri 8 vjet burg në një gjykim që u kritikua për të meta të mëdha procedurale. Këto ngjarje dëmtoi imazhin e Qeverisë së demokratëve në Evropë dhe SHBA.

¹²⁰ Dhimitër Binaj *An Analysis of the United States-Albanian Security Relations in the light of the war on terrorism*, (Naval Postgraduate School Monterey California, (2004), 50-53.

¹²¹ Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*, (Tiranë: AIIS 2011), 270.

¹²² Leonard Demi, *Shqipëria dhe Diplomacia Amerikane*, (Tiranë: Botimet Dudaj Tiranë 2008.)

Në të njëjtën periudhë, Presidenti Berisha u përpoq që të centralizonte pushtetin duke iniciuar miratimin e Kushtetutës së re, që i ofronte më shumë të drejta në vendimmarrje si President, duke anashkaluar Parlamentin dhe duke shpallur referendum popullor. Megjithatë, më 6 nëntor 1994, votuesit e refuzuan propozimin e Kushtetutës së re, 55% ishin kundër dhe vetëm mbi 40% pro, duke shënuar rënie edhe më të madhe të popullaritetit të Partisë Demokratike.¹²³

Shqipëria kishte hyrë në procesin e tranzicionit nga një shtet i izoluar dhe i qeverisur nga një regjim komunist në vend të pluralizmit demokratik, të pronës private dhe tregtisë së lirë. Të gjitha vendet që kishin kaluar dhe po kalonin këtë rrugë në Evropën Lindore, nuk e kishin lehtë. Por, për Shqipërinë, kjo ishte edhe më e vështirë, sepse pritjet dhe kërkesat e shqiptarëve ishin të mëdha.

¹²³ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), fq. 351 dhe Miranda Vickers dhe James Pettifer, *Nga anarkia te një identitet Ballkanik*, (Tiranë: Toena 1998), fq. 261.

I.4 Tranzicioni i vështirë politik, demokratik dhe social 1995-1996

Për të gjitha vendet e Evropës Lindore që ndërruan sistemin ish-komunist njëpartiak dhe me ekonomi të planifikuar me sistemin e ri demokratik të pluralizmit politik dhe tregut të lirë në zhvillimin e ekonomisë, procesi i tranzicionit i viteve 90-të ishte i vështirë dhe traumatik.

Për Shqipërinë ky proces dukej shumë më i vështirë për shkak se qytetarët e saj kishin vuajtur nga regjimi më i egër në Evropë, që u kishte mohuar të drejta themelore të njeriut, lirinë për të vendosur për veten, lirinë për të kërkuar lumturinë, pronën private. Ndryshimet që kishin ndodhur në Evropën Lindore ishin ndryshime politike dhe në avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, ndërsa gjendja ekonomike në Gjermaninë Lindore, Hungari, Çekosllovakia p.sh. ishte pakrahasimisht më e mirë se në vendet më në jug, posaçërisht në Shqipëri.

Gjendja në Shqipëri kishte qenë më e rëndë. Shtypja dhe persekutimi i qytetarëve nga regjimi komunist ishte më i lartë krahasuar me vendet e tjera në Evropën Lindore. Izolimi, mungesa e lirisë së lëvizjes dhe mungesa e perspektivës ekonomike për qytetarët e Shqipërisë ishin pjesë e jetës për gjenerata.

Për shkak se gjendja në Shqipëri kishte qenë aq e rëndë dhe kishte zgjatur për gati gjysmë shekulli i kishte shtyrë qytetarët që të kërkojnë ndryshime të mëdha dhe thelbësore, për të pasur pronë private, për të lëvizur të lirë brenda dhe jashtë shtetit dhe njëkohësisht edhe të përmirësojnë standardin e tyre jetësor.

Qytetarët e Shqipërisë kërkonin ndryshime të menjëhershme nga udhëheqësit e lëvizjes që kishte triumfuar mbi komunistët dhe kjo ishte që nga fillimi një kërkesë e madhe që u shtrua para Partisë Demokratike.

Në periudhën e viteve 1992-1995, Partia Demokratike mori përsipër obligimin e premtuar për të ringjallur ekonominë, për të përmirësuar jetën e qytetarëve si dhe për të instaluar shtetin e së drejtës, lirisë së shprehjes dhe të demokracisë. Në të njëjtën

kohë, udhëheqësit morën përsipër edhe ekonominë e rrënuar, mungesën e produkteve esenciale për jetë, borxhin e madh të jashtëm të shtetit dhe inflacionin në rritje.

Për të arritur transformimin rrënjësor të shoqërisë nevojitej ristrukturim i përgjithshëm i sistemit në Shqipëri, që kishte ndodhur edhe në të gjitha vendet e Evropës Lindore, që përmbante komponentin e ndryshimit të aparatit shtetëror dhe atij të shërbimit publik, transformimin e ndërmarrjeve ekonomike dhe të pronës, hapjen e tregut të produkteve dhe kapitalit, instalimin e konkurrencës nga jashtë. Të gjitha këto veprime duheshin të ndërmerren për ta avancuar shoqërinë, por kërkohej përsëri durim dhe sakrificë nga qytetarët.

Në Evropën Lindore, fituesit që kishin mposhtur regjimin komunist dhe që kishin tani detyrën e zbatimit të rendit të ri demokratik dhe ekonominë e tregut të lirë, u desh të ballafaqoheshin me dëshpërimin e qytetarëve kur kërkuan edhe më tutje përkrahjen e tyre për shkak se reformat ishin të dhimbshme dhe duhej më shumë kohë.

Ndryshimet që kishin pasur në sistemin qeverisës, në radhët e administratës, posaçërisht në strukturat e sistemit të sigurisë së brendshme dhe të jashtme, duke shtuar këtu rritjen e importeve të produkteve nga jashtë në fakt nuk kishin zbutur papunësinë askund në vendet e Evropës së Lindjes dhe nuk kishin përmirësuar nivelin e shërbimeve publike. Si pasojë, partitë fituese demokratike u ballafaquan me erozion të përkrahjes dhe besueshmërisë.

Shqipëria, brenda periudhës katër vjeçare, 1992-1995, u zhvillua si vendi më ndërmarrës në gjithë Evropën Lindore dhe shkaqet janë të shumta, por në radhë të parë ishte mundësia e përnjëhershme e investimeve nga jashtë në të gjitha segmentet ekonomike. Brenda kësaj periudhe vetëm nga Komisioni Evropian dhe vendet anëtare Shqipëria përfitoi 1,2 miliardë dollarë në grante dhe në programe të përkrahjes së institucioneve.¹²⁴

¹²⁴ “*Albanian Times*”, 29 tetor 1995

Sipas vlerësimeve zyrtare të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve ¹²⁵ rezultatet e përpjekjeve të Qeverisë së Shqipërisë ishin inkurajuese. Produkti i Brendshëm Bruto (GDP) në vitin 1993 ishte 11%, në vitin 1994 ishte 8%, në vitin 1995 kishte shënuar mbi 8%. Inflacioni kishte rënë nga 250% në vitin 1991 në vlerë njëshifrore dhe valuta LEK ishte stabilizuar. Të hyrat shtetërore ishin ende të varura nga ndihmat ndërkombëtare dhe nga remitencat e shqiptarëve jashtë Shqipërisë dhe me gjithë synimin e Qeverisë për stabilitet fiskal dhe ngritje të kapaciteteve investuese, çështja themelore mbetej infrastruktura e pamjaftueshme, mungesa e sistemit funksional bankar, çështja e rregullimit të taksave dhe burokracia.

Një raport nga Ministria e Financave theksonte se Shqipëria ishte shumë e varur nga shqiptarët jashtë Shqipërisë, 3/5 e familjeve kishin së paku një anëtar që punonte jashtë Shqipërisë, afër 13% të popullatës dhe 28% të forcës aktive punuese jetonte jashtë vendit. Sipas shënimeve të vitit 1995, kontributi i emigrantëve shqiptarë në neto valutën e huaj në vend, që deponohej në banka apo dërgohej përmes postës, ishte rreth 450 milionë dollarë apo 25% e prodhimit për kokë banori GNP. ¹²⁶

Gjate kësaj periudhe ndodhën edhe ndryshime të mëdha demografike me lëvizjen e banorëve nga fshatrat në qendrat urbane. Sipas shënimeve të Institutit të Statistikave, të shtatorit të vitit 1995, popullata urbane numëronte 45% nga 34% në vitin 1990, me rreth 65.000 familje nga fshati që kishin kërkuar ndërrim vendbanimi në qytete. ¹²⁷

Reformat dhe zhvillimet në Shqipëri kishin ecur paralelisht me zhvillimet politike në Shqipëri. Gjatë periudhës së tranzicionit, Qeveria që udhëhiqej nga Partia Demokratike, kryente punët ekzekutive dhe zbatimin e reformave ligjore. Presidenti Sali Berisha në doktrinën e veprimit të tij ishte i bindur se ndryshimet rrënjësore duhej të bëheshin duke mposhtur pengesat me vendosmëri. Për këtë ai edhe kishte simpatinë e një pjese të administratës amerikane. Analistë të situatës politike theksonin se

¹²⁵ US Department of State, Background Notes: Albania, September 1996, Bureau of European and Canadian Affairs

¹²⁶ "Republika", dhjetor 1995

¹²⁷ "Republika", 1 tetor 1995

SHBA-të favorizonin Berishën dhe PD-në për të pasur një Presidencë të fortë dhe për këtë i kishin ndihmuar edhe në hartimin e propozimit për Kushtetutën e vitit 1994.¹²⁸

Mosmiratim i Kushtetutës, në referendumin e mbajtur më 6 dhjetor, e solli Partinë Demokratike në situatë të ndërlikuar si dhe vuri në pyetje influencën politike të Presidentit Berisha. Konfliktet që pasuan brenda Partisë Demokratike, midis Presidentit Berisha dhe kreut të PD-së Eduard Selami, që kishin pasur dallime edhe për shkak të vendimit të Presidentit për t'i ikur votimit në Kuvend dhe për të zgjedhur referendumin si rrugë për të miratuar Kushtetutën, u thelluan edhe më shumë.¹²⁹ Në mars të vitit 1995, Eduard Selami u shkarkua nga posti i Kryetarit të PD-së.

Rast tjetër i polarizimit të gjendjes dhe humbjes së fuqisë së PD-së ishte edhe ai i Gjyqtarit të Kasacionit z. Zef Brozi. Ndonëse i emëruar si njeri i Berishës, në krye të Gjykatës së Kasacionit në vitin 1993, ai publikisht kishte kritikuar mënyrën e përkrahjes së referendunit për Kushtetutën e re. Prokurori i Përgjithshëm kishte ngritur akuza ndaj Brozit, por Parlamenti, më 1 shkurt 1995, refuzoi heqjen e imunitetit të tij me 53 ndaj 49 votave, duke treguar kështu se sa ishte rrënuar fuqia e PD-së.¹³⁰

Në planin ekonomik, Shqipëria arriti që të fitonte mbështetje të madhe financiare dhe besim nga kreditorët. Vendi edhe kishte stabilitet financiar për marrë hua nga jashtë si vlera e 500 milionë dollarëve për ristrukturimin e borxhit të jashtëm në korrik 1995.¹³¹ Kjo formë ishte edhe një përpjekje për zbutjen e humbjeve që Shqipëria kishte nga regjimi i sanksioneve ekonomike, që OKB i kishte vënë Jugosllavisë nga viti 1992 deri 1995, dhe që llogariteshin në mes të 300 dhe 400 milionë dollarë në vit.

Bashkimi Evropian, në tetor të vitit 1995, i dhuroi Shqipërisë një grant prej 275 milionë dollarësh (për periudhën 1996-1999) në përkrahje të investimeve publike në Shqipëri. Në tetor të vitit 1995, Presidenti i Bankës Botërore, James Wolfensohn,

¹²⁸ Miranda Vickers dhe James Pettifer, “Nga anarkia te një identitet Ballkanik”, (Tiranë: Toena 1998), 259.

¹²⁹ Valentina Duka, “Histori e Shqipërisë 1912-2002”, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 351

¹³⁰ Elez Biberaj, “Shqipëria në Tranzicion 1990-2010”, (Tiranë: AIIS 2011), 242-243.

¹³¹ “Financial Times”, 27 korrik 1995.

vizitoi Shqipërinë në mision për mbledhjen e fakteve për reformën e ekonomisë së vendit.

Sektori privat kishte rritje shumë të shpejtë, në fund të vitit 1994 ishin regjistruar 45,751 biznese private, ku një e treta ishin kompani të huaja apo në kooperim me kompanitë e vendit. Në vitin 1995 kontributi që sektori privat gjeneronte në të hyra nga taksat doganore dhe tatimet tejkalonin ato të kompanive publike.¹³² Parlamenti, në nëntor 1995, aprovoi legjislacionin për të lejuar privatizimin e sistemit bankar, ndërsa në dhjetor 1995, Parlamenti aprovoi buxhetin për vitin 1996, në vlerë prej afër 1 miliardë dollarësh. Buxheti i aprovuar ishte 21,2% më i lartë se ai i vitit 1995, dhe synonte rritjen e prodhimit përmes investimeve publike në rritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës.¹³³

Por, të gjitha arritjet nuk reflektoheshin në jetën e përditshme të qytetarëve të Shqipërisë. Ata ishin ende të varfër dhe me mungesë të perspektivës. Sipas një raporti të OKB-së, në këtë periudhë, të ardhurat për kokë banori ishin 800 dollarë në vit, ndërsa pagat në sektorin shtetëror 80 dollarë në muaj.¹³⁴

Situata brenda në Shqipëri gjatë kësaj periudhe ishte e polarizuar. Ish-të burgosurit politikë dhe e djathta ishte e mendimit se Qeveria po tregohej e butë ndaj ish-zyrtarëve komunistë, ndërsa e majta pohonte të kundërtën dhe theksonte se Qeveria po përdorte shantazhin për të bërë presion në udhëheqësit dhe përkrahësit e saj.¹³⁵

Partia Demokratike, megjithatë, lëvizi duke kaluar në Parlament Ligjin për Gjenocidin, në shtator 1995, sipas të cilit ndalonte emërimin në poste publike apo në institucione të gjithë personat që kishin mbajtur poste në regjimin komunist para marsit të vitit 1991. PD rishikoi Ligjin Zgjedhor duke preferuar që pragu zgjedhor të

¹³² "Rilindja Demokratike", 8 tetor 1994.

¹³³ "Albanian Times", 30 dhjetor 1995

¹³⁴ "Human Development Report: Albania", 1995, 16.

¹³⁵ Elez Biberaj, "Shqipëria në Tranzicion 1990-2010", (Tiranë: AIIS 2011), 255.

ngrihet nga 4% në 10%, por si pasojë e presionit të Komisionit Evropian dhe SHBA-ve u vendos pragu në 7%.¹³⁶

Në planin e raporteve me SHBA-të, Presidenti Berisha gëzonte përkrahjen e Departamentit të Shtetit edhe për shkak të politikës proamerikane që kishte në raport me zhvillimet në Ballkan, përkatësisht në ish-Jugosllavi. Presidenti Berisha, në shtator të vitit 1995, vizitoi Uashingtonin për t'u takuar me Presidentin Clinton dhe Sekretarin e Shtetit Warren Christopher për të thelluar bashkëpunimin me forcat e NATO-s në kuadër të bashkëpunimit ushtarak. Në këto takime, Presidenti Berisha ofroi shfrytëzimin e bazave të ushtrisë shqiptare për forcat e NATO-s. U diskutuan raportet bilaterale me SHBA-të si dhe vendet e rajonit, por u theksua edhe një herë se SHBA-të llogaritin në Shqipërinë në planet afatgjate strategjike në rajon.¹³⁷ Në fillim të vitit 1996 treguesit ishin në favor të Qeverisë dhe opsionit të Presidentit Berisha. Vlerësimi i opinionit publik, i kryer në janar 1996 nga kompania amerikane "Public Opinion Strategies", rezultoi me një përkrahje për Berishën prej më shumë 40% nëse zgjedhjet do të mbaheshin menjëherë, ndërsa 63% të të anketuarve kishin vlerësim pozitiv për Berishën. Vetëm 19% u deklaruan se përkrahnin socialistët e Fatos Nanos.¹³⁸

Ndoshta, mund të thuhet se përkrahja, së bashku me presionet nga brenda se nuk po tregohej e vendosur sa duhet me ish-komunistët, ka shtyrë organet e ndikuara nga PD që të ndërmarrin hapa të tjerë kundër ish-zyrtarëve të regjimit komunist. Prokuroria kërkoi përsëri Ramiz Alinë të dëshmonte për rastin Shkodra (më 2 prill 1991 ishin vrarë aktivistë kundër komunizmit), ndërsa numri i të arrestuarve si ish-zyrtarë komunistë shkoi në 39.¹³⁹ Në të njëjtën kohë, organet e rendit bastisën furgonët që shpërndanin gazetën kryesore opozitare "Koha Jonë" duke shkaktuar reagimin e hapur të organizatës ndërkombëtare që mbron të drejtat e gazetarëve "Reporters Sans Frontiers". Menjëherë pas kësaj, në shkurt të vitit 1996, u arrestua Ramiz Alia nën akuzat për krime kundër njerëzimit.

¹³⁶ Miranda Vickers dhe James Pettifer, "Nga anarkia te një identitet Ballkanik", (Tiranë: Toena 1998), 276-277.

¹³⁷ US State Dept Press Briefing, 12 shtator 1995.

¹³⁸ "Albanian Times", 15 janar 1996.

¹³⁹ "Reuters", 20 janar 1996.

Presidenti Berisha nënshkroi Ligjin e Zgjedhjeve përkundër protestave të mëdha që partitë opozitare kishin në Kuvendin e Shqipërisë, të cilat konsideronin se Ligji në formën e miratuar mundësonte abuzime nga ana e Qeverisë. Dy pikat kryesore që kontestoheshin ishin pika ku institucionet shtetërore emëronin kryetarët e komisioneve zgjedhore si dhe pika që mundësonte që Presidentit t'i jepet e drejta e ndarjes gjeografike të njërive zgjedhore.

Bashkëpunimi me SHBA-të nuk mungonte edhe në fillim të vitit 1996. Në shkurt të këtij viti, Ministri i Mbrojtjes, Safet Zhulali u takua me Komandantin e Trupave Amerikane në Evropë, Gjeneralin George Joulwan në Shtutgart, Gjermani. Ministri Zhulali përsëri kishte shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar edhe më ngushtë në operacionet paqeruajtëse në Bosnjë dhe Hercegovinë si dhe paralajmëroi mbajtjen e manovrave ushtarake “Shqiponja Paqësore 1996” me pjesëmarrje të trupave amerikane dhe partnerëve të NATO-s. Këto manovra do mbaheshin në korrik 1996 në jug të Tiranës.

Në planin e asistencës teknike, Shqipëria dhe SHBA-të nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit që nënkuptonte përkrahje në fushën e ndërtimitarisë dhe të urbanizmit që do të zbatohet nga USAID-i.

Në mars të vitit 1996, Sekretari i Mbrojtjes William Perry vizitoi Shqipërinë, si pjesë e turneut rajonal, me rastin e mbajtjes së Konferencës Rajonale të Ministrave të Mbrojtjes, duke vlerësuar pozitivisht përpjekjet e Shqipërisë në procesin e reformave demokratike dhe përafrimin e forcave ushtarake me standardet e NATO-s. Sekretari Perry premtoi një ndihmë prej 100 milionë dollarësh, në formë mjetesh dhe pajisjesh amerikane, për ushtrinë e Shqipërisë. Por, më e rëndësishme se ndihma ishte deklarata e tij se forcat amerikane nuk kishin në plan të krijojnë një bazë permanente ushtarake në Shqipëri dhe kishte shtuar “ndonëse kjo nuk përjashtohet në kushte të caktuara dhe asnjëherë pa ftesën e Qeverisë së Shqipërisë”.¹⁴⁰ Kjo ishte hera e parë që një prezencë ushtarake e forcave amerikane në një bazë amerikane në Shqipëri u deklarua si opSION

¹⁴⁰ “*Albanian Times*”, 2 prill 1996.

i mundshëm nga një zyrtar kaq i lartë i administratës amerikane në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Kuvendi i Shqipërisë u shpërnda më 29 mars 1996 për të hapur rrugën për zgjedhjet parlamentare të planifikuara për 26 maj 1996, ndërsa dy partitë kryesore politike PD dhe PS filluan fushatat e tyre parazgjedhore në prill 1996. Platforma e PD-së ishte e bazuar në rritjen e ekonomisë, ndaljen e inflacionit dhe transformimin e shoqërisë në Shqipëri nga diktatura komuniste në shoqëri të ekonomisë së tregut dhe të sundimit të ligjit. Platforma e PS-së ishte e bazuar në theksimin e të gjitha anomalive që kishin ndodhur në Shqipëri për të cilat fajësonin “pushtetin arbitrar” të Berishës. Po ashtu, PS akuzonte Qeverinë për premtimet e pareaizuara për zbutjen e gjendjes sociale, luftën kundër korrupsionit si dhe lënien e vendit pa kushtetutë.

Administrata amerikane në këtë periudhë dha mbështetje të qartë për Presidentin Berisha dhe PD-në, jozyrtarisht por edhe publikisht. Në maj të vitit 1996, Ministri i Jashtëm Alfred Serreçi u takua me Sekretarin e Shtetit Warren Christopher për të diskutuar marrëdhëniet bilaterale, por me vëmendje në zhvillimet në Kosovë. Në raportin për shtyp pas takimit u theksua se SHBA-të përkrahin fuqishëm procesin e konsolidimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Shqipëri.¹⁴¹

Një javë para zgjedhjeve, Timothy Wirth, Nën-sekretar për çështje globale në Departamentin e Shtetit, në një intervistë për “Zërin e Amerikës” (edicioni në gjuhën shqipe) vlerësoi pozitivisht arritjet në Shqipëri në planin e zhvillimit të demokracisë dhe të ekonomisë. Në këtë prononcim, Wirth kishte bërë thirrje për zgjedhje të lira dhe të drejta duke theksuar se nëse zgjedhjet nuk janë të tilla atëherë do të zbehet dëshira e Amerikës për ta përkrahur Shqipërinë.¹⁴²

Edhe PS bëri përpjekje për të dërguar mesazhin e saj drejt institucioneve amerikane. Delegacioni i udhëhequr nga Servet Pëllumbi dhe i përbërë nga Ilir Meta, nënkryetar dhe Kastriot Islami, zëdhënës, kishte udhëtuar për në Uashington, por përveç takimeve

¹⁴¹ *US State Department Press Briefing*, 9 maj, 1996.

¹⁴² Elez Biberaj, “*Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*”, (Tiranë: AIIS 2011), fq. 397.

të rëndësisë së dytë nuk kishin arritur që të përçonin porosinë që kishin - se Partia Socialiste tani është larg nga ajo pasuese e PPSH-së.

Zgjedhjet e 26 majit 1996 u mbajtën në një situatë tejet të rëndë dhe të tendosur. Këto zgjedhje, po ashtu, kishin rëndësinë e tyre për të parë jo vetëm se kush do të fitonte dhe nëse do të kishte ndryshim në qeverisje, por edhe për të parë nëse Shqipëria ka avancuar standardet e mbajtjes së zgjedhjeve dhe procesit elektoral. Partia Demokratike i fitoi bindshëm zgjedhjet e 26 majit duke marrë 122 vende në Kuvend nga 140 të mundshme. Por, pak orë para se të mbylleshin vendvotimet, Partia Socialiste deklaroi se po tërhiqej nga zgjedhjet për shkak të parregullsive të mëdha në vendvotime. Partia Socialiste akuzoi strukturat e pushtetit për dhunë të ushtruar ndaj përfaqësuesve të opozitës në komisionet zgjedhore në zona të ndryshme. Zëdhënësi Kastriot Islami kërkoi nga Komisioni Qendror Zgjedhor dhe Gjykata Kushtetuese të shpallë zgjedhjet e pavlefshme dhe të organizohen zgjedhjet e reja “në kushtet e garantuara demokratike”.¹⁴³ Presidenti Berisha, në një reagim të shpejtë, akuzoi Partinë Socialiste për tentim të falsifikimit të votave dhe për plane të liga për të penguar procesin zgjedhor. Për Presidentin Berisha tërheqja e Partisë Socialiste do të rezultonte me ndikim pozitiv në stabilitetin politik të Shqipërisë dhe ishte i bindur se Partia Socialiste po shkonte drejt dezintegritimit apo “vetëvrasjes politike”.¹⁴⁴

Në mesin e afër 200 vëzhguesve ndërkombëtarë në zgjedhjet e 26 majit kishte edhe vëzhgues të financuar nga SHBA-të si “Shoqata për Kulturë Demokratike” si dhe zyrtarë nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë. Reagimi i Departamentit të Shtetit të SHBA-ve ishte i shpejtë. Më 28 maj, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Glyn Davies, deklaroi se raportet preliminare nga vëzhguesit thonë se ka pasur parregullsi, disa edhe serioze, për të cilat duhet menduar thellë para se të vlerësohen zgjedhjet.¹⁴⁵

Udhëheqësit e opozitës në krye me Partinë Socialiste organizuan një miting në Tiranë për të shfaqur pakënaqësinë rreth zgjedhjeve dhe procesit zgjedhor. Qëllimi ishte të mbahej mitingu me çdo kusht, ndonëse i ndaluar nga policia pasi nuk ishte paraqitur

¹⁴³ “Reuters”, 26 maj 1996.

¹⁴⁴ “Washington Times”, 27 maj 1996.

¹⁴⁵ *US State Department Press Briefing*, 28 maj 1996.

tri ditë më herët para mbajtjes siç e kërkonte ligji, për të shfrytëzuar edhe prezencën e medieeve ndërkombëtare dhe vëzhguesve ndërkombëtarë që ende ishin në Shqipëri. Policia veprroi me dhunë dhe shpërndau nga sheshi Skënderbeu rreth 200 demonstrues në krye me udhëheqësit e opozitës.¹⁴⁶

Incidenti i 28 majit solli edhe ashpërsimin e qëndrimit të vëzhguesve ndërkombëtarë në Tiranë dhe me këtë udhëheqësit e opozitës e arritën qëllimin e tyre. Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut botoi raportin që theksonte se administrimi i zgjedhjeve nuk kishte qenë në përputhje me ligjin për zgjedhjet.¹⁴⁷ Instituti Kombëtar Demokratik nga SHBA-të, në vlerësimin e botuar theksonte se “parregullsitë e shpeshta gjatë votimit dhe reagimi i dhunshëm ndaj protestuesve më 28 maj kanë prekur rëndë ndershmërinë e procesit të votimit.”¹⁴⁸

Instituti Ndërkombëtar Republikan, në deklaratën rreth zgjedhjeve, vlerësonte se “megjithëse jo shumë të përhapura, parregullsitë që janë vënë re gjatë votimit ngrenë shumë pikëpyetje lidhur me zhvillimin dhe ndershmërinë e zgjedhjeve të vitit 1996 në disa zona të Shqipërisë.”¹⁴⁹

Në reagimin e parë, Departamenti i Shtetit të SHBA-ve adresoi shqetësimet te Qeveria e Shqipërisë për, siç thuhej, parregullsitë e raportuara nga OSBE dhe organizatat e ndryshme joqeveritare evropiane dhe amerikane si NDI dhe NRI, duke kërkuar nga Qeveria dhe partitë politike që të tregojnë maturi, të shmangin dhunën duke kërkuar zgjidhje paqësore.¹⁵⁰ Të nesërmen, qëndrimi i Departamentit të Shtetit u bë edhe më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë. Pas takimit që diplomatët amerikanë patën me përfaqësuesit e OSBE-së në Vjenë, u arrit qëndrim i përbashkët për të kërkuar nga Qeveria e Shqipërisë përsëritjen e zgjedhjeve në disa zona zgjedhore. Po ashtu,

¹⁴⁶ “Reuters”, 28 maj 1996.

¹⁴⁷“Observations of the Parliamentary Elections Held in the Republic of Albania May 26th and June 2nd 1996”, OSCE ODHIR dhe Elez Biberaj, “*Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*”, (Tiranë: AIIS 2011), fq. 407.

¹⁴⁸ NDI for International Affairs, “Comment on the May 26 1996 Albanian Elections”, 31 maj 1996 dhe Elez Biberaj, “*Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*”, (Tiranë: AIIS 2011), fq. 407.

¹⁴⁹ International Republican Institute, “Albanian Parliamentary Election Observation, Mission Preliminary Statement”, 28 maj 1996 dhe Elez Biberaj, “*Shqipëria në Tranzicion 1990-2010*”, (Tiranë: AIIS 2011), 408.

¹⁵⁰ *US State Department Press Briefing*, 30 maj 1996.

kërkohej nga Qeveria që përveç përsëritjes në disa zona të marrë parasysh “parregullsitë e mëdha” të procesit zgjedhor për proceset e ardhshme.¹⁵¹ Në ndërkohë, opozita ndërmoi një hap tjetër për të mbajtur presionin mbi Qeverinë dhe mbi 100 kandidatë në zgjedhje filluan grevën e urisë në Tiranë dhe u tregua e vendosur se do të bojkotonte edhe raundin e dytë të zgjedhjeve më 2 qershor 1996. Në të njëjtën kohë, Qeveria akuzoi misionin vëzhgues të OSBE-së, më saktësisht një pjesë të tij, se kishin simpati për socialistët dhe se ishin të njëanshëm në vlerësimin për procesin zgjedhor.

Departamenti i Shtetit të SHBA-ve përforcoi qëndrimin për nevojën e ndryshimit të procesit zgjedhor në Shqipëri para përsëritjes së zgjedhjeve. Në deklaratën e 19 qershorit 1996 administrata amerikane kërkoi nga Qeveria e Shqipërisë që të rishikojë çështjen e zgjedhjeve dhe të bashkëpunojë me OSBE-në dhe vëzhguesit ndërkombëtarë.¹⁵²

Presidenti Berisha bëri një përpjekje për të përmirësuar imazhin e tij në raport me situatën e krijuar me administratën amerikane. Në qershor 1996 ai pranoi miqtë e tij nga administrata republikane e ish-Presidentin George H. Bush dhe ish-Kryesuesin e Shtabit të Përgjithshëm Collin Powell në Vlorë. Sipas njoftimeve për media, ish-Presidenti Bush kishte përgëzuar arritjet dhe zhvillimin e suksesshëm të demokracisë në Shqipëri, ndërsa Presidentin Berisha për suksesin e privatizimit në vend.

Presidenti Berisha mbeti i palëkundur në qëndrimin e tij se nuk do të kishte përsëritje të zgjedhjeve në Shqipëri. Në Forumin e Krans Montanës, në qershor të vitit 1996, ai theksoi se parregullsitë e shprehura do të përmirësoheshin dhe se zgjedhjet e reja do të mbaheshin sipas planit në vitin 2000.

Megjithatë, administrata amerikane e bëri të qartë se drejtimi dhe masat që planifikonte Qeveria dhe Presidenti Berisha nuk mjaftonin. Në dëshminë e mbajtur para Nën-Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Veprimtaritë Ndërkombëtare, Rudolf V. Perina, Zëvendës Ndihmës Sekretari i Parë i Departamentit të Shtetit, theksoi se SHBA-të po rishikonin marrëdhëniet me Shqipërinë pas “parregullsive serioze që janë

¹⁵¹ *US State Department Press Briefing*, 31 maj 1996.

¹⁵² *US State Department Press Briefing*, 19 qershor 1996.

shfaqur në zgjedhjet e majit” përfshirë edhe programet e ndihmës ekonomike. Perina shpjegoi se nga Qeveria e Shqipërisë do të kërkohej hapja e dialogut politik me opozitën për të miratuar Kushtetutën e re dhe për të mbajtur zgjedhjet e reja parlamentare sa më shpejt që është e mundur.

Si rrjedhim i presioneve politike nga jashtë dhe brenda, Partia Demokratike hapi dialogun politik me opozitën për të gjetur zgjidhjen. Të dyja palët kishin arsytet e veta për këtë dialog, demokratët për të shmangur presionin, ndërsa opozita e shihte si rast të ri për t’u kthyer përsëri në faktor veprues në Shqipëri. Instituti Ndërkombëtar Republikan, dega në Tiranë, udhëhequr nga Peter Dickinson, ndërmjetësoi në bisedat në mes të forcave politike dhe në fund autoritetet pranuan që të zbatojnë shumicën e rekomandimeve të INR për ndryshime ligjore dhe procedurale në ligjin e zgjedhjeve. Në gusht 1996, Presidenti Berisha nxori një dekret që krijonte Komisionin Qendror Zgjedhor. Pastaj, në shtator 1996, Presidenti Berisha organizoi një tryezë të rumbullakët me përfaqësuesit e trembëdhjetë partive politike dhe pranoi shumicën e kërkesave të opozitës lidhur me procedurat e zgjedhjeve lokale. Kjo nënkuptonte përfaqësim proporcional të partive politike në komisionet zgjedhore ku nënkryetari i komisionit do të vinte nga Partia Socialiste, pastaj shtoi kohën e shfrytëzimit të radiotelevizionit për partitë opozitare, lehtësoi procedurat për marrje të lejeve për mitingje propaganduese.

Në tetor 1996, Qeveria kërkoi që misioni ODHIR të zvogëlohej në numër, gjë që shtyu këtë mision të tërhiqej plotësisht. Ministri i Jashtëm, Tritan Shehu kritikoi misionin ODHIR, në një konferencë shtypi në Tiranë të mbajtur më 16 tetor, përderisa zëdhënësi i Partisë Socialiste, Kastriot Islami largimin e misionit të ODHIR e cilësoi si lëndim të imazhit të demokracisë në Shqipëri.

Departamenti i Shtetit të SHBA-ve reagoi të njëjtën ditë. Në prononcimin për media u theksua se vendimi për largimin e misionit të OSCE-ODHIR-it ishte “më shumë se dëshpërues”.¹⁵³

¹⁵³“Washington Post”, duke cituar zëdhënësen e Departamentit të Shtetit Elizabeth Pryor

Në një prononcim edhe më të ashpër, më 17 tetor, Kryesuesi i Komisionit US-OSCE, Republikani Christopher H. Smith dhe Nënkryetari Senatori Alfonse D'Amato e cilësuan kërkesën e Qeverisë për zvogëlim të numrit të anëtarëve të misionit ODHIR si “jashtëzakonisht të papranueshme”, ndërsa përkrahën vendimin e këtij misioni për t’u tërhequr nga vëzhgimi i zgjedhjeve. Sipas tyre, Shqipëria po bëhej secilën herë më pak e hapur dhe më pak tolerante ndaj pluralizmit politik.

Në këto kushte të zhvillimeve të vrullshme politike, presioni për një organizim të mirë dhe mbarëvajtje të rregullt të zgjedhjeve ishte mbi autoritetet e shtetit. Zgjedhjet lokale u mbajtën më 20 tetor 1996 dhe u vëzhguan nga qindra vëzhgues ndërkombëtarë, nga Këshilli i Evropës, SHBA-të dhe organizatat e tjera të specializuara për monitorimin e zgjedhjeve. Partia Demokratike fitoi në 58 nga 64 Bashki, përkthyer në vota rreth 90% të tyre dhe në masë vërtetuan rezultatin e zgjedhjeve parlamentare. Vëzhguesit e huaj u shprehën të kënaqur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve duke shpresuar se parregullsitë do të trajtoheshin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Departamenti i Shtetit të SHBA-ve u shpreh se zgjedhjet ishin demokratike dhe se shprehën vullnetin e popullit të Shqipërisë dhe përsëri theksuan kërkesën që Qeveria e Shqipërisë të punojë drejt fillimit të një procesi gjithëpërfshirës për miratimin e Kushtetutës së re dhe mbajtjes së zgjedhjeve të reja parlamentare.¹⁵⁴

Fitorja e Partisë Demokratike dhe e Presidentit Berisha ishte e plotë, por raportet me Departamentin e Shtetit dhe administratën e Presidentit Clinton ishin dëmtuar. Presidenti Berisha ende gëzonte përkrahje në radhët e Departamentit të Mbrojtjes, i cili kishte interesat e veta të investuara në Shqipëri dhe çmonin rolin e Presidentit Berisha në raport me çështjet e përkrahjes logjistike për misionet ushtarake të NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe ruajtjen e pozicionit të kujdesshëm ndaj zhvillimeve në Kosovë. Ndonëse Presidenti Berisha ishte kryesisht përgjegjës për ftohjen e raporteve me Departamentin e Shtetit të SHBA-ve, kishte mendime se një zhvillim i tillë i raporteve i konvenonte administratës së Presidentit Clinton. Me arritjen e paqes

¹⁵⁴ *US State Department Press Briefing*, 31 tetor 1996.

në Bosnjë dhe Hercegovinë, kjo administratë dëshironte të fokusohet më shumë në partnerë të tjerë në Ballkan, në radhë të parë në Millosheviqin.¹⁵⁵

Gjendja politike në Shqipëri mbeti e polarizuar edhe pas zgjedhjeve lokale. Partia Demokratike shtrëngoi qëndrimin se nuk do të hartohet Kushtetuta e re në një proces gjithëpërfshirës jashtë Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa Partia Socialiste nuk dëshironte të hynte në Kuvend për të mos legjitimuar rezultatin e zgjedhjeve të 26 majit. Në këtë situatë nuk kishte një organizëm apo instrument ndërkombëtar që do të ndihmonte tejkalimin e ngërçit. Në anën tjetër, gjendja ekonomike mbeti e rëndë dhe e pandryshuar. Inflacioni u rrit në 20% në vitin 1996 krahasuar me 5% në vitin 1995, deficitin buxhetor ishte 260 milionë dollarë, ndërsa Banka Qendrore kishte vetëm 270 milionë dollarë rezerva valutore. Ngjarjet e fundvitit dhe kriza e kompanive huadhënëse që veprimtarinë e bazonin në formë të skemave financiare piramidale do të sjellin ndryshime të mëdha në Shqipëri. Në shtator 1996, Fondi Monetar Ndërkombëtar kërkoi nga Qeveria që të distancohet nga veprimtaria e këtyre kompanive dhe të ndërmarre masa për të mos lejuar përhapjen e mëtejme. Në tetor 1996, Nënsekretari për Çështje Globale në Departamentin e Shtetit të SHBA-ve, Timothy Wirth, në takimin me Ministrin e Mbrojtjes, Safet Zhulalin në Washington, i tërhoqi vëmendjen Qeverisë për mundësinë e kolapsit të kompanive të skemave piramidale dhe pasojave që do të ndodhin.¹⁵⁶

Dukej se ishte vonë, dhe në dhjetor të vitit 1996 filloi mbyllja e kompanive të tilla që sollën humbjen e kursimeve të shumë shqiptarëve. Në disa raporte flitej edhe për mbi një miliard dollarë të humbur. Humbja e madhe financiare e kursimeve do të dëshpërojë qytetarët e Shqipërisë dhe do të krijojë parakushtet për ndryshimet e mëdha dhe krizën që do të sjellë rrëzimin e Qeverisë dhe largimin e Partisë Demokratike nga pushteti.

¹⁵⁵ Gabriel Partos, "Albania: Conflict Prevention and Crisis Management", (London: International Security Information Service, 1997), fq. 5.

¹⁵⁶ Dhimitër Binaj, "An Analysis of US-Albanian Security Relations in light of the war on terrorism", Naval Postgraduate School Monterey, (California, December 2004)

KAPITULLI II

SHBA-TË DHE KOSOVA 1989-1997

II.1 Kosova nën Serbinë 1912-1988

Historia e Kosovës në shekullin e XX është histori e dhunës, e fushëbetejës permanente në mes të pushtuesve serbë dhe shqiptarëve. Konflikti në mes të dy popujve është bartur nga shekulli XIX, nga brezi në brez, ndërsa edhe tani kur Kosova është e pavarur dhe sovrane animozitetet ende shfaqen, pasi Serbia ende ka qëndrim armiqësor ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Përgjatë gjithë shekullit XX politika e dhunës, e përjashtimit dhe e diskriminimit kundër shqiptarëve të Kosovës është shfaqur ciklikisht në formën e një politike apo fushate, të planifikuar me qëllimin përfundimtar shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova dhe serbizimin e territorit të Kosovës. Si në fillim të shekullit gjatë Luftërave Ballkanike, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe në fund të shekullit në Luftën e Kosovës, shqiptarët e Kosovës kanë qenë qenë buzë greminës dhe afër shpërbërjes, shpërnguljes dhe shfarosjes. Ishte dhe mbetet fuqia e brendshme dhe motivimi i jashtëzakonshëm që i ka ruajtur shqiptarët e Kosovës dhe i ka udhëhequr në rrugën e rezistencës, flijimit dhe rilindjes.

Fillimi i rënies së Perandorisë Osmane në Evropë dhe rritja e aspiratave të popujve të tjerë në Ballkan për të krijuar shtetet e tyre nacionale kanë shtyrë shqiptarët që të fillojnë të organizohen për të mbrojtur territoret e veta. Në vitin 1878, Serbia filloi fushatën ushtarake jugore duke pushtuar qytetin e Nishit e më pastaj edhe rajonin e Toplicës, Vranjës, Leskovcit dhe Prokuples. Llogaritet se mbi 50.000 shqiptarë janë dëbuar brutalisht me dhunë dhe në mënyrë të organizuar nga këto vendbanime dhe

shumica u vendosën në Kosovën e sotme.¹⁵⁷ Pas Kongresit të Berlinit këto territore mbetën pjesë e Serbisë.

Shqiptarët u organizuan dhe u bashkuan dhe në qershor të vitit 1878 krijuan “Lidhjen e Prizrenit”, një organizatë politike dhe ushtarake e cila për qëllim kishte mbrojtjen e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre në një entitet të vetëm. Ekspansioni i Serbisë drejt jugut dhe Kosovës ishte pjesë e planit “Naçertanije” të Ilija Garashinit, në të cilin kërkohet forcimi i Serbisë me pushtimin e Kosovës dhe të Maqedonisë për të mbushur hapësirën gjeostrategjike pas largimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani.

Lidhja e Prizrenit u tregua e suksesshme duke kontrolluar Kosovën në periudhën 1880-1881, pastaj u vazhdua nga Lidhja e Pejës (1899) si dhe kryengritjet e mëdha të armatosura të viteve 1910, 1911 dhe 1912 kundër Perandorisë Osmane. Pika kulmore ishte pushtimi i Shkupit nga 16.000 shqiptarë më 14 gusht 1912, pas të cilit Sulltani pranoi 14 pikat e Hasan Prishtinës. U krijua Shqipëria etnike brenda Perandorisë Osmane, që përfshinte edhe Kosovën. Por, kjo nuk do të zgjaste shumë.¹⁵⁸

Gjatë periudhës midis viteve 1878-1912 në Kosovë dhe Maqedoni pati kryengritje, revoltë, jostabilitet dhe Perandoria Osmane u largua nga Ballkani. Në tetor të vitit 1912, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria e Greqia i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Në nëntor 1912, Shqipëria shpalli pavarësinë në Vlorë në përpjekje për të ruajtur entitetin shqiptar. Deri në fund të vitit 1912, Serbia pushtoi shumicën e Kosovës, ndërsa Mali i Zi qytetet e Kosovës perëndimore.

Ushtria serbe hyri në tetor të vitit 1912 në Kosovë, të cilën e pushtoi brenda tri javëve, dhe më 23 tetor 1912 zyrtarisht konfirmoi se ka përfunduar me operacionin e “çlirimit” të Kosovës. Ushtria serbe dhe trupat paraushtarake ndërmorën një mori masakrash të tmerrshme, fushata dëbimesh në përgjithësi, një dhunë që do të përsëritet edhe në fund të shekullit të XX gati në mënyrë identike. Dhunën e ushtruar korrespondentët e huaj të asaj kohe e cilësuan “asgjësim sistematik të popullsisë

¹⁵⁷ Tim Judah, *Kosovo What everyone needs to know* (Oxford University Press 2008), fq35.

¹⁵⁸ Peter Bartl, *Albanien* (Pustet, Regensburg), fq121-133.

muslimane apo shqiptare”.¹⁵⁹ Në këtë periudhë sipas shënimeve otomane, austro-hungareze, por edhe serbe, shumica e popullatës në Kosovë ishte shqiptare dhe, varësisht prej burimeve, përbënte prej 65%-80%, ndërsa ajo serbe 20-35%.¹⁶⁰

Shqiptarët dhe serbët u ndeshën sërish gjatë tërheqjes së ushtrisë serbe nëpër Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore. Kosova në këtë periudhë u pushtua nga trupat austriake dhe bullgare, të cilat u përqendruan deri në vijën kufitare me Shqipërinë e atëhershme.

Më herët, më 18 janar 1913, qeveria e Serbisë i dërgoi një memorandum fuqive të mëdha evropiane, në përgjigje të një memorandumit të qeverisë së Shqipërisë të hartuar në Vlorë. Memorandum serb këmbëngulte në tri arsye në favor të aneksimit serb të Kosovës :

1. E drejta historike e mbështetur në kujtimin e Perandorisë së Dushanit dhe të Patrikanës së Pejës.
2. E drejta etnografike e pagjymtuar nga “invazioni i arnautëve” (referim për imigrimin shqiptar)
3. E drejta morale si një komb më i qytetëruar.¹⁶¹

Shtetet fituese të Luftës së Parë Botërore, Serbisë i dhuruan Kosovën kryesisht për shkak të humbjeve të pësuar, 1,3 milionë Serbë të vrarë apo 1/3 e popullatës së Serbisë.¹⁶²

Në tetor 1918, serbët u rikthyen në Kosovë dhe Maqedoni dhe në tri vitet e ardhshme shtypën me egërsi rezistencën e shqiptarëve të Kosovës. Në nëntor 1918 në Shkodër u krijua Komiteti për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, i njohur si Komiteti i Kosovës, i udhëhequr nga Hasan Prishtina, që ndihmoi rezistencën ‘kaçake’ të shqiptarëve në

¹⁵⁹ Leon Trotsky, *The Balkan Wars 1912-1913*, (New York: Monad Press 1980), 286, 266-272.

¹⁶⁰ Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, (London: Pluto Books 2000), fq. 9.

¹⁶¹ Marco Dogo, *Albanesi e Serbi le radici del conflitt*; (Marco 1992), fq. 54.

¹⁶² Kjell Magnusson, *The Serbian Reaction: Kosovo and Ethnic Mobilization Against Serbs*, (Nordic Journal of Soviet and East European Studies, 1987), dhe Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, (London: Pluto Books 2000),

Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni. Në janar dhe shkurt 1919, forcat serbe vranë dhe plagosën me mijëra shqiptarë, sipas disa të dhënave rreth 6000 duke shkatërruar 3873 shtëpi. Ndërsa, në mes të viteve 1918-1921 mbi 12000 shqiptarë të Kosovës janë vrarë nga ushtria serbe.¹⁶³ Numri i luftëtarëve shqiptarë arriti në 10.000, por nuk mund të mateshin me ushtrinë serbe. Rezistenca e Kaçakëve praktikisht u shua në vitin 1922. Fundi i rezistencës së Kaçakëve nuk erdhi vetëm si rezultat i dominimit të forcave serbe, por edhe dallimeve brendashqiptare. Në vitin 1920, Bajram Curri ishte Ministër i Luftës në Qeverinë shqiptare, ndërsa në vitin 1921, Hasan Prishtina u emërua kryeministër. Në vitin 1922, Ahmet Zogu, Ministër i Punëve të Brendshme u pozicionua kundër KK, por kosovarët dhe oponentët e tjerë e rrëzuan nga pushteti në vitin 1924. Një vit më vonë, Zogu u kthye dhe me ndihmën edhe të forcave jugosllave dhe Gardës së Bardhë ruse e mori pushtetin në Tiranë. Bajram Curri u vra në vitin 1925, ndërsa Hasan Prishtina në vitin 1933.¹⁶⁴

Qeveria në Beograd e filloi procesin e “denacionalizimit” të Kosovës duke ndaluar përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe botimet në gjuhën shqipe.¹⁶⁵ Në vitin 1929, Mbreti i Mbretërisë së Serbëve-Kroatëve-Sllovenëve, apo Jugosllavisë së Parë, e ndau vendin në nëntë krahina (banovina në serbokroatishte), kështu pjesa jugore e Kosovës u bë pjesë e Banovinës së Vardarit që ishte Maqedonia, pjesa verilindore u bë pjesë e Banovinës së Moravës me qendër në Nish, Serbi, ndërsa pjesa veriperëndimore u bë pjesë e Banovinës së Zetës që ishte Mali i Zi. Kështu, Kosova më nuk ekzistonte si entitet në Jugosllavinë e Parë. Po ashtu, qeveria jugosllave shqiptarët i konsideronte civilizim inferior jo të barabartë me pakicat e tjera si gjermanët, hungarezët, sllovakët dhe të tjerët. Kështu, shqiptarët nuk i gëzonin të drejtat e pakicave sipas “Traktatit të St. Germain”, të arritur në vitin 1920. Për pozitën e rendë të shqiptarëve në Mbretërinë e Serbisë, Ligës së Kombeve u ishin drejtuar me shkrim priftërinjtë Gjon Bisaku,

¹⁶³ Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, fq. 273 dhe fq. 267.

¹⁶⁴ Tim Judah, “*Kosovo what everyone needs to know*”, (Oxford University Press 2008), fq. 42-43 dhe Oliver Jens Schmitt, “*Kosova Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*”, (Prishtinë: Koha 2012), fq. 152.

¹⁶⁵ Branka Magas, *The Destruction of Yugoslavia: Tracking the Break-up 1980-92*, (London: Verso 1993), fq. 30.

Shtjefën Kurti dhe Luigj Gashi. Në letër theksohej se “Jugosllavia ka organizuar banda të armatosura që terrorizojnë shqiptarët dhe shkatërrojnë fshatrat e tyre, ndërsa çdo akt i shkatërrimit pasohet me kolonizimin e vendbanimeve të tyre nga serbët dhe malazezët. Jugosllavia po provokon në secilën mënyrë shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Qeveria jugosllave u përgjigj se fjala është për Komitetet e shqiptarëve irredentistë, që janë të lidhur me Shqipërinë”.¹⁶⁶ Qeveria serbe e Beogradit filloi me programin e kolonizimit të Kosovës duke sjellë rreth 70.000 kolonë serbë dhe malazezë në Kosovë në dy fushata në mes të viteve 1922-1929 dhe 1933-1938. Për kolonët u ndërtuan 330 vendbanime dhe fshatra, 12.689 shtëpi, 46 shkolla dhe 32 kisha ortodokse.¹⁶⁷ Në vitin 1935 në Beograd është mbajtur Konferenca Ndërministrore, në të cilën u vendos që shqiptarët që banonin në rajonet kufitare të shpërngulen të parët, ndërsa prona e tyre u deklarua pronë shtetërore. Qeveria e Beogradit konfiskoi 47.044 hektarë tokë të punueshme të shqiptarëve të Kosovës.¹⁶⁸ Njëkohësisht u nënshkrua një traktat me Turqinë për “kthimin” e “Turqve”, që në të vërtetë ishin shqiptarë, në Turqi, të nënshkruar më 11 korrik 1938, që rezultoi me emigrimin e ndërmjet 90.000-150.000 shqiptarëve në Turqi. Përqindja e serbëve në Kosovë në vitin 1928 ishte rritur në 38% nga 24% në vitin 1919.¹⁶⁹

Nacionalistët serbë vazhduan presionet mbi shqiptarët edhe më tutje. Pjesëtari i të ashtuquajturit “Klubi Kulturor i Beogradit” historiani Vasa Çubrilloviq, më 7 mars 1937 paraqiti “Memorandumin për dëbimin e shqiptarëve” nga Kosova. Në atë dokument ai theksonte se “e vetmja mënyrë për ta trajtuar çështjen e shqiptarëve është forca brutale e organizuar shtetërore, sepse nëse nuk i kryejmë llogaritë me ta tani në kohën e duhur brenda 20-30 vjetëve do të ballafaqohemi me një irredentizëm të tmerrshëm shenjat e të cilit janë të dukshme dhe të cilat pashmangshëm do të sjellin

¹⁶⁶ Vladimir Djuro Degan, “Medjunarodno uredjenje položaja muslimana sa osvrtom na uredjenje drugih vjerskih i i narodnosnih skupina na području Jugoslavije” Prilozi VIII, (Instituti i Lëvizjes Punëtore Sarajevë 1972).

¹⁶⁷ Hivzi Islami, “*Demographic Reality in Kosovo*” dhe Howard Clark, “Civil Resistance in Kosovo”, (London: Plutobooks), 13.

¹⁶⁸ Nikola Gacesa “Settlement of Kosovo and Metohija after World War I and the Agrarian Reform, Kosovo: Past and Present”, 102.

¹⁶⁹ Noel Malcolm, “*Kosovo a short history*”; (Pan 2002), 262.

në rrezik territoret tona jugore”.¹⁷⁰ Në Memorandumin e prezantuar, Çubrilloviqi theksonte se kolonizimi i Kosovës nuk mjafton dhe se duhej të krijohej psikoza e frikës në mesin e shqiptarëve, të armatoseshin kolonët dhe serbët vendas, të inicioheshin incidente lokale për t’i shtypur më pastaj me dhunë brutale. “Aparati shtetëror duhet të përdoret në çdo masë dhe shqiptarët të dënohen rreptë për secilin rast të shkeljes së ligjit, taksat të mblidhen me çdo kusht. Shqiptarët janë të ndjeshëm në çështjet e fesë dhe besimit, prandaj duhet të keqtrajtojmë edhe priftërinjtë edhe imamët. Çetnikët dhe malazezët duhet të lejohen të veprojnë në Kosovë dhe në Dukagjin duke provokuar konflikte me shqiptarët që pastaj duhet të shtypen me gjak sipas një metode që Serbia e ka zbatuar në mënyrë mjaft efikase pas vitit 1878, rrënimin deri në themel të fshatrave dhe vendbanimeve shqiptare”. Të gjitha këto masa Serbia do t’i zbatojë në Kosovë, gati duke i replikuar, në vitet 1998-1999.

Po ashtu, Vasa Çubrilloviq, që më vonë do të jetë udhëheqës i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, mbante qëndrimin se nëse “Gjermania mund të përjashtojë dhjetëra mijëra hebrenj dhe Rusia mund t’i transferojë me miliona njerëz nga njëra pjesë në pjesën tjetër të kontinentit, transferimi i disa qindra mijëra shqiptarëve nuk do të shkaktonte fillimin e luftës botërore”.¹⁷¹ Por, në vend të largimit të shqiptarëve do të ndodhte e kundërta. Shqiptarët do të bashkoheshin, ndërsa serbët do të humbnin dominimin mbi Kosovën. Në Luftën e Dytë Botërore, Jugosllavia kapitulloi më 17 prill 1941 dhe si rezultat i marrëveshjeve të Fuqive të Boshtit, Kosova u nda në tri pjesë. Pjesa më e madhe iu bashkua Shqipërisë nën administrimin italian, pjesa veriore Serbisë nën administrimin gjerman, ndërsa pjesa lindore iu bashkua Bullgarisë. Shqiptarët e Kosovës i shfrytëzuan rrethanat e krijuara për të kërkuar hakmarrje posaçërisht ndaj kolonëve serbë dhe deri në prill të vitit 1944, sipas oficerit politik gjerman Hermann Neubacher, rreth 40.000 serbë ishin shpërngulur nga Kosova.¹⁷²

¹⁷⁰ Ibrahim Berisha (redaktor), *Serbian Colonization and Ethnic Cleansing of Kosova: Documents and Evidence*, (Prishtina 1993), fq21-23.

¹⁷¹ Tim Judah, *The Serbs: History, Myth and Deconstruction of Yugoslavia*, (New Heaven, London, Yale University Press, 1997), fq. 149.

¹⁷² Noel Malcolm, *Kosovo a short History*, (New York University Press 1998) , ff. 305-313.

Arritja e forcave nazifashiste kishte një domethënie tjetër dhe më të veçantë për shqiptarët e Kosovës. Në rrethanat e krijuara me këtë pushtim ishte e domosdoshme që lufta kundër tij të lidhej ngushtë me zgjidhjen e çështjes kombëtare, ku në të njëjtën kohë shqiptarët e Kosovës donin ta largonin pushtuesin e ri, por shumë më tepër pushtuesin serb.¹⁷³ Ndonëse u krijuan strukturat komuniste në Kosovë të krijuara nga Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe me mbështetje nga Shqipëria, respektivisht Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Shqipërisë, masat e gjera të shqiptarëve të Kosovës nuk i jepnin përkrahje sepse vetë nocioni Jugosllavi për shqiptarët e Kosovës ishte sinonim i dhunës shtetërore antishqiptare të ushtruar nga serbët. Në anën tjetër, nacionalistët shqiptarë nuk iu bashkuan forcave nacionalçlirimtare, sepse mendonin se një luftë e udhëhequr nga komunistët do të përfundonte me rivendosjen e pushtetit jugosllav-serb përsëri në Kosovë. Me kapitullimin e Italisë, nga data 16-20 shtator 1943, në Prizren u mbajt Lidhja e Dytë e Prizrenit, si organizatë që angazhohej për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Në krye të Lidhjes u zgjodh Rexhep Mitrovica që më vonë, më 16 shtator 1943, do të emërohej Kryeministër i Qeverisë në Tiranë. Lidhja kërkoi ndihmë në krijimin e një force ushtarake që do ta mbronte Kosovën dhe trojet e tjera shqiptare me ndihmën e Gjermanisë, por përpjekja e rekrutimit dhe trajnimit të forcës së armatosur nuk pati sukses për shkak të dallimeve në mes të udhëheqësve të Lidhjes dhe ushtarakëve gjermanë. Lidhja donte që forcat e krijuara të përdoreshin vetëm në Kosovë dhe Shqipëri, ndërsa ushtarakët gjermanë kërkonin dislokimin e tyre edhe në frontet e tjera.

Me tërheqjen e trupave gjermane nga Ballkani u zbeh edhe ndikimi i Lidhjes në Kosovë, megjithatë Lidhja e Dytë e Prizrenit ishte organizata më e rëndësishme nacionaliste që veprroi në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Lidhja mori përsipër mbrojtjen e trojeve etnike nga rreziku sllav dhe bashkimin e tyre në një shtet të vetëm kombëtar.¹⁷⁴ Më 31 dhjetor 1943 dhe 1 dhe 2 janar 1944 në fshatin Bujan, në Malësinë e Gjakovës u mbajt Konferenca e Bujanit me qëllim të bashkimit të të gjitha forcave të armatosura shqiptare në luftë kundër forcave të Fuqive të Boshtit. Rezoluta

¹⁷³ *Historia e Popullit Shqiptar IV*, (Toena Tiranë, 2008), fq. 131.

¹⁷⁴ *Historia e Popullit Shqiptar IV*, (Toena Tiranë, 2008), ff. 131-140

përfundimtare garantonte shqiptarët se “rruga që duhet ndjekur për të realizuar aspiratat kombëtare të popullit të Kosovës është angazhimi në luftën e përbashkët me popujt e tjerë kundër pushtuesit nazist; përmes kësaj lufte populli shqiptar do të ketë mundësi të vetëvendosë për fatin e vet deri në shkëputje”.¹⁷⁵ Në fund Partia Komuniste e Jugosllavisë as nuk e pranoi e as nuk e respektoi vendimin e Konferencës së Bujanit.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës u përballën me mashtrimet dhe dhunën e komunistëve jugosllavë e sidomos të atyre serbë. Përderisa brigadat shqiptaro-kosovare luftonin në Serbi dhe Kroaci, brenda Kosovës mbi shqiptarët ushtrohej shtypje e egër, arrestime, vrasje dhe terror i vërtetë. Pas revoltave të shqiptarëve në dhjetor 1944 dhe janar 1945, me urdhër të Josip Broz Titos në Kosovë u vendos administratë ushtarake (8 shkurt - 5 korrik). Gjatë kësaj periudhe u organizuan gjyqe që dënuan e burgosën një numër të madh të shqiptarëve, shumë të tjerë u vranë dhe u zhdukën në prita të organizuara nga ushtria komuniste jugosllave. Disa historiografë shqiptarë vlerësojnë se numri i shqiptarëve të vranë e të plagosur gjatë periudhës së administrimit ushtarak arrin në 47.000. Nga 8-10 korrik 1945 në Kuvendin e Prizrenit, të orkestruar nga Partia Komuniste e Serbisë, 137 delegatë prej tyre vetëm 32 shqiptarë, miratuan rezolutën me të cilën shprehej dëshira e popullit të Kosovës për t’u bërë pjesë e Serbisë.

Gjatë viteve 50-ta udhëheqësit nga Beogradi vazhduan me presionin dhe terrorin konstant ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ata nuk ishin viktimat e dhunës direkte, por raporti i Jugosllavisë së re komuniste, nën modelin e “vëllazërim-bashkimit” nuk ndryshoi shumë ndaj shqiptarëve të Kosovës që ende konsideroheshin ‘element i pabesueshëm’.¹⁷⁶ Jugosllavia e re nuk e donte emancipimin e shqiptarëve, Instituti i posakrijuar i Studimeve Albanologjike u ndalua, folklori shqiptar po ashtu, dhe rregulla të posaçme të shkrimit u aplikuan për shqiptarët e Kosovës për t’i veçuar nga ata të Shqipërisë. Plani i dizajnuar në vitin 1918 për shpërnguljen e shqiptarëve, por

¹⁷⁵ *Historia e Popullit Shqiptar IV*, (Toena Tiranë, 2008), fq. 143.

¹⁷⁶ Latinka Perović, *Zatvaranje kruga-ishod rascepa 1971-1972*, (Svijetlost: Sarajevo 1991), fq41.

edhe të turqve dhe myslimanëve të tjerë u riaktualizua.¹⁷⁷ Paralelisht me procesin e shkombëtarizimit, ku shqiptarët udhëzoheshin të regjistroheshin si turq për t'iu shpëtuar persekutimeve, zhvillohej aksioni i mbledhjes së armëve në fshatrat shqiptare. Vetëm në vitin 1956 policia jugosllave kishte torturuar mbi 60.000 shqiptarë gjatë aksionit të mbledhjes së armëve.¹⁷⁸ Shënimet rreth shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi nuk përputhen. Burimet turke theksojnë se nga viti 1949 deri në vitin 1957 në Turqi janë shpërngulur mbi 200.000 shqiptarë, ndërsa sipas historianëve kosovarë Pajazit Nushi, Hakif Bajrami, Ukshin Hoti, në periudhën 1950-1966 janë shpërngulur rreth 400.000 shqiptarë.

Me demonstratat e vitit 1968 shqiptarët e Kosovës arritën të sigurojnë përdorimin e flamurit kombëtar, deri atëherë të ndaluar, si dhe themelimin e Universitetit të Prishtinës (1970), që do të jetë gjenerator i ndërrimeve historike në Kosovë dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës në vitin 1975. Gjatë viteve të 70-ta shqiptarët e Kosovës u afirmuan në çdo lëmi të jetës shoqërore, në arsim dhe kulturë, duke përparuar dhe kishin më shumë liri nga regjimi i Beogradit. Por, nuk hoqën dorë nga kërkesa për t'u bërë të barabartë me republikat e tjera në Jugosllavi dhe për t'u shkëputur nga Serbia. Synimin e përbashkët për avancimin e statusit të Kosovës nga autonomia krahinore në Republikë e kishin të gjitha vijat politike në Kosovë. Kuadrot më të moderuara të shqiptarëve këtë mundoheshin ta arrinin përmes ndërrimeve kushtetuese, ndërsa një pjesë tjetër e shqiptarëve ishte më radikale dhe nën ndikimin elementeve të diasporës shqiptare, përmes së cilës në Kosovë depërtonin ide më radikale. Kësaj gjendjeje duhet t'i bashkohet edhe një pjesë e vijuesve të Universitetit të Prishtinës që përqaftuan teza radikale për zgjidhjen e çështjes së popullit shqiptar në Jugosllavi, jo vetëm në Kosovë.¹⁷⁹ Shqiptarët e Kosovës, me rritjen e potencialit intelektual, ekonomik e social me të gjitha mjetet kërkonin më shumë për veten dhe Kosovën, dhe kjo dukej vështirë e arritshme në sistemin komunist të Jugosllavisë së atëhershme.

¹⁷⁷ Petrit Imami, *Srbi i Albanci kroz vekove*, (Beograd: Samizdat FreeB92, 1999), fq. 323.

¹⁷⁸ Slavko Gaber dhe Tonci Kuzmanić, *Kosovo-Srbija-Jugoslavija* (Lubjanë: Krt 1989), fq. 71-72.

¹⁷⁹ Oliver Jens Schmit, *Kosova Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, (Prishtinë: Elefans, 2012), fq. 23.

Situata e tillë ringjalli nacionalizmin serb me Dobrica Ćosićin, kryeideatorin e nacionalizmit serb në Jugosllavinë komuniste, i cili ngritjen e Kosovës e shihte si rrezik të ngritjes së të gjithë shqiptarëve. Ai në ditarin e tij kishte shënuar: “Meqë bota është e tillë çfarë është, dhe Jugosllavia është e tillë çfarë është, shqiptarët kanë çdo të drejtë të luftojnë për bashkimin e kombit të tyre të ndarë. Askush nuk mund të jetojë i qetë në një ‘komunitet’ që ekonomikisht, ideologjikisht dhe politikisht udhëhiqet nga hegjemonia serbo-kroate. Shqiptarët e Jugosllavisë e kanë të ndaluar të bashkohen me shtetin amë të tyre. Për shkak të ‘demokracisë’ në Jugosllavi shqiptarët e Kosovës janë bërë avangarda nacionale dhe Piemonti i popullit shqiptar të shpërndarë. Ashtu siç po rrjedhin ngjarjet nuk ka zgjidhje tjetër përpos të krijohen vijat e demarkacionit, t’u jepet e drejta e vetë-vendosjes shqiptarëve, të ndryshohet Jugosllavia dhe të krijohen shtetet nacionale në Ballkan”.¹⁸⁰ Pra, kërkesat e shqiptarëve për të drejta më të mëdha ishin të njohura për serbët dhe të tjerët dhe ngritja politike, kulturore dhe ekonomike e tyre, pashmangshëm do të ballafaqonin Kosovën me pushtetin jugosllav. Rilindja nacionale shqiptare në Jugosllavi, posaçërisht në Kosovë, është rritur në vitet e 70-ta të shekullit XX. Kulminacioni u arrit me shënimin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, në vitin 1978, që inkurajoi shumë shqiptarë të rinj t’i zotohen Shqipërisë. Intensifikimi i bashkëpunimit kulturor në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Shqipërisë ndihmuan rritjen e nacionalizmit shqiptar dhe kufiri ndërmjet “afirmimit dhe ngritjes kombëtare” dhe “nacionalizmit” filloi të zhdukej.¹⁸¹ Në Kosovë popullata serbe ishte pakicë, shumë nga ata kurrë nuk e mësuan gjuhën shqipe dhe zgjidhjen për problemet e tyre në Kosovë, të çfarëdo natyre, e kërkonin nga Beogradi, ndërsa shqiptarët e Kosovës ishin në institucione shtetërore dhe ishin shumicë, por më me rëndësi kishin qëllim avancimin e mëtejme të statusit të Kosovës.

Kjo u pa menjëherë pas vdekjes së udhëheqësit komunist të Jugosllavisë, Josip Broz Titos, që vdiq më 4 maj 1980. Një vit më vonë, më 11 mars 1981 studentët e Universitetit të Prishtinës filluan demonstratat për kushte më të mira që eskaluan në demonstrata anti-jugosllave me kërkesa të qarta për Kosovën Republikë dhe lirin e

¹⁸⁰ Dobrica Ćosić, *Piščevi zapisi 1952-1968*, (Beograd: Filip Višnjić, 2000)

¹⁸¹ Petrit Imami, *Srbi i Albanci kroz vekove*, (Beograd: Samizdat FreeB92, 1999), fq333.

të burgosurve politikë. Autoritetet jugosllave dërguan njësi të mëdha policore dhe ushtarake në Kosovë rreth 45.000 ushtarë dhe 20.000 policë,¹⁸² arrestuan qindra protestues ndërsa numri i të vrarëve kurrë nuk është bërë zyrtar, por llogaritet të jetë në dhjetëra¹⁸³ apo qindra.¹⁸⁴ Udhëheqësia komuniste serbe i shfrytëzoi demonstratat e vitit 1981 për të cilësuar kërkesat e shqiptarëve si “separatiste”, “irredentiste”, “kundërrevolucionare” dhe për rezultat u shkarkuan udhëheqësit komunistë të nivelit krahinor të Kosovës, Mahmut Bakalli, Xhavit Nimani, Pajazit Nushi, etj. Pas përkrahjes publike që udhëheqja e RPS të Shqipërisë u bëri demonstratave të shqiptarëve të Kosovës më 8 prill 1981, udhëheqësit e Jugosllavisë e fajësuan edhe Shqipërinë. Si rezultat u ndërpre bashkëpunimi shkencor dhe kulturor me Shqipërinë, ndërsa mbi 300 intelektualë shqiptarë të Kosovës u burgosën dhe u izoluan në periudha 1-3 mujore. Ky sistem i ndëshkimit do të përsëritet edhe pas shtypjes së autonomisë në vitin 1989.¹⁸⁵

Në të njëjtën kohë kur shqiptarët e Kosovës po e kërkonin me çdo formë Kosovën më të lirë dhe më të avancuar, serbët e Kosovës filluan të ndiejnë presionin e rritjes së aspiratave shqiptare, ndërsa në Serbi filluan të dominojnë forcat centraliste që dëshironin Beogradin me më shumë vendimmarrje. Serbët e Kosovës kishin filluar edhe më herët të shpërngulen nga Kosova për motive kryesisht ekonomike: gjendja e vështirë ekonomike, mungesa e perspektivës profesionale, ofertat e majme nga shqiptarët në tregun e patundshmërive. Në periudhën 1971-1981, Kosovën e kishin braktisur rreth 30.000 serbë¹⁸⁶, në periudhën 1968-1971, pas largimit nga pushteti të udhëheqësit famëkeq komunist Aleksandar Ranković, nga Kosova ishin larguar afër 15000 serbë. Pas konflikteve të vitit 1981 u thellua ndarja në mes të shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë dhe filloi homogjenizimi etnik brenda bashkësive etnike dhe ndarja e theksuar territoriale. Në vitin 1985 në 666 prej 1435 bashkësive lokale në

¹⁸² *Histori e Popullit Shqiptar*, (Tiranë: Toena 2008), fq. 368.

¹⁸³ Tim Judah, *Kosovo What Everyone Needs to know*, (Oxford University Press 2008), fq. 58.

¹⁸⁴ Oliver Jens Schmit, *Kosova Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, (Prishtinë: Elefans, 2012), fq. 231.

¹⁸⁵ *Histori e Popullit Shqiptar*, (Tiranë: Toena 2008), fq. 369.

¹⁸⁶ Branka Magas, *The Destruction of Yugoslavia*, fq. 47.

Kosovë nuk jetonte asnjë serb, ndërsa në 150 të tjera serbët përbënin vetëm 3% të banorëve. Të tjerët ishin shqiptarë. Po ashtu, në 197 fshatra të Kosovës nuk kishte asnjë shqiptar.¹⁸⁷ Sipas statistikave jugosllave në vitin 1953 në Kosovë ka pasur 27% serbë dhe malazezë, ndërsa në kohën e regjistrimit të vitit 1991 kjo shifër ishte nën 10%.¹⁸⁸ Në të njëjtën kohë propaganda serbe në Beograd nuk pushonte me akuza dhe dëshmi të serbëve të persekutuar nga shqiptarët. Kështu raportohej për raste të dhunimit të femrave serbe nga shqiptarët, për sulme ndaj objekteve kishtare ortodokse, shkatërrimit të varrezave si mjete të presionit për të shpërngulur serbët dhe malazezët nga Kosova. Serbët kthyen në plan të parë paragjykimet për shqiptarët si komb armiqësor, bindje të cilat i kishin lënë anash në kohën e lulëzimit të socializmit vetëqeverisës.

Mediet në Serbi filluan fushatën e tyre historike antishqiptare, që do të përsëritet edhe në vitet e 90-ta, për shqiptarët dhe rritjen e tyre demografike të qëllimshme për t'i bërë “serbët pakicë në trojet e tyre historike dhe se kjo është vegla e shqiptarëve për të fituar atë që nuk arritën me kryengritjet e armatosura”.¹⁸⁹ Në këtë periudhë në Beograd zëdhënës i serbëve të Kosovës filloi të bëhet Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, ndërsa situatën e shfrytëzoi edhe Kisha Ortodokse Serbe për të ndërhyrë në krijimin e bindjeve politike në Beograd. Kombinimi i Akademisë Serbe dhe Kishës Ortodokse Serbe në formësimin e elitës politike në Beograd në bashkëveprim me elementet serbe në polici, e sidomos në Ushtrinë Popullore të Jugosllavisë, do të jenë me pasoja të tmerrshme për të gjithë popujt joserbë të Jugosllavisë, e posaçërisht për shqiptarët e Kosovës. Në shtator të vitit 1986 u publikua një dokument i quajtur “Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë”, i nënshkruar nga një grup i akademikëve serbë, që ndikoi në ashpërsimin e represionit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Procesi i krijimit të Memorandumit ishte iniciuar nga nacionalisti Dobrica Ćosić, i përjashtuar nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste në vitin 1968, përveç tjerash edhe për qëndrimin se ‘liderët politikë shqiptarë në PKJ janë separatistë’. Në

¹⁸⁷ Oliver Jens Schmit, *Kosova Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, (Prishtinë: Elefans, 2012), ff. 232-234.

¹⁸⁸ Marc Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, (Prishtinë: Koha 2011), fq. 74.

¹⁸⁹ “Politika”, Beograd: “Odjeci i reagovanja”, Dhjetor 6, 1988.

vitin 1984 së bashku me bashkëmendimtarë nga ASHAS filluan të krijojnë Memorandumin, të publikuar në shtator të vitit 1986, që do të trajtonte çështjen e serbëve në Jugosllavi. Në Memorandum theksohej se është shqetësuese që 24% të serbëve në Jugosllavi jetojnë jashtë Serbisë (kryesisht Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci), por numri rritet në 40% nëse shtohen edhe krahinat Vojvodina dhe Kosova. Gjuha në Memorandum bëhet historike kur trajtohet çështja e serbëve të Kosovës, ku thuhet se ata i janë të nënshtruar “gjenocidit fizik, politik, ligjor dhe kulturor dhe se kjo është një disfatë historike më e rëndë sesa disfatat e pësuar në Kryengritjet serbe të vitit 1804 apo 1941”. Në Memorandum theksohet se “në rast se gjërat nuk ndryshojnë në mënyrë radikale në më pak se dhjetë vite nuk do të ketë serbë në Kosovë dhe do të arrihej qëllimi i racistëve të Shqipërisë së Madhe, ndërsa fati i Kosovës është çështje vitale për gjithë kombin serb”. Sipas Memorandumit, udhëheqësit e Serbisë janë fajtorë pasi kanë lënë gjërat të degjenerojnë në masë të dëmshme për popullin serb dhe kërkohej nga ta që të mos vazhdojnë të jenë pasivë, por të ndërmarrin iniciativë. Rëndësia e këtij Memorandumi qëndron në krijimin e bazamentit të menduarit intelektual se Serbia ka të drejtë të veprojë siç do të veprojë në ish-Jugosllavi, por së pari në Kosovë.¹⁹⁰ Në të vërtetë, anëtarët e ASHAS që në vitin 1976 në botimin e “Librit të kaltër” kishin kërkuar ricentrazlizimin e Serbisë dhe rikthimin e Kosovës dhe Vojvodinës në kuadër të Republikës së Serbisë. Lidhja Komuniste e Serbisë e shfrytëzoi këtë moment për të filluar me projektin e rrënimit të autonomisë së Kosovës, që ishte projekt i përkrahur në disa shtresa dhe me paramendim të qartë nga intelektualët dhe ASHAS, Kisha Ortodokse Serbe, shërbimet inteligjente të Serbisë, policia dhe ushtria në terren dhe serbët e Kosovës. Në prill të vitit 1982, priftërinjtë ortodoksë apeluan te Sinodi i Shenjtë duke akuzuar shqiptarët e Kosovës për veprim sistematik të politikës së gjenocidit kundër serbëve. Në vitin 1984, teologu Atanasije Jeftić botoi librin që shënonte “dhunimin e vajzave të mitura dhe motrave të nderit në fshatrat dhe manastiret serbe në Kosovë” si dhe shpërnguljen e 200.000 serbëve dhe malazezëve në 15 vjetët e fundit.¹⁹¹

¹⁹⁰ Tim Judah, *Kosovo What everyone needs to know*, (Oxford University Press, 2008) 61-63.

¹⁹¹ Noel Malcolm, *Kosovo a short History*, (New York University Press 1998) , ff. 329,339.

Në vitin 1990 një grup intelektualësh serbë nga Beogradi krijoi Komisionin e Pavarur për të hulumtuar çështjen e dhunimeve të femrave serbe në Kosovë. Pas hulumtimeve botuan raportin në të cilin theksohej se: “imazhi i Kosovës i ngritur viteve të fundit si regjion ku dhunimet janë shtuar në përmasa alarmuese është i pasaktë. Akuzat për dhunimet e femrave serbe nga shqiptarët si dhe akuzat se kjo bëhet për arsye ‘nacionaliste’ janë të pasakta, ndërsa procedurat hetimore dhe ndëshkimore në raport me këtë vepër penale, pra dhunimit, në Kosovë nuk ndryshojnë nga mesatarja në Jugosllavi apo pjesë të tjera të Serbisë”.¹⁹²

Në janar të vitit 1986, 216 intelektualë të shquar serbë nënshkruan petitionin në të cilin thuhej “që qëllimi kryesor i shqiptarëve të Kosovës është Kosova etnikisht e pastër ku pastaj do të vazhdohet me pushtime të tjera të territoreve serbe, malaziasë, dhe maqedonase”. Kulminacioni i angazhimit nationalist serb u tregua me publikimin e Memorandumit të shtatorit 1986 ku theksohej se “në pranverë të vitit 1981 një luftë e hapur totale është deklaruar kundër popullit serb që ishte e përgatitur me kujdes paraprakisht në faza të ndryshme të reformave politike administrative dhe kushtetuese dhe se pjesa e mbetur e popullit serb në Kosovë e ballafaquar me terrorin fizik, moral dhe psikologjik është duke u bërë gati për eksod të përgjithshëm”.¹⁹³ Në vitin 1985, Komiteti i Serbëve dhe Malazezëve të Kosovës, organizoi mbledhjen e nënshkrimeve nën moton: “Kjo është toka jonë. Nëse Kosova dhe Metohija nuk janë serbe, ne nuk kemi tokën tonë”.¹⁹⁴ Arritën të mbledhin 2016 nënshkrime dhe në shkurt të vitit 1986 filluan me demonstrata të organizuara në Beograd.¹⁹⁵ Tendencat e tilla të shprehura hapur në shtresat e ndryshme të shoqërisë serbe dhe qëndrimet antishqiptare patën medoemos ndikim në punën dhe veprimet e Lidhjes Komuniste të Serbisë (LKS). Lëvizjet i nxiti Ivan Stamboliq, udhëheqës i LKS-së në vitet 1984-1987 dhe i Serbisë 1987-1988 para se të ndërrohej nga Slllobodan Millosheviqi. Më 24 prill 1987,

¹⁹² Report of Independent Commission -*The Kosovo knot: to untie or to cut* (Belgrade, Chromos 1990)

¹⁹³ Kosta Mihailović dhe Vasilije Krestić Memorandum of *Serbian Academy of Sciences and Arts: Answers to Criticisms*, Belgrade 1995.

¹⁹⁴ Laura Silber dhe A Little, *Yugoslavia: The Death of a nation* (Harmondsworth Penguin 1995), fq. 35.

¹⁹⁵ Kjell Magnusson, *The Serbian Reaction: Kosovo and Ethnic Mobilization Against Serbs*, Nordic Journal of Soviet and East European Studies, 1987, fq. 14-15.

Milloseviqi vizitoi qytezën e Fushë Kosovës për të qetësuar serbët lokalë që u konfrontuan me policinë lokale (kryesisht të përbërë nga shqiptarët). Ky moment shënon paraqitjen e tij të parë publike si komunist tani në petkun e nacionalistit populist, që mbrojnë serbët jashtë Serbisë. Këtë imazh Milloseviqi do ta shfrytëzojë gjatë gjithë viteve të 90-ta deri në përfundimin e karrierës dhe jetës së tij.

Në shtator të vitit 1987, Aziz Kelmendi, ushtar në Ushtrinë Popullore të Jugosllavisë, u akuzua dhe u dënua për vrasjen e katër ushtarëve të tjerë në një proces gjyqësor mjaft të dyshimtë, së bashku me tetë ushtarë të tjerë, në kohëzgjatje burgimi prej 2-20 vjet. Ky incident u politizua skajshmërisht nga mediet e Beogradit dhe vetëm shtoi atmosferën anti-shqiptare brenda serbëve të Serbisë që kërkonin ndryshime politike si dhe të qasjes ndaj Kosovës.

Në shtator të vitit 1987 në Plenumin e VIII-të të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, Milloseviqi nisi procesin e rrëzimit politik të Ivan Stamboliqit, duke paralajmëruar shfaqjen e një programi nacionalist të drejtuar kryesisht kundër Kosovës dhe shqiptarëve.¹⁹⁶ Në një nga intervistat e tij të para pas ardhjes në krye të Lidhjes Komuniste të Serbisë Milloseviqi theksoi se: “Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 duhet të rishikohet dhe debatohet në çdo element të saj që mbulon fushat si drejtësinë, lirinë, kulturën, gjuhën, shkrimin. “ Ndërsa për shqiptarët e Kosovës ai kishte shtuar: “Është fakt se rritja e numrit të lindjeve në Kosovë është ndër më të lartat në botë, kjo më nuk është tabu-temë dhe është pjesë e debatit publik. Rritja e lindjeve duhet të shikohet edhe në aspektet socio-politike. Popujt që jetojnë me apo pranë shqiptarëve po shndërrohen në pakica dhe po e humbin hapësirën e tyre për jetë”¹⁹⁷.

¹⁹⁶ Misha Glenny, *“The Fall of Yugoslavia*, (London: Penguin 1993), fq. 32.

¹⁹⁷ Slobodan Milosević, *Godina raspleta*, (BIGZ, Beograd 1989), revista “*NIN*” Beograd, 3 korrik 1988 dhe Sonja Biserko *Yugoslavia’s Implosion- Fatal attraction of Serbian Nationalism*, (Belgrade: Zagorac 2012), fq. 213

II.2 Roli dhe ndihma e SHBA-ve në krijimin e pluralizmit demokratik në Kosovë

Fillimi i rritjes së fuqisë së Slobodan Millosheviqit në Serbi dhe në Jugosllavi ka nisur në Kosovë. Kundërpeshë ishte organizimi i shqiptarëve të Kosovës në parti politike demokratike dhe në krijimin e institucioneve të Kosovës, që u quajtën nga pushtetit i Beogradit “institucione ilegale”, ndërsa nga vendet e Perëndimit “institucione paralele”. Po ashtu, shqiptarët e Kosovës zgjodhën rrugën joviolente të përballjes me aparatin represiv të Beogradit dhe Ibrahim Rugovën si udhëheqës të tyre. Rugova dhe Millosheviqi do të dominojnë skenën politike në Kosovë dhe në Serbi deri në fillimin e luftës së hapur në Kosovë në vitin 1998. Në të gjitha vetitë dhe tiparet e tyre ata ishin të ndryshëm. Slobodan Millosheviqi kishte lindur në qytetin Pozharevc, më 20 gusht 1941 dhe ishte anëtarësuar në Partinë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1959. Në radhët e PKJ-së më vonë LKJ-së kishte përparuar pahetueshëm duke u qëndruar lojal eprorëve të tij. Millosheviqin e kishte përkrahur me vite udhëheqësi komunist i Serbisë Ivan Stamboliq, të cilin Millosheviqi e përmbysi në luftën politike të brendshme brendapartiake dhe urdhëroi vrasjen e tij në vitin 1999. Millosheviqi konsiderohej një aparatçik partiak, jurist dhe bankier, që hetoi rënien e komunizmit në Jugosllavi dhe vendosi të luante kartën e nacionalizmit serb për t’u ngritur në skenën politike dhe për të fituar fuqi në Serbi dhe Jugosllavi.¹⁹⁸ Babai dhe nëna e tij ishin vetëvrasë dhe kjo, sipas psikanalistëve, ka pasur ndikim në personalitetin e tij. Sipas disa biografëve të tij, jeta e tij ka momente të ngjashme me biografitë e disa diktatorëve dhe nacionalistëve ekstremë. Si Hitleri, Stalini, Napoleoni, Franko, Tito edhe Millosheviqi prejardhjen e kishte nga ‘vendet kufitare’, pasi prindërit e tij ishin me origjinë nga Mali i Zi dhe jo nga Serbia. Si edhe Hitleri dhe Stalini, në rini ai ishte i ekspozuar mitologjisë historike dhe religjionit ortodoks (babi i tij kishte studiuar teologjinë).¹⁹⁹ Psikologët që kishin studiuar sjelljet e tij e

¹⁹⁸ Tim Judah, *Kosovo What everyone needs to know*, (Oxford University Press, 2008), fq. 65.

¹⁹⁹ Slavoljub Djukić, *Između slave i anateme: Politička biografija Slobodana Miloševića*, (Beograd: Filip Višnjić 1994), fq. 14

kanë përcaktuar si “narcisoid që nuk ka kapacitet për t’u ndier fajtor”.²⁰⁰ (Negociatori britanik Lord David Owen, që kishte takuar Millosheviqin shumë herë gjatë krizës dhe luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, kishte vërejtur një paranojë të theksuar ndaj bashkësisë ndërkombëtare dhe të huajve (joserbëve) në përgjithësi).²⁰¹ Në kontekstin e sqarimit të “paranojës armiqësore” mund të shpjegohet edhe qëndrimi i tij ndaj kombeve të tjera, në radhë të parë shqiptarëve, por edhe mënyra e veprimit të propagandës agresive mediatike serbe, në fund të viteve 80-ta para fillimit të luftërave të ish-Jugosllavisë që fajësonin Vatikanin, SHBA-të, Gjermaninë, shqiptarët, kroatët, myslimanët për tentimin e shkatërrimit të Jugosllavisë dhe Serbisë. Millosheviqi, në manifestimin qendror të shënimit të 600 vjetorit të Betejës së Kosovës në vitin 1989 kishte deklaruar: “Ne do të fitojmë përkundër faktit se armiqtë e jashtëm të Serbisë së bashku me ata brenda saj janë duke bërë plane kundër saj. Pas gjashtë shekujve përsëri jemi në beteja, ato ende nuk janë vetëm me armë por as ato nuk përjashtohen”.²⁰²

Shqiptarët e Kosovës, në ballafaqimin me Millosheviqin dhe serbët agresivë, zgjodhën një rrugë tjetër, ndryshe nga kryengritjet e fillimit dhe mesit të shekullit XX, atë të rezistencës paqësore në krye me Ibrahim Rugovën.

Ibrahim Rugova kishte lindur në fshatin Cerrcë, afër qytetit të Istogut më 2 dhjetor 1944. Më 10 janar 1945 komunistët jugosllavë ia kishin pushkatuar të atin, Ukën dhe gjyshin Rrustë Rugova, që kishte qenë luftëtar i njohur i rajonit të Kosovës Perëndimore kundër çetave çetnike që po depërtonin në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Rugova studioi letërsinë në Prishtinë dhe Paris duke doktoruar në vitin 1984, ndërsa u pranua anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës në vitin 1996, kur u shpall edhe Doktor Nderi në Sorbonë, Paris. Rugova ishte themelues dhe kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nga 23 dhjetori 1989, partisë së parë politike shqiptare që sfidoi regjimin komunist në fuqi. Ibrahim Rugova i përkiste brezit të 68-tës dhe rrethit të intelektualëve që u njohën si ‘Qarku kulturor i

²⁰⁰ Stevan Petrović, “*Novi Vjesnik*” 12 tetor 1992 dhe Sabrina P. Ramet *Balkan Babel-Disintegration of Yugoslavia from death of Tito to the fall of Milosevic* (Westview Press, Boulder, Colorado), fq. 309.

²⁰¹ David Owen, *Balkan Odyssey*, (London: Victor Gollanz, 1995), fq. 127.

²⁰² Fjalimi në Gazimestan, Prishtinë 28 qershor 1989

Prishtinës'. Rugova ishte nacionalist i kultivuar dhe shqiptar në kuptimin rilindës të fjalës që rezulton natyrshëm nga e kaluara e tij familjare dhe personale si dhe formimi kulturor, letrar, e historik. Ibrahim Rugova i udhëhoqi shqiptarët e Kosovës, duke u munduar të ruajë substancën e tyre në një rezistencë politike me premisa të humanizmit dhe lirisë njerëzore universale. Këtë e kishte bërë duke njohur edhe me vetë fatkeqësinë e familjes së vet egërsinë serbe ndaj Kosovës që është përsëritur ciklikisht gjatë shekullit XX.²⁰³ Në vitin 1989 ai kishte deklaruar: “Serbët po vijnë në Kosovë të hakmerren. Nëse Serbia do të përpiqet të shtypë identitetin tonë kombëtar, atëherë do të ketë kryengritje. Unë i paralajmëroj serbët: edhe ata janë një popull i vogël. Në të kaluarën sa herë një popull i vogël është përpjekur të luajë rolin e një fuqie në Ballkan, kjo ka përfunduar me tragjedinë e tij”.²⁰⁴

Karriera e Millosheviqit, apo më mirë shndërrimi i tij nga komunisti mbrojtës i vlerave dhe unitetit të Jugosllavisë në nacionalist dhe mbrojtës të së drejtave të serbëve në Kosovë dhe unitetit të Serbisë, filloi në Fushë Kosovë më 24 prill 1987, kur ai ju drejtua serbëve dhe malazezëve lokalë që ankoheshin për të mosrespektimin e të drejtave të tyre dhe presionin që u bëhej nga shqiptarët. Millosheviqi e përdori fatin e pretenduar të serbëve si argument kryesor për të rrëzuar udhëheqësin e LK të Serbisë Ivan Stamboliq në dhjetor të vitit 1987. Pastaj procesi i reintegrimit të Kosovës dhe suprimimit të autonomisë së saj, të arritur me Kushtetutën e vitit 1974, u shty me më shumë forcë. Në fillim të vitit 1988 rreth 50.000 serbë nënshkruan petitionin duke kërkuar integrim më të madh të Kosovës me Serbinë duke kërcënuar me aksion të drejtpërdrejtë të “vetëmbrojtjes së lirisë, nderit, dhe dinjitetit”.²⁰⁵ Edhe elita intelektuale serbe, por edhe ajo shqiptare kishin agjendat e tyre dhe ishin të vetëdijshme për ngjarjet që do të vijnë dhe përplasjen e pashmangshme në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Më 26 dhe 27 prill të vitit 1988 në Universitetin e Kollarcit, Beograd u mbajt takimi i shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë për të diskutuar

²⁰³ *Presidenti Rugova*, (Presidenca e Kosovës, 2007) ff. 13-21.

²⁰⁴“ *Der Spiegel*”, Hamburg nr.26, 26 qershor 1989

²⁰⁵ Viktor Meir, *Yugoslavia: A history of its demise* (London: Routledge, 1999), fq73 dhe Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, (Prishtinë: Koha 2011) fq. 85.

pikëvështrimet rreth raporteve në mes të dy popujve. Delegacioni shqiptar përbëhej nga: Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja, Besim Bokshi, Ali Aliu, Sabri Hamiti dhe Jusuf Buxhovi ndërsa delegacioni serb nga Aleksandar Petroviq, akademiku Pavle Iliq, Rade Stojanoviq, Milan Komneniq, akademiku Radovan Samarxhiq dhe Jovan Deretiq. Në këto takime intelektualët serbë dhe shqiptarë paraqitën qëndrimet e tyre në të cilat u pa qartë se nuk kishte pajtim dhe qëndrueshmëri në raportet Serbi-Kosovë. Intelektualët serbë u shprehën qartë se ekziston “gjendje lufte në mes të serbëve dhe shqiptarëve” (Komneniq), se “serbët e Kosovës po e paguanin çmimin e sjelljes civilizuese dhe se në vend t’u bashkohen shkrimtarëve serbë shkrimtarët shqiptarë e përkrahin krimin” (Petrov), se “shqiptarët e shfrytëzojnë Jugosllavinë kundër Jugosllavisë me anë të natalitetit dhe arsimitit “(Samarxhiq).

Intelektualët shqiptarë theksuan se “diskursi i serbëve ishte pjesë e arsenalit të shekullit XIX të projekteve shtetmëdha serbe me të cilat Serbia arriti të gëlltiste dy herë më shumë popullatë joserbe në territorin e saj, por shtypja e Kosovës do t’i kthehej në bumerang historik dhe problem ekzistencial” (Rugova), se “lufta për identitet kulturor paraqet luftën për civilizim dhe kultura e shkruar shqiptare, që ka mbijetuar shekujt, është zhvilluar para pushtimit të Ballkanit nga turqit dhe afirmon rezistencën dhe qëndresën (Hamiti), se “historiografia serbe është kthyer në makinë propaganduese serbe për qëllime hegjemoniste dhe shoviniste ku me anë të falsifikimeve të dokumenteve ndërtohej e drejta serbe ndaj Kosovës si djep shpirtëror serb dhe qendër e shtetësisë së saj” (Buxhovi).²⁰⁶ Ishte e paraparë që të mbahej takimi i ardhshëm pas dy javësh në Prishtinë, por intelektualët serbë nuk pranuan të shkonin në ballafaqimin tjetër. Takimin e shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë në Beograd e kishin përcjellë mediet, por edhe diplomatët e huaj, posaçërisht ata gjermanë dhe amerikanë. Pas takimeve të prillit, ambasadori i SHBA-ve në Beograd Warren Zimmermann kishte pasur disa takime me shkrimtarët shqiptarë dhe Kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ibrahim Rugovën, të cilit i kishte dhënë mbrojtje si intelektual në paraqitjet e tij publike në mediet evropiane perëndimore.²⁰⁷

²⁰⁶ Jusuf Buxhovi, “*Kthesa Historike - Vitet e Gjermanisë dhe epoka LDK-së*”, (Prishtinë: Faik Konica 2008)

²⁰⁷ Intervistë me Jusuf Buxhovin, Sekretar i parë i i LDK-së, 12 janar 2013.

Planet e Millosheviqit për suprimimin e autonomisë së Kosovës përmes ndryshimit të Kushtetutës së Serbisë u shfaqën me projekt-propozimin për Kushtetutën e re të Serbisë, të paraqitur për diskutim më 11 qershor 1988. Udhëheqësia serbe rrëzoi udhëheqjen e atëhershme politike të Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe ndërmori masa që Mali i Zi të mos kundërshtonte veprimin serb. Millosheviqi mori lejen e përfaqësuesve të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë për planet e tij. Paraprakisht, të organizuar nga elementet e sigurimit të shtetit dhe të mobilizuar nga përkrahësit e Millosheviqit, anembanë në Kosovë, Vojvodinë, Serbi e Mal të Zi u mbajtën mitingje përkrahëse për Millosheviqin në mes të vjeshtës 1988 dhe pranverës 1989.

Në nëntor të vitit 1988, Millosheviqi ndërroi udhëheqësinë e LK të Kosovës, përkatësisht Azem Vllasin dhe Kaqusha Jasharin, duke vendosur në vend të tyre njerëzit lojalë Rrahman Morinën, Husamedin Azemin dhe Ali Shukrinë. Të nxitur nga minatorët e Trepçës afër 300.000 shqiptarë protestuan në mbrojtje të liderëve shqiptarë të LKK-së por pa sukses.

Intelektualët shqiptarë, 215 shkrimtarë, shkencëtarë, gazetarë, mjekë, në një përpjekje më shumë për të sensibilizuar çështjen e shkeljeve kushtetuese që ishin të pandalshme, më 21 shkurt 1989 i dërguan Kuvendit të Serbisë, Kryesisë së RSFJ-së, Kryesisë së KQ të LKJ-së, Kryesive të Republikave dhe Krahinave dhe Kryesisë së Konferencës Krahinore të LSSP-së së Kosovës, një apel për mbrojtjen e kushtetutës ekzistuese dhe të drejtat e Kosovës. Më vonë ky apel do të njihet si “Apeli 215” dhe një numër i konsiderueshëm i nënshkruesve do të dërgohet në paraburgim izolues nga policia e Serbisë pas suprimimit të autonomisë. Të paktën 245 shqiptarë intelektualë, por edhe administratorë, drejtorë fabrikash e specialistë, janë burgosur dhe janë keqtrajtuar rëndë në burgjet e Nishit, Leskovcit, Beogradit me qëllim që të izoloohen udhëheqësit e mundshëm të rezistencës shqiptare.

Më 24 shkurt 1989, Parlamenti i Serbisë miratoi ndryshimet kushtetuese dhe pritej vetëm edhe miratimi nga Kuvendi i Krahinës Autonome të Kosovës të pranojë

Kushtetutën e re. Në Kosovë filloi greva e minatorëve të “Trepçës” dhe demonstratat masive të shqiptarëve. Llazar Mojsov, Kryetar i Kryesisë Federative të RSFJ-së, zhvillimet i cilësoi si irredentiste dhe bëri publik një dokument, të zbuluar në Prishtinë e që më vonë u dëshmuar të jetë fabrikim, që tregonte për qëllimin e krijimit të Republikës së Kosovës dhe kjo mjaftoi të shpallej gjendja e jashtëzakonshme në mars të vitit 1989 dhe njësi të bashkuara të policisë federative u dërguan në Kosovë për të shtypur protestuesit.²⁰⁸ Në pjesën tjetër të Jugosllavisë, në Slloveni dhe Kroaci, u organizuan protesta në përkrahje të shqiptarëve të Kosovës. Në Slloveni afër një milion qytetarë nënshkruan deklaratën ku theksohej se Jugosllavia kishte dy zgjidhje: të njohë kërkesat legjitime të shqiptarëve të Kosovës apo të pranojë zhdukjen e demokracisë dhe okupimin e përhershëm ushtarak të Kosovës. Këto zhvillime shpjegojnë se si sllovenët e lidhnin fatin e tyre në Jugosllavi me pozitën e shqiptarëve të Kosovës. Në fakt, zhvillimet në Kosovë vetëm përshpejtuan përpjekjet e Sllovenisë dhe Kroacisë drejt ndarjes nga Jugosllavia dhe problemit të Kosovës në tërësi.²⁰⁹

Kuvendi Krahinor i Kosovës me vetëm 10 vota kundër prej 187 delegatësh miratoi ndryshimet kushtetuese, ndërsa në sallë votuan edhe njerëz që nuk ishin deputetë si dhe e gjithë ndërtesa e Kuvendit dhe Prishtina ishte në gjendje të shtettrrethimit policor e ushtarak.²¹⁰ Më 28 mars 1989, Serbia zyrtarizoi ndryshimet kushtetuese, në Kosovë u dërguan forca të mëdha policore dhe ushtarake dhe vetëm në këtë ditë, sipas të dhënave zyrtare, u vranë 22 shqiptarë dhe dy policë në protestat e mëdha që shpërthyen. Por, sipas shënimeve të organizatës “Amnesty International” janë vrarë 140, janë plagosur qindra protestues, ndërsa mbi 900 janë arrestuar, dënuar apo përjashtuar nga shkolla në raste të të miturve.²¹¹

Më pas Serbia më 22 mars 1990 miratoi programin legjislativ të titulluar “Programi për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të

²⁰⁸ “Politika” 3 mars 1989 Beograd, dhe Sonja Biserko “Yugoslavia’s Implosion-The fatal attraction of Serbian Nationalism”, (Belgrade Zagorac, 2012), fq. 214.

²⁰⁹ Howard Clark, “Civil Resistance in Kosovo”, (London: Plutobooks 2000), fq. 51.

²¹⁰ Marc Weller, “Shtetësia e Kontestuar”, (Prishtinë: Koha 2011), fq. 87.

²¹¹ Amnesty International Yugoslavia, *Police Violence in Kosovo Province-the victims*, September 1994 EUR/70/16/94 fq4 dhe Howard Clark *Civil Resistance in Kosovo* (London: Plutobooks 2000), fq. 52.

Kosovës” për të rikthyer vendimmarrjen serbe në territorin e Kosovës dhe përjashtimin e shqiptarëve nga vendimmarrja duke i shndërruar në pakicë të Serbisë. Kjo nënkuptonte një pako Ligjesh diskriminuese anti-shqiptare si Ligji që ndalonte shitjen e patundshmërive ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, Ligjin për shkollimin fillor dhe të mesëm, Ligjin për shkollat e mesme, Ndërrimin e Ligjit për Institutin e Historisë të Kosovës etj.²¹² Sipas këtij programi, që do të zbatohet me përpikëri, Serbia do të revokonte të gjitha të drejtat që Kosova i kishte fituar pas vitit 1966. Gjuha zyrtare tani ishte gjuha serbo-kroate, ndërroheshin emrat e rrugëve dhe shesheve, shitoret u detyruan të vendosnin mbishkrimet në alfabetin cirilik, u rikthye emri “Kosovë dhe Metohi”, dhe kjo ishte mënyrë për të treguar se Kosova tani ishte serbe. Në periudhën 1990-1992, Kuvendi i Serbisë miratoi 32 ligje dhe 470 vendime speciale për Kosovën që nënkuptonin edhe: transferin e të gjitha përgjegjësive të ruajtjes së rendit te Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, krijimin e policisë speciale vetëm për Kosovën, vendosjen e medieeve të Prishtinës nën kontrollin e Beogradit, krijimin e komunave të reja me shumicë serbe në Kosovë, transferin e asetëve të institucioneve të Kosovës tek ato të Serbisë, ndalimin e shitblerjes së pronave në mes të serbëve dhe shqiptarëve dhe ndalimin e shqiptarëve për të marrë pjesë në privatizimin e ndërmarrjeve publike. Në vitin 1992, Serbia miratoi edhe “Programin zhvillimor për ndalimin e shpërnguljes dhe kthimit të serbëve dhe malazezëve në Kosovë” që përmbante projekte investuese për shtëpi të reja dhe vende pune për serbët dhe malazezët e kthyer.²¹³

Në të njëjtën periudhë, në mes të 18-23 marsit 1990 rreth 7000 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në 13 qytete të Kosovës u helmuan. Autoritetet serbe nuk e pranuan këtë veprim, por hulumtimet e ekspertëve ndërkombëtarë treguan se mund të ishte fjala për helmin kimik “sarin” për të cilin dihej se e posedonte Armata Popullore e Jugosllavisë.

Shqiptarët e Kosovës helmimin ndaj fëmijëve dhe nxënësve e kuptuan si një ndër provokimet më të rënda dhe dëshmi se jeta e përbashkët me serbët është e

²¹² Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë Nr.30/89

²¹³ Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, (London: Pluto Press, 2000), fq. 71-72.

pamundshme. Mosbesimi u bë aq i madh sa që filluan të refuzojnë trajtimet mjekësore nga mjekët serbë. Kështu, më 10 maj 1990 u themelua Shoqata “Nëna Terezë” që për vite të tëra do të jetë shtylla e ofrimit të shërbimeve elementare të shëndetësisë në Kosovë. Klinika e parë e përkrahur nga Shoqata “Nëna Terezë” u hap në Prishtinë, më 30 mars 1992, ndërsa deri në vitin 1998 u hapën edhe 70 të tilla në mbarë Kosovën. Në këto klinika punuan mbi 7000 vullnetarë që u dhanë ndihmë mjekësore mbi 350.000 banorëve të Kosovës.

Po ashtu, shqiptarët vendosën në vitin 1990 të bojkotojnë të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë nga Serbia si dhe regjistrimin e popullsisë një vit më vonë.

Përveç incidentit të helmimit të nxënësve dhe të rinjve shqiptarë, autoritetet serbe filluan që nga viti 1989 të bëjnë ndarjen fizike të nxënësve dhe shkollave në vetëm serbe dhe vetëm shqiptare. Në shkollat fillore dhe të mesme, në mjediset e përziera, mësimi zhvillohej në ndërrime. Shembulli më tipik i segregacionit të tillë ishte Shkolla Fillore “Dardania” në Prishtinë, ku në njërin ndërrim mësonin serbët, ndërsa në ndërrimet e tjera nxënësit shqiptarë, ndërsa vetë shkolla ishte e ndarë me mure në mënyrë që nxënësit të mos kenë kurrfarë kontakti.

Më 26 qershor 1990 u aktivizua Ligji për rrethanat e jashtëzakonshme që mundësonte administrimin e Kosovës nga Beogradi duke anuluar të gjitha vendimet e mëparshme të organeve të Kosovës. Organet e sigurisë dhe policia u çarmatosën, ndërsa 3075 punëtorë të Sekretariatit të Punëve të Brendshme u larguan nga puna.

Më 5 korrik 1990, Serbia miratoi Ligjin për shuarjen e punës së Kuvendit Krahinor dhe Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Më 28 shtator 1990 Serbia ia dha vetes Kushtetutën e re ku kishte ndërruar preambulën nga “Serbia shteti i kombit serb dhe kombeve dhe kombësive të tjera” në “Serbia është shtet demokratik i popullit serb”. Shqiptarët e Kosovës tani ligjërisht trajtoheshin si “pakicë kombëtare” edhe në vetë territorin e tyre. Këto ndryshime nënkuptonin edhe ndryshimet në Kushtetutën e RSFJ-së, mirëpo ajo shkonte drejt dezintegritimit kështu që ngjarjet e mëvonshme ishin më dramatike se procedurat legjislative.

Rrënimi i autonomisë në Kosovë u përjetua si ripushtim i radhës nga Serbia, e cila filloi me largimin e shqiptarëve nga jeta administrative, shoqërore, ekonomike dhe politike duke filluar me përjashtime nga puna në të gjitha nivelet. Nga shqiptarët që punonin qoftë në administratë, qoftë në ndërmarrjet publike kërkoheshin nënshkrimi i deklaratës së lojalitetit ndaj shteti serb. Kështu, në tre muajt e parë të nënshtrimit të Kosovës u përjashtuan nga puna 90% të të punësuarve në ekonomitë shtetërore apo rreth 115.000 njerëz.²¹⁴ Serbët lokalë u punësuan gati të gjithë, ndërsa ofroheshin paga më të mira dhe shtesa të tjera për serbët nga Serbia që dëshironin të vinin në Kosovë për të punuar në administratë, polici, gjyqësor, etj. Në një mënyrë vazhdonte metoda e kolonizimit të mëtutjeshëm të Kosovës.

Në krye të shqiptarëve erdhi elita intelektuale që ishte e përfaqësuar kryesisht në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës dhe Institutin Albanologjik të Kosovës. I pari që filloi të artikulonte qartë qëndrimin e shqiptarëve në mediet perëndimore dhe në diskutimet me diplomatët e akredituar në Beograd ishte Ibrahim Rugova. Qëndrimet e tij se në Jugosllavi po kërkojnë aksione të shqiptarëve për të arsyetuar represionin ndaj tyre, se duhet të ndalet arbitrariteti serb, se nëse vazhdon shtypja nga serbët atëherë shqiptarët do të kërkojnë rrugëdalje tjetër ndoshta edhe në drejtim të Serbisë, bënë jehonë të madhe në qarqet diplomatike perëndimore.²¹⁵

Më 23 dhjetor 1989, në hapësirat e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, u themelua Lidhja Demokratike e Kosovës. Para themelimit, udhëheqësit e LDK-së kishin njoftuar hollësisht Ambasadën e SHBA-ve në Beograd për qëllimin dhe programin e LDK-së. Nga gushti 1989 e deri në themelimin e LDK-së diplomatët amerikanë ishin të pranishëm rregullisht në Kosovë. Në fazën e fundit, amerikanët kanë pasur qasje të plotë në themelimin e LDK-së dhe dokumentet bazike. Ata kishin kërkuar nga themeluesit që t'u përmbahen të gjitha procedurave në përputhje me ligjin federativ të partive politike në RSFJ dhe kishin qenë garantues të themelimit të LDK-së.²¹⁶ Përcaktimi i zyrtarëve amerikanë ishte që Ibrahim Rugova të udhëheqë LDK-në, sepse

²¹⁴ Oliver Jens Schmitt, *Kosova-Histori e Shkurtër e një treve Ballkanike*, (Prishtinë: Koha 2012), fq. 247.

²¹⁵ Nga intervista "Der Spiegel" nr. 26, 26 qershor 1989

²¹⁶ Intervistë me Jusuf Buxhovin, Sekretar i Parë i LDK-së, 12janar 2013.

ishite Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, që në konfrontim me programet serbe për të nënshtruar politikisht dhe ekonomikisht Kosovën kishte marrë rolin e institucionit mbrojtës të shqiptarëve. Ndërsa, arsyeja tjetër ishte se Rugova, në saje të prononcimeve të hapura për mediet e huaja dhe në Jugosllavi ishte kthyer në lider të pakontestueshëm të shqiptarëve jo vetëm në Kosovë, por edhe në hapësirat e tjera të ish-Jugosllavisë. Rugova, për amerikanët ishte njeriu më i përshtatshëm për të marrë timonin e LDK-së. Amerikanët ishin të entuziazmuar me rritjen e shpejtë të LDK-së në Kosovë dhe kërkonin që kjo rritje të përcillej me largimin e shqiptarëve nga Lidhja Komuniste dhe sateliti i saj LSPP.²¹⁷ Për vetëm një muaj në LDK u anëtarësuan mbi 150.000 anëtarë. Pas LDK-së u themeluan edhe partitë të tjera demokratike si Partia Fshatare e Kosovës, Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia e Unitetit Kombëtar, Partia Popullore Shqiptare, Partia e Prosperitetit Demokratik në Maqedoni, Partia e Veprimit Demokratik në Preshevë, Lidhja Demokratike në Mal të Zi, Lidhja Demokratike e Kosovës për Kroaci dhe dega e Iniciativës Demokratike të Bashkuar të Jugosllavisë.

Pas mbylljes së ndërtesës së Kuvendit të Kosovës për delegatët e Kuvendit, ata, më 2 korrik 1990, miratuan Deklaratën Kushtetuese në të cilën nuk pranonin ndryshimet e votuara dhe të imponuara nga Serbia, anuluan votimin e datës 23 mars 1990 dhe kërkuan ekzistimin e Kosovës si njësi e barabartë në Federatën Jugosllave. Më 7 shtator 1990, delegatët e Kuvendit të Kosovës në qytetin e Kaçanikut, miratuan Kushtetutën e Kosovës që përkufizonte Kosovën si “shtet demokratik, sovran dhe të pavarur të popullit shqiptar dhe të pjesëtarëve të popujve të tjerë dhe pakicave kombëtare”. Për të dyja veprimet, udhëheqësit shqiptarë kishin pëlqimin e përfaqësuesve të SHBA-ve, madje në biseda me Ibrahim Rugovën amerikanët kishin premtuar siguri të plotë nga veprimi eventual policor. Gjatë kohës së përgatitjeve për Deklaratën Kushtetuese, përfaqësuesit amerikanë dy herë në biseda konfidenciale ishin takuar me Ibrahim Rugovën dhe Fehmi Aganin, që ishte i ngarkuar nga LDK të bashkëveprojë me deputetët e Kuvendit. Në takime amerikanët kishin dhënë edhe

²¹⁷ Intervistë me Jusuf Buxhovin, Sekretar i Parë i LDK-së, 12janar 2013.

sugjerime që ishin inkorporuar në tekstin përfundimtar.²¹⁸ Shqiptarët vendosën në vitin 1990 të bojkotojnë të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë nga Serbia si dhe regjistrimin e popullsisë një vit më vonë.

Ibrahim Rugova, si kryetar i LDK-së, së bashku me udhëheqës të tjerë nga Kosova, në prill të vitit 1990 zhvilloi vizitën e parë në Uashington, ku u prit në Departamentin e Shtetit. Kjo vizitë synonte ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe problemeve të mëdha me të cilat ballafaqohej. Po ashtu, vizita ishte legjitimim i Rugovës si lider i shqiptarëve të Kosovës dhe legjitimim i LDK-së si lëvizje institucionale. Zyrtarët e SHBA-ve i dhanë përkrahje përcaktimit të shqiptarëve për zgjidhje demokratike dhe paqësore të çështjes së Kosovës. Për prezencën e Kosovës në Uashington meritat më të mëdha i kishte lobi shqiptaro-amerikan, që ishte më i organizuar se organizatat e ngjashme në Evropë. Përfaqësuesit e mbi 350.000 shqiptaro-amerikanëve kishin themeluar që në vitin 1986 “Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane”.²¹⁹ Edhe në Kosovë, amerikanët përmes Ambasadës së SHBA-ve në Beograd, vazhdimisht përkrahnin rezistencën institucionale-paqësore. Ambasadori Warren Zimmermann, në një nga vizitat në Kosovë, kishte thënë se LDK duhet të jetë strumbullari i organizmit partiak në Kosovë, ndërsa organizimi i partive politike shqiptare në Maqedoni dhe Serbi të jugut duhej t’u përshtatej specifikave lokale në koordinimin me LDK-në. Kështu, zyrtarët e LDK-së, Fehmi Agani, Ali Aliu dhe Bujar Bukoshi ndihmuan formimin e Partisë për Veprim Demokratik në krye me Riza Halimin në Preshevë dhe Partinë e Prosperitetit Demokratik në krye me Nevzat Halilin. Partitë politike demokratike të shqiptarëve të krijuara në Kosovë dhe në vende të tjera të ish-Jugosllavisë u gjetën para nevojës së koordinimit për shkak të ndryshimeve në terren dhe fillimit të dezintegritimit të Jugosllavisë. Kështu, në korrik të vitit 1991 u krijua Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi me Ibrahim Rugovën kryetar.

²¹⁸ Intervistë me Jusuf Buxhovin, Sekretar i i Parë i LDK-së, 12 janar 2013.

²¹⁹ Sami Repishti, *American-Albanian Community: Home-grown Lobbyists*, (Balkan War Report April/May 1993) fq. 18)

Formimi i këtij Këshilli nën drejtimin e LDK-së dhe me udhëzimin e tërthortë të zyrtarëve amerikanë, në të vërtetë, do të paraqesë parakushtin e Lëvizjes gjithëpopullore të shqiptarëve të Kosovës kundër dhunës dhe pushtimit serb dhe do të konstitujë pushtetin paralel, institucionet e Kosovës që nga solidariteti, organizimi i arsimit, shëndetësisë e më vonë sigurisë e mbrojtjes.

Në Kosovë, do të krijohet sistemi i kundërvënies civile të shqiptarëve ndaj çdo elementi të shtetit serb duke e shndërruar praninë e Serbisë në Kosovë në okupator klasik. Kjo sjellje e shqiptarëve ishte luftë pa konfrontim të armatosur, i cili do të vijë në vitin 1998 dhe 1999. Suksesi më i madh i këtij bashkimi të forcave politike shqiptare ishte krijimi i bindjes se Kosova mund të funksionojë e pavarur dhe e vetme. Pas themelimit të Qeverisë së Kosovës, me kryeministër Bujar Bukoshin, më 19 tetor 1991, filloi edhe organizimi praktik i sistemit të pushtetit të shqiptarëve në Kosovë.²²⁰

Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës u organizua mbledhja e tatimit në fitim apo “Fondi i 3%” në diasporë dhe në Kosovë. Me anë të mjeteve të grumbulluara finançohej sistemi arsimor në Kosovë me rreth 20.000 mësues e profesorë dhe 317.000 nxënës e rreth 12.000 studentë.²²¹ Në periudhën 1992-1998, mësimi në 41 nga 441 shkolla fillore dhe në 60 nga 66 shkolla të mesme në Kosovë u zhvillua në lokale të improvizuara. Në periudhën 1990-1997 institucionet arsimore të Kosovës botuan dhe në Kosovë, përmes Shqipërisë dhe Maqedonisë, shpërndanë 156 tituj botimesh shkollore në bazë të Planprogramit të ri mësimor.²²² Në periudhën e fillimit të funksionimit të institucioneve të Kosovës, sektori i arsimit kishte barrën më të rëndë dhe më të rëndësishme, prandaj ishte më i godituri nga policia serbe. Policia keqtrajtonte rregullisht mësimdhënësit, nxënësit dhe pronarët e lokale të shndërruara në shkolla para fillimit të vitit të ri shkollor. Në fillim të vitit të ri shkollor 1993/1994, Qeveria e Republikës së Kosovës iu drejtua opinionit botëror dhe institucioneve

²²⁰ Jusuf Buxhovi, *Kthesa Historike-Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së* (Prishtinë: Faik Konica 2008), ff. 296-299.

²²¹ Oliver Jens Schmitt, *Kosova-Histori e Shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Prishtinë: Koha, 2012, fq. 249.

²²² Abdyl Ramaj *Gjendja e Arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë dhe mundësitë e normalizimit të përkohshëm*, LDK, gusht 1997.

ndërkombëtare me deklaratën ku ndërmjet të tjerash thuhej: “Procesi arsimor për shqiptarët në periudhën 1991-1993 ishte i përcjellë nga represioni i skajshëm. Si rezultat i terrorit shtetëror, 18 nxënës janë vrarë, dy mësimdhënës, një drejtor shkolle dhe tre prindër. Policia serbe ka rrahur dhe maltretuar 2000 mësimdhënës dhe drejtorë shkollash dhe më shumë se 400 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. 140 mësimdhënës dhe 6 nxënës janë dënuar me burgim prej 20-60 ditësh”.²²³

Universiteti i Prishtinës, që ishte cilësuar nga serbët si “çerdhe e nacionalizmit shqiptar”, jo vetëm për shkak të demonstrative të vitit 1981, po ashtu u godit nga regjimi serb i instaluar në Kosovë. Në vitin 1991, 984 profesorë të Universitetit u larguan nga puna si dhe u mbyllën 13 fakultetet e Universitetit, ndërsa mësimi u organizua në 250 lokale private të improvizuara.

Ambasadori Warren Zimmermann dhe zyrtarët amerikanë ishin të parët që përkrahën sistemin paralel në fushën e arsimit dhe shëndetësisë duke premtuar se ndihma konkrete do të mbërrinte nëpërmjet kanaleve humanitare që nuk mund të pengoheshin nga Beogradi. Departamenti i Shtetit kishte caktuar dy diplomatë që do të koordinonin veprimet me Këshillin e Solidaritetit për të ndihmuar punën e institucioneve në Kosovë në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, e më vonë edhe vetëmbrojtje deri në filllet e kundërvënies së armatosur.²²⁴

Nën udhëheqjen e LDK-së, me durim dhe këmbëngulësi, shqiptarët e Kosovës zhvilluan një politikë të refuzimit të provokimeve serbe duke krijuar dhe mbajtur strukturat politike dhe sociale në Kosovë, duke lobuar për ndihmë dhe përkrahje ndërkombëtare. Ata arritën me sukses të limitojnë okupimin serb dhe t’i shpëtojnë luftës së hapur duke e mbajtur të bashkuar popullin dhe duke arritur të përfitojnë simpatinë e vendeve perëndimore që dënuan Serbinë për shkeljen e të drejtave të tyre të njeriut. Sukseset më të mëdha të politikës së rezistencës paqësore ishin:

²²³ Komunikatë e Qeverisë së Kosovës, 6 shtator 1993.

²²⁴ Jusuf Buxhovi, *Kthesa Historike-Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së*, (Prishtinë: Faik Konica 2008), fq. 332.

1. Duke refuzuar të provokohen shqiptarët nuk i dhanë shans regjimit serb të përdorë forcën brutale dhe fituan betejën morale ndaj Beogradit para opinionit ndërkombëtar.
2. Duke ndërtuar institucionet shtetërore paralele, shqiptarët e Kosovës demonstuan kapacitetet e vetë-organizimit duke përmbushur dy qëllime themelore: mbajtjen e jetës deri-diku në suaza të normales në Kosovë dhe ndalimin e planeve të Serbisë për shpërndarjen e shqiptarëve duke i dëbuar jashtë Kosovës. Në këtë përpjekje rol të jashtëzakonshëm ka luajtur diaspora e organizuar shqiptare, aktivitetet vullnetare në Kosovë dhe solidariteti social që për rezultat kishte unitetin nacional dhe vetëfljimin.
3. Duke mbajtur kohezion dhe konsistencë në kërkesat e tyre, shqiptarët e Kosovës arritën që për Kosovën të sigurojnë përkrahjen ndërkombëtare, në radhë të parë të SHBA-ve, që problemi i Kosovës të mos trajtohet si “çështje e brendshme” e Serbisë.²²⁵

Meqë situata në ish-Jugosllavi po shkonte pakthyeshem drejt konflikteve të armatosura, shqiptarët e Kosovës vendosën të marrin qëndrimin e tyre. Në referendumin e 26-30 shtatorit 1991, të shpallur ilegal nga pushtetit serb, shqiptarët e Kosovës me shumicë absolute vendosën që në rast të dezintegrimit të Jugosllavisë, Kosova të shpallej shtet i pavarur. Në Referendum votuan 914,802 votues apo 87% të elektoratit me 99,87% të votave pro-pavarësisë së Kosovës. Më 19 tetor 1991, Kuvendi i Kosovës amandamentoi Kushtetutën e Kaçanikut dhe deklaroi pavarësinë e Kosovës. Ndërsa, më 11 tetor 1991, Këshilli Koordinues i Parive Politike Shqiptare në Jugosllavi miratoi “Deklaratën Politike për Tri Opsionet e Zgjedhjes së Çështjes Shqiptare” në të cilën u paraqitën në mënyrë të qartë qëllimet e shqiptarëve:

1. Nëse nuk ndryshohen kufijtë e jashtëm e as ata të brendshëm të Jugosllavisë, atëherë duhet të ekzistojë Republika e Kosovës si shtet sovran i pavarur me të drejtë bashkimi në lidhjen e shteteve sovrane në Jugosllavi. Pjesët e popullit

²²⁵ Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, (London: Pluto Press, 2000) 128-129.

shqiptar që mbesin të jetojnë në Maqedoni, në Mal të Zi, dhe në Serbi do të kenë statusin e popullit shtetformues dhe të gjitha të drejtat që dalin nga kjo.

2. Nëse kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë nuk ndryshojnë, por ndryshojnë kufijtë e brendshëm ndërmjet republikave, atëherë kërkesë është Republika Shqiptare në Jugosllavi e ndërtuar mbi bazën e parimit etnik dhe të parimeve të tjera që vlejnë për serbët, sllovenët dhe popujt e tjerë të Jugosllavisë.
3. Nëse ndryshojnë kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë, atëherë populli shqiptar në Jugosllavi përmes deklarimit të përgjithshëm me plebishit do të vendosë për bashkimin e territoreve në të cilat jetojnë shqiptarët dhe kështu do të krijohet shteti integral shqiptar në Ballkan në kufijtë e tij etnikë.²²⁶

Në prill të vitit 1991 filluan edhe konfliktet e para të armatosura në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, që vëmendjen e opinionit ndërkombëtar do ta largojnë nga Kosova dhe përpjekjet e shqiptarëve dhe do ta zëvendësojnë me iniciativat e shumta ndërkombëtare për të ndalur konfliktet e tjera në ish-Jugosllavi.

²²⁶ “Presidenti Rugova”, Presidenca e Kosovës , 2007, ff. 50-52.

II.3 Kosova gjatë luftërave në ish-Jugosllavi - konferenca e Dejtonit

Në shumicën e analizave që trajtojnë shpërbërjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, historiografët dhe analistët politikë dhe ushtarakë shpjegojnë procesin e dezintegrimit brenda paradigmës së mungesës së kohezionit të Jugosllavisë pas vdekjes së Titos në vitin 1980, krizës ekonomike të viteve 80-ta dhe rritjes së nacionalizmit në Kosovë, Serbi dhe Kroaci dhe elementeve separatiste që kërkonin ridefinim të Jugosllavisë. Në vitet e 80-ta, përkatësisht në fund të viteve 80-ta, u bë e qartë se qëllimet e popujve përbërës të Federatës Jugosllave ishin drejtuar drejt zgjidhjes së çështjeve nacionale. Në këtë periudhë është parë haptas se kriza ekonomike dhe inercioni politik me të cilin elitat udhëheqëse komuniste udhëhiqnin Jugosllavinë nuk ishin kompatible. Nëse merret parasysh edhe nacionalizmi në rritje, ndikimi i emigracionit ekstrem i shqiptarëve, kroatëve dhe serbëve, dhe roli i Armatës Popullore të Jugosllavisë, që kërkonte të ridefinohej në situata të reja, atëherë lehtë kuptohet pse shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë ishte e paevitueshme. Në fakt, shpërbërja e dhunshme e RSFJ-së kishte filluar në Kosovë me demonstratat e shqiptarëve të Kosovës të vitit 1989, në mbrojtje të sovranitetit të Kosovës kundër forcave të armatosura të policisë serbe, federative dhe Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe organizimin e partive politike demokratike që kërkonin ndryshimin e statusit të Kosovës. Por, atë e kishte nisur nacionalizmi serb dhe idetë e krijimit të Serbisë së Madhe brenda Jugosllavisë ekzistuese. Shpërbërja e Jugosllavisë u ndihmua edhe nga mungesa e zgjidhjes dhe ballafaqimit me zhvillimet politike, ekonomike, sociale, për të cilat udhëheqësia politike në nivel të Federatës nuk kishte qëndrim unik.

Së pari ishte çështja e *ridefinimit të Federatës Jugosllave*. Në vitin 1989 ekzistonin katër alternativa: Federata të shndërrohej në Konfederatë, propozim i përkrahur nga intelektualët sllovenë, Federata të ndërrohej në Federatë asimetrike, propozim i përkrahur nga partitë politike në Slloveni, Federata të konsolidohej dhe të unifikohej edhe më shumë, propozim i përkrahur nga partitë serbe dhe shumica e intelektualëve

serbë në Beograd, Federata të mbetej e tillë çfarë ishte, propozim që nuk përkrahej nga asnjë entitet.

Pastaj ishte çështja e *drejtimit ekonomik*. Ekzistonte konsensus i gjerë se reformat ekonomike janë të domosdoshme. Por, përderisa republikat e zhvilluara, Sllovenia dhe Kroacia, ishin në favor të privatizimit dhe të ekonomisë së tregut të lirë, ato më pak të zhvilluara si Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia ishin për vazhdimin e modelit të ‘ekonomisë së planifikuar’. Po ashtu, ndryshimi i modelit ekonomik ishte edhe çështje politike, sepse privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe shtetërore do të thoshte ndryshimin e strukturës udhëheqëse dhe humbjen e privilegjeve të udhëheqësve komunistë.

Pluralizmi politik dhe krijimi i partive të reja politike të orientimeve të ndryshme ishte një sfidë për udhëheqësinë e RSFJ-së dhe LKJ-në. Nuk mund të parashihej shtrirja e tyre si dhe fuqia që do të përfitojnë në zgjedhjet e lira dhe demokratike.

Rënia e sensit të komunitetit të përbashkët, është ndoshta edhe faktori më i rëndësishëm në shpërbërjen e Jugosllavisë. Komunikimi në mes të popujve, republikave, elitave intelektuale dhe kulturore në Jugosllavi ishte në rënie të madhe. Demonstratat e shqiptarëve të Kosovës në vitin 1981 dhe deri tek ato edhe më të dhunshme të vitit 1989 kishin krijuar bindjen edhe te popujt e tjerë se zgjidhja përfundimtare nuk përjashtonte edhe konfliktet e armatosura. Kundërshtarët e kësaj mundësie theksonin se me “Kartën e Helsinkit” nuk do të pranohej krijimi i shteteve të reja. Vendet Perëndimore, vërtetë do të vazhdonin të përkrahnin Jugosllavinë, deri në veprimet e Serbisë së Millosheviqit në pranverën e viti 1991, dhe natyrisht se nuk do të përdornin forcën për të ruajtur Jugosllavinë si entitet unik.²²⁷ Kjo sidomos vlente për SHBA-të. Shumë vite para vdekjes së Titos, analistët amerikanë kishin bërë një studim për zhvillimet dhe rrugën e Jugosllavisë në periudhën “pas-Titos”.²²⁸ Në Memorandumin e Këshillit Nacional të Sigurisë, të datës 13 shtator 1971, analistët i rekomandonin vendimmarrësve amerikanë që në raport me Jugosllavinë të zbatojnë

²²⁷ Sabrina P. Ramet *Balkan Babel-The Disintegration of Yugoslavia from the death of Tito to the fall of Milosevic*, (Boulder: Westview Press, 2002), ff. 44-46.

²²⁸ Jordan Baev, *US Intelligence Community Estimates on Yugoslavia, National Security and the Future 2000*.

politikë të kujdesshme që do të jetë karakteristikë e politikës së SHBA-ve ndaj Jugosllavisë për të gjithë periudhën në vijim deri në vitin 1992.²²⁹ Kjo politikë nënkuptonte që “SHBA-të të jenë të kujdesshme që të mos drejtojnë jugosllavët në drejtimin të cilin ata nuk duan të marrin, duke marrë parasysh se ndikimi sado i vogël i SHBA-ve në kohë të trazirave do të mund të ndikonte në zhvillimet në Jugosllavi. SHBA-të do të duhej të përkrahin, por jo edhe të udhëheqin këto zhvillime”.

Ekspertët ushtarakë dhe të inteligjencës së SHBA-ve kishin analizuar katër skenarë potencialë për të ardhmen e Jugosllavisë dhe tre nga skenarët parashihnin shpërbërjen e pjesshme apo të tërësishme të Jugosllavisë, ndarjen nga Jugosllavia të Sllovenisë, Kroacisë, Vojvodinës, Maqedonisë dhe Kosovës. Krahas qëndrimit për përkrahjen dhe ruajtjen e integritetit të Jugosllavisë, ekspertët amerikanë përkrahnin edhe idenë, si mjet të fundit, të përdorimit të forcave të SHBA-ve dhe NATO-s për të rikthyer “balancin strategjik” në Evropë.

Në këta tre skenarë, ekspertët amerikanë, këshillonin administratën amerikane që udhëheqësve në Zagreb dhe Lubjanë të mos u jepet përkrahja direkte në rast të kërkesave secesioniste. Skenari i katërt, më i rrezikshëm, nënkuptonte konfrontimin e drejtpërdrejtë ushtarak në rast të ndarjes së Jugosllavisë në dy pjesë ku njëra është pro-Perëndimore dhe do të kërkonte ndihmën e SHBA-ve dhe NATO-s, përkatësisht Sllovenia dhe Kroacia, ndërsa pjesa tjetër do të ndihmohej nga forcat e armatosura të BRSS-së, përkatësisht Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Në analizën e vitit 1979, ekspertët e inteligjencës dhe ata ushtarakë amerikanë, rikujtonin trazirat etnike në Kroaci dhe Kosovë dhe akuzat e shqiptarëve të Kosovës se “Serbia e ka shndërruar Kosovën në koloni politike dhe ekonomike të serbëve”. Në analizën e CIA-s, të datës 26 janar 1983, dhe në analizën e Këshillit Nacional të Sigurisë, 14 mars 1984, situata në Jugosllavi paraqitej si e paqëndrueshme dhe brengosëse. Në raport theksohej se “regjimi federal kishte humbur prestigjin në vend, ndërsa asnjë nga trashëgimtarët e Titos nuk mund t’i afrohej reputacionit të tij”. Po

²²⁹ NSA, *US Policy and Post-Tito Yugoslavia*-NSSM fq. 129

ashtu, shënohen “raportet e tensionuara etnike në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, ndërsa demonstratat e shqiptarëve kanë rëndësi strategjike”.²³⁰

Shpërbërja e Jugosllavisë, para fillimit të konflikteve të armatosura, karakterizohet me dy faza: përpjekjen e ruajtjes së sistemit të vjetër të përbashkët, establishmenti politik dhe intelektual përpiquej të ruante pozitat pa u përpjekur për të ndërmarrë reforma, sepse ato do të ndërronin balancin e forcave shoqërore të krijuara nga Tito, dhe në fazën e dytë të rritjes së nacionalizmit serb dhe paraqitjes së Millosheviqit që zgjidhjen e kërkonte në forcimin dhe centralizimin e Jugosllavisë me rolin dominues të Serbisë. Millosheviqi, ndonëse jo drejtpërdrejt, pranoi idetë e Memorandumit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, të botuar në vitin 1986, ndërsa akademikët Mihajlo Marković dhe Kosta Mihajlović, që ishin anëtarë të Komitetit që krijoi Memorandumin, u bënë anëtarë me influencë në Partinë Socialiste të Serbisë që ishte trashëgimtare e Lidhjes Komuniste të Serbisë. Millosheviqi kishte hetuar potencën e nacionalizmit serb për të ardhur në pushtet pas vizitës së parë në Kosovë, në vitin 1987, dhe në këtë platformë si dhe me bekimin e APJ-së, erdhi në krye të LKS-së në shtator të atij viti. Dhe, mund të thuhet, se e nisi trendin e udhëheqësve nationalistë dhe populistë në republikat e tjera të Jugosllavisë. Pas rrëzimit të udhëheqësve komunistë në Kosovë, Vojvodinë dhe në Mal të Zi, Millosheviqi nuk arriti të destabilizojë republikat e tjera të Jugosllavisë, por vendosi që pushtetin ta përforcojë me përkrahësit e idesë së Serbisë së Madhe. Në të njëjtën kohë, Millosheviqi në mënyrë të shkathtë dhe dinake mori përkrahjen e intelektualëve nationalistë në krye me Dobrica Qosiqin, duke kërkuar Serbi më të fuqishme në Jugosllavi të centralizuar si dhe të APJ-së duke kërkuar të ruhen vlerat e Jugosllavisë nga populli i saj dhe të mbrohen në rast nevojë.²³¹

Derisa Millosheviqi ishte duke ndërtuar pozitën e tij udhëheqëse, nacionalisti Dobrica Qosiq ishte duke ndihmuar krijimin e partive serbe në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë dhe duke këshilluar udhëheqësit e tyre Jovan Rashković dhe Radovan

²³⁰ NSDD 133, March 14 “US policy Toward Yugoslavia”.

²³¹ Fjalimi i Millosheviqit në tubimin e madh në Beograd, 19 nëntor 1988, shënuar edhe në Sllobodan Millosheviq “*Godine Raspleta*”, fq. 276).

Karaxhiq.²³² Millosheviqi në politikë dhe Qosiqi në pjesën intelektuale të Serbisë, e legjitimuan propagandën si mjet të luftës për të arritur qëllimet e serbëve në Jugosllavi. Në rastin e shqiptarëve të Kosovës dhe kërkesave të vitit 1981 dhe 1989, në mediet serbe, u plasuan si kërkesa “irredentiste” dhe “kundërrevolucion”, dhe e njëjta retorikë është përdorur për të shqetësuar dhe mobilizuar serbët në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë për “përsëritjen e gjenocidit të ‘ustashëve’ (duke u referuar në formacionet e armatosura të Shtetit të Pavarur të Kroacisë 1941-1945)” dhe “hakmarrjen e myslimanëve kundër ortodoksisë”. Qosiqi shpesh herë kishte theksuar se “në historinë e serbëve gënjeshtër u ka shërbyer serbëve shpeshherë njësoj sa edhe trimëria”.²³³ Gënjeshtër u bë pjesë e strategjisë serbe në fillim të luftërave në Jugosllavi. Strategjet e propagandës serbe theksonin se “duhet pasur shumë kujdes se çfarë të vërtete për serbët u paraqitet perëndimorëve dhe se gënjeshtër dhe ‘të vërtetat e pjesërishme’ duhet të mbrohen nga të gjitha shtresat e serbëve kudo në mënyrë që serbët të kuptohen më mirë nga të huajt”.²³⁴

Në vitin 1989, Sllovenia dhe Kroacia kërkonin ridefinimin e Jugosllavisë përkatësisht decentralizimin e pushtetit dhe rol më të madh të republikave në federatë që ishte qëndrim diametralisht i kundërt me Millosheviqin dhe Serbinë. Serbia kishte anuluar autonominë e Kosovës dhe të Vojvodinës, por paradoksalisht kërkonte të drejta dhe autonomi për serbët në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Në janar të vitit 1990, pas Kongresit të 13-të u shpërbë Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, në zgjedhjet parlamentare të vitit 1990 në Slloveni dhe Kroaci fituan partitë dhe koalicionet anti-komuniste, ndërsa Millosheviqi, në emër të Serbisë kishte deklaruar se “Serbia duhej të bëhej gati të jetonte pa Jugosllavinë dhe se qëllimi i Serbisë është krijimi i kufijve brenda të cilëve nuk do të ketë konflikt, ndërsa jashtë tyre lufta është e paevitueshme”.²³⁵ Në shtator të vitit 1990, Serbia miratoi Kushtetutën e re në të cilën ruante funksionet e mbrojtjes dhe punëve të jashtme, përkatësisht kishte nenin 135, ku

²³² Dobrica Ćosić, *Pisčevi Zapisi 1981-1991*, fq 290, dhe Sonja Biserko *Yugoslavia's Implosion*, fq. 97.

²³³ Dušica Milanović, *Maske Uma*, (Beograd, Narodna Knjiga 2003), fq265.

²³⁴ Slobodan Despot, *Geopolitička Stvarnost Srba*, 1997 dhe Sonja Biserko *Implosion of Yugoslavia*, fq. 99.

²³⁵ Borisav Jović, *Poslednji dani SFRJ*, (Beograd: Politika 1995), fq. 131.

thuhej qartë se “Serbia do të zbatojë ligjet federative përveç në rastet kur kundërshtohen interesat e saj”.

Në muajin gusht dhe shtator 1990, serbët e Kroacisë të organizuar nën Këshillin Nacional Serb organizuan referendumin ku me shumicë votash vendosën të shpallin autonominë e tyre në territoret ku përbënin shumicën. Nën orkestrimin dhe përkrahjen logjistike nga Beogradi filloi armatosja e serbëve të Krajnës, në Kroaci. Në të njëjtën kohë filloi armatosja e serbëve në pjesën lindore të Bosnjës e Hercegovinës dhe rajonet rreth Sarajevës. Për të implementuar planet, Millosheviqi arriti të bashkonte ish-komunistët, tani në Partinë Socialiste të Serbisë, dhe elementet e ekstremit të djathtë, ideologjia e të cilëve buronte nga idetë çetnike dhe radikale të Luftërave Ballkanike. Historiani kroat, Ivo Banac ideologjinë nacionaliste të Millosheviqit e karakterizoi si: “formë të re të nacionalizmit integrues serb me ndikime komuniste dhe fashiste që mbledh sentimentet antidemokratike të së majtës dhe të djathtës. Kjo ideologji përmban averzionin e komunistëve ndaj demokracisë dhe besimin e ekstremistëve të djathtë në popullin spontan dhe homogjen. Kjo ideologji anti-liberale dhe anti-perëndimore që fajëson Perëndimin për rënien e socializmit dhe Jugosllavisë si dhe shpërbërjen e BRSS-së”.²³⁶ Bashkëpunëtorët e Millosheviqit, qoftë ideologjikë, qoftë ushtarakë, të ekstremistëve të djathtë u radhitën në Partinë e Ripërtëritjes Serbe (SPO) të Vuk Drashkoviqit dhe Partinë Radikale Serbe (SRS) të Vojislav Sheshelit. Në programin e partisë SPO kërkohet kolonizimi i Kosovës me serbë për të arritur balancin numerik me shqiptarët e Kosovës, largimin e shqiptarëve që janë vendosur ilegalisht nga Shqipëria në Kosovë, mbrojtjen e tokave serbe në Kroaci.²³⁷ Në programin e partisë SRS, kufijtë e Serbisë në perëndim janë aty ku jetojnë serbët në Kroaci, ndërsa kërkohet largimi i 360.000 shqiptarëve nga Kosova dhe kolonizimi i serbëve në Kosovë “në lokacione strategjike për të ndërprerë hapësirën etnike shqiptare si dhe t’u pamundësohet jeta normale duke ndërprerë shërbimet komunale etj”²³⁸. SPO dhe SRS do të marrin rol të rëndësishëm në regrutimin e vullnetarëve

²³⁶ Ivo Banac, *Raspad Jugoslavije*, (Zagreb: Derieux, 2001), fq. 32.

²³⁷ *SPO Programme*-Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, 1997, fq. 152.

²³⁸ *SRS Programme*-Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, 1997, fq. 134.

serbë për të marrë pjesë në luftërat në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë duke kryer disa nga krimet më të rënda kundër civilëve.

Milloseviqi në anën e tij përfitoi edhe Armatën Popullore të Jugosllavisë apo thënë më saktë caqet politike të Milloseviqit i shkonin përshtati udhëheqësisë së APJ-së që kërkonte rol të ri në Jugosllavinë që po shpërbëhej. APJ ka qenë gjithnjë e dominuar nga serbët, ndërsa rolin e vet e ka konsideruar si gardiane të shtetit stabil me autoritarizmin e bazuar në karakterin konservativ fshatar të shoqërisë serbe. Ushtria kishte luajtur rol kyç në krijimin e Serbisë, zgjerimit të saj, krijimit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllovene, ndërsa Ushtria Nacional-Çlirimtare kishte çliruar Jugosllavinë nga okupatorët nazifashistë. Në Jugosllavinë komuniste APJ ishte ushtri politike e bazuar në konceptin e “vëllazërim-bashkimit”. APJ financohej nga buxheti i shtetit, në vitin 1990 4,6% të të gjitha të hyrave në buxhet alokoheshin për APJ-në (2,5 miliardë dollarë) dhe në periudhën e fillimit të konflikteve 1990-1991, APJ numëronte 180.000 ushtarë dhe oficerë të karrierës, rreth 100.000 ushtarë të rekrutuar, ndërsa së bashku me pjesëtarët rezervë të sistemuar në Mbrojtjen Territoriale kjo arrinte numrin e 2 milionë ushtarëve nën armë; APJ ishte ushtria e katërt në Evropë.²³⁹ APJ ishte e krijuar për të mbrojtur kufijtë e Jugosllavisë, por është angazhuar për herë të parë gjatë demonstratave të shqiptarëve të Kosovës të vitit 1968, në ndihmë të policisë për të ndalur Lëvizjen popullore në Kroaci të vitit 1971 dhe me brutalitet përsëri në Kosovë në vitin 1989. APJ dhe Mbrojtja Territoriale, sipas Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974, ishin dy komponente që duhej të punonin së bashku për mbrojtjen nga armiku i jashtëm. Mbrojtja Territoriale ishte nën komandën e republikave dhe krahinave, ndërsa APJ nën komandën e Titos dhe pas vdekjes së tij nën komandën e Kryesisë së RSFJ-së.

Në vitin 1978, Kryesia e RSFJ-së miratoi dokumentin “Lufta speciale kundër Jugosllavisë” që përcaktonte doktrinën në luftën kundër oponentëve të APJ-së. Në fakt “Lufta Speciale” ishte lufta që Shërbimi i Kundër Zbulimit (KOS) bënte kundër nacionalistëve, shqiptarëve dhe kroatëve, disidentëve sllovenë etj., apo instrument me

²³⁹ Institute of Strategic Studies, Military Balance 1990-1991, London IIS ff. 95-96.

të cilin APJ zhvilloi veprimtarinë e spiunimit të zyrtarëve shtetërorë dhe partiakë në republika dhe krahina.

Angazhimi ushtarako-politik i APJ-së u pa hapur pas demonstratave të shqiptarëve të Kosovës të viti 1981, kur forcat e APJ-së ndihmuan policinë në shtypjen e protestave. Në atë periudhë u vendos të shpërndahet Mbrojtja Territoriale e Kosovës, që numëronte 60.000 anëtarë me 70% të tyre shqiptarë, që konsiderohej që mund të jetë forcë separatiste. Në këtë periudhë shqiptarët ishin në vendin e tretë për nga numri i rekrutëve për APJ, pas serbëve dhe kroatëve. Forcat e APJ-së në Kosovë u forcuan me tri brigada të motorizuara, regjimente të artilerisë së rëndë dhe forcave kundërajrore. Sipas planit operacional, Kosova ishte e rrethuar nga forcat e stacionuara në Shkup, Nish dhe Beograd, me detyra të caktuara në rast të trazirave.²⁴⁰ APJ kishte dilemat e veta për Millosheviqin, por e pranuan si aleat në fund të vitit 1988, pasi Branko Mamullën në krye të APJ-së e zëvendësoi gjenerali Velkjo Kadijeviq. Udhëheqësit e APJ-së e identifikuan Millosheviqin si mbrojtësin e vetëm të RSFJ-së dhe APJ mori anën e Serbisë duke u ndarë gradualisht nga Sllovenia dhe Kroacia.²⁴¹ Pas shpërbërjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në janar 1990, APJ u gjet në pozitë të vështirë manovruese sidomos para zgjedhjeve të lira të planifikuara të mbaheshin në pranverë të po atij viti. APJ ishte kritike ndaj zgjedhjeve shumëpartiake në Slloveni dhe Kroaci, duke i quajtur fitore për partitë e së djathtës, por jo edhe për zgjedhjet në Serbi ku kishte fituar partia socialiste. Në takimin 12-15 mars 1991, të Komandës Supreme të APJ-së me Kryesinë e RSFJ-së, ushtarakët kërkuan vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Jugosllavi. Ky propozim u refuzua. Gjenerali Kadijeviq më 13 mars 1991 fshehurazi kishte vizituar Moskën për të kërkuar përkrahjen për grushtshtet në Jugosllavi, gjë që u refuzua nga Ministri i Mbrojtjes Dmitri Yazov.²⁴² Pas zgjedhjeve në Slloveni dhe Kroaci, për APJ-në, më nuk kishte dilema dhe asnjëherë nuk i pranuan si legjitime qeveritë e Lubjanës dhe Zagrebit, por filloi zbatimin e skenarit të provokimeve.

²⁴⁰ Branko Mamula, Sekretar Federativ i i Mbrojtjes 1982-1988, "Slučaj Jugoslavija", (Podgorica: CID 2000), fq. 41.

²⁴¹ Velkjo Kadijević, Sekretar Federativ i i Mbrojtjes 1988-1992 "Moje vidjenje raspada", fq. 89.

²⁴² Borisav Jović, "Poslednji dani SFRJ", (Beograd: Politika 1995), fq. 295.

Në Kroaci, serbët e armatosur në dy raste sulmuan policinë kroate në prill të vitit 1991, në Plitvicë dhe në Pakrac, pas shkëmbimit të zjarrit kishte ndërhyrë APJ për të ndarë palët ndërluftuese. Ky ishte skenari i planifikuar për intervenim dhe çarmatosje të Kroacisë, përkatësisht forcave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që ishin lojale ndaj qeverisë në Zagreb. Më 25 qershor, Sllovenia dhe Kroacia deklaruan pavarësinë e tyre. APJ reagoi në Slloveni menjëherë, por hasi në rezistencë të organizuar nga forcat e policisë dhe Mbrojtjes Territoriale. Lufta zgjati vetëm 10 ditë dhe forcat e APJ-së u tërhoqën. Por, caku i vërtetë ishte Kroacia. Në vitin 1990, KOS-i kishte planifikuar një seri veprimesh nën shifrën e kodifikuar “Korniza”. Sipas këtij plani, në Kroaci, do të vendoseshin qindra pjesëtarë të APJ-së, por edhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë për të armatosur dhe organizuar serbët e Kroacisë dhe për të kryer aksione diversante në Kroaci. Plani “Korniza” për herë të parë ishte përmendur publikisht në shtator 1991 dhe qëllimi kryesor ishte mbajtja e Kroacisë në Jugosllavi, duke përforcuar kufijtë perëndimorë.²⁴³ Po ashtu, në fillim të vitit 1990, Kryesia e RSFJ-së, në krye me Borisav Joviqin, kishte vendosur për çarmatosjen e Mbrojtjes Territoriale të Sllovenisë dhe Kroacisë (ndonëse Sllovenia rezistoi suksesshëm), dhe të krijojë njësi të motorizuara rreth Zagrebit, Kninit, Banja Llukës dhe në rajonin e Hercegovinës, njëjtë siç kishin vepruar në Kosovë.²⁴⁴ Lufta në Kroaci filloi në prill 1991 dhe në shtator të atij viti arriti kulminacionin me sulmet e APJ-së edhe në qytetet e mëdha Vukovar, Dubrovnik e Zarë. Rezistenca e forcave kroate e detyroi APJ-në të ndryshojë planin “Korniza” duke u përqendruar në vijën e fundit perëndimore në rajonet ku jetonin serbët, të përcaktuara nga nacionalistët ekstremë Drashkoviç dhe Sheshel. Millosheviçi dhe ushtarakët ishin të mendimit se me këtë mund të fitonin ende Jugosllavinë me rreth 17 milionë qytetarë.²⁴⁵ Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në shtator 1991, vendosi embargo për shitjen e armëve vendeve të ish-Jugosllavisë dhe kjo masë më së shumti goditi Kroacinë dhe më vonë Bosnjën e Hercegovinën.

Me serbët në pushtet në rajonet që dominonin në Kroaci, që tani ishin bashkuar në Republikën Serbe të Krajines, Beogradi zyrtar ftoi OKB-në për të ndërmjetësuar në

²⁴³ Ilija Radaković, *Besmislena YU ratovanja*, (Beograd: Vreme,) fq. 7.

²⁴⁴ Borisav Jović, *Poslednji Dani SFRJ*, fq. 146.

²⁴⁵ Veljko Kadrijević *Moje vidjenje raspada*, (Beograd: Politika 1993), fq.134.

Kroaci. Më 9 nëntor 1991, përmes letrës zyrtare drejtuar Sekretarit Përgjithshëm, kërkohet krijimi i zonës neutrale në mes të forcave serbe dhe atyre kroate deri në përfundim të krizës në Jugosllavi dhe duke respektuar ligjet ndërkombëtare. OKB e dërgoi të dërguarin e posaçëm, Cyrus Vance dhe më 17 nëntor 1991, OKB miratoi Rezolutën 721 që planifikonte dërgimin e 14.000 trupave paqësore në Kroaci, sipas planit Vance të 2 janarit 1992. Luftimet intensive në Kroaci praktikisht përfunduan në shkurt të vitit 1992. Numri i të vrarëve llogaritej në mes të 6.000-10.000, 400.000 banorë ishin refugjatë dhe 30% e territorit mbeti i okupuar nga serbët.²⁴⁶

Milloseviqi dhe APJ tani mund të koncentroheshin në Bosnjë e Hercegovinë. Në fakt, në dhjetor 1991, APJ mori vendim për largimin e të gjithë oficerëve dhe ushtarëve që nuk ishin nga kjo republikë me qëllim të sigurojnë mbrojtjen politike dhe ligjore për Serbinë në rast se akuzohet si agresore në Bosnjë dhe Hercegovinë. APJ do të tërhiqej edhe nga Maqedonia në mars të vitit 1992, pasi në shtator të vitit 1991 qytetarët e Maqedonisë kishin votuar për Maqedoninë shtet të pavarur.

Në Kroaci, krahas forcave të APJ-së, u përdorën edhe njësitë paramilitare të partive SPO, SRS dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Këto njësi ishin nën komandën e drejtpërdrejtë të Beogradit dhe ishin më se të nevojshme, sepse kishte rënë numri i rekrutëve për njësitë e APJ-së.²⁴⁷ Krijimi i Republikës Serbe të Krajines për Milloseviqin shënoi përfundimin e APJ-së si ushtri jugosllave. Tani ishte koha për ushtri pro-serbe për Ushtri të Jugosllavisë pasi shteti quhej Republika Federative e Jugosllavisë - RFJ. Në maj të vitit 1992, u pensionuan 38 gjeneralë së bashku me shefin e KOS-it gjeneralin Aleksandar Vasiljeviq, që në luftën e Kosovës do të kthehej sërish në ushtri si zëvendës-komandant i inteligjencës së Sigurimit në UJ. Republika Federative e Jugosllavisë u shpall më 27 mars 1992, ndërsa Dobrica Qosiqi u zgjodh President. Ushtria e Jugosllavisë - në fakt e Serbisë - fokusohet në problemet në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe njësitë që u larguan nga Sllovenia dhe Kroacia u vendosën në këtë republikë duke e okupuar në mënyrë të qetë. Në tetor të vitit 1991, Alija Izetbegoviq kishte proklamuar neutralitetin e Bosnjës dhe Hercegovinës në

²⁴⁶ New York Times, *Casualty Figures*, 28 shkurt 1992.

²⁴⁷ Veljko Kadijević, *Moje vidjenje raspada* (Beograd: Politika, 1993), fq. 142.

konfliktin në Kroaci, ndërsa deputetët e partisë së tij, Partisë së Aksionit Demokratik SDA, në Kuvendin e BeH në Sarajevë kishin deponuar memorandumun për Bosnjën dhe Hercegovinën shtet sovran dhe të pavarur nga RFJ. Udhëheqësi i serbëve të BeH dhe Presidenti i Republikës Serbe, që bashkonte territoret e serbëve shumicë në BeH, Radovan Karaxhiq kërcënoi boshnjakët se po e dërgojnë Bosnjën drejt luftës dhe popullin e vet drejt zhdukjes.²⁴⁸

Në shtator të vitit 1991, në Bosnjë dhe Hercegovinë u krijuan katër rajone autonome me shumicë serbe dhe kërkuan ndihmë nga Ushtria e RFJ-së, 5000 trupa u vendosën nga RFJ për të siguruar kufijtë e rajoneve autonome serbe.²⁴⁹ Deri në fund të dhjetorit 1991, Ushtria Jugosllave kishte pozicionuar artilerinë e rëndë në pikat strategjike përreth qyteteve Sarajevë, Mostar, Bihaq dhe Tuzëll duke vepruar pandalshëm sipas planit “Korniza”.

Qëndrimi i politikës së jashtme të SHBA-ve ishte definuar në përkrahjen e ndryshimeve demokratike në Jugosllavi, që nënkuptonin përkrahje për secesionistët, por problemi konsiderohej evropian dhe si i tillë do të duhej të zgjidhej në Komunitetin Evropian. Pas një vizite të dështuar në Beograd më 21 qershor 1991, Sekretari i Shtetit, James Baker dhe Ministri i Jashtëm i Holandës, Hans van den Broek, që përfaqësonte Presidencën e KE-së, më 2 korrik 1991, lëshuan një deklaratë të përbashkët për Jugosllavinë në Uashington ku ranë dakord që KE duhet të trajtonte krizën në Jugosllavi.²⁵⁰

Komuniteti Evropian vendosi që të organizojë një mekanizëm për trajtimin e krizës në ish-Jugosllavi duke angazhuar përfaqësuesit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Jugosllavisë dhe republikave të saj, nën udhëheqjen e politikanit britanik Lord Peter Carrington. Konferenca e njohur si “Konferenca e Carringtonit”, nga 12 shtatori 1991 deri më 14 gusht 1992 mbajti trembëdhjetë sesione në Hagë dhe në Bruksel. Pas njohjes së Sllovenisë dhe Kroacisë si shtete sovraane, përfaqësuesit e federatës së

²⁴⁸ “Večernje Novosti” 16 tetor 1991.

²⁴⁹ Noel Malcolm, *Bosnia-A short History* (New York: University Press 1994), ff. 227-228.

²⁵⁰ Gert Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010), fq. 40.

Jugosllavisë më nuk ishin ftuar. E nisur si kornizë që do të ndalte dhunën dhe do të gjente zgjidhje për çështjet e sovranitetit dhe pakicave kombëtare, Konferenca nuk solli sukses, sepse gati të gjitha palët nuk respektonin marrëveshjet e arritura në sesionet plenare. Më 9 korrik 1991, Lordi Carrington pati një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së Boutros Boutros-Ghali që nuk solli një akord të plotë dhe me 25 gusht 1992, Lordi Carrington do të jepte dorëheqje.

Në terren, më 9 janar 1992, serbët e Bosnjës shpallën Republikën Serbe me Kuvendin dhe Kushtetutën e saj të miratuar më 28 shkurt 1992. Më 6 prill 1992, menjëherë pas referendunit, të mbajtur prej 29 shkurtit - 1 mars 1992, në të cilin shumica e qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës votoi për pavarësi, qeveritë e Bashkimit Evropian dhe SHBA-të vendosën ta pranojnë Bosnjën dhe Hercegovinën si shtet të pavarur. Serbët e armatosur u vënë menjëherë në veprim duke sulmuar Sarajevën më 4 prill 1992 dhe duke e mbajtur në rrethim për katër vite. Më 22 maj 1992 u krijua Ushtria e Republikës Serbe, ndërsa serbët morën nën kontroll 70% të territorit të Bosnjës dhe Hercegovinës që e mbajtën deri në verën e vitit 1995.

Pritjet e serbëve dhe Millosheviqit në Beograd ishin që lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë do të përfundonte shpejtë për shkak të epërsisë së madhe ushtarake që kishin ndaj forcave boshnjake dhe kroate. Qëllimet strategjike serbe ishin pastrimi etnik i territoreve nën kontrollin e tyre ushtarak, okupimi i Sarajevës, okupimi i brigjeve të lumit Sava dhe Drina, dhe pjesën e majtë të lumit Neretva për t'i lidhur me Serbinë dhe Malin e Zi. I dërguari i Komisionit për Hetimin e Shkeljeve të Ligjit për të Drejtat Humanitare të OKB-së, Sherif Bassiouni, në dëshminë e tij para Kongresit të SHBA-ve, më 4 prill 1995, kishte vërtetuar strategjinë e “pastrimit etnik” dhe taktikën e vrasjeve, gjymtimeve, dhunimeve të civilëve e forcave serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë.²⁵¹

Në anën tjetër, boshnjakët nuk kishin qenë të përgatitur për luftë dhe shkatërrim të shkallës më të cilën u përballën. Në mars 1991, SDA krijoi “Ligën Patriotike” si njësi mbrojtëse, ndërsa Ushtria e Bosnjës dhe Hercegovinës u krijua më 14 maj 1992. Po

²⁵¹ US Congress files, April 4, 1995.

ashtu, edhe kroatët e Bosnjës dhe Hercegovinës krijuan në korrik 1992 entitetin e tyre në Hercegovinën Perëndimore të quajtur “Herceg-Bosna” në krye me nacionalistin Mate Boban, qëllimi përfundimtar i të cilëve ishte bashkimi me Kroacinë. Më 30 maj 1992, Këshilli i Sigurimit të OKB-së vendosi sanksionet ekonomike ndaj Serbisë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së autorizoi një forcë paqeruajtëse të vendoset në aeroportin e Sarajevës; UN Protection Force apo UNPROFOR.

Në gusht të vitit 1992, pas 50.000 të vrarëve dhe mbi 2 milionë të të shpërngulurve për shkak të agresionit serb në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, Bashkimi Evropian organizoi Konferencën e Londrës. Në këtë Konferencë u ftuan liderët e gjashtë republikave të ish-Jugosllavisë dhe për herë të parë edhe përfaqësuesit e pakicave kombëtare, që mund të përcillnin bisedimet në anekset e Konferencës. Kosovën e përfaqësonte delegacioni me në krye Presidentin Ibrahim Rugova. “Konferenca e Londrës” ishte një ndërmarrje ambicioze e bashkëkryesuar nga Kryeministri britanik John Major dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Në fund pas debatimeve dhe negociatave u miratua një deklaratë për Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe një dokument i titulluar “Serbia dhe Mali i Zi, Relacioni Bashkë-Kryetarët” që përmbante pikat e debatuar që kishin të bënin me Kosovën, Vojvodinën, Sanxhakun, por në fund kishte mbështetjen vetëm të Kryeministrit britanik.²⁵² Konferenca e Londrës njohu integritetin territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ftoi forcat paqeruajtëse të OKB-së për të mbajtur armëpushimin. Po ashtu, u vendos që në bashkëkryesim të veprohet ku Bashkëkryetar në emër të OKB-së ishte Cyrus Vance, deri më 1 maj 1993, i pasuar nga ish-Ministri i Jashtëm i Norvegjisë, Thorvald Stoltenberg, ndërsa në emër të Komunitetit Evropian, më vonë BE-së, diplomati britanik David Owen deri më 12 qershor 1995 i pasuar nga ish-Kryeministri suedez Carl Bildt.

Në korrik 1992, filloi “Konferenca e Gjenevës” për të vazhduar punën e gjetjes së zgjidhjes për Bosnjën dhe Hercegovinën. Me një dallim nga “Konferenca e Londrës” në Gjenevë tani flitej për ‘tri palët ndërluftuese’ sepse edhe kroatët e Bosnjës dhe Hercegovinës kishin arritur të bëhen faktor politik. OKB-ja, në tetor 1992 dërgoi 8000 forca paqeruajtëse për të shpërndarë ndihma humanitare në Bosnjë dhe Hercegovinë.

²⁵² Gert Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010), fq. 56.

Bashkëkryesuesit Vance dhe Owen ishin caktuar si negociatorë, por qëndrimet e palëve ishin të palëkundura. Alija Izetbegoviqi dhe boshnjakët kërkonin Bosnjën e bashkuar, ndërsa Karaxhiqi, Millosheviqi dhe serbët theksonin se serbët kanë të drejtë të vendosin për veten e tyre dhe t'i bashkohen Serbisë. Rusia përjashtonte çdo përdorim të forcës kundër forcave serbe. Kështu Vance dhe Owen, në tetor 1992, paraqitën planin e tyre që Bosnjën dhe Hercegovinën e ndante në dhjetë kantone etnike.²⁵³ Përfaqësuesi kroat Mate Boban e pranoi planin, Presidenti boshnjak Alija Izetbegoviqi, nën presionin e Perëndimit e pranoi, por serbët e Bosnjës e refuzuan në tërësi.

Plani “Vance-Owen” shënoi një ndryshim dramatik në praktikën diplomatike rreth konflikteve ndërkombëtare që sipas ligjeve ndërkombëtare ekzistonte si princip ruajtja e stabilitetit gjatë tranzicioneve politike. Sipas principit “*Uti possidetis, ita possidetis*” (mund të mbash atë që ke pasur më parë), që ishte zbatuar në periudhën e pavarësisë së kolonive në Afrikë dhe Azi, kufijtë e brendshëm administrative trajtoheshin legjitim. Me planin Vance-Owen u hapën dyert për pranimin e pjesërisht të pushtimeve në terren dhe kjo u konvenonte serbëve.

Më 6 prill 1993, Ministrat e Jashtëm të BE-së miratuan “Deklaratën për ish-Jugosllavinë” duke theksuar se nëse serbët e Bosnjës nuk e pranojnë planin “Vance-Owen” atëherë Federata Serbo-Malazeze do të izolohet edhe më shumë.²⁵⁴ Më 17 prill 1993, Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi Rezolutën për shtrëngimin e sanksioneve ekonomike kundër Serbisë.²⁵⁵ Në këtë periudhë, administrata e Presidentit Clinton filloi të konsideronte sulmet ajrore kundër forcave serbe, për herë të parë prej fillimit të krizës në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa Pentagoni filloi të mbledhë informata në terren në identifikimin e caceve.²⁵⁶ Millosheviqi kishte pranuar planin “Vance-Owen”, por ai përfundimisht u refuzua nga serbët e Bosnjës dhe plani dështoi.

²⁵³ Detajet e planit shënohen te David Owen, “*Balkan Odyssey*” (London: Victor Gollancz 1995) ff. 89-93.

²⁵⁴ “Borba”, Beograd 7 prill 1993

²⁵⁵ “Politika”, Beograd 19 prill 1993

²⁵⁶ “Los Angeles Times”, 10 maj 1993.

Në periudhën 1992 dhe 1993, Qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës lobonte për heqjen e embargos së armëve e përkrahur nga SHBA-të, Gjermania dhe vendet islamike, por e bllokuar nga Britania e Madhe dhe Franca. Qëndrimi i britanikëve ishte i qartë dhe i definuar nga Sekretari i Jashtëm Douglas Hurd se “armatosja e boshnjakëve do të prolongonte luftën”, duke shqetësuar zyrtarët e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve se ndoshta britanikëve dhe francezëve është fitorja e serbëve në Bosnjë dhe Hercegovinë.²⁵⁷ SHBA-të dhe aleatët nuk patën sukses të ndërprejnë embargo as në Këshillin e Sigurimit të OKB-së e as pas votimit pro në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për shkak të vetos britanike dhe franceze.²⁵⁸ Administrata e Presidentit Clinton vendosi se nëse nuk mund të intervenohet në Bosnjë dhe Hercegovinë, atëherë duhet të ndërrohet bilanci i forcave të armatosura në terren. Në periudhën e vitit 1993 forcat boshnjake dhe ato kroate filluan luftën për dominimin e territoreve të Bosnjës Qendrore. Për të mundësuar armatosjen e boshnjakëve nevojitej të ndërpritej ky konflikt. SHBA-të kërcënuan Presidentin kroat Franjo Tudjman me sanksione ekonomike, në janar 1994, nëse nuk do të ndërpriste ndihmën ushtarake logjistike për kroatët e Hercegovinës. Paqja Boshnjako-Kroate u arrit në shkurt të vitit 1994 dhe armatosja e boshnjakëve, e financuar nga vendet islamike, mund të fillonte.

Në qershor të vitit 1994, përfaqësuesit e OKB-së dhe BE-së krijuan një plan të ri paqësor të cilin ua prezantuan Uashingtonit dhe Moskës që parashikonte krijimin e Federatës Boshnjako-Kroate me 51% të territorit dhe pjesës serbe me 49%. Nëse serbët nuk do të pranonin këtë plan atëherë do të largohej embargoja e armëve për boshnjakët dhe kroatët, nëse serbët e Bosnjës do ta pranonin planin do të largoheshin sanksionet ekonomike ndaj RFJ-së. Ashtu si edhe në vitin 1993 serbët e Bosnjës e refuzuan edhe këtë propozim. Për rezultat kjo solli deri tek ndarja në mes të

²⁵⁷ “New York Times”, 2 shtator 1993.

²⁵⁸ Sabrina P. Ramet *Balkan Babel-Disintegration of Yugoslavia from death of Tito to the fall of Milosevic* (Westview Press, Boulder, Colorado), fq. 212.

Milloseviqit dhe Karaxhiqit dhe Serbia deklaroi kufijtë e saj të mbyllur për trafikimin e armëve për serbët e Bosnjës.²⁵⁹

Më 11 gusht 1994, Presidenti Clinton paralajmëroi kërcënimin për serbët se nëse nuk do të pranojnë planin paqësor deri në tetor 1994, atëherë do të kërkonte mënyra për të larguar embargon e armëve.²⁶⁰ Serbët e Bosnjës paralajmëruan bashkimin e territoreve të tyre me RFJ-në dhe territoret e serbëve të Kroacisë.²⁶¹ SHBA-të kishin filluar të llobojnë te aleatët e tyre për veprime më të vendosura ndaj serbëve të Bosnjës. Sekretari i Mbrojtjes William Perry, më 28 shtator 1994, kishte kërkuar nga NATO veprime ushtarake ndaj serbëve të Bosnjës, por rezistencë kishin shfaqur britanikët dhe francezët me arsyen se forcat e tyre në terren mund të bëhen ‘caqe ushtarake’ të serbëve në hakmarrje.²⁶² SHBA-të konkretisht vepruan në tetor 1994 dhe zyrtarët e Pentagonit njoftuan se një mision ushtarak, i komanduar nga gjenerali John Galvin do të dërgohet në Sarajevë për të integruar forcat e armatosura boshnjake dhe kroate si dhe do të ndihmojë trajnimit e mëtutjeshëm të tyre.²⁶³ Pentagoni më parë kishte krijuar planin për armatimin dhe trajnimin e forcave të armatosura boshnjake që do të kushtonte deri në 5 miliardë dollarë.²⁶⁴

Përfundimisht, administrata e Presidentit Clinton më 11 nëntor 1994, vendosi që nuk do të parandalonte armatosjen e boshnjakëve dhe tërhoqi luftanijet e vendosura për këtë qëllim nga Deti Adriatik. Më 29 nëntor 1994, Sekretari i Mbrojtjes William Perry dhe Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, Gojko Shushak nënshkruan “Memorandumin e Bashkëpunimit në Çështjet e Mbrojtjes dhe ato Ushtarake”, që nënkuptonte trajnimin e forcave kroate nga ushtarakët amerikanë. Rritja e fuqisë së forcave kroate dhe boshnjake korrespondonte me rënien e fuqisë së serbëve të Kroacisë dhe të Bosnjë dhe Hercegovinës. Në shkurt të vitit 1995, ushtria kroate numëronte 100.000 ushtarë dhe

²⁵⁹ Sabrina P. Ramet *Balkan Babel-Disintegration of Yugoslavia from death of Tito to the fall of Milosevic* (Westview Press, Boulder, Colorado), fq. 217.

²⁶⁰ “*New York Times*”, 12 gusht 1994.

²⁶¹ “*New York Times*”, 19 gusht 1994.

²⁶² “*New York Times*”, 29 shtator 1994.

²⁶³ “*New York Times*”, 21 tetor 1994.

²⁶⁴ “*Daily Telegraph*”, London, 19 nëntor 1994.

180.000 rezervistë krahasuar me forcat serbe që numëronin 50.000 trupa. Forcat e armatosura boshnjake numëronin 164.000 ushtarë.

Administrata e Presidentit Clinton besonte se ndryshimi i situatës në terren do të mundësonte arritjen e marrëveshjes për përfundimin e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, mirëpo për këtë duhej dobësuar pozicionet e serbëve në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kështu më 1 maj 1995, forcat kroate sulmuan pjesët e rajonit të Sllavonisë duke kaluar në ofensivë dhe duke larguar forcat serbe nga ky rajon. Më 4 gusht 1995, forcat kroate sulmuan Krajinën dhe Kninin, kryeqytetin e Republikës Serbe të Krajinës, duke e çliruar gati gjithë Kroacinë e okupuar përveç pjesës lindore të Sllavonisë që kufizohej me Serbinë. Në të njëjtën kohë, forcat kroate dhe ato boshnjake sulmuan rajonin e Bosnjës perëndimore duke liruar pjesët afër qytetit të Bihaqit. Mbi 150.000 serbë u shpërngulën drejt Serbisë. Një numër i madh i tyre do të drejtohet në Kosovë. Megjithatë, momenti që do të jetë përcaktues për fatin dhe përfundimin e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci ishte pushtimi i zonave të mbrojtura nga forcat e OKB-së në qytezat Zhepa dhe Srebrenica dhe vrasja e afër 7000 burrave dhe djemve boshnjakë nga ana e forcave serbe. Forcat e NATO-s filluan të bombardojnë pozicionet e serbëve më 30 gusht 1995 dhe kjo fushatë do të zgjasë deri në fillimin e procesit të bisedimeve në Dejton, në nëntor 1995. Besohet se gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë janë vrarë nga 150.000 deri në 200.000 njerëz, kryesisht civilë, ndërsa ishin shpërngulur mbi 2 milionë të tjerë.

Udhëheqësia e Kosovës në vitin 1991 mendohej të evitonte pikërisht këtë që ndodhi në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, luftën e hapur me serbët dhe APJ-në. Në “Konferencën e Carringtonit” Kosova e kishte vështirë të fuqizohej, sepse nuk ishte e pranuar ndërkombëtarisht. Por, Rugova gëzonte mbështetjen e popullit të Kosovës më shumë se çdonjëri nga udhëheqësit etnikë që i janë drejtuar Konferencës, dëshmuar nga një mori zgjedhjesh, sondazhesh dhe demonstrimesh të hapura publike. Megjithatë, BE për të ftuar Rugovën në seancat plenare të Konferencës do të duhej të kapërcente disa pengesa:

- 1) të njihte që karakteri federativ i Kosovës mbizotëronte atë që ishte pjesë e Serbisë dhe i ofronte Kosovës të drejtën e shkëputjes si republikat e tjera;
- 2) të deklaronte se administrata e Kosovës e krijuar nga Millosheviqi ishte jolegjitime;
- 3) të rrezikonte bojkotimin e Serbisë për pjesëmarrje në Konferencë që do të çonte në dështimin e saj.

Askush në BE nuk dëshironte dështimin e Konferencës. Shqiptarët e Kosovës ndikimin e tyre në Konferencë e bënë përmes lidhjeve dhe ndërhyrjeve tek anëtarët e Konferencës dhe Ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve evropiane, përmes dokumenteve, letrave, memorandumeve dhe demonstratave të mëdha të organizuara në Hagë dhe Bruksel. Presidenti Ibrahim Rugova, Gazmend Zajmi, Avdyl Krasniqi, Bajram Kelmendi, Veton Surroi, Adem Demaçi u ishin drejtuar pjesëmarrësve të Konferencës për të shtyrë përpara çështjen e Kosovës. Po ashtu, përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës i mbështeste Republika e Shqipërisë në letrat dhe ndërhyrjet gojore të Presidentit Ramiz Alia, Kryeministrit Aleksandër Meksi, Ministrit të Jashtëm Muhamet Kapllani dhe nga Kisha Ortodokse që sugjeruan pjesëmarrjen e Shqipërisë në emër të shqiptarëve të Jugosllavisë. Mbështetja për pjesëmarrjen e Kosovës në Konferencë vinte nga Parlamenti Evropian, Kongresi i SHBA-ve²⁶⁵ dhe Këshilli i Evropës. Kështu, Kosova nuk luajti rol të rëndësishëm në Konferencën e Carringtonit, ndërsa vetë ai vetëm dy herë ishte takuar me Presidentin Rugova, në janar dhe korrik 1992.²⁶⁶ Megjithatë, Kosova synonte të forconte institucionet e veta duke qëndruar në një vijë politike, pra në asnjë mënyrë të mos pranohej kthimin në asnjë formë autonomie nën Serbinë apo Jugosllavinë dhe duke mos lënë hapësirë që të ketë mendime të tjera politike përpos atyre të dakorduara në Këshillin e Partive Politike. Presidenti Rugova, më 27 nëntor 1991, i kishte dërguar një letër Këshillit të

²⁶⁵ Kongresmenët Eliot Engel, Tom Lantos, Benjamin Gilman, Dick Sweet dhe Susan Molinari kërkuan “njohjen diplomatike të Republikës së Kosovës” më 13 janar 1992.

²⁶⁶ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010), 316-317.

Sigurimit të OKB-së duke kërkuar protektorat ndërkombëtar, si fazë kalimtare drejt definimit të statusit final të Kosovës në bazë të vullnetit të popullit të saj.

Më 24 maj 1992, në Kosovë u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, të cilat i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës, duke marrë 96 nga 130 vende në Parlament, ndërsa Rugova u zgjodh President i parë i Republikës së Kosovës. Policia serbe kryesisht nuk i pengoi zgjedhjet, ndërsa në Parlament 14 vende u mbajtën të lira për serbët e Kosovës. Mbledhjen e Parlamentit të Kosovës, të caktuar më 23 qershor 1992, nuk e lejoi policia e Serbisë.

Zgjedhja e Rugovës provoi politikën e rezistencës paqësore ekskluzive dhe mençuria e kësaj politike u konfirmuan në Raportin e Misionit të OSBE-së, që vizitoi Kosovën prej 28 majit - 2 qershor 1992. Misioni diagnostifikoi një gjendje parakonflikti me një prani të rëndë e të dukshme ushtarake dhe policore serbe dhe shumë civilë të armatosur. Përballë një fuqie të tillë shqiptarët nuk kishin gjasa, theksohej në raport.²⁶⁷ “Konferenca e Londrës” për Jugosllavinë më 26-27 gusht 1992 nisi një proces të negociatave me ndërmjetësim ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve thelbësore që kishte Kosova. U krijua Grupi për Kosovën të cilin e udhëhoqi diplomati gjerman Geert Hinrich Ahrens që do të ndihmonte bisedimet në mes të institucioneve të Kosovës dhe institucioneve të Serbisë. Qëllimi kryesor i ndërmjetësuesve të huaj ishte të vinin palët së bashku në negociata trepalëshe. Grupi i Punës u takua në Gjenevë, 30 shtator - 1 tetor 1992, ku institucionet e Kosovës i përfaqësonte kryeministri Bujar Bukoshi, ndërsa ato të RFJ-së dhe republikave Serbisë dhe Malit të Zi, zëvendësministri i qeverisë federative Konstantin Obradović. Në këtë takim u cilësua çështja e arsimit si çështje që duhet të zgjidhet me prioritet në Kosovë. Negociatat e vërteta filluan në Prishtinë, më 13 dhe 14 tetor 1992 në ambientet e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, pala shqiptare ishte e përfaqësuar nga Rexhep Osmani, ndërsa pala serbe e përfaqësuar nga Ministri federativ i Arsimit, Ivan Iviq dhe Ministri Federativ për të Drejta të Njeriut dhe Pakicave Momčillo Grubač. Palët u pajtuan,

²⁶⁷ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010),332 dhe raport i Misionit Faktmbledhës për Kosovën të Qendrës për Parandalimin e Konfliktëve të OSBE-së, 5 qershor 1992, ende i pashfrytëzueshëm publikisht)

ndërmjet tjerash, që të fillohet me normalizimin e procesit mësimor në Kosovë.²⁶⁸ Në periudhën tetor-nëntor 1992 u zhvilluan disa takime me premtime se do të plotësoheshin kërkesat e shqiptarëve për normalizimin e procesit arsimor. Megjithatë, serbët deri në fund u treguan kooperativ ndaj palës ndërkombëtare për të sabotuar në fund përpjekjet dhe premtimet me arsyetimin se çështjet e arsimit janë çështje të nivelit republikan dhe jo federativ. Në të njëjtën periudhë, partia e Millosheviqit, SPS, dhe ajo e Sheshelit, SRS, fituan në zgjedhjet federative dhe republikane të 20 dhjetorit 1992 dhe morën kursin radikal nacionalist.

Raportet e inteligjencës që vinin nga Serbia, për një goditje ushtarake ndaj shqiptarëve, kanë shtyrë Presidentin George H. Bush që më 24 dhjetor 1992 të kërcënohej ndaj Beogradit se SHBA-të do të përdorin forcën ushtarake, në Serbi dhe në Kosovë, nëse Serbia i sulmon shqiptarët. Ky kërcënim është përsëritur edhe nga Presidenti Bill Clinton, më 19 shkurt 1993, dhe nga ambasadorja e SHBA-ve në OKB, Madeleine Albright në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në gusht të vitit 1993.²⁶⁹

Negociatat për përmirësimin e të drejtave të njeriut, arsimit dhe shëndetësisë me ndërmjetësimin e Grupit Punues të krijuar nga “Konferenca e Londrës” nuk dhanë rezultate, sepse serbët nuk respektuan marrëveshjet apo premtimet e dhëna dhe nuk kishte mekanizëm që do t’i detyronte të bëjnë këtë. Por, Millosheviqi në asnjë mënyrë nuk dëshironte të jepte përshtypje se nuk ishte basjkëpunues me bashkëkryesuesit e “Konferencës së Londrës”, Owen dhe Stoltenberg dhe përdorte mënyra për përfitimin e kohës duke nxitur iniciativa dhe duke mos i përmbushur ato deri në fund. Në prill të vitit 1994, zëvendëskryeministri i Qeverisë së RFJ-së, Zheljko Simiq, kishte iniciativën e re të takohej me udhëheqësit shqiptarë të Kosovës, në territorin e RFJ-së. Këtë e kishte refuzuar Presidenti Rugova duke kërkuar takim në një vend të tretë dhe me ndërmjetësim ndërkombëtar.

Më 2 nëntor 1994, Owen dhe Stoltenberg ishin takuar me delegacionin e udhëhequr nga Presidenti Rugova në Gjenevë. Në këtë takim bashkëkryetarët kishin kërkuar nga

²⁶⁸ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010), ff. 339-341.

²⁶⁹ UN Security Council provisional verbatim record, August 9th, 1993 (15.06.2013)

Rugova që të fokusohet në dialog për autonominë e Kosovës, ndonëse ai kishte këmbëngulur në kërkesën për pavarësinë e Kosovës dhe protektoratin ndërkombëtar si fazë kalimtare. Rugova kishte kërkuar gjallërimin e Grupit të Posaçëm për Kosovën dhe kishte theksuar se Owen dhe Stoltenberg mund të nxitnin një takim në mes të tij dhe Millosheviqin me pjesëmarrjen e tyre si palë ndërmjetësuese. Bashkëkryesuesit nuk vendosën të bëjnë as njërën e as tjetrën, por dërguan në Kosovë Kai Eiden, diplomat norvegjez, në një mision faktmbledhës mbi gjendjen e pakicave në RFJ. Eide vizitoi Kosovën vetëm një herë, më 23-24 maj 1995, dhe në raportin e tij theksonte se shqiptarët mund të joshen në një dialog me një rend dite të kufizuar dhe se pjesëmarrja e palës së tretë, që kërkonin shqiptarët dhe refuzonin serbët, ishte vështirë e realizueshme.

Në mesin e vitit 1995 ishte e qartë se Millosheviqi dhe Serbia, nga mosveprimi evropian, ishin frymëzuar të premtojnë dhe mashtrojnë pa brengën e ndëshkimit qoftë edhe diplomatik. Ndërmjetësimi ndërkombëtar kishte arritur në një pikë të ulët efikasiteti dhe bashkërendimi por edhe servilizmi ndaj Millosheviqit.²⁷⁰ Në Kosovë gjendja ishte e tensionuar, por ishte nën kontroll. Në Kosovë nuk kishte pasur demonstrata të mëdha që nga fillimi i viteve të 90-ta, ndërsa largimi i të rinjve nga Kosova në masë të madhe drejt vendeve perëndimore ishte brengosës. Institucionet e Kosovës funksiononin, por dukej se kishin arritur zenitin brenda mundësive të tyre. Ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës ishte arritur, por ende çështja e statusit dhe të drejtave të njeriut vlerësohej nga perëndimorët se duhej zgjidhur brenda RFJ-së.

²⁷⁰ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010),358-359.

II.4 Konferenca e Dejtonit dhe implikimet për Kosovën

Deri në vitin 1995, politika e jashtme e SHBA-ve për Bosnjën dhe Hercegovinën ishte e fokusuar në mbajtjen e embargos dhe ndalimit të armatimit të palëve ndërluftuese dhe përkrahjes së përpjekjeve evropiane për të gjetur një zgjidhje paqësore. Në vitin 1994, SHBA-të morën rolin e ndërmjetësuesit për të ndërprerë konfliktin në mes të forcave kroate dhe atyre boshnjake për shkak të situatës në terren dhe mundësisë që Bosnja dhe Hercegovina të ndahej nga elementet nacionaliste serbe dhe kroate që mbështetnin këtë ide në Beograd dhe Zagreb. Po ashtu, për dallim nga pjesëmarrja në planin diplomatik, SHBA-të ishin mjaft aktive në zhvillimin e politikave ushtarake dhe strategjisë “lift and strike”, të propozuar nga administrata e Presidentit Bill Clinton në vitin 1993. Sipas kësaj strategjie kërkohet suspendimi i embargos për armët për boshnjakët e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe mundësia e goditjes nga ajri i caqeve ushtarake të forcave serbe.

Ndërrimi i dukshëm i politikës së SHBA-ve ndaj situatës në Bosnjë dhe Hercegovinë ka ndodhur në pranverën dhe verën e vitit 1995. SHBA-të morën përsipër iniciativën e gjetjes së zgjidhjes së konfliktit në Bosnjë dhe Hercegovinë si rezultat i rrethanave të kohës dhe mundësive. Sukseset ushtarake të forcave të armatosura të Kroacisë në luftë kundër forcave serbe si dhe gjendja e rëndë ekonomike në Republikën Federative të Jugosllavisë (RFJ) krijuan mundësitë e nevojshme për SHBA-të të marrin rolin udhëheqës në strategjinë e gjerë diplomatike dhe ushtarake.²⁷¹

Gjatë gjithë vitit 1995 diplomacia amerikane ishte aktive për të bindur aleatët në Grupin e Kontaktit (Rusinë, Britaninë e Madhe, Italinë dhe Francën), udhëheqësit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe qeveritë e Republikës Federative të Jugosllavisë, bashkë me Republikën Serbe të vetëshpallur, Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, për të bërë një përpjekje që të gjendet një zgjidhje për përfundimin e konflikteve në ish-Jugosllavi.

²⁷¹ Saadia Touval, *Coercive Mediation on the Road to Dayton*, International Negotiation I, Kluwer Law International, Holandë 1996, fq. 553.

Iniciativa amerikane kishte dimensionin diplomatik dhe ushtarak. Diplomacia amerikane mori përsipër kontrollin e procesit negociator, ndërsa elementet e forcave të armatosura të SHBA-ve kishin për detyrë të përkrahnin veprimet kundër forcave serbe në terren për të zbutur pozicionin e tyre negociator. Në një situatë të ndërlikuar politika e jashtme e SHBA-ve mori drejtimin e thjeshtësimit. Së pari SHBA-të vendosën të marrin përsipër rolin udhëheqës në negociatat që do të zhvilloheshin në SHBA, duke njohur rolin e OKB-së, BE-së dhe Rosisë si faktorë të jashtëm. Mirëpo, u vendos që negociatat të udhëhiqen nga SHBA-të, përkatësisht një negociator, Richard Holbrooke dhe ekipi i tij, ndërsa aleatët dhe të tjerët do të kenë praninë e tyre. Po ashtu, u vendos nga administrata e Presidentit Clinton që të thjeshtësohet struktura e negociatave me palët ndërluftuese. Kështu, boshnjakët do t'i përfaqësonte Presidenti Alija Izetbegović, ndërsa në rastin e serbëve përfaqësues i RFJ-së dhe serbëve të Bosnjës dhe Hercegovinës do të ishte Slobodan Millosheviq, e i Kroacisë dhe i kroatëve të Bosnjës dhe Hercegovinës Presidenti Franjo Tuđman. Dhe, në fund, u vendos që operacionet ushtarake kundër forcave serbe të intensifikoheshin, qoftë përmes bombardimeve të NATO-s, qoftë me lejimin e ofensivave të forcave kroate dhe boshnjake në verën e vitit 1995 në rajonin e Bihaqit, BeH dhe Krahinës Autonome Serbe në Kroaci. Gjatë bombardimeve të NATO-s janë goditur qendrat komanduese dhe komunikimet e forcave serbe si dhe depot e armëve, pjesë të artilerisë së rëndë dhe mjeteve të blinduara.

Më 1 nëntor 1995, në bazën e Forcave Ajrore të SHBA-ve *Wright-Peterson* afër qytetit Dayton në Ohajo, filluan bisedimet për t'i dhënë fund konfliktit në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pas tri javësh të bisedimeve intensive është arritur ndërprerja e konfliktit në mes të Kroacisë dhe Serbisë dhe e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe janë zvogëluar tensionet në mes të Greqisë dhe Maqedonisë. Në fund të negociatave u ruajtën kufijtë e jashtëm të Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa territori i saj u nda në Republikën Serbe (49% e territorit) dhe Federatën Boshnjako-Kroate (51% e territorit), ndërtimin e institucioneve demokratike e mori përsipër BE, mbajtjen e zgjedhjeve të lira OSBE, ndërsa sigurinë dhe implementimin e Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit e kishte NATO përmes operacionit IFOR.

Me gjithë mungesat që kishte Marrëveshja Paqësore e Dejtonit ajo ishte një arritje e madhe dhe sukses i politikës së jashtme të SHBA-ve, në radhë të parë që krijoi mundësitë për të rindërtuar ish-Jugosllavinë pas katër vjetësh të luftës së tmerrshme. Politika e jashtme e SHBA-ve u tregua e suksesshme për disa arsye, por në radhë të parë pasi SHBA-të gëzonin statusin e fuqisë së pakontestueshme në vitin 1995. SHBA-të posedonin resurse të mjaftueshme ekonomike dhe ushtarake për të detyruar, joshur, negociuar, dhe në fund për t'i bindur palët të pranojnë kushtet e Marrëveshjes Paqësore. Përpos që ndihmuan si negociatorë në mes të palëve është e qartë se Holbrooke dhe ekipi i tij edhe imponuan zgjidhjet për problemet që ishin shfaqur gjatë negociatave.

Në Dejton nuk u gjet zgjidhja dhe as që u trajtua problemi i statusit të Kosovës dhe shqiptarëve, ndonëse prej këtu filloi shkatërrimi i Jugosllavisë.

Arsye për të provuar që të gjendet një zgjidhje për Kosovën në Dejton kishte shumë. Kosova dhe shqiptarët të parët filluan të kërkojnë zgjidhje për statusin e tyre jashtë Jugosllavisë, duke inkurajuar përpjekjet e mëvonshme të Sllovenisë dhe Kroacisë për të kërkuar pavarësinë e tyre.²⁷² Regjimi serb nën udhëheqjen e Slobodan Millosheviqit, për një dekadë kishte shkelur të gjitha të drejtat e njeriut në Kosovë, kishte përjashtuar shqiptarët nga jeta sociale duke krijuar aparthejd në Evropë, dhe kishte suprimuar me dhunë brutale autonominë që kishte Kosova nga viti 1974. Të gjitha këto shkelje ishin të njohura për SHBA-të dhe gjithë bashkësinë ndërkombëtare dhe ekzistonte vlerësimi se zgjidhja përfundimtare për Kosovën do të jetë edhe zgjidhje përfundimtare e çështjes së Jugosllavisë, gjë që edhe ndodhi vetëm katër vjet më vonë pas aksionit të NATO-s “Operation Allied Force” (OAF) që largoi forcat serbe nga Kosova.

Por, çështja e Kosovës në vitin 1995 nuk ishte me prioritet për politikën e jashtme të SHBA-ve krahasuar me gjendjen në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Departamenti i Shtetit të SHBA-ve vlerësonte luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë jo

²⁷² Presidenti i Kroacisë Franjo Tugjman kishte vlerësuar se heqja e autonomisë së Kosovës ishte ‘moment simbolik’ që shënoi përfundimin e udhëheqjes federale të Jugosllavisë, Alan Ferguson *Yugoslavia coming apart at the seams*, Toronto Star, 14 tetor 1990

vetëm si luftën më të tmerrshme në Evropë pas luftës së Dytë Botërore, por edhe kërcënim të drejtpërdrejtë për gjithë Evropën pas përfundimit të “Luftës së ftohët”. Serbët e Bosnjës dhe Hercegovinës po përpiqeshin që përmes veprimeve gjenocidale të shfarosnin popullatën boshnjake, serbët e Kroacisë të përkrahur nga

Republika Federative e Jugosllavisë kishte okupuar 30% të territorit të Kroacisë dhe si rezultat mijëra refugjatë kishin vërshuar vendet e Evropës Perëndimore.²⁷³ Përpjekjet e udhëhequra nga OKB-ja për të ndaluar fushatat pushtuese të serbëve ishin treguar të kota, ndërsa Uashingtoni dhe Brukseli asnjëherë nuk kishin marrë në konsiderim përdorimin e forcës apo edhe vetëm kërcënimin për përdorim të forcës kundër agresionit serb.

Presidenti Bill Clinton në vitin 1993 kërkoi një politikë më agresive (siç kishte premtuar në fushatën parazgjedhore presidenciale një vit më herët), vetëm për t’u përballur me shumicën në Kongresin e SHBA-ve dhe pjesën më të madhe të forcave të armatosura të udhëhequra nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Colin Powell që ishin kundër angazhimit më agresiv apo ushtarak në ish-Jugosllavi. Ishte masakra e Srebrenicës, në Bosnjën Lindore, ku në verë të vitit 1995 u vranë nga forcat serbe mbi 7000 boshnjakë në zonën e mbrojtur nga trupat paqeruajtëse holandeze, nën mandatin e OKB-së, që vendosi ndërrimin definitiv të kahjes së politikës amerikane në ish-Jugosllavi.

Gjatë fushatës parazgjedhore presidenciale të vitit 1992, Presidenti Clinton ishte pro veprimit më pozitiv në trajtimin e çështjes së Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa Sekretari i Shtetit Warren Christopher dhe më vonë Madeleine Albright përkrahën idenë e “multilaterizmit të vendosur” me SHBA-të në rolin udhëheqës të përkrahura nga vendet e tjera të bashkësisë ndërkombëtare në intervenimet për të ndaluar gjenocidet, shtetet e dështuara dhe urinë. Në vitin e parë dhe të dytë të mandatit presidencial Clinton u përqendrua në çështjet e brendshme të SHBA-ve.²⁷⁴ Megjithatë në vitin 1993, Strategjia e re ushtarake “Bottom-Up Review” konfirmoi konceptin

²⁷³ Derek Chollet, *The Road to Dayton Accords*, (Palgrave MacMillan New York 2005.)

²⁷⁴ Alan Dobson dhe Steve Marsh *US Foreign Policy since 1945*, New York Routledge, fq. 140.

‘Wilsonian’ internacionalist të Presidentit Clinton. Sipas Strategjisë së re synohej ndalimi i shpërndarjes së armëve nukleare në botë, gatishmëria e forcave të armatosura të SHBA-ve të luftojnë në dy fronte të mëdha në të njëjtën kohë, por edhe përkrahja e vlerave demokratike në botë dhe gatishmëria që në ‘mënyrë efikase të participohet në operacionet multilaterale të vendosjes së paqes dhe veprimet unilaterale që mund të jenë paqeruajtja, ndihma humanitare, lufta kundër drogës, lufta kundër terrorizmit’.²⁷⁵

Presidenti Clinton vlerësoi atë kohë se SHBA-të nuk mund të mos involvohen në ish-Jugosllavi dhe se ishte para dy mundësive: ose të ndihmojë tërheqjen e trupave të OKB-së, që do të thoshte dështim i përpjekjeve ndërkombëtare, ose të ndërmarrë nën udhëheqjen amerikane një përpjekje për të përfunduar luftën dhe për të mbrojtur civilët. Sipas një studimi të Departamentit të Shtetit rreth situatës në Bosnjë dhe Hercegovinë, Presidenti Clinton dhe zyrtarët e lartë të politikës së jashtme ishin të befasuar në qershor 1995, kur kishin mësuar se forcat ushtarake amerikane do të involvoheshin në Bosnjë dhe Hercegovinë me apo pa dëshirën e administratës. Sipas vlerësimeve të studimit, NATO do të involvohej për të ndihmuar ‘helmetat e kaltra’ të OKB-së, nëse situatat në terren bëhej kaotike, dhe forcat amerikane do të duhej të përkrahnin këtë operacion për të ruajtur premtimin ndaj NATO-s dhe kredibilitetin e Aleancës. Sipas një këshilltari të Presidentit Clinton vendimi i vështirë për të dërguar trupat amerikane në Bosnjë dhe Hercegovinë është marrë gati pa u vërejtur.²⁷⁶

Në pranverë të vitit 1995 planifikuesit ushtarakë të NATO-s kishin krijuar një plan të detajuar (1300 faqe) operacional për të ndihmuar tërheqjen e forcave të OKB-së, UNPROFOR. Sipas planit të titulluar “Op-Plan 40104” rreth 20.000 ushtarë amerikanë si pjesë e forcës së NATO-s do të ndihmonin këtë tërheqje. Gjenerali Wesley Clark, në atë kohë një nga strategët në Shtabin e Përgjithshëm, e kishte përshkruar këtë plan si “një përpjekje të madhe me mundësi të lartë për konflikt para

²⁷⁵ C.W. Kegley dhe E.R. Wittkopf, *World Politics: Trend and Transformation*, (New York: St Martin’s, 1995), fq. 415.

²⁷⁶ W. Bass *The Triage of Dayton*, *Foreign Affairs* 77:5, 1998, fq. 99.

dhe gjatë tërheqjes së forcave të OKB-së ekuivalente me një plan lufte”.²⁷⁷ Ndërsa diplomati Carl Bildt e kishte cilësuar si “plan i përkryer ushtarak për një katastrofë të madhe politike”.²⁷⁸

Presidenti Clinton filloi të ndryshonte politikën e jashtme të SHBA-ve në raport me ngjarjet në ish-Jugosllavi duke manovruar për të ruajtur rolin udhëheqës të SHBA-ve së bashku me Britaninë e Madhe dhe Francën, në krijimin e forcës ushtarake për Bosnjë dhe Hercegovinë, për të ruajtur partneritetin me Rusinë, dhe për të ruajtur kohezionin në Kongresin e SHBA-ve. Sekretari i Shtetit, Warren Christopher me Shefin e Kabinetit Tom Donilon, Zëvendës Sekretari Strobe Talbott, Ndihmës Sekretari për Evropë Richard Holbrooke, Këshilltarët për Siguri Sandy Berger dhe Anthony Lake, Këshilltari për Siguri i Zëvendës Presidentit Leon Fuerth, dhe Drejtori i CIA-s John Deutch përbënin ekipin që do të zbatonte politikën e re diplomatiko-ushtarake për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe ish-Jugosllavinë në përgjithësi.

Shtytje edhe më të madhe planeve amerikane u dha ambasadorja e SHBA-ve në OKB, Madeleine Albright, e cila vlerësonte se situata në Bosnjë dhe Hercegovinë dëmtonte pozicionin diplomatik të SHBA-ve në botë. Ajo prezantoi planin e saj “Elements of a New Strategy” që udhëzonte administratën e Presidentit Clinton të planifikonte veprimet për Bosnjën pa forcat e UNPROFOR-it. “Bosnja po e shkatërron politikën tonë të jashtme brenda dhe në arenën ndërkombëtare, ndërsa strategjia e tanishme e veprimit e bën Presidentin të duket i dobët”, theksohej në dokument.²⁷⁹

Albright këshillonte të veprohej guximshëm: SHBA-të duhej të ushtronin presion te evropianët që të tërhiqen nga Bosnja dhe Hercegovina dhe të përfundojnë misionin e OKB-së. SHBA-të duhet të heqin embargon e armëve dhe të mundësojnë armatosjen e forcave të qeverisë boshnjake, ndërsa NATO duhet të veprojë me bombardime për të mbrojtur territoret e boshnjakëve. Në këtë mënyrë Millosheviqi do të mund të zgjidhte të pranonte kushtet ose të përballej me faktin se një forcë ushtarake e fuqishme

²⁷⁷ Wesley Clark *Waging Modern War*, (Public Affairs 2001), fq. 48.

²⁷⁸ Carl Bildt *Holbrooke's History* (Survival, 1998), fq. 188.

²⁷⁹ Madeleine Albright, *A Memoir Madam Secretary* (New York, Miramax Books 2001), f. 186.

kërcënon serbët e Bosnjës dhe vendimin se a do t'i ndihmojë ushtarakisht apo jo. Presidenti Clinton pjesërisht i pranoi këshillat e ambasadores Albright.²⁸⁰

Po ashtu, ishte vendosur që të ushtrohej presion mbi Millosheviqin dhe të përdorej mundësia e largimit të sanksioneve ekonomike ndaj RFJ-së si 'karotë', si dhe të inkurajohej që të përfaqësonte të gjithë serbët, si në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kroaci, duke izoluar udhëheqësit lokalë të serbëve si Radovan Karaxhiq, Ratko Mlladiq. Kjo u bë e mundur më 25 korrik 1995, kur Tribunali për krime të Luftës në Hagë ngriti aktakuzën kundër tyre.

Pas arritjes së mirëkuptimit me partnerët evropianë për mënyrën e veprimit, administrata e Presidentit Clinton duhej të qartësonte rolin e Ruisë në zgjidhjen e problemeve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Qëllimi i Ruisë ishte i qartë: Rusia donte të jetë pjesë e forcave paqeruajtëse, por jo nën komandën e NATO-s. Qëllimi i SHBA-ve ishte që forca ndërkombëtare për Bosnjën dhe Hercegovinën "IFOR" të bëhej shembull i mundësisë së partneritetit NATO-Rusi.²⁸¹ Pas negociatave në mes të Presidentit Clinton dhe atij të Ruisë Boris Jelcin dhe Sekretarit të Mbrojtjes William Perry dhe Ministrin të Mbrojtjes së Ruisë Pavel Grachev, është arritur marrëveshja për pjesëmarrjen e së paku 2000 trupave ruse, me kusht që të bashkëpunojnë me NATO-n dhe jo nën NATO-n.²⁸²

Në gusht të vitit 1995, Presidenti Clinton nisi përpjekjen diplomatike që do të përfundonte në nëntor me Marrëveshjen Paqësore të Dejtonit. Vendimi për të dërguar 20.000 ushtarë amerikanë si pjesë e forcave të NATO-s, që numëronin 60.000 ushtarë, për të zbatuar Marrëveshjen kishte vetëm 36% të përkrahjes së opinionit publik në SHBA.²⁸³

²⁸⁰ Ivo Daalder *Getting to Dayton – The Making of America's Bosnian Policy*, (Brookings 2000), fq92-93, dhe Derek Chollet *The Road to Dayton Accords*, fq. 19.

²⁸¹ Derek Chollet, *The Road to Dayton Accords*, ”: Palgrave MacMillan New York 2005 fq. 118 nga intervista me Strobe Talbott).

²⁸² Strobe Talbott, *The Russia Hand*, (Random House, New York 2002), ff. 179-186.

²⁸³ Richard Holbrooke në hyrjen e *The Road to Dayton Accords*, (New York, Palgrave MacMilan 2005), fq. 3.

Marrëveshja Paqësore e Dejtonit, që u arrit në SHBA por u nënshkrua formalisht më 14 dhjetor 1995 në Paris, për rezultat pati përfundimin e konflikteve të armatosura në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Bosnja dhe Hercegovina praktikisht u nda në dy entitete, Republikën Serbe dhe Federatën Boshjako-Kroate, u krijua Zyra e Përfaqësuesit Ndërkombëtar si organ mbikëqyrës i zbatimit të marrëveshjes, u hap rruga për mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve të lira nën mbikëqyrjen e OSBE-së, si dhe u krijuan mundësitë për njohjen dhe krijimin e raporteve normale, dhe në fushën e respektimit të së drejtës ndërkombëtare në mes të RFJ-së, Kroacisë, dhe Bosnjës e Hercegovinës. Në planin e zhvillimeve në Ballkan, me gjetjen e zgjidhjes në Dejton me ndihmën amerikane, politika e jashtme amerikane e vërtetoi se asnjë zgjidhje për këtë rajon nuk mund të arrihet pa angazhimin e drejtpërdrejtë amerikan.²⁸⁴

Paralelisht me çështjen e Bosnjës dhe Hercegovinës, negociatorët amerikanë filluan të kërkojnë zgjidhjen për rajonin e Sllavonisë Lindore, në Kroaci, që ende ishte nën kontrollin e serbëve rebelë. Kroatët kërkonin kthimin e territorit nën sovranitetin e tyre, ndërsa Millosheviqi kërkonte koncesione sepse nuk kishte interes për konflikt pas humbjeve që ju shkaktuan serbëve në operacionin “Stuhia”, në fillim të gushtit 1995. Marrëveshja u arrit që faza e parë kalimtare të zgjasë 12 muaj me mundësi të vazhdimit për 12 muaj të tjerë, nëse administrata kalimtare në këtë territor e vlerëson të nevojshme.²⁸⁵ Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë Gojko Shushak kishte insistuar që forcat paqeruajtëse, që do të vendoseshin në Sllavoninë Lindore në fazën kalimtare, të vendosen nën komandën amerikane të IFOR-it , ndërsa pala serbe kërkonte kontingjent të trupave ruse për këtë rajon. Në fund u arrit Marrëveshja e Erdutit, që vendoste protektoratin e OKB-së në rajonin e Sllavonisë Lindore për 12+12 muaj, ku pas këtij afati territori do të kalonte nën kontrollin e Kroacisë pas mbajtjes së zgjedhjeve të lira lokale.²⁸⁶

²⁸⁴ R.A. Remington, US Military and the Dayton Accords: Politicians in Uniform, Balkan Forum nr.4 1996, ff. 43-46.

²⁸⁵ Richard Holbrooke, *To end a War-Završiti Rat*, (Sahinpasic 1998,) ff. 263-264

²⁸⁶ “Basic Agreement on the Region of Eastern Slavonia, Baranja and Western Sirmium”, 12 nëntor 1995

Richard Holbrooke dhe ekipi i tij, në shtator të vitit 1995, vendosën të provonin të kërkonin zgjidhje për problemin në mes të Greqisë dhe Maqedonisë apo Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë “IRJM”. Në shkurt të vitit 1994, Greqia kishte vendosur sanksione ekonomike ndaj Maqedonisë për shkak të emrit “Republika e Maqedonisë”, të cilin edhe sot nuk e pranon. Në vitin 1994, në Maqedoni ishin të stacionuar 550 ushtarë amerikanë si pjesë e forcës së OKB-së me qëllim të parandalimit të përhapjes së konfliktit në ish-Jugosllavi në pjesët jugore të saj. Pas takimeve që Chris Hill dhe James Pardew patën me Presidentin e Maqedonisë Kiro Gligorov si dhe Holbrooke me Kryeministrin e Greqisë Adreas Papandreou u arrit marrëveshja që sanksionet ekonomike dhe embargoja ndaj Maqedonisë të suspendoheshin, ndërsa çështja e emrit dhe simboleve të shtetit të diskutoheshin brenda kornizës së negociatave nën udhëheqjen amerikane.²⁸⁷

Me Marrëveshjen Paqësore të Dejtonit u krijuan parakushtet për krijimin e kornizës së re të sigurisë në rajon, që nënkupton në faza të ndryshme zgjerimin e NATO-s në faza të ardhshme përmes anëtarësimit formal, përmes programit Partneriteti për Paqe, apo programeve të tjera përcjellëse të aleancës veriatlantike. Tri shtetet nënshkruese të marrëveshjes së pari ishin të obliguara të vënë nën kontroll forcat e armatosura pa rritje të numrit të tyre në periudhën 1995-1998. Masat e kontrollit të armatimit u vendosën sipas parimeve të “Marrëveshjes mbi forcat konvencionale në Evropë “CFE” në bazë të Marrëveshjes së Firencës 1996, ku raporti i potencialit të armatimit të rëndë (tanket, artileria e rëndë, automjetet e blinduara, forcat ajrore avionët dhe helikopterët) do të limitohet në raportin RFJ, Kroaci, BeH në raportin 5:2:2, ndërsa Federata Boshnjako-Kroate me Republikën Serbe 2:1.²⁸⁸

Bashkimi Evropian mori përsipër integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt strukturave euroatlantike. Këshilli i Ministrave të vendeve të BE-së, më 28 tetor 1996, miratoi dokumentin “Marrëdhëniet e ardhshme kontraktuale me disa nga vendet e Evropës Juglindore” ku për bazë mori gjendjen pozitive në rajon pas Marrëveshjes së Dejtonit, rritjen e zhvillimit ekonomik, përmirësimin e drejtave të njeriut me theks te

²⁸⁷ Richard Holbrooke, *To end a War*, (përkthyer dhe botuar nga Sahinpasic 1998,) ff. 124-130)

²⁸⁸ Radovan Vukadinović, *Sigurnost na Jugoistoku Europe*, Interland, Varzhdin, 1999, ff 46-49)

pakicat kombëtare. Po ashtu, duke marrë parasysh reagimet e vendeve të cilat i afekton ky dokument (BeH, Kroaci, RFJ, Shqipëri, Maqedoni) dhe duke vënë si parakusht raportet fqinjësore në raport me shpejtësinë e procesit të përafrimit me BE-në, dy çështje kyçe u vendosën: nuk do të ketë asnjë mundësi të krijimit të strukturave të ish-Jugosllavisë dhe mungesa e përgatitjes së njërit shtet nuk mund të ndalojë shtetet e tjera në rrugën drejt BE-së.²⁸⁹

Në korrik të vitit 1996, Presidenti Clinton paralajmëroi iniciativën amerikane "South Eastern Cooperation Initiative" SECI, si një mekanizëm të ri për trajtimin e problemeve të vendeve të Evropës Juglindore. Kjo iniciativë post-Dejton kishte për qëllim disa synime të politikës së jashtme amerikane: krijimin e kushteve për paqe dhe stabilitet në këtë rajon nga BeH e deri te raportet turko-greke; të vërtetohet edhe një herë se pa lidhshimin amerikan nuk ka zgjidhje të situatave të konfliktit; të tregohet se NATO në periudhën pas "luftës së ftohët" ka rol të ri të rëndësishëm si instrument i bashkëpunimit atlantik; të parandalohet shtrirja e ndikimit të ideve fundamentaliste islamike posaçërisht në BeH; të parandalohet shtrirja e interesave të Rusisë në Ballkan si fuqi e madhe. Tekstin inicial të SECI, më 6 dhjetor 1996, e nënshkruan Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Moldavia, Rumania, IRJM, Greqia, Hungaria dhe Turqia. Me inkuadrimitin e RFJ-së, Kroacisë dhe Sllovenisë në këtë mekanizëm, politika e jashtme amerikane dëshironte të krijonte lidhjen në mes të Evropës Juglindore, Ballkanit dhe Moldavisë, ku qëllimi përfundimtar ishte shtrirja e NATO-s në këto rajone.²⁹⁰

Në raport me Rusinë, në Dejton u arrit përparim i madh në raportet NATO-Rusi dhe në fushën e bashkëpunimit ushtarak. Inkuadrimiti i forcave ruse brenda misionit IFOR ka hapur rrugën për arritjen e marrëveshjes "Founding Act" në vitin 1997 dhe në krijimin e Këshillit NATO-Rusi në vitin 2002. Në Dejton u krijua precedenti për inkuadrimitin e Rusisë në zgjidhjen e problemeve rajonale, siç ishte rasti me rolin e Rusisë në përpjekjet diplomatike për t'i dhënë fund luftës në Kosovë në vitin 1999.

²⁸⁹ Po aty fq. 58

²⁹⁰ Radovan Vukadinović, *Sigurnost na Jugoistoku Europe*, (Interland, Varazhdin, 1999), ff. 60-63

Problemi i Kosovës nuk ishte i panjohur për SHBA-të. Në fakt, shërbimet inteligjente por edhe diplomatike, që prej fillimit të viteve 80-ta të shekullit XX kishin paraparë dhe analizuar se destabilizimi dhe shpërbërja e ish-Jugosllavisë do të mund të fillonte në Kosovë. Në hapjen e bisedimeve të Dejtonit, Zëvendës Sekretari i Shtetit Strobe Talbott kishte theksuar se përhapja e luftës së hapur në Kosovë përfundimisht do mund të ndizte gjithë Ballkanin.²⁹¹ Ndërsa në përfundim të bisedimeve të Dejtonit Sekretari i Shtetit Warren Christopher identifikoi “Kosovën, Shqipërinë dhe IRJM-në si vendet me potencial për të nxitur një luftë të gjerë pas Bosnjës dhe Hercegovinës”.²⁹²

Pra Kosova, ishte në vëmendjen e negociatorëve amerikanë, por jo edhe pjesë e procesit negociues. Dhe kjo u bë me qëllim.

Përzgjedhja e negociatorëve kishte ndikim në përzgjedhjen e çështjeve që do të trajtoheshin në Dejton dhe atyre që do të mbeteshin jashtë. Strategjia e Presidentit Clinton ishte që të zgjidhej problemi i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë, në pjesën e integritit të Sllavonisë Lindore. Paralelisht me këtë, Holbrooke dhe ekipi i tij, pa udhëzime nga Washingtoni, improvizoi një zgjidhje në kontestin në mes të Greqisë dhe Maqedonisë. Po ashtu, u arrit partneritet më i madh në raportin e veprimit të përbashkët NATO-Rusi. Por, negociatorët amerikanë vetëdijshëm nuk e trajtuan çështjen e Kosovës. NATO vetëm katër vjet më vonë ndërmori fushatën OAF për çlirimin e Kosovës dhe pyetja që shtrohet është: a ka mundur të evitohet konflikti dhe tragjedia e madhe që ka ndodhur në Kosovë nëse kjo çështje do të trajtohej në Dejton?

Negociatorët amerikanë mendonin në atë kohë se mosprania e Kosovës në bisedimet në Dejton ishte vendim i drejtë dhe ka ndihmuar procesin paqësor në Bosnjë dhe Hercegovinë.²⁹³ Gjatë negociatave disa herë kishin tentuar të provojnë të ushtrojnë presion ndaj Millosheviqit për të hapur çështjen e Kosovës, por pa sukses. Negociatorët kishin nevojë për Millosheviqin edhe pas Dejtonit për procesin e

²⁹¹ Fjalimi i mbajtur i botuar në “*Federal News Service*”, 1 Nëntor 2005

²⁹² (Deklaratë për Komisionin për Çështje Ndërkombëtare të Kongresit të SHBA-ve, “*Federal News Service*” 30 nëntor 1995).

²⁹³ (Derek Chollet, *The Road to Dayton Accords* : (New York: Palgrave MacMillan) 2005, fq. 190).

implementimit të Marrëveshjes Paqësore të arritur dhe për këtë arsye nuk patën mundësi të ndikojnë sa duhet për të ndalur sjelljet e regjimit të tij ndaj Kosovës, dhe pasojat u treguan më vonë të jenë tragjike.²⁹⁴

Marrëveshja në Dejton ishte në fakt marrëveshje me Millosheviqin jo vetëm për Bosnjën Hercegovinë dhe Sllavinë Lindore të Kroacisë, por ishte marrëveshje për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes Paqësore. Dhe, për sa kohë Millosheviqi trajtohej si i nevojshëm ai për aq kohë në Kosovë mundi të zhvillonte politikën e dhunës dhe nënshtrimit të shqiptarëve. SHBA-të morën vendim për të ndërprerë luftimet dhe vrasjet në vitin 1995 dhe për të sjellë paqen në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Millosheviqi mbijetoi bashkë me krizën e madhe, që do të zhvillohet me vonë në Kosovë.²⁹⁵

Situata në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte prioritet i bisedimeve në Dejton, Kroacia ia arriti që të realizojë futjen e çështjes së Sllavisë Lindore në proces, ndërsa përkrahësit e Kosovës, në radhë të parë SHBA-të e konsideruan se presioni për të hapur çështjen e Kosovës do të zvogëlonte mundësinë e kompromiseve të serbëve për të arritur rregullimin e problemeve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Po ashtu, vendet perëndimore vlerësonin se Slobodan Millosheviqi ishte i pazëvendësueshëm si përfaqësues i serbëve në atë kohë sepse besonin se ishte i vetmi që do të mund të detyronte rebelët serbë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kroaci të pranojnë zgjidhjet e negociuara, gjë që edhe e bëri në fund të fundit. Millosheviqi nuk kishte treguar simpati për udhëheqësit e rebelëve serbë, ndërsa për Kosovën qëndrimi i tij ishte i prerë dhe i njohur, sepse nacionalizmi që kishte treguar ndaj Kosovës kishte definuar identitetin e tij politik që nga fillimi.²⁹⁶

Millosheviqi dhe regjimi i tij vazhdonin të mbanin Kosovën nën masë të dhunshme, apo më mirë të thuhet nën gjendje të jashtëzakonshme ushtarako-policore, ku vetëm në vitin 1995 forcat serbe kishin vrarë në mënyrë arbitrare 11 shqiptarë, kishin plagosur 11 të tjerë, dhe kishin arrestuar 2500 shqiptarë të Kosovës të rrahur e të

²⁹⁴ Tim Judah, *Kosovo: War and Revenge*, (Yale University Press 2000, fq 120-126).

²⁹⁵ Michael Ignatieff, *Virtual War, Kosovo and Beyond*, (Metropolitan Books 2000) fq. 49.

²⁹⁶ Warren Zimmermann, *The Demmons of Kosovo*, The National Interest Nr. 52, 1998

keqtrajtuar në të shumtën e rasteve dhe sipas organizatës „Human Rights Watch“ Serbia e mbante nën kontroll Kosovën duke zbatuar shkelje të qëllimshme, në shkallë të gjerë dhe të organizuar të të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës, shumicë në Kosovë, duke i shtyrë drejt vetëmbrojtjes së armatosur.²⁹⁷ Qëllimet e shqiptarëve të Kosovës ishin mjaft të qarta dhe kishin qenë të tilla që nga viti 1989 dhe Referendumi i vitit 1991. Për shqiptarët nuk kishte kthim prapa në statusin e Kosovës para shpërthimit të luftës në Jugosllavi e as autonomisë në Serbi, por drejt pavarësisë së plotë nga Serbia. Sipas Presidentit Ibrahim Rugova asnjë nga kërkesat e shqiptarëve nuk mund të realizohej pa ndarjen nga Serbia dhe se Kosova e pavarur ishte zgjidhja optimale duke shtuar se shqiptarët nuk kanë vënë përpara kërkesa maksimaliste si bashkimin me Shqipërinë.²⁹⁸

Politika paqësore e udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova kishte dy qëllime kryesore: ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, duke e prezantuar çështjen e statusit të saj si çështje të vetëvendosjes së popullit të Kosovës dhe evitimin e luftës së hapur me serbët dhe regjimin e Millosheviqit për të ruajtur popullin shqiptar të Kosovës. Rugova kishte fituar simpatinë e vendeve Perëndimore për konsistencën e qëndrimeve të tij politike dhe përkrahjen e madhe të shqiptarëve të Kosovës deri në atë kohë, ndonëse vendet Perëndimore asnjëherë nuk e trajtonin publikisht çështjen e Kosovës si çështje që duhej zgjidhur jashtë kufijve të RFJ-së. Problemi i Kosovës ishte i pranishëm në medie si problem dhe gjendje e vështirë, por që nuk eksplodonte krahasuar me Bosnjën dhe Hercegovinën e Kroacinë dhe shkatërrimet që kishin ndodhur në periudhën 1991-1995.

Me gjithë qëllimin e negociatorëve amerikanë dhe Millosheviqit, natyrisht për arsye dhe interesa të ndryshme, që çështja e Kosovës të mos figurojë në Dejton, ajo megjithatë u inkorporua në agjendën finale. Marrëveshja Paqësore e Dejtonit suspendoi sanksionet ekonomike ndaj Serbisë, ndërsa suspendimin e tërësishëm e kushtëzoi me mbrojtjen e të drejtave të garantuara të pakicave në Serbi, përkatësisht

²⁹⁷ Human Rights Watch Raporti Botëror botuar 1996).

²⁹⁸ Cituar nga Craig Whintey, *Balkan powder keg watches the fuse*, New York Times, 25 Maj 1993

në Kosovë. Lehtësimi i sanksioneve që ndodhi gjatë viteve 1996 dhe 1997 ishte përsëri moment dëshpërues për shqiptarët e Kosovës.

Udhëheqësit shqiptarë në krye me Presidentin Rugova arritën qëllimin që deri në përfundim të luftërave në ish-Jugosllavi të mos e fusin në luftë të hapur Kosovën, por nuk ia arritën që të imponoheshin si palë në bisedimet e Dejtonit. Shqiptarët në përgjithësi u dëshpëruan pas përmbylljes së procesit të Dejtonit dhe përfundimeve se çështja e statusit të Kosovës dhe aspiratat për Kosovë të lirë dhe të pavarur ishin lënë anash apo në nivel të përmirësimit të të drejtave të njeriut. Po ashtu, shqiptarët e Kosovës e kishin parë reagimin e dobët dhe paaftësinë e forcave të OKB-së në Bosnjë dhe Hercegovinë për të ndaluar dhunën ndaj civilëve. Udhëheqësit e shqiptarëve e kishin të qartë se çfarë porosie ishte Dejtoni për Kosovën. Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Bujar Bukoshi, kishte deklaruar se brenga kryesore ishte marginalizimi i problemit të Kosovës dhe se rezistenca ndaj Serbisë nuk do të jetë më paqësore.²⁹⁹

Refuzimi i çfarëdo negociate për Kosovën në Dejton i pozicionoi shqiptarët në një moment shumë të vështirë me mundësi të vogla manovrimi. Pasojat e para u panë në fillimin e fragmentimit të faktorit politik të shqiptarëve të Kosovës, së pari me rritjen e presionit të forcave që kërkonin lëvizje më radikale kundër regjimit të Beogradit, fillimisht nga përfaqësuesit e shqiptarëve në vendet Perëndimore e më pastaj edhe në Kosovë, ndërsa më vonë edhe drejtpërdrejtë me dallimet dhe distancimet në raportet në mes të Presidentit Rugova dhe Kryeministrit Bukoshi.

Përpjekja e SHBA-ve për t'i dhënë fund luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe krijimi i themeleve për një shtet të ri ka dhënë disa mësimë për mënyrën se si SHBA-të mund të zgjidhin konfliktet, të kombinojnë diplomacinë “shuttle” dhe bisedimet ndërkombëtare paqësore, të ndërtojnë raportet në mes të forcës ushtarake dhe diplomacisë, të menaxhojnë dhe bashkëpunojnë me aleatët kyçë dhe të ndërtojnë shoqëritë dhe institucionet.

Rezultati i Konferencës së Dejtonit ishte dëshpërues për shqiptarët e Kosovës dhe për përpjekjet e tyre që të arrihet statusi i Kosovës së pavarur përmes bisedimeve dhe

²⁹⁹ Cord Meyer, “*Test of Resolve in Kosovo*”, Washington Times, 15 nëntor 1995)

dialogut në një Konferencë ndërkombëtare. Për shqiptarët e Kosovës ngjarjet e vitit 1995 në Bosnjë dhe Hercegovinë theksuan dy momente themelore: ata i priste një valë e represionit serb së bashku me refugjatët e rinj serbë që kishin ardhur nga pjesët e Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe e panë mosefikasitetin apo dështimin e forcave paqësore në mbrojtje të civilëve, siç kishte ndodhur në Srebrenicë. Megjithatë, tani ishte momenti që edhe shqiptarët e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare të fokusoheshin më shumë në Kosovë dhe rreth gjetjes së një zgjidhjeje për çështjen e Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare nuk e hoqi të ashtuquajturin “murin e jashtëm të sanksioneve” për RFJ-në, që nënkuptonte mospranimin e RFJ-së në institucionet ndërkombëtare, politike dhe financiare, nga të cilat ishte përjashtuar për shkak të veprimeve ushtarake në vendet e ish-Jugosllavisë, pa përmirësim të të drejtave të njeriut në Kosovë.

SHBA-të, po ashtu, kishin negociuar me Millosheviqin dërgimin e një misioni të SHBA-ve në Prishtinë që do të udhëhiqej nga një diplomat i rangut të lartë nga Departamenti i Shtetit. Përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës deklarativisht mirëpritën bisedimet në “Konferencën e Dejtonit” dhe kërkonin që zgjidhja për Kosovën, që nënkuptonte pavarësinë e saj, të gjendej në dialog me Beogradin dhe me praninë e palës së tretë.³⁰⁰ Presidenti Rugova, më 8 dhjetor 1995, u takua me Sekretarin e Shtetit të SHBA-ve Warren Christopher, duke kërkuar angazhimin e SHBA-ve për të zgjidhur ‘problemin kyç’ të Ballkanit - çështjen e Kosovës. Sekretari Christopher kishte theksuar qartë se SHBA-të nuk do të lejonin konflikt në Kosovë. Presidenti Rugova, më 12 dhjetor 1996, u takua me Ministrin e Jashtëm të Gjermanisë, Klaus Kinkel, duke kërkuar mbështetjen e Gjermanisë për të mbajtur presionin mbi Millosheviqin dhe për të marrë parasysh kërkesat e shqiptarëve të Kosovës.³⁰¹ Në këtë periudhë Bashkimi Evropian filloi të tregonte shenja se çështjet në ish-Jugosllavi janë zgjedhur, ndërsa pikërisht Gjermania kishte marrë vendim që të kthejë prapa të gjithë refugjatët e ish-Jugosllavisë, së bashku me 130.000 shqiptarë

³⁰⁰ Gert Hinrich-Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, (Tiranë: Toena 2010), fq. 363.

³⁰¹ “*Presidenti Rugova*”, Presidenca e Kosovës 2007, fq. 254.

nga Kosova.³⁰² Në fillim të vitit 1996, SHBA-të deklaruan se do të hapnin një zyre informative në Prishtinë, ndërsa në shkurt të vitit 1996 Millosheviqi e pranoi kërkesën që një diplomat amerikan të jetë i vendosur në Prishtinë si udhëheqës i misionit amerikan në Kosovë. Qeveria amerikane kishte provuar për një kohë të gjatë të ketë një prezencë të vendosur në Kosovë, por autoritetet e Beogradit këtë kurrë nuk e kishin pranuar. Zyra Amerikane në Prishtinë u hap më 6 qershor 1996 dhe hapjen e saj e bëri Nënksecretari i Shtetit John Cornblum. Kjo Zyre ishte e karakterit informativ dhe kulturor, por në vijë raportuese ishte degë e Ambasadës së SHBA-ve në Beograd dhe raportonte në baza të rregullta mbi zhvillimet politike dhe të sigurisë në Kosovë. Zyra Amerikane në Prishtinë ishte bërthama e krijimit të misionit të përhershëm diplomatik amerikan në Kosovë. Zyrtarisht quhej “United States Information Service in Prishtina” dhe diplomati i parë amerikan në Kosovë ishte Michael McClellan, i cili ishte i ngarkuar të krijonte kontakte me institucionet e Kosovës dhe institucionet e Serbisë në Kosovë dhe të informonte Ambasadën e SHBA-ve në Beograd, përkatësisht oficerin politik Nicholas Hill, mbi gjendjen në Kosovë. Për shqiptarët e Kosovës hapja e misionit amerikan në Kosovë ishte shenjë se nuk janë harruar dhe se çështja e tyre nuk është hedhur anash. Presidenti Rugova dhe liderët e tjerë ishin të qartë dhe unikë në prezantimin e kërkesës për Kosovën e pavarur edhe në këtë nivel diplomatik. Pas fillimit të punës së Zyrës Amerikane në Prishtinë, Kosovën filluan ta vizitojnë më shumë diplomatë nga Zvicra, Rusia, Gjermania, Suedia, Franca dhe Britania e Madhe.³⁰³

Gjatë kësaj periudhe kishte edhe një orvatje për të arritur marrëveshje në nivelin e funksionimit të arsimit në Kosovë. Pala që ndërmjetësonte ishte Komuniteti i Shën Exhidios, ndërsa u negociua dhe u arrit marrëveshja për një plan sipas të cilit autoritetet serbe do të lironin objektet e arsimit fillor, të mesëm dhe Universitetit të Prishtinës, në faza të ndryshme, për nxënësit dhe studentët shqiptarë. Marrëveshja u nënshkrua në Beograd dhe në Prishtinë, më 1 shtator 1996, nga Millosheviqi dhe

³⁰² Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, (London: Pluto Press, 2000), fq. 123.

³⁰³ Intervistë me Michael McClellan 23.01.2013

Rugova. Ndonëse në shtator të vitit 1996 në disa shkolla fillore filloi mësimi në objektet shkollore, në përgjithësi kjo marrëveshje nuk u respektua nga autoritetet serbe. Në këtë periudhë filluan të shfaqeshin edhe haptas dallimet në mes të Presidentit Rugova në njërin anë dhe Kryeministrit Bujar Bukoshi dhe Adem Demaçit, si udhëheqës i Partisë Parlamentare të Kosovës, rreth mënyrës së veprimit të mëtejme në Kosovë. Animizitetet shkuan aq larg sa me vendim të Kryeministrit Bukoshi u ndërpreu fondet financiare për Zyrën e Presidentit të Kosovës, ndërsa Demaçi publikisht kritikonte politikën ‘pasive dhe joefikase’ të Presidentit Rugova dhe ithtarëve të tij.

Në qershor të vitit 1996, në Beograd, Kryetari i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, Aleksandar Despiq, në fjalimin e tij gjatë takimit vjetor të anëtarëve të Akademisë, u shpreh pro negociatave në mes të serbëve dhe shqiptarëve për “demarkacion paqësor dhe civilizues” të Kosovës përgjatë vijave etnike.³⁰⁴ Sipas Despiqit, rritja demografike e shqiptarëve herët apo vonë do të jetë problem i madh dhe barrë e rëndë për Serbinë, prandaj duhej menduar për të bërë ndarjen nga shqiptarët e Kosovës. Po ashtu, opozita serbe në Beograd organizoi protesta të përditshme që zgjatën për tre muaj rresht kundër regjimit të Millosheviqit. Në këtë periudhë udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës ishin nën presion për t’iu bashkangjitur apo për të përkrahur në një mënyrë apo tjetrën opozitën e Beogradit. Por, në Prishtinë ishin të vendosur se Kosova nuk do të ishte pjesë e luftës politike në Serbi. Ndërsa opozita serbe asnjëherë nuk dha ndonjë propozim se si mendonte të zgjidhte problemin e Kosovës.

Gjendja në Kosovë në vitin 1997 ishte e rëndë, e tendosur dhe pranë shpërthimit. Më 14 mars 1997, Adem Demaçi doli me propozimin për krijimin e një konfederate të shteteve që do të quhej “Ballkania”, që do të përbëhej nga Serbia, Mali i Zi e Kosova. Sipas propozimit të Demaçit këto shtete sovraane do të ishin të barabarta në konfederatë, dhe kjo ishte hera e parë që propozohej një status për Kosovën ndryshe

³⁰⁴ “*Naša Borba*”, 10 qershor 1996.

nga kërkesa për pavarësi që ishte artikuluar në referendumin e vitit 1991. Deri në vjeshtë të vitit 1997 situata në Kosovë nuk ndryshoi. Në vjeshtë Unioni i Pavarur i Studentëve të Prishtinës organizoi demonstratat me kërkesë për të hyrë në objektet e Universitetit të Prishtinës. Më 1 tetor 1997, rreth 15.000 studentë dhe afër 30.000 qytetarë të Prishtinës protestuan duke u përpjekur që të afroreshin te objektet shkollore. Forca të mëdha policore përdorën dhunë brutal për të shpërndarë protestuesit si dhe burgosën udhëheqjen e UPS-së. Në të njëjtën ditë protesta të ngjashme u mbajtën në gjashtë qytete të tjera të Kosovës dhe që të gjitha u shpërndanë me dhunë. Lëvizja studentore, e udhëhequr nga Bujar Dugolli, student në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës, e mobilizoi opinionin publik në Kosovë dhe e përshpejtoi konfrontimin me autoritetet serbe dhe me policinë.

Më 28 nëntor 1997, në rajonin e Drenicës, gjatë varrimit të një mësuesi të vrarë nga policia serbe, tre persona të maskuar, të armatosur dhe të uniformuar, u paraqitën duke shënuar paraqitjen e parë publike të kësaj natyre të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prej këtij momenti e tutje konflikti i hapur në mes të shqiptarëve dhe forcave ushtarake dhe policore serbe ishte i pashmangshëm. Në një nga vendimet e fundit të këtij viti, më 28 dhjetor 1997, Presidenti Rugova shpalli zgjedhjet parlamentare dhe Presidenciale për datën 22 mars 1998.

KAPITULLI III

SHBA DHE NDRYSHIMET E MËDHA NË KOSOVË DHE NË SHQIPËRI

III.1 Ndërrimi i qeverisë në Shqipëri

Në fund të vitit 1996 në Shqipëri filloi rënia e kompanive që funksionin në formën e “skemave piramidale”.

Fondi Monetar Ndërkombëtar kishte paralajmëruar për situatën e rëndë financiare dhe kishte kërkuar nga qeveria që të mos lejonte veprimin e mëtejshëm të kompanive si “Sudja”, “Xhaferri”, “Populli”, “Gjallica”. FMN kërkonte veprimin e menjëhershëm të qeverisë për nadlimin e veprimtarisë së tyre madje duke vënë si parakusht kontrollin mbi këto kompani për dhënien e ndihmave financiare për Shqipërinë.

Edhe Departamenti i Shtetit të SHBA kishte njohuri për zhvillimet ekonomike dhe sociale dhe efektin që po krijonin kompanitë piramidale. Qeveria amerikane i ofroi qeverisë së Shqipërisë ekipin ekonomik të udhëhequr nga Peter Vander Nat, nga Komisioni federal i Tregtisë, të cilët ishin ekspertë për trajtimin dhe luftimin e skemave piramidale. Qëllimi i këtij ekipi ishte të ndihmojë qeverinë e Shqipërisë për t’u përballuar me pasojat që do të krijonte mungesa e rregullimit të veprimtarisë së kompanive që vepronin sipas skemave piramidale.³⁰⁵

Qeveria e Shqipërisë, duke parë rrezikun e tronditjeve sociale, vendosi që të hartojë një ligj për mbylljen e të gjitha kompanive piramidale dhe të fillojë me kthimin e një pjese të mjeteve që qytetarët kishin humbur duke bërë likuidimin e aseteve të

³⁰⁵ US State Dept Press Brief 29 janar 1997

kompanive. (Deklaratë e Kryeministrit Aleksandër Meksi Albanian Daily News 22 janar 1997) Plani i Qeverisë ishte që t'u paguante një pjesë të kursimeve të humbura qytetarëve në formë të mjeteve apo të zgjidhnin të përfitonin një formë të depozitave. Shumica e investuesve nuk pranuan zhdëmtimin e pjesshëm sepse kishin bindjen se shteti do të garantonte zhdëmtimin e plotë në një fazë të mëvonshme.

Situatën e krijuar sociale kishte filluar Partia Socialiste dhe elementet brenda saj që kishin krijuar edhe trazirat në Tiranë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1996. Në jug të Shqipërisë, nën udhëheqjen e Sabit Brokajt dhe Gramos Rucit (në fusnotë shpjegon se kush janë) kishte filluar organizimi i të gjithë të paknaqurve por më së shumti militantëve të PS për protesta kundër qeverisë.

Në janar 1997 opozita krijoi Forumin për Demokraci, një organizatë që bashkontë socialistët, ish-të përndjekurit politikë, opozitarë që kërkuan menjëhër rrëzimin e qeverisë dhe dorëheqjen e Kryeministrit Aleksandër Meksi.

Më 10 shkurt 1997, në reagimin e policisë kundër protestuesve në Vlorë u vranë dy protestues dhe gjatë gjithë këtij muaji në Shqipëri ishte gjendje e tensionit dhe e trazirave. Administrata amerikane kishte shqetësimin për zgjerimin e trazirave nga protestat në një konfrontim të armatosur në mes të forcave të qeverisë dhe opozitës. Ata kërkuan nga autoritetet e Tiranës që të lejojnë të drejtën e protestuesve që të protestojnë në mënyrë të qetë. Poashtu, kërkuan nga udhëheqësit e protestuesve që të kërkojnë largim nga përdorimi i dhunës. Departmenti Shtetit edhe në këtë rast kërkonte nga Presidenti Berisha, siç kishte bërë pas zgjedhjeve të vitit 1996, hartimin e kushtetutës së re në një proces gjithpërfshirës së bashku me të gjitha forcat politike si dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.³⁰⁶ Por, Berisha dhe Partia Demokratike kishin vendosur që të marrin një kurs të ndryshëm nga udhëzimet amerikane dhe shkonin drejt ballafaqimit me forcat që udhëhiqeshin nga socialistët në jug dhe që rrezikonin pushtetin e tyre edhe në Tiranë.

Më 2 mars 1997, Parlamenti i Shqipërisë shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Shqipëri dhe vendosi ndalimin e qarkullimit nga mbrëmja deri në mëngjes duke

³⁰⁶ Press Statement US State Dpt 25 shkurt 1997

autorizuar forcat e policisë dhe ushtrisë që vendosin rendin duke përdorur të gjitha mjetet që kanë në dispozicion, duke ndaluar tubimet, dhe duke vënë censurën mbi shtypin.³⁰⁷ Njëkohësisht, Aleksandër Meksi dha dorëheqje nga pozita e Kryeministrit. Më 3 mar 1997, Parlamenti i Shqipërisë rizgjodhi Presidentin Berisha për mandat të dytë pesëvjeçar.

Departmenti i Shtetit i SHBA-ve, në deklaratën e lëshuar më 3 mars 1997, ku shprehej brenga për situatën e vështirë në Shqipëri theksonte keqardhjen për vendosjen e censurës nga Parlamenti. Në deklaratë shprehej keqardhja që Berisha ishte zgjedhur President në rrethana të tilla pasi ky veprim do të sillte polarizim të situatës në vend të zgjidhjes së problemeve.³⁰⁸ (Press Statement US State Dpt 3 mars 1997. Poashtu, Departmenti Shtetit kërkoi nga qytetarët amerikanë që të mos udhëtojnë në Shqipëri si dhe nga ata që janë brenda të largohen. Në atë kohë, në Shqipëri jetonin rreth 1600 shtetas të SHBA-ve kryesisht në Shqipërinë veriore.

Në fakt, elementi më i rëndësishëm në këtë deklaratë është thirrja për krijimin e një qeverie të re gjithpërfshirëse që do zgjidhte krizën e krijuar dhe do të drejtonte Shqipërinë drejt zgjedhjeve të reja parlamentare. Duke parë ndikimin që kishin Italia dhe Greqia në Shqipëri, zyrtarët amerikanë filluan të veprojnë me partnerët nga këto shtete që përmes mekanizmave të OSBE-së të dërgojnë mesazhe qeverisë së Shqipërisë për të ndryshuar qëndrimin dhe për të krijuar qeverinë e re.

Në Shqipëri sistemi institucional dhe aparati shtetëror dhe i sigurisë pësoi kolaps total duke u dorëzuar para forcave të organizuara dhe të armatosura të udhëhequra organizatat që përkraheshin nga PS. Forcat e dërguara nga Qeveria për t'u përballur me kryengritësit u shpërndanë pa u ndeshur. Depotë e armëve mbetën të pambrojtura dhe u hapën nga qytetarët. Burgjet u hapën dhe u liruan kriminelët. Vendi i shte jashtë kontrollit ku forcat e qeverisë, mund të thuhet se kishin kontroll në veri ndërsa opozita në jug.

³⁰⁷ Elez Biberaj Shqipëria në Tranzicion fq 437, Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë 02.03.1997 ff. 44-45

³⁰⁸ Press Statement US State Dpt 3 mars 1997

OSBE emëroi ish-kancelarin austriak Frank Vranickin që të ndërmjetsojë në bisedimet në mes të Berishës dhe përkrahësve të tij dhe partive që përkrahnin të rrebeluarit. Më 9 mars 1997, pas bisedimet në mes 10 partive politike, u arrit marrëveshja për krijimin e Qeverisë së Pajtimit Kombëtar. Kjo Qeveri ishte kalimtare, udhëheqej nga Bashkim Fino, ish-kreu socialist i Gjirokastrës, dhe duhej të udhëheqte Shqipërinë deri në zgjedhjet e reja të parapara për 29 qershor 1997.

Departmenti i Shetit të SHBA-ve u shpreh i kënaqur me zhvillimet dhe gatishmërinë e Presidentit Berisha të përkrahë Qeverinë e re, ndërsa në ndërkohë urdhëroi të gjithë diplomatët që shërbenin në Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë të largohen nga Shqipëria. Në Ambasadë kishte mbetur vetëm Amasadorja Marisa Lino dhe 17 diplomatët më të nevojshëm.³⁰⁹

Këshilli i Sigurimit të OKB-së, më 28 mars 1997, aprovoi Rezolutën 1101 për krijimin e një force ndërkombëtare të sigurisë për të ndihmuar Qeverinë e Shpëtimit Kombëtar dhe për të mundësuar shpërndarjen e ndihmave humanitare. Ndonëse e perkrahnin këtë vendim, administrata e Presidentit Clinton nuk preferonte të bënte pjesë në këtë forcë.³¹⁰ Arsyeja kryesore për këtë ishte pjesëmarrja e madhe e forcave amerikane ende aktive në Bosnje dhe Hercegovinë.

Në fillim të prillit 1997, Frank Vranicki, në cilësinë e Përfaqësuesit Special të Kryesuesit të OSBE-së vizitoi Athinën, Romën dhe u takua me Kryeministrin Bashkim Fino për të krijuar një plan veprues për të stabilizuar situatën në Shqipëri.

Vranicki propozoi planin sipas të cilit Bashkimi Evropian do të jetë përgjegjës për shpërndarjen e ndihmave humanitare dhe përkrahjen ekonomike, OSBE do të jetë përgjegjëse për ngritjen e demokracisë, dialogut politik dhe përgatitjes së zgjedhjeve, ndërsa Italia do të merrte përsipër organizimin e një force ndërkombëtare ushtarake në Shqipëri. Më 15 prill 1997 filloi operacioni ushtarak i quajtur “Operacioni Alba”, me zbatimin e 1000 trupave të para nga 6000 të planifikuara që ishin zotuar nga Italia, Greqia, Franca, Spanja, Turqia, Rumania dhe vende të tjera evropiane.

³⁰⁹ State Dpt Press Brief 12 mars 1997

³¹⁰ US State Dpt Press Brief 31 mars 1997

Fillimi i vendosjes së forcave ushtarake, kryesisht të NATOs, nën operacionin “Alba” shënoi edhe përfundimin e rrebelimit të madh të vitit 1997 dhe shmangien e luftës civile në Shqipëri. Ende në Shqipëri grupet e organizuara të armatosura dhe individët e ndryshëm vazhduan të kontrollojnë territorin e Shqipërisë dhe vrasjet e krimet e ndryshme vazhduan edhe më tej. Nuk dihet saktë se cili është numri i saktë i viktimave por llogaritet se në mes të marsit dhe korrikut të vitit 1997 në Shqipëri janë vrarë mbi 2000 ndërsa janë plagosur mbi 10000 qytetarë.

Në planin politik filloi ndërrimi i pushtetit. Presidenti Berisha ishte i izoluar politikisht sepse më nuk gëzonte përkrahjen ndërkombëtare, ndërsa në Shqipëri fajësohej për lejimin e veprimit të kompanive piramidale dhe rënien e institucioneve të shtetit. Zyrtarët amerikanë e kishin këshilluar që të hapte dialogun me opozitën për të hartuar kushtetutën e re, për të ndërruar ligjin zgjedhor, për të përsëritur zgjedhjet e vitit 1996. Presidenti Berisha refuzoi të dëgjonte këto këshilla si dhe nuk e kishte llogaritur si duhet faktin se rëndësia strategjike ushtarake e Shqipërisë për NATO-n dhe SHBA-të kishte rënë pas arritjes së paqes në ish-Jugosllavi.

Tani, SHBA-të kërkonin partner të rinj në radhë të parë sepse në vitin 1996 kishin humbur besimin se Presidenti Berisha mund të kontrollonte situatën në Shqipëri. Para vendimit për fillimin e operacionit “Alba”, që në fakt ishte operacion i i parë i NATOs në Shqipëri, ambasadorët e kësaj aleance ishin mbledhur në Bruksel për të diskutuar, mes tjerash, edhe veprimet e ardhshme në Shqipëri. Në këtë takim ishte shprehur qëndrimi amerikan se Berisha duhet të largohet.³¹¹ Ndërsa, Peter turnoff, Nënkretari i Shtetit për çështje politike në Departmentin e Shtetit të SHBA-ve, në intervistë televizive ishte shprehur se krerët e rebelëve “shprehin interesat dhe apiratat e banorëve të jugut të Shqipërisë. Ai shpjegonte takimin e mbajtur në një anije italiane në mes të përfaqësuesve të Komiteteve të Shpëtimit dhe Frank Vranickit.³¹²

³¹¹ Elez Biberaj Shqipëria në Tranzicion, fq. 443, “US says Berisha should quit” Financial Times 15-16 mars 1997

³¹² Elez Biberaj, Shqipëria në Tranzicion fq. 443, “Albania in Anarchy”, Newshour with Jim Lehrer, 14 mars 1997

Më 12 maj 1997, Medllin Allbrajt, Sekretare e Shtetit, pranoi Kryeministrin Bashkim Fino dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë për të shprehur përkrahjen si dhe për të dërguar porosinë se nuk do të pranohet asnjë veprim nga cilado palë që do të pengonte apo vononte zgjedhjet e planifikuara.³¹³

Fushata parazgjedhore, bashkë me zgjedhjet e 29 qershorit, u zhvillua në kushte të jashtëzakonshme në Shqipërinë me qytetarët e armatosur dhe me praninë e forcave ushtarake ndërkombëtare. Dy partitë kryesore politike PD dhe PS nuk paraqitën platform programore por u përqëndruan në akuza dhe kundërakuza. Partia Demokratike i akuzonte socialistët për shkaktimin e trazirave dhe dhunës në Shqipëri, ndërsa Partia Socialiste i akuzonte demokratët për humbjen e kursimeve të qytetarëve dhe premtonte kthimin e kursimeve. Fushata parazgjedhore ishte e dhunshme me raste të plagosjeve të qytetarëve, të kërcënimeve dhe frikësimeve të kandidatëve. Vetë Presidenti Berisha i shpëtoi atentatit, më 4 qershor 1997, kur u sulmua gjatë tubimit të PDs në fshatin Shkallnur, Durrës.³¹⁴ Mbi 500 vëzhgues arritën në Shqipëri për të monitoruar zgjedhjet. Treshja ndërkombëtare që kishte për detyrë të përcaktojë nëse zgjedhjet ishin të drejta dhe të lira përbëhej nga Catherine Lalumiere, ish-Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Evropës, Russel Johnston nga Këshilli i Evropës dhe Javier Ruperez nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së. Departmenti i Shtetit dërgoi delegacionin vëzhgues 55 anëtarësh në krye me John Shattuck, Ndihmës sekretar për demokraci, të drejta të njeriut, dhe punë.

Në zgjedhjet e 29 qershorit morën pjesë 72.96% të votuesve, ndërsa fitoi Partia Socialiste me 52,71% të votave që sipas sistemit zgjedhor rezultonte në 101 vende në Parlamentin e Shqipërisë. Partia Demokratike fitoi 25,82% të votave.

SHBA-të përshëndetën mbarëvajtjen e zgjedhjeve duke vëzhguar procesin e votimit si dhe procesin e numërimit të votave. Në deklaratën e lëshuar një ditë pas zgjedhjeve

³¹³ Statement by US State Dept 12 maj 1997

³¹⁴ (Xhejms Petiffer Miranda Vickers Ceshlja Shqiptare Riformësimi i Ballkanit, Bota Shqiptare Libri Tiranë 2007 fq. 129

u theksua se dhuna në disa pjesë të Shqipërisë nuk kishte ndikim në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.³¹⁵

Tranzicioni që pasoi ishte i shpejtë. Më 1 korrik 1997, Presidenti Berisha pranoi rezultatin e zgjedhjeve para se të shpallehin zyrtarisht rezultatet përfundimtare duke pohuar fitoren e Partisë Socialiste. Më 23 korrik 1997, në ditën e mbledhjes së Parlamentit të ri të dalë nga zgjedhjet Sali Berisha dha dorëheqje nga detyra e Presidentit. Parlamenti i Shqipërisë, më 24 korrik 1997, zgjodhi Rexhep Mejdani për President të ri. Më 25 korrik 1997, Presidenti Mejdani emëroi Fatos Nanon kryeministër duke e ngarkuar me krijimin e qeverisë së re. SHBA-të përgëzuan Presidentin Mejdani dhe Kryeministrin Nano duke kërkuar që përpos përqëndrimit në përmirësimin e rendit public dhe ekonomisë të punojnë me opozitën për pajtimin politik dhe krijimin e institucioneve demokratike.³¹⁶ Më 11 gusht 1997 përfundoi Operacioni “Alba” të cilin Këshilli i Sigurimit i OKB-së e vlerësoi të suksesshëm. Nga Shqipëria u larguan të gjitha forcat e huaja, përpos një numri ushtarësh grekë.³¹⁷

SHBA-të shfaqën menjëherë përkrahje të drejtpëdrejtë për institucionet e reja në Shqipëri. Më 26 shtator 1997, Medllin Allbrajt takoi në Nju Jork Kryeministrin Fatos Nano. Ky ishte takimi i parë bilateral i nivelit të lartë prej fillimit të acarimit të raporteve SHBA-SHqipëri. Allbrajt siguroi Nanon se përkrahja amerikane nuk do të mungojë dhe kërkoi nga ai që të shfrytëzonte mundësinë e krijuar për të vendosur vendin përsëri në rrugën e integritit të plotë në Evropë. Me këtë rast, Allbrajt kishte theksuar qartë se bashkësia ndërkombëtare do të qëndronte për të forcuar Shqipërinë duke vepruar në kanale bilateral dhe të përbashkëta në misionet e NATOs dhe OSBE-së.³¹⁸

Pas këshillave të zyrtarëve amerikanë Qeveria në krye me Fatos Nanon filloi të krijojë një kornizë për ngritjen e ekonomisë në vend së bashku me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. FMN premtoi 12 milionë dollarë ndihmë të

³¹⁵ US State Dpt Press Statement 30 qershor 1997

³¹⁶ US State Dpt Press Statement 25 korrik 1997

³¹⁷ UN Daily Highlights 14 gusht 1997

³¹⁸ US State Dpt Press Statement 26 shtator 1997

jashtëzkonshme, ndërsa Qeveria ngriti TVSH-në 20% për të mbuluar deficitin e lartë buxhetor. Më 22 tetor 1997, në Bruksel u mbajt konferenca e Donatorëve për të ndihmuar Shqipërinë. Donatorët premtuan se do të zotojnë mbi 100 milionë dollarë për të mbuluar deficitet buxhetore në afatin tetor 1997-mars 1998. Donatorët poashtu premtuan 500 milionë dollarë për tri vitet e ardhshme në formën e investimeve dhe asistencës teknike.³¹⁹ Qeveria e Fatos Nanos filloi procesin e pastrimit të institucioneve shtetërore nga përkrahësit e PD-së dhe zëvendësimin me përkrahësit e socialistëve, posaçërisht në sektorin e sigurisë dhe administratës. U zëvendësuan të gjithë ambasadorët, u shkarkuan 27 gjeneralë ushtrie përfshirë edhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm, u pezulluan të gjitha gjyqet, ndërsa disa historigrafë vlerësojnë se mbi 400 funksionarë të lartë shtetërorë u shkarkuan dhe u zëvendësuan me përkrahës të Partisë Socialiste para fundit të vitit 1997.³²⁰

Deputetët e Partisë Demokratike kishin pranuar të marrin pjesë në punimet e Parlamentit të Shqipërisë më 13 gusht 1997, por u larguan kur në hapsirat e Parlamentit u plagos deputeti i shquar i PDse Azem Hajdari.

Gjatë krizës së vitit 1997, kur Shqipëria gati rrëshqiti në luftë civile, shqiptarët kaluan nëpër një traumë gati kolektive duke vërtetuar se tranzicioni i përnjëhershëm nga diktatura totalitare, që ishte komunizmi në Shqipëri, në një shoqëri të kapitalizmit liberal, çfarë e përqafoi qeverisja e Berishës dhe demokratëve, nuk mund të kalojë pa pasoja sociale.

Në fund të vitit 1997 Shqipëria mbeti ende e ndarë dhe e polarizuar politikisht dhe hendeku që ishte krijuar vështirë se mund të tejkalohet në një afat të shkurtër

Gjatë kësaj periudhe u vërtetua se problemet e brendshme në Shqipëri nuk mund të zgjidhen pa ndërhyrjen e fuqive ndërkombëtare qoftë politikisht apo në fushën e sigurisë. Administrata e Presidentit Clinton, e zënë ushtarakisht në Bosnje dhe Hercegovinë, kishte vendosur që lidhësin në rastin e krizës së vitit 1997 t'ua lë

³¹⁹ European Commission and World Bank, Albania Donors Conference, Chairman's Conclusions, Bruksel, 22 tetor 1997

³²⁰ Elez Biberaj Shqipëria në Tranzicion fq. 47

evropianëve. Poashtu, strukturat e Departamentit të Shtetit kishin vendosur që në një mënyrë të dënojnë Berishën për mosdëgjueshmërinë e treguar. Por, në plan afatgjatë, planifikuesit në Vashington kishin vërejtur se potenciali destabilizues që mund të krijonte Shqipëria në krizë nuk mund të mohohet. Shqetësimet përgjatë gjithë periudhës së krizës në Shqipëri u hetuan fuqishëm te shqiptarët e Kosovës, tradicionalisht përkrahës të Berishës dhe demokratëve. Kriza që do të fillojë në Kosovë në fund të vitit 1997 do të vërtetojë lidhshmërinë dhe ndjeshmërinë që ka Shqipëria me Kosovën dhe do të vë përsëri në sprovë Shqipërinë dhe administratën amerikane.

III.2 SHBA-të dhe lufta në Kosovë 1998-1999

Në fillim të vitit 1998 Kosova ishte para konfliktit të hapur në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Demonstratat e udhëhequra nga studentët e Univerzitetit të Prishtinës dhe reagimi i dhunshëm i policisë serbe ndaj protestuesve dhe dështimi i implementimit të Marrëveshjes për Arsimin treguan se regjimi Millosheviqit nuk do të leshonte pe ndaj kërkesave të shqiptarëve. Poashtu, lëvizjet në Prishtinë dhe në terren në vendet e tjera të Kosovës tregonin dita ditës se udhëheqja politike e LDK-së dhe Presidentit Rugova po humbte kontrollin mbi shqiptarët dhe veprimet e tyre. Ushtria Çlirimtare e Kosovës filloi të shfaqej haptas në rajonet e Kosovës Qendrore dhe të Kosovës Perëndimore, ndërsa sulmet dhe shkëbimet e zjarrit me forcat policore serbe u shpeshuan. Vetëm në muajin janar dhe shkurt të vitit 1998 u regjistruan 66 incidente të tilla, ndërsa në gjithë vitin 1997 ishin 55 e në vitin 1996 31 incidente të armatosura.³²¹ Në janar të vitit 1998, forcat speciale të policisë së Serbisë filluan manovrat dhe shpërndarjen taktike në rajonet e Drenicës, afër qyteteve të Lipjanit dhe Pejës, me qëllim të sigurimit të komunikimeve kryesore në Kosovën Qendrore dhe Perëndimore. Në të njëjtën kohë filloi armatosja e civilëve serbë në Kosovë, ndërsa grupet e para paramilitare serbe arritën në Kosovë.³²² Më 27 shkurt, forcat policore serbe u konfrontuan me një njësit të UÇK-së afër fashtrave Likoshan dhe Qirez, në Kosovën Qendrore, dhe në shkëmbim të armëve pati të vranë dhe të plagosur në të dyja anët. Pas këtij incidenti forcat serbe sulmuan fshatrat duke vranë 24 civilë shqiptarë. Kjo mënyrë e veprimit të forcave policore serbe, të sulmit ndaj fshatrave shqiptare pas konfrontimeve me UÇK-në, do të përsëritet gjatë gjithë vitit 1998.

Më 5 mars forcat policore serbe sulmuan dhe vranë gati gjithë familjen Jasharaj, të udhëhequr nga Adem Jashari, dhe ky moment ishte moment homogjenizues i shqiptarëve të Kosovës për t'iu bashkangjitur radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të

³²¹ International Crises Group, (*Kosovo Spring, March 1998*) fq. 30.

³²² Independent International Commission on Kosovo, *Kosovo Report*, London: Oxford University Press 2000, fq. 68

Kosovës, sepse policia serbe jo vetëm që kishte vrarë edhe civilë të paarmatosur gjatë këtij akcioni, ajo edhe i kishte gjymtuar qëllimisht kufomat si taktikë frikësimi dhe terrori ndaj shqiptarëve. Efekti i kësaj ngjarjeje edhe sot jehon si momenti kur shqiptarët e Kosovës vendosën të hyjnë në luftë të hapur me policinë dhe ushtrinë serbe.

Përgjatë vitit 1998 radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u rritën në rajonet e Kosovës qendrore dhe perëndimore, në kufi me Reoublikën e Shqipërisë, duke detyruar angazhimin e Ushtrisë Jugosllave si dhe tri Njësive të Policisë Speciale të Serbisë që operonin brenda strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.³²³ Gjatë periudhës së shkurtit dhe marsit të vitit 1998 forcat policore serbe vranë rreth 85 shqiptarë, kryesisht civilë të paarmatosur dhe për këtë arsye Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1160/1998.³²⁴ Kjo Rezolutë thirrej në qëndrimet e Grupit të Kontaktit të miratuara në takimet e 9 dhe 25 marsit 1998. Rezoluta e miratuar dënoi përdoriminin përtej mase ndaj demonstruesve shqiptarë në protestat paqësore, por edhe aktivitetet terroriste të UÇK-së në Kosovë duke theksuar se të gjitha anëtarët e OKBS-së e përkrahin sovranitetin territorial të RFJ-së. Me këtë Rezolutë u përkrahë edhe embargo për armët ndaj RFJ-së, e kundërshtuar nga Rusia, nga RFJ u kërkua që menjëherë të fillojë tërheqjen e forcave speciale policore serbe nga Kosova dhe përmbajtjen e veprimeve policore ndaj civilëve. Në debatin rreth Rezolutës, përfaqësuesi i SHBA-ve, Bill Riçardson kishte theksuar se bashkësia ndërkombëtare nuk guxonte që në rastin e Kosovës të përsëriste gabimet e së kaluarës dhe të priste më gjatë për veprime serioze. Ai ritheksoi se siguria në rajon drejtpërdrejt ndikon në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe se përkeqësimi i situatës në Kosovë: paraqet kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, drejtpërdrejtë ndikon në stabilitetin e vendeve fqinje, rrezikon paqen në Ballkan, dhe si e tillë situatat në Kosovë nuk është vetëm çështje e brendshme e RFJ-së. Riçardson kishte përshëndetur fuqishëm përkushtimin e Ibrahim Rugovës dhe përfaqësuesve të shqiptarëve të Kosovës për gjendjen e zgjidhjes me mjete paqësore përmes negociatave. Ai kishte theksuar se

³²³ Stefan Trobestm, *The Kosovo Conflict*, (SIPRI Yearbook 1999), fq 68

³²⁴ www.un.org/peace/kosovo/98sc1160.htm (19.02.2015)

SHBA-të nuk do të toleronin aktivitetet terroriste duke kërkuar nga Millosheviqi ta ndalojë represionin, të pajtohet për dialog dhe të fillojë përbushjen e kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare.³²⁵

Megjithëse aktorët ndërkombëtarë si Grupi i Kontaktit dhe Bashkimi Evropian përpiqeshin të gjejnë një zgjidhje paqësore, situata në terren në Kosovë përkeqësohej edhe më shumë. Në Rezolutën 1199/1998³²⁶ Këshilli i Sigurimit konfirmoi se situata e krijuar paraqiste kërcënim për paqen në regjion dhe kërkoi nga Republika Federative e Jugosllavisë të ndërprejë veprimet ushtarake, të tërheqë forcat e tilla nga Kosova si dhe ta mundësojë asistencën humanitare për popullatën e Kosovës. Situata zhvillohej mjaft shpejtë si në terren si në planin diplomatik.

Grupi i Kontaktit u takua në Romë më 29 prill 1998 për të definuar 9 majin si datën kur duhet të formulohen kushtet elementare për dialog. Me këtë rast u kërkuar nga shqiptarët e Kosovës të largohen nga përdorimi i dhunës. Në maj të vitit 1998 Presidenti Clinton vlerësoi përpjekjet be Grupit të Kontaktit nuk janë të mjaftueshme për të arritur zgjidhje të qëndrueshme dhe se duhej bërë më shumë.³²⁷ Njëkohësisht me përpjekjet e Grupit të Kontaktit, edhe SHBA-të me Riçard Hollbrukun, edhe Rusia me Nikolaj Afanasyevskym filluan misionet e tyre paralelele.

Në maj të vitit 1998 SHBA-të emëruan Ambasadorin Christopher Hill, që shërbente në Maqedoni, si përfaqësues special të SHBA-ve për Kosovën me qëllim të hapjes së dialogut në mes të palëve të konfrontuara. Në këtë periudhë disa elemente e përkufizonin misionin e Hillit: qëndrimet diametrikisht të kundërta të palëve, për serbët Kosova ishte Serbi, shqiptarët kërkonin pavarësi të plotë, në këtë kohë intervenimi i SHBA-ve nuk ishte opcion³²⁸ dhe Grupi i Kontaktit ishte kundër Pavarësisë së Kosovës³²⁹.

³²⁵ UN, Ekstrakte nga debatet në Këshillin e Sigurimit lidhur me Rezolutën 1160 (1998)

³²⁶ Security Council Resolution 1160 (1998), 31 Mars 1998

³²⁷ Bill Clinton, *My Life*, Alfred A. Knopf, New York, 2004, fq. 787

³²⁸ “Askush në pozitë të lartë në Washington nuk ishte në favor të përdorimit të forcave ushtarake”. Blerim Shala, *The Diplomatic War for Kosova: A dialogue with Christopher Hill*, Zëri, Prishtinë, fq. 47

³²⁹ Nga Konkluzat e takimit të Grupit të Kontaktit në Romë

Në këtë periudhë SHBA-të ende nuk e kishin të definuar politikën e tyre ndaj Kosovës, apo caqet që duhej arritur në fund të përfundimeve të konfliktit shqiptaro-serb. Presidenti Clinton më 6 maj deklaroi se ligjërisht Kosova është pjesë e Serbisë dhe se serbët duhet t'u japin shqiptarëve një formë të vetëqeverisjes dhe të drejtën e marrjes së vendimeve brenda kornizave të Serbisë. Ky qëndrim i Clintonit kërkesat e shqiptarëve i minimizonte ndërsa shqiptarët i trajtonte si pakicë kobëtare që duhet të gjejnë zgjidhje brenda Serbisë-që ishte nga fillimi qëllimi i politikës serbe.

Por, vetëm një ditë më vonë Xhejms Folli, zëdhënës i Shëtpisë së Bardhë, kundërshtoi Clintonin duke thënë se SHBA-të zgjidhjen për Kosovën e kërkojnë brenda RFJ-së e jo brenda Serbisë.³³⁰ Pretendimi i SHBA-ve ishte se Millosheviqi do ta pranonte Kristofer Hillin si mediator.³³¹ SHBA-të përdorën adutët e fortë Riçard Hollbrukun dhe Robert Gellbardin që bashkë me Hillin në fillim të majit vizituan Beogradin për të marrë miratimin e Millosheviqit. Qëllimi i takimit ishte: të sigurohet pajtimi i Millosheviqit për Hillin si mediatir, të vërtetohet se a është i mundshëm procesi paqësor, të propozohet takimi në mes të Millosheviqit dhe Rugovës për të nisur procesin paqësor³³². Pas Beogradit, përfaqësuesit amerikanë më 10 maj erdhën në Prishtinë për të marrë pajtimin e Rugovës se do të takohej me Millosheviqin. Rugova dhe përfaqësuesit e tjerë të shqiptarëve fuqimisht refuzonin një takim të tillë sepse një gjest i tillë në opinion publik në Kosovë dhe në radhët e UÇK-së do të interpretohej si tradhëti ndaj Kosovës. Vetëm pas raundit të tretë të bisedimeve Rugova panoi të takohej me Millosheviqin me kusht që do të takohej më Clintonin në një fazë të mëvonshme.³³³ Takimi në mes të Millosheviqit dhe Rugovës u mbajt në Beograd më 15 maj 1998, pa paraninën amerikane që ishte kusht i Millosheviqit, por që nuk ishte i

³³⁰ US has not suggested the "Ultimate Disposition for Kosovo must be within Framework of the FRY, says Foley, Kosova Daily Report 1423, 98-05-08

³³¹ Millosheviqi kishte refuzuar më herët që këtë rol ta ketë Felipe Gonzales

³³² Blerim Shala, *The Diplomatic War for Kosova: A dialogue with Ambassador Christopher Hill*, Zëri, Prishtinë, 2003, fq. 48

³³³ Përfaqësuesit e SHBA-ve patën disa takime gjatë kësaj periudhe: me Millosheviqin më 9 dhe 11 maj 1998, udhëheqësinë shqiptare në Tiranë 1998, dhe me Rugovën dhe përfaqësuesit e tjerë të shqiptarëve të Kosovës më 10 dhe 12 maj 1998

pëlqyeshëm për shqiptarët e Kosovës. Taskimi, në fakt, pati vetëm një rezultat-fillimin e dialogut Beograd-Prishtinë, ndërsa dëmtoi në masë reputacionin e Rugovës.

Sipas marrëveshjes paraprake Bill Clinton pranoi në Shtëpinë e Bardhë Presidentin e Kosovës Ibrahim Rugovën i cili nga Clintoni kërkoi realizimin e qëllimeve të shqiptarëve të Kosovës-pavarësinë e plotë të saj.³³⁴ Clinton nuk premtoi përkrahje për pavarësi për Kosovën por theksoli se „SHBA-të nuk do të lejojnë një Bosnjë dhe Hercegovinë të re në rajon“.³³⁵ Por veprimet ushtarake serbe nuk pushuan. Gjatë pranverës dhe verës së vitit 1998 forcat e UÇK-së kontrollonin një sasi të madhe të territorit të Kosovës, duke ndërprerë një nga një komunikimet lindje-perëndim që ishin vitale për ushtrinë e RFJ-së sepse cenohej kufiri me Republikën e Shqipërisë. Në periudhën e korrikut dhe gushtit forcat policore dhe ushtarake serbe ndërmorën një mori veprimesh luftarake me qëllim të deblokimit të komunikimeve dhe shkatërrimit të forcave të UÇK-së si dhe fshatrave që përkrahnin këto forca. Vetëm në verën e vitit 1998 në Kosovë kishte mbi 150.000 refugjatë brenda Kosovës. Ofanziva serbe vazhdoi edhe në shtator të vitit 1998 dhe pjesa dërmuese e UÇK-së u largua në Shqipëri.³³⁶ Situata katastrofale brenda Kosovës kishte shtyer edhe Shtëpinë e Bardhë që të ndërmerre hapa për të parandaluar katastrofën absolute humanitare në Kosovë. Por, para se të vepronte si udheheqëse SHBA-të provuan edhe një herë që përmes Grupit të Kontaktit të bëjnë presion mbi Millosheviqin që të ndalë veprimet ushtarake. Më 12 qershor 1998 anëtarët e Grupit të Kontaktit u takuan në Londër vetëm për të konstatuar se gjendja në Kosovë është përkeqësuar.³³⁷ Dallimet ekzistonin brenda anëtarëve të Grupit të Kontaktit, evropianët qëndronin në mes të autorizimit për përdorim të forcës kundër Serbisë me kusht që ky veprim të ishte brenda ligjshmërisë së OKB-së, SHBS-të ishin për sepse kishin fakte se RFJ po bën shkelje të Rezolutavë të OKBS-së, ndërsa Rusia ishte kundër dhe kërcënonte me veto. Rusia e kishte të qartë

³³⁴ Rugova shoqërohej nga Fehmi Agani, Bujar Bukoshi, dhe Veton Surroi, ndërsa Clintoni shoqërohej nga nënkryetari Al Gore dhe këshilltarët për siguri kombëtare Sandy Berger dhe Leon Fuerth

³³⁵ Dario Malnar, *Sjedinjene Americke Drzave i Stvaranje Drzave Kosovo*, Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Shkencave Politike, Zagreb 2012 fq. 173

³³⁶ Xhavit Haliti, *Kështu e bëmë luftën*, Prishtinë: www.filozofiaurbane.com 2013 (24.01.2014)

³³⁷ Contact Group, Statement on Kosovo, 12 June 1998

se drejtimi që po merrte Grupi i Kontaktit ishte i dominuar nga SHBA-të dhe Aleatët e gatshëm ta përdorin NATON në veprimet kundër Serbisë. Rusia më 16 qershor ftoi në Moskë Presidentin e RFJ-së Millosheviqin për t'u takuar me Jelcinin ku Millosheviqi edhe një herë u zotua se do të zbatojë Rezolutën 1160 (1998). Poashtu, Millosheviqi pranoi lëvizjen e monitoruesve të zbatimit të Rezolutës, të diplomatëve të akredituar në Beograd. Ky qëndrim më vonë është marrë si bazë për krijimin e Misionit KDOM.

338

I menjëhershëm ishte reagimi i SHBA-ve që do të përcaktojë politikën ndaj Kosovës prej qershorit 1998 e deri në fillim të bombardimeve të Serbisë në mars 1999. Më 19 qershor 1998 Këshilli Nacional i Sigurisë trajtoi çështjen e Kosovës. Në mbledhje morën pjesë: Samuel Berger, Këshilltar për Siguri i Presidentit Clinton, Sekretarja Medllin Allbrajt, Strobe Talbot, Ambasadori Robert Gelbard si përfaqësues të Departamentit të Shtetit, Sekretari Uilliam Koen dhe Bear McDonnell nga Departamenti i Mbrojtjes, Ambasadori i SHBA-ve në OKB Uilliam Richardson, Xhorxh Tenet nga CIA, Gjenerali Hju Shelton nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Xhim Steiberg dhe Donalld Kerik nga Shtëpia e Bardhë dhe Xhok Kovi nga Këshilli Nacional i Sigurisë. Përfaqësuesit në fund të takimit u dakorduan që zgjidhja politike e konfliktit në Kosovë duhet të bazohet në këto principe: 1. të vendoset autonomia e Kosovës brenda RFJ-së, me Kuvend të vetin, organet e veta ekzekutive policore dhe gjyqësore si dhe përfaqësimin adekuat në nivelin federal, 2. Të krijohen lidhjet me Serbinë përmes trupave të përbashkëta në mes të Serbisë dhe Kosovës për të trajtuar çështjet ekonomike, kulturore, fetare, 3. T'u garantohen të drejtat e pakicave, 4. Të mbahen zgjedhjet demokratike për institucionet e Kosovës dhe ato të nivelit federativ, 5. Të krijohen mekanizma mbrojtës për Kosovën në rast se në nivelin federativ propozohen masa që janë në kundërshtim me interesat e Kosovës, 6. Të jipen garancione ndërkombëtare të heqjes graduale të sanksioneve ndaj RFJ-së që ndërlidhen me implementimin e marrëveshjes politike, njëkohësisht të aplikohen sanksione edhe më të rënda ndaj palëve që pengojnë marrëveshjen dhe monitorimin ndërkombëtar të saj. Të gjithë të pranishmit ishin të pajtimit se SHBA-të së bashku me

³³⁸ Jevgenij Primakov, *Minsko Polje politike*, CEMA, Zagreb, 2011, fq. 226

Grupin e Kontaktit dhe aleatët e partnerëte tjerë duhet të udhëheqin përpjekjet ndërkombëtare për të arritur marrëveshjen politike të bazuar në kërkesat që të ndalen të gjitha armiqësitë, të eliminohen pikat kontrolluese në rrugët e Kosovës, të tërhiqen të gjitha forcat e Ushtrisë së RFJ-së dhe policisë së Serbisë në kazerna ose jashtë Kosovës, të tërhiqen ushtarët kosovarë (mendohet për UÇK-në) në hapsira që do të caktohen më vonë me monitorim të përgjithshëm ndërkombëtar të paqes. Për të dyja palët SHBA-të kishin kërcënimet nëse nuk i përmbahen marrëveshjes politike që duhej ndërtuar. Për Millosheviqin sanksione edhe më të rënda nëse tregohet i padëgjueshëm, heqjen graduale të sanksioneve ekzistuese dhe normalizimin e raporteve ndërkombëtare nëse tregohet bashkëpunues. Për kosovarët nuk do të kishte mbrojtje në rast të sulmeve ndaj forcave policore dhe ushtarake serbe, do të pengohej financimi i UÇK-së si dhe do të shfuqizohej Rezoluta 1160 e OKB-së që do të mundësonte riarmatosjen e RFJ/Serbisë, ndërsa nëse tregohen bashkëpunues UÇK do të kishte përfaqësuesin e saj në tavolinën e bisedimeve.

Në këtë takim u vendos se SHBA-të duhet të angazhohen në mbajtjen e Konferencës vendimtare të Paqes jashtë kufijve të RFJ-së. Poashtu, pjesëmarrësit u dakorduan që menjëherë të fillojnë me planet për krijimin e Grupit Negociator me Ibrahim Rugovën udhëheqës të kosovarëve si dhe të fillohet me planet për të afruar UÇK-në në proceset politike. Në të njëjtën kohë, u vendos që të bëhet presion edhe më i madh ndaj Millosheviqit të ndalë dhunën dhe të angazhohet në procesin e bisedimeve duke mos i ofruar heqjen e sanksioneve në këtë periudhë. Pjesëmarrësit u pajtuan që duhet të punohet së bashku me Rusinë dhe anëtarët e tjera të Këshillit të Sigurimit, që SHBA-të të kërkojnë Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që fuqizon monitoruesit ndërkombëtarë në Kosovë, mundëisht sipas Kapitullit të VII. Pjesëmarrësit poashtu u pajtuan që njëkohësisht të fillojnë bashkëveprimin me Britaninë e Madhe dhe Francën për të krijuar bazën ligjore për veprime ushtarake të NATO-s në Kosovë pa autorizimin e OKB-së. Pjesëmarrësit u pajtuan që NATO të përshpejtojë përgaditjet

dhe planet e reagimit të shpejtë si dhe mënyrës së veprimit për të përmbushur misionin duke mos destabilizuar vakuumin e njëanshëm ushtarak.³³⁹

Prej këtij takimi u pa qartë se strategjia amerikane ishte mosdryshuimi i kufijve ekzistues të Republikës Federative të Jugosllavisë por edhe avancimin e statusit të Kosovës në nivel federativ apo shkëputjen e saj nga Serbia. Gjatë gjithë verës së vitit 1998 përfaqësuesit e niveleve të larta të shtetit në agjendë e kishin Kosovën dhe ndërtonin strategjinë e arritjes së ngritjes së autonomisë së saj dhe ndaljes së dhunës ndaj shqiptarëve. Riçard Hollbruk kishte misionin që të bindë Millosheviqin të pranojë të gjitha kërkesat e Grupit të Kontaktit, jo vetëm ato që kishte pranuar në Moskë duke ja bërë të qartë se Aleatët nuk përjashtojnë anjë formë veprimi në rastin e Kosovës. Hollbruk duhej të bindte Rugovën se duhej të krijonte ura lidhëse me UÇK-në dhe se ai ende është figura qendrore dhe esenciale e kosovarëve. Hollbruk duhej të bindte UÇK-në se Aleatët nuk do ta përkrahin përpjekjen për arritjen e pavarësisë së Kosovës me dhunë por presin nga ata që t'i bashkohen procesit politik me një rol më aktiv por me Rugovën në krye. Edhe një herë SHBA-të kërkuan nga Britania e Madhe dhe Franca gatishmëri për të vepruar në Kosovë ushtarakisht edhe pa OKB-në.³⁴⁰ Në këtë periudhë Ambasadori Chris Hill u angazhua për të krijuar kontakte më të shpeshta me lidërshtipin e UÇK-së, por duke mbajtur Rugovën si figurën kryesore politike të kosovarëve. Takimet e para me përfaqësuesit e UÇK-së i bënë Riçard Hollbruk dhe Robert Gellbard. Gellbard u takua në Zvicër me Bardhyl Mahmutin, dhe pas këtij takimi i dërgoi porosi Rugovës se UÇK veten e sheh të barabartë në pozitën kur do të vendoset pozicioni i përbashkët negociues i shqiptarëve.³⁴¹ Në të njëjtën kohë në Tiranë Kristofer Hill u takua me Xhavit Halitin , njërin nga njerëzit më me influencë në UÇK. Në këtë takim Haliti ia kishte bërë të qartë Hillit se UÇK nuk është e interesuar për asnjë formë të autonomisë, por vetëm për pavarësinë e saj. Haliti

³³⁹ Meeting of NSC Principals June 19th 1998-Summary of conclusions of Principals Committee Meeting on Kosovo, Declassified in part per E.O.13526, Biblioteka e Presidentit Clinton

³⁴⁰ Meeting of NSC Principals Committee 22nd June, 1998-Summary of Conclusions of Principals Committee Meeting on Kosovo; Declassified per E.O. 13526, Biblioteka e Presidentit Clinton

³⁴¹ Blerim Shala, *The Diplomatic War for Kosova : A Dialogue with Christopher Hill*, Zëri, Prishtinë, 2003, fq. 61-62

poashtu angazhimin eventual të NATO-s e kuptonte si mjet për zgjidhjen e problemit të Kosovës e jo ndaljes së luftimeve.³⁴²

Në planin diplomatik SHBA-të shtuan angazhimet për të bindur Britaninë e Madhe, Francën, dhe Gjermaninë për të vepruar ushtarakisht edhe pa autorizimin e OKB-së. Në këtë qëllim Sandi Berger dhe Medllin Allbrajt do të takonin homologët e tyre për t'i bindur se Rusia nuk ka të drejtë të vetos për veprimet e NATO-s.³⁴³

Këshilltari për Siguri Nacinale i Presidentit Clinton, Samuel Berger, në Memorandumin e datës 24 shtator të titulluar : Kosovo-Përgaditja për Ultimatum, i kishte sygjeruar Presidentit Clinton që të përdorë mjetin e kërcënimit ushtarak përmes mekanizmave të NATO-s për të parandaluar krizën humanitare që kishte kapluar Kosovën përderisa dimri po afrohej. Në këtë memorandum theksohet se bisedimet në mes të përfaqësuesve të shqiptarëve dhe autoriteteve të Beogradit të udhëhequra nga Ambasadori Chris Hill nuk do të kishin sukses nëse dhuna nuk do të ndalej në Kosovë. Sipas këshillave të Bergerit NATO duhej të gjeneronte hapa të mjaftueshëm për t'u përgaditur ushtarakisht dhe politikisht për të publikuar ultimatumin RFJ-së duke i dërguar sinjal të qartë dhe të fortë Millosheviqit. Kjo do të mund të arrihej me një Rezolutë të OKB-së që do të ishte bazë e mjaftueshme për përdorimin e forcës së Aleatëve, por që nuk do të autorizonte forcën në mënyrë eksplicite. Sipas Bergerit, arritja e Rezolutës dhe e veprimit nuk do të ishte e lehtë për Presidentin Clinton për disa arsye: së pari arritja e koncenzusit brenda Aleatëve ishte punë e vështirë posaçërisht duke marrë parasysh kundërshtimet e Rusisë, së dyti Kongresi nuk ishte në favor të marrjes me çështjen e Kosovës sepse ende ekzistonin vështirësi në funksionimin e SFOR-it (forcave paqeruajtëse në Bosnje dhe Hercegovinë). Kongresi vështirë do të përkrahte angazhimin e forcave amerikane në përkrahje të agjendës së „autonomisë së Kosovës“, së treti përdorimi i forcave ajrore në këtë moment do t'i detyronte SHBA-të të marrin rolin e zbatimit të marrëveshjes së arritur nëse ajo arrihet

³⁴² Po aty fq. 61

³⁴³ Meeting of NSC Principals Committee 30th June, 1998-Summary of Conclusions of Principals Committee Meeting on Kosovo; Declassified per E.O. 13526, Biblioteka e Presidentit Clinton

dhe nëse Kongresi nuk e konteston. NATO për zbatimin e demilitarizimit të Kosovës planifikonte 36.000 forca në terren dhe 8000 në Republikën e Shqipërisë. NATO kishte bërë plane por nuk kishte arritur koncenzusin e duhur për këtë plan, prandaj shqyrtohej mundësia e krijimit të një force policore lokale dhe institucioneve të tjera të sigurisë që do të bartnin zbatimin e marrëveshjes duke hequr këtë barrë nga supet ndërkombëtare, posaçërisht të ushtrisë së SHBA-ve. Në fund ekzistonte edhe mundësia që Beogradi të tërhiqej nga bisedimet nëse kushtëzohet me ultimatum ushtarak duke sforcuar krizën humanitare, duke marrë pengje ndërkombëtare, duke u hakmarrë ndaj qytetarëve amerikanë dhe interesave të tyre. Me gjithë riskun e definuar në këtë memorandum, Presidenti Clinton e aprovoi kërkesën dhe ju drejtua NATO-s që diplomacia të përkrahet me ultimatum gradual ushtarak.³⁴⁴ Më 24 shtator 1998 NATO vendosi presionin mbi Millosheviqin me shpalljen e Kërcënimit Veprues (ACTWARN) për veprime të kufizuara ushtarake ajrore në faza të ndryshme, ndërsa më 8 tetor 1998 Grupi i Kontaktit dërgoi përfaqësuesin special Riçard Hollbruk në Beograd për të kërkuar zbatimin e Rezolutës 1199/1998 misioni i të cilit ishte i përkrahur nga kërcënimi i hapur ushtarak i NATO-s. Kjo përpjekje diplomatike rezultoi me Marrëveshjen në mes të NATO-s dhe RFJ-së mbi verifikimin e veprimeve ajrore dhe OSBE-RFJ mbi verifikimin e veprimeve tokësore. Më këto marrëveshje ndërkombëtare Beogradi pranoi praninë e monitoruesve ndërkombëtarë në Kosovë që do të garantonin ndërprerjen e veprimeve ushtarake ndaj civilëve në Kosovë. Më 6 korrik organizata KDOM (Kosovo Diplomatic Observer Mission) u bë operative dhe udhëhiqej nga një grup koordinues i ambasadorëve të vendeve të Grupit të Kontaktit, Austrisë, Polonosë, BE-së dhe OSBE-së. Arritja më e madhe fillimisht ishte ndërmjetësimi për ndërprerjen e luftimeve dhe mundësia që organizatat humanitare të vepronë në Kosovë në ndihmë të të pastrehëve dhe refugjatëve.³⁴⁵ Në këtë periudhë katastrofa humanitare në Kosovë me mbi 200.000 të shpërngulur nga vendbanimet e tyre e ende mbante vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare. Nuk shkoi shumë kohë dhe forcat policore serbe kryen edhe një masakër në fshatin Obri e Epërme në

³⁴⁴ Samuel Berger, *Memorandum for the President-Kosovo Preparing for an Ultimatum*, Biblioteka e Presidentit Clinton, Dokument i deklasifikuar më 24 shtator 1998

³⁴⁵ Stefan Trobestm, *The Kosovo Conflict*, (1999) SIPRI Yearbook, fq. 57

Kosovën Qendrore ku vranë 16 civilë shqiptarë. Ky masakër pati jehonë të madhe në opinionin publik ndërkombëtar.³⁴⁶ Në tetor të vitit 1998 në pajtueshmëri me kërkesat e Rezolutës 1199/1998 dhe si rezultat i bisedave Hollbruk-Milloshëviq, NATO dhe RFJ nënshkruan Marrëveshjen mbi krijimin e KVM OSCE (Kosovo Verification Mission).³⁴⁷ Sipas Marrëveshjes u krijua zona e përbashkët e sigurisë të cilën e përbënte e gjithë Kosova së bashku me 25km të territorit përreth Kosovës. Aeroplanët e paarmatosur të NATO-s fituan të drejtën e fluturimit mbi këtë zonë dhe kontrollit të respektimit të marrëveshjes. Poashtu, NATO krijoi njësitë speciale përkrahëse që do të ndihmonin në evakuimin e përfaqësuesve të KVM, nëse konflikti i armatosur do të shpërthente përsëri. Këto forca, pjesa e parë rreth 2000 ushtarë, u vendosën në Maqedoni në nëntor të vitit 1998.³⁴⁸ Megjithatë, konfliktet ndërmjet forcave policore dhe ushtarake serbe dhe atyre të UÇK-së nuk pushuan. Qëllimi i Misionit Vëzhgues ishte të vërtetohet se a mundën të gjitha palët t'i përmbahen kushteve të Rezolutës 1199/1998, prandaj nevojitej marrëveshja që do t'u mundësonte pjesëtarëve të Misionit Vëzhgues të udhëtojnë në gjithë Kosovën. Qendra e Misionit Verifikues ishte në Prishtinë, ndërsa ishin edhe nën-qendrat rajonale në gjithë Kosovën.

Misioni Verifikues KDOM arriti të prodhojë një armëpushim të shkurtër për disa muaj. Rëndësia e monitoruesve ndërkombëtarë e posaçërisht atyre udhëheqës amerikanë siç ishte Shon Bërns ishte se ata ua bënë të qartë vendimmarrësve në SHBA se shqiptarët e Kosovës të të gjitha grupacioneve, si elita ashtu edhe fshati, ishin të vendosur për një qëllim: pavarësinë e Kosovës. Poashtu, monitoruesit amerikanë e njohën popullaritetin e UÇK-së dhe raportonin se pa përfaqësuesit e tyre negociatat eventuale për Kosovën do të jenë të pasuksesshme. Për shqiptarët e Kosovës prania e monitoruesve ndërkombëtarë ishte një ngritje e moralit sepse monitoruesit përfaqësonin drejtpërdrejtë interesimin ndërkombëtar për Kosovën, diçka që shqiptarët e Kosovës e kishin kërkuar me vite. KDOM kishte rregulla të përcaktuara dhe të

³⁴⁶ Krieger, H. , *The Kosovo Conflict and International Law, an Analytical Documentation 1974-1999*, Cambridge International Series, Vol11, Cambridge University Press (2001), fq. 116

³⁴⁷ NATO FRY, Agreement Providing for the Establishment of an Air Verification Mission over Kosovo, Belgrade, 15 October 1998, UN Doc. S/1998/991, Annex, 23 October 1999

³⁴⁸ The OSCE Decision No 263, 25 October, point 1

qarta-raportimin e fakteve nga terreni dhe asnjëherë të mos intervenojnë apo ndalin konfrontimet në mes të shqiptarëve dhe forcave serbe. Vetë Misioni ishte i ndarë në tri pjesë: US KDOM, EU KDOM, dhe Russia KDOM sepse këto ishin vendet me influencë dhe me interesim për Kosovën.

Ndonëse Millosheviqi e pranoi Misionin Verifikues ai asnjëherë nuk u largua nga qëllimi i shpartallimit të kryengritësve shqiptarë. Beogradi zyrtar asnjëherë nuk i pengonte monitoruesit e KDOM-it por ishin oficerët në terren që vendosnin se në cilën zonë mund të hyjnë monitoruesit. Këtë strategji Millosheviqi e përdori deri në fund të misionit verifikues. Mirëpo, pas vrasjes së 21 shqiptarëve më 26 shtator 1998 Sekretarja Allbrajt dhe Riçard Hollbruk arritën të bindin NATO-n për të filluar planifikimin për bombardimin e menjëhershëm të caqeve serbe gjë që e detyroi Millosheviqin të shpallë armëpushim dhe të premtojë se do të bënte negociata me shqiptarët. KDOM së shpejti u rrit nën ombrellën e OSBE-së në Kosovo Verification Mission apo Misionin Verifikues të Kosovës në krye të së cilës ishte Ambasadori Uilliam Uaker. Deri në fund të vitit 1998 ishte e qartë se ndalimi i luftimeve ishte i përkohshëm. Të dy palët e shfrytëzuan periudhën tetor 1998 janar 1999 për t'u riarmatosur dhe përforcuar. Forcat e UÇK-së u rigrupuan në zonat e Kosovës qendrore, lindore e sidomos në rajonin e Llapit në kufi me Serbinë, ndërsa Serbia grupizonte forcat përreth kufijve të Kosovës për të hyrë përsëri brenda në momentin e duhur. Më 1 tetor 1998 Kristofer Hill prezantoi Planin e Parë për zgjidhjen e krizës në Kosovë.³⁴⁹ Negociatat para prezantimit ishin të vështira sepse Millosheviqi kishte qëndrimin se UÇK-ja është mposhtur dhe se sie tillë procesi negociues është i panevojshëm, dyshonte se SHBA-të po planifikonin ndërrimin tij si dhe kundërshtonte qëllimet e SHBA-ve për internacionalizimin e situatës dhe shpërndarjen e misionit paqësor në Kosovë, në atë kohë të papranueshëm për Millosheviqin.³⁵⁰

³⁴⁹ First Draft Agreement for a Settlement of the Crisis in Kosovo, 1 October 1998

³⁵⁰ Hollbruk dhe Killark ishin të mendimit se forcat paqësore duhen të ishin nga NATO, përderisa Kristofer Hill në atë kohë konsideronte se NATO dhe anëtarët e saj nuk ishin të gatshme për një veprim të tillë.

Plani i Parë nuk u përqëndrua në atë se Kosova a do të jetë nën ingerencat e Serbisë apo RFJ-së, por më shumë ishte i përqëndruar në krijimin e institucioneve vendore për të stabilizuar Kosovën. Kështu, me Plan parashihej Parlamenti që do të mund të miratonte edhe Kushtetutën e Kosovës, ndërsa secilës pakicë i garantonte të drejtën e vetos. Plani parashihte edhe Qeverinë e Kosovës, institucionet e tjera administrative dhe institucionin e Ombudspersonit. Funkcioni i Presidentit të Kosovës nuk parashihej duke shkaktuar pakënaqësi të madhe të Rugova dhe përkrahësit të tij. Planin e refuzuan të dy palët, por sipas Hillit ky nuk ishte dështim sepse palët u angazhuan në trajtimin e tij.³⁵¹ Plani i Dytë i Hillit u prezantua më 1 nëntor 1998 si version që: forconte entitetin e Kosovës, parashihte institucionin e Presidentit të Kosovës, si dhe gjyqësorin më të precizuar të Kosovës. Këtë plan Hilli ua kishte prezantuar edhe UÇK-së. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Beogradit e refuzuan edhe këtë plan. Serbia shkoi një hap më tutje dhe më 18 nëntor organizoi një konferencë me pakicat lojale ndaj Serbisë për të definuar një kundër propozim për të minuar përpjekjet e Hillit dhe për t'i bërë shqiptarët të barabartë me pakicat e tjera në Serbi.³⁵² Plani i Tretë i Hillit i paraqitur më 2 dhjetor ishte i papranueshëm për shqiptarët e Kosovës që për herë të parë theksuan njëzëri se për zgjidhje qoftë kalimtare qoftë përfundimtare duhet të mbahet një Konferencë Ndërkombëtare.³⁵³ Serbët poashtu e refuzuan këtë plan, ndonëse ishte më i favorshëm për kërkesat e tyre. Në të njëjtën kohë, UÇK përmes përfaqësuesit politik Adem Demaqit deklaroi se është e gatshme të pranojë statusin e njëjtë me Serbinë dhe Malin e Zi në RFJ në një fazë tri vjeçare pas së cilës populli i Kosovës do të vendoste me referendum të ardhmen e vet.³⁵⁴ Prania e madhe ndërkombëtare në Kosovë përpos që bënte presion për zgjidhjen e krizës ajo edhe e intensifikonte atë. Shqiptarët e Kosovës, përmes Kuvendit të Kosovës, kërkuan intervenimin e NATO-s ,

³⁵¹ Blerim Shala, *The Diplomatic War for Kosova: A Dialogue with Ambassador Christopher Hill*, Zëri, Prishtinë, 2003, fq. 76

³⁵² Joint Proposal of the Agreement on the Political Framework of Self-Governance in Kosovo and Metohija, 20 November, 1998, Belgrade

³⁵³ Presidenti Ibrahim Rugova injoroi plotësisht këtë plan dhe kërkoi që plani 1 nëntorit 1998 duhej të verifikohet në një Konferencë me karakter ndërkombëtar, Kosova Daily Report 1628, 98-12-048

³⁵⁴ UCK does not settle for anything less than full-independence, UCK General Staff says, Kosova Daily Report 1629, 98-12-05

demilitarizimin e saj dhe krijimin e protektoratit ndërkombëtar.³⁵⁵ Situata përsëri përshkallëzohej dhe SHBA-të përaëri u gjetën në situatë të krijojnë një bllok unik të shqiptarëve të Kosovës. Në përpjekje për të bërë këtë, kah fundi i vitit 1998 Kris Hill takohej me Xhavit Halitin dhe përfaqësues të tjerë që ishin në Kosovë. Në të njëjtën kohë Lari Rossin, diplomat amerikan, takohej me Bardhyl Mahmutin me të cilin takohej edhe Riçard Hollbruk. Robert Gelbard poashtu dëshironte të ishte i informuar dhe lidhje e kishte Shon Bernsin e KDOM-it, ndërsa në terren Misionin Verifikues të OSBE-së e udhëhiqte Uilliam Uaker. Berns dhe Uaker nuk komuniknin sepse kishin instruksione të ndryshme. Kështu shpeshherë komandantët e Zonave Operative të UÇK-së merrnin informata konfuze, zonat e luftës kështu ashtu ishin heterogjene dhe të orientuara në raporte klanore Dukagjin, Drenicë, Llap. Në këtë mënyrë konfuzion krijohej edhe te Presidenti Rugova dhe njerëzit e tij.³⁵⁶ Megjithë kushtet e pavarshme Kristofer Hill më 27 Janar 1998 paraqiti edhe Planin e Katërtvetëm dy ditë para se Grupi i Kontaktit do të vendoste që të mbante Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën.

Pas masakrit që bënë forcat serbe në fshatin Reçak, ku më 15 janar 1999 vranë mbi 45 fshatarë të paarmatosur, ishte e qartë se Millosheviqi nuk do ta ndalte luftën. Vetëm dy javë më vonë forcat serbe më 29 janar 1999 vranë 28 shqiptarë në fshatin Rogovë në Kosovën Perëndimore.

Për Perëndimin koha e gjetjes së zgjidhjes brenda një afati të shkurtër u zvogëlua edhe më shumë dhe SHBA-të dhe Aleatët u gjetën para dy alternativave. Të bombardojnë menjëherë Serbinë pasi ajo kishte shkelur Marrëveshjen e Tetorit dhe kështu të ruajnë kredibilitetin e NATO-s, apo të provojnë të gjejnë një zgjidhje në një konferencë ndërkombëtare siç e kishin shqyrtuar qysh në muajin qershor 1998. Vendosën për versionin e dytë dhe Grupi i Kontaktit, nën udhëheqjen e Francës, ftoi palët në Konferencën e Rambujesë më 6 shkurt 1999. Çështja e pazgjidhur ende ishte se nën patronatin e kujt do të mbaheshin bisedimet. Medllin Allbrajt kërkonte që bisedimet t'i

³⁵⁵ Kosova's Parliament calls for NATO Intervention in Kosova, Kosova Daily Report 1651, 98-12-30

³⁵⁶ Dario Malnar, *Sjedinjene Americke Drzave I Stvaranje Drzave Kosovo*, Sveuciliste u Zagrebu, Fakultet Politickih Znanosti, Zagreb 2012 fq 204

udhëhiqte NATO, që ishte organizatë më homogjene se sa Bashkimi Evropian, ku rol të fuqishëm kishin SHBA-të dhe duke u thirrur në atë se ky sistem po funksiononte pa problem në Bosnje dhe Hercegovinë. Partnerët evropianë, posaçërisht Franca përparësi i jepnin Grupit të Kontaktit, që përbëhej nga gjashtë anëtarë, dhe si arsyetim vlerësonin se NATO është organizatë shumëanëtarëshe andaj vebdimarrja do të ishte më e vështirë, ndërsa Rusia ishte poashtu në Grupin e Kontaktit. Qëndrimi evropian dominoi dhe u vendos që Grupi i Kontaktit t'i udhëheqë bisedimet në Konferencën Ndërkombëtare. Kundër këtij vendimi zëshëm ishte Zëvendës Komandanti i NATO-s Klaus Naumman i cili këtë veprim e konsideoi si gabim të madh sepse Rusia nuk i ndante qëndrimet e njëjta me NATO-n rreth Kosovës. Kështu negociatat morën një qasje të çasje të çuditshme sepse NATO nuk ishte në tavolinën e bisedimeve, ndërsa Grupi i Kontaktit përdorte NATO-n për të bindur serbët dhe shqiptarët për arritjen paqësore të konfliktit. Pengesa tjetër, sipas Naummanit ishte që pesë anëtarë të NATO-s ishin pjesë e Grupit të Kontaktit, por nëse do të vinte koha që të aktivizoheshin veprimet luftarake, gjë që do të ndodhë në mars 1999, shtetet e tjera të NATO-s do të duhej t'u përmbaheshin një pakice vendimmarrëse dhe ky lloj segregacioni do të dobësonite unitetin e NATO-s.³⁵⁷

Vetëm dy ditë para fillimit të Konferencës Paqësore në Rambuje nga SHBA-të erdhi deklarata shumë e qartë që precizonte qëndrimet e SHBA-ve të poashpallura deri atëherë. Sekretarja Allbrajt në paraqitjen para Institutit Për Paqe theksoi se: 1. nuk ka garancione se pavarësia e Kosovës do të siguronte paqen në Kosovë dhe se ka mjaft arsye për frikë se pavarësia e Kosovës do të rrezikonte stabilitetin e pjesëve të tjera të rajonit, prandaj qytetarët e Kosovës duhet të marrin mundësinë të qeverisin Kosovën në mënyrë demokratike pa ndikimin e Beogradit. Kështu për Kosovën do të siguroheshin forca të mjaftueshme të policisë lokale nën kontrollin e organeve vetëqeverisëse tyrivjeçare. Poashtu në Kosovë do të vendosen forca paqeruajtëse. Pra, Kosovës i ofrohej një autonomi e gjerë për së paku tri vitet në vijim. 2. Nëse Millosheviqi refuzon propozimet e Grupit të Kontaktit atëherë mund t'i presë „sulmet ajrore të NATO-s“. 3. Nëse shqiptarët e Kosovës krijojnë obstrukcione më nuk mund

³⁵⁷ Klaus Naumman, <http://pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/interviews/naumann.html> (12.03.2013)

të llogarisin në përkrahjen e NATO-s dhe bashkësisë ndërkombëtare. 4. Në RFJ ka nevojë për zhvillim të demokracisë së vërtetë.³⁵⁸

Deklarata e saj e fundit për zhvillimin e demokracisë së mirëfilltë në Serbi e përkthyer nga gjuha diplomatike qartë e theksonte se SHBA-të më nuk e mbështetnin Millosheviqin dhe se demokratizimi i Serbisë nuk është i mundshëm me Millosheviqin në krye. Por, poashtu, me këtë qëndrim SHBA-të vështirë se do të mund të llogaritnin në bashkëpunimin e Millosheviqit.

³⁵⁸ Secretary of State Madeleine Allbright, Remarks and Q/A Session at the US Institute of Peace, Washington DC, February 4 1999.

III.3 SHBA-të dhe Konferenca e Rambujesë

Bisedimet e Konferencës së Rambujesë filluan zyrtarisht më 6 shkurt 1999 nën kryesimin e Ministrit Francez të Punëve të Jashtme Hubert Vedrin dhe Ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe Robin Kuk. Fillimisht ideja ishte që të mos zgjasin më shumë se shtatë ditë. Përbërja e delegacioneve, që në fillim, nuk jipte shpresa se kjo Konferencë do të prodhonte paqen në Kosovë. Fillimisht, Millosbheviqi si Kryesues të Delegacionit të Beogradit dërgoi Millan Millutinoviçin, që ishte Kryetar i Serbisë dhe një delegacion të përbërë nga serbët dhe pakicat e tjera joserbe, për të theksuar se Kosova është çështje e brendshme e Serbisë. Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër ishte shumë heterogjenë sepse ishte i përbërë nga përfaqësuesit e UÇK-së në krye me Hshim Thaçin, përfaqësuesit e partisë Lëvizja e Bshkimit Demokratik në krye me Rexhep Qosjen, përfaqësuesit e LDK-së në krye me Presidentin e Kosovës Ibrahim Rugovën, si dhe Blerim Shalën dhe Veton Surroin. Të gjithë, pak a shumë, i bashkonte padurueshmëria ndaj LDK-së dhe Presidentit Rugova në veçanti. Që në fillim të Konferencës u pa se delegacioni i Beogradit kishte ardhur për të blerë kohë për Millosheviçin dhe pushtetin e tij, ndërsa në delegacionin e Kosovës ishte beteja për primatin e udhëheqjes së shqiptarëve të Kosovës, të cilin e kishte LDK-ja për vite të tëra.

Pala shqiptare kishte dy kërkesa themelore: mbajtjen e referendumit për pavarësinë e Kosovës dhe shpërndarjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Pala serbe insistonte se çështja e Kosovës është çështje e brendshme e Serbisë dhe do të trajtohej në kuadër të Kushtetutës së Serbisë. Këto dy qëndrime diametrikisht të kundërta ishin sfidë e madhe për negociatorët Kristofer Hill (SHBA), Wolfgang Petritsch (BE) dhe Igor Mayorski (Rusi) që për bazë kishin propozimin e Grupit të Kontaktit për arritjen e paqes në Kosovë. Ky propozim kishte pjesën politike që u prezantua menjëherë dhe që nuk pritej se do të ndysohej shumë as nga serbët e as nga shqiptarët e Kosovës. Propozimi bazohej në kërkesën e Beogradit për sovranitetin dhe integritetin e RFJ-së që në atë kohë të gjitha palët e involvuara në proces si Këshilli i Sigurimit të OKB-së,

NATIO, Grupi i Kontaktit nuk e vënin në dyshim. Me pjesën e propozimit politik ishin edhe anekset e dokumentit për zbatimin e Marrëveshjes përfundimtare, posaçërisht ai ushtarak që u prezantua në fund. Sipas diplomatit amerikan dhe ekspertit për Rusinë në Departmentin e Shtetit të SHBA-ve Strobe Talbot qëllimi i Konferencës ishte kthimi i autonomisë së Kosovës që do të qëndronte e tillë deri te vendimi për referendumin për statusin e Kosovës.³⁵⁹ Në fakt SHBA-të kurrë nuk kanë besuar se Konferenca mund të rezultojë me rezultat pozitiv³⁶⁰.

Pala serbe u tregua pasive gjatë gjithë kohës edhe gjatë trajtimit të dokumenteve që propozoheshin, ndërsa pala shqiptare bënte analiza të gjera të propozimit përfundimtar si dhe ishte aktive me propozime shtesë. Gjatë kësaj kohe Presidenti i SHBA-ve Clinton ishte nën presionin e procesit të shkarkimit (impeachment) për shkak të aferës Lewinski dhe nuk ishte mjaft aktiv në rrjedhën e konferencës. Me të fituar luftën kundër shkarkimit të tij Clintoni ju kthye Konferencës së Rambujesë dhe SHBA-të shtuan presionin për të arritur Marrëveshjen në Konferencë. Presidenti Clinton më 13 shkurt 1999 ftoi në takim udhëheqësit e Kongresit të SHBA-ve për të diskutuar Konferencën e Rambujesë dhe rolin e mundshëm të SHBA-ve në misionin paqësor në Kosovë të udhëhequr nga NATO.³⁶¹ Në një prononcim për opinionin publik Clintoni theksoi se SHBA-të do të kontribuonin me 4000 ushtarë në misionin paqeruajtës në Kosovë pas arritjes së Marrëveshjes Paqësore. Konferenca e Rambujesë thjeshtë do të dështonte pa vendosshmërinë dhe taktizimet amerikane sepse qëndrimet e palëve ishin shumë larg njëra tjetrës. Aktivizmi i ri i SHBA-ve rezultoi me vendimin e Grupit të Kontaktit më 14 shkurt për vazhdimin e bisedimeve. Në këtë takim të mbajtur në Paris u vendos që palëve t'u paraqiten edhe plani politik edhe ai ushtarak i Marrëveshjes. Pas këtij takimi SHBA-të morën iniciativën dhe rolin kryesor në bisedimet e mëtejshme. Poashtu, SHBA-të ndërruan taktikën që

³⁵⁹ Strobe Talbot, *The Russia Hand: A memoir of Presidential Diplomacy*, (New York:Random House, 2002) fq. 303

³⁶⁰ Kristofer Hill: Isha i befasuar kur evropianët, posaçërisht francezët insistonin në Konferencë sepse e dija që nuk ka elemente për marrëveshje”, Blerim Shala, *The Diplomatic War for Kosova: A Dialogue with Ambassador Christopher Hill*, (Zëri, Prishtinë, 2003), fq. 85

³⁶¹ Në përgaditje të këtij takimi Clinton më herët kishte konsultuar ekipin e tij për rolin e NATO-s, shpenzimet për SHBA-të, strategjinë dalëse të SHBA-ve

ishte e vendosur nga evropianët në fillim: izolimin e negociatorëve në Rambuje deri në arritjen e marrëveshjes. SHBA-të filluan me atë që në diplomaci quhet „proximity talks“ apo bisedimet e drejtpërdrejta.³⁶² Kështu Kristofer Hill udhëtoi në Beograd për t'u takuar me Millosheviqin për ta bindur që të ketë një qasje më serioze në bisedime. Pala serbe e inkurajuar propozoi ndryshime në Marrëveshjen përfundimtare që nënkuptonin edhe veton e pakicave në Kosovë në organet e përkohshme vetëqeverisëse. Propozimi i dytë kishte të bënte me aneksin ushtarak të marrëveshjes i cili ishte plotësisht i njëjtë me doktrinën e veprimit të NATO-s në Bosnje dhe Hercegovinë: vënien në shfrytëzim të komunikimeve, hapësirës ajrore, tokësore të RFJ-së në përkrahje të misionit paqeruajtës në Kosovë. Kjo ishte e papranueshme për Millosheviqin dhe Rusinë sepse shkelej sovraniteti i Serbisë. Poashtu, dokumenti përfundimtar kërkonte demilitarizimin e UÇK-së, gjë që nuk e pranuan shqiptarët e Kosovës. Por, anëtarët perëndimore të Grupit të Kontaktit konsideronin se me delegacionin e Kosovës nuk do të ketë probleme. SHBA-të konsideronin se pala shqiptare duhet të pranojë çfarëdo propozimi politik që siguron tërheqjen e forcave serbe dhe atyre të RFJ-së dhe hyrjen e NATO-s në Kosovë. Menjëherë do të formoheshin institucionet demokratike në Kosovë në të cilat do të dominonin shqiptarët. Por, SHBA-të neglizhuan faktin se shqiptarët kishin kaluar një periudhë të vështirë të organizimit dhe armatimit ushtarak dhe nuk mund të pranonin demilitarizimin aq lehtë poashtu pa u qartësuar çështja e referendumit për të ardhmen e Kosovës pas tri vitesh të vetëqeverisjes.³⁶³ Pasi dokumentet e propozuara nuk morën pajtimin e palëve bisedimnet u vazhduan edhe për tri ditë dhe sollën pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të Sekretares Allbrajt në Rambuje. Fillimisht qëllimi ishte të bindet pala shqiptare për ta pranuar Marrëveshjen Përfundimtare, sepse refuzimi i shqiptarëve i vendoste SHBA-të në pozitë të pavolitshmendaj Aleatëve të tjerë e posaçërisht i shkante për shtati Rusisë dhe Serbisë. Pala shqiptare pranoi qëndrimet amerikane përpos Hshim Thaçit, që ishte edhe kryesues i delegacionit shqiptar, për shkak se

³⁶² Marc Weller, *Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence*, (Oxford: University of the Press 2009) fq. 129

³⁶³ Marc Weller, *Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence*, (Oxford: University of the Press 2009) fq. 131

kërkohej demilitarizimi i UÇK-së dhe Thaçi ishte nën presion të komandantëve të Zonave të Luftës në Kosovë se një gjë e tillë është e papranueshme. Për më shumë, gjatë bisedimeve në Francë, Komandantët e Zonave e ndërruan Azem Sylën, deri atëherë Shef i Shtabit të UÇK-së, me Sylejman Selimin, Komandant të Zonës Operative të Drenicës. Për të bindur shqiptarët u është mundësuar konsultimi me ekspertët e NATO-s për aspektet ushtarake të Marrëveshjes, pastaj edhe Ismail Kadare dhe Ministri i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë ushtruan ndikimim e tyre për të zbutur qëndrimet e shqiptarëve të Kosovës. SHBA-të ishin jashtëzakonisht të shqetësuara me kryeneçësinë e Thaçit. Kristofer Hill i kishte thënë Ministrit Paskal Milo se Thaçi duhet të shkonte në një pushim të gjatë, ndërsa Sekretarja Allbrajt ishte prekuar aq shumë sa që kishte deklaruar privatisht se nëse nuk do të kishte marrëveshje, me fajin e Thaçit, ajo do ta harronte fjalën Kosovë.³⁶⁴

Në momentin që Serbia hetoi se SHBA-të po bëjnë presion mbi shqiptarët nisën një ofanzivë ushtarake kundër pozicioneve të UÇK-së në rajonin e Zonës Operative të Llapit, në Kosovën Verilindore dhe afër kufirit me Maqedoninë, në Kosovën Jugore, aktivizuan fletëarrestin për Thaçin në Interpol, dhe së fundi insistuan në bisedime direkte me shqiptarët.

Pala shqiptare ishte e vendosur që çështja e referendimit për të ardhmen e Kosovës, pas tri vitesh vetëqeverisjeje, të jetë pjesë e Marrëveshjes Përfundimtare. Sekretarja Allbrajt edhe me letër të shkruar ju drejtua delegacionit shqiptar se populli i Kosovë do të ketë të drejtë të vendosë për fatin e vendit të vet në formë të referendimit. Për të gjithë ishte i qartë rezultati i referendimit. Ai do të ishte –pavarësia për Kosovën. Të gjetur në një situatë të vështirë u vendos që bisedimet të mos ndërpriten plotësisht por të shtyhen për më vonë pasi pala shqiptare të kryente konsultimet me opinionin publik në Kosovë dhe Komandantët e Zonave të Luftës. Në këtë periudhë ekzistonte një drojë se SHBA-të do t'i kthehen sistemit të veprimit si në Dejton, në bisedime të stilit shkop-karrotë me Beogradin dhe shqiptarët e Kosovës në formë të bisedimeve

³⁶⁴ Paskal Milo, *Ditari i një Ministri të Jashtëm*, (Tiranë: Toena, 2009) fq. 159

bilaterale përmes ndonjë misioni të ri të Riçard Hollbrukut.³⁶⁵ Gjatë periudhës deri në vazhdimin e Konferencës së Rambujesë edhe në nfrontin diplomatik edhe në terren në Kosovë dhe Serbi kishte lëvizje të mëdha. Më 10 mars 1999 Kristofer Hill dhe Riçard Hollbruk u takuan me Millosheviqin në Beograd dhe nuk patën sukses ta bindin ta nënshkruajë Marrëveshjen Përfundimtare për shkak të aneksit ushtarak të Marrëveshjes të cilin Serbia e refuzonte apriori e mbështetur nga Rusia. Shqiptarët e Kosovës u treguan shumë më pragmatikë. Duke patër se serbët nuk do ta pranojnë Marrëveshjen ata e pranuan Marrëveshjen në tërësi duke fituar përkrahjen e Aleatëve dhe duke ju afruar qëllimeve të largimit të Serbisë/RFJ-së nga Kosova.

Vazhdimi i Konferencës së Rambujesë u zhvillua në Paris më 15 mars 1999. Delegacioni shqiptar menjëherë theksoi se kishte ardhur për të përfunduar Marrëveshjen Kalimtare të paraqitur në Rambuje më 23 shkurt 1999³⁶⁶. Pala serbe erdhi me propozim plotësisht të ri politik dhe refuzonte nënshkrimin e Marrëveshjes sipas 23 shkurtit 1999. Në të njëjtën kohë përfaqësuesi rus Mayorski refuzoi të nënshkruajë Marrëveshjen e Parisit kështu që atë e nënshkruan vetëm pala shqiptare.

Konferenca e Rambujesë tregoi se kohezion në mes të SHBA-ve dhe Aleatëve në Grupin e Kontaktit nuk kishte pasur asnjëherë dhe se interesat e shteteve si Franca, Italia, Gjermania, Greqia si anëtare të NATO-s nuk ishin edhe aq të vendosura për veprime ushtarake kundër Serbisë siç ishin SHBA-të dhe Britania e Madhe. Dëmet të cilat do të krijohen nga këto paqartësi në mes të vendeve të NATO-s do të shihen gjatë fushatës së bombardimeve që filloi menjëherë pas përfundimit të përpjekjeve për arritje të marrëveshjes paqësore kalimtare. Sipas Hollbrukut problemi kryesor dhe arsyeja e dështimit të Rambujesë ishte mungesa e Millosheviqit. Por, sipas udhëheqësve të NATO-s Gjeneralëve Vesli Kllark dhe Klaus Naumman ishte pikërisht hapja e aneksit ushtarak në fund e jo në fillim të bisedimeve arstye e dështimit. Sipas tyre, po ta kishte të qartë që në fillim Millosheviqi se NATO është i

³⁶⁵ Marc Weller, *Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence*, (Oxford: University Press, Oxford 2009) fq. 135

³⁶⁶ Dario Malnar, *Sjedinjene Americke Drzave i Stvaranje Drzave Kosovo*, (Sveuciliste u Zagrebu, Fakultet Polickih Znanosti, 2012) fq. 225

pathyeshëm do të ishte më bashëpunues.³⁶⁷ Por, Millosheviqi vendosi të provokojë vendosshmërinë e NATO-s. CIA, në raportin e saj më 16 mars 1999 e kishte informuar Presidentin Clinton se Serbia po planifikonte një ofanzivë në shkallë të lartë në Kosovë. Sekretarja Allbrajt ishte e gatshme për dështimin e negociatave për të shpenzuar të gjitha opcionet që prolongojnë intervenimin ushtarak kundër Serbisë. Ideja e saj ishte se duhet dëshmuar se SHBA-të kanë bërë krejt çka është e mundur në nivelin diplomatik, edhe prezencën e saj fizike në bisedime, në mënyrë që të mos ketë më arsytetime për të mos intervenuar ushtarakisht.³⁶⁸ Në një prononcim shpjegues Presidenti Clinton kishte theksuar se Kosova është në qendër të Ballkanit, regjion me rëndësi të madhe strategjike për SHBA-të dhe Evropën. Për herë të parë Clintoni Kosovën e ka vënë në nivelin e rrezikimit të interesave amerikane, nëse nuk ndalet dhuna në Kosovë: 1. Kriza në rritje humanitare do të përhapet në vendet fqinje, 2. Ekziston rreziku i përhapjes së konfliktit dhe stabilitetit fragjil të rajonit duke përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë, Shqipërinë, Greqinë, dhe Turqinë.³⁶⁹

Megjithatë, ka edhe mendime se SHBA-të kanë pasur agjendë të qartë të intervenimit ushtarak ndaj Serbisë dhe rrëzimit të Millosheviqit nga pushteti pavarësisht nga Konferenca e Rambujesë dhe rezultati i saj. Sipas ithtarëve të kësaj teorie SHBA-të kanë përdorur ambiguitetin diplomatik nga teoria deri në praktikë. Kjo është vërejtur në mënyrën se si e kanë ndërruar formën e mbajtjes së Konferencës që fillimisht ishte e ngjajshme me atë të Dejtonit: palët negociatore dhe ndërmjetësuesit e izoluar detri në arritjen e Marrëveshjes, në atë bilaterale duke lejuar takime të ndara të Hillit dhe Hollbrukut me Millosheviqin në Beograd, të Thaçit me Adem Demaçin në Lubjanë. Çështja thelbësore në Konferencën e Rambujesë në fakt nuk ishte ndalja e konfliktit, së paku jo as për shqiptarët e as për serbët, por çështja e referendumit për të ardhmen e Kosovës pas tri vitesh të vetëqeverisjes dhe ithtarët e teorisë se SHBA-të kanë dashur medoemos ta bombardojnë Serbinë theksojnë se qëllimisht kjo çështje është

³⁶⁷ Klaus Naumann, <http://pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/interviews/naumann.html> (12.03.2013)

³⁶⁸ Marc Grossman, *Diplomacy before and after conflict, Prism 1, No. 4*, (Center for Complex Operations, 2010) fq. 5

³⁶⁹ President Clinton: A Commitment to Peace in Kosovo, The White House at Work Archives, March 19, 1999

futur në dokumentin përfundimtar.³⁷⁰ Delegacioni shqiptar ka qenë i vendosur që të mos e pranojë as shprehjen „vullneti i popullit“ por ka insistuar në termin „referendum“ me çdo kusht në fund të vetëqeverisjes trivjeçare. Për këtë qëndrim ata kanë pasur përkrahjen amerikane. Një ndihmës i afërt i Sekretares Allbrajt kishte deklaruar se për diplomacinë amerikane ka ekzistuar vetëm një qëllim : të fillohet lufta së bashku me evropianët. Por, diplomacia amerikane së pari i ka lënë evropianët dhe rusët që të harxhojnë të gjitha mundësitë e arritjes së paqes në mes të serbëve dhe shqiptarëve. Pastaj, diplomacia amerikane ka dramatizuar negociatat duke përfshirë vetë Sekretaren e Shtetit për të pasur alibi se zgjidhja pa luftë kundër Beogradit është e pamundshme dhe në të njëjtën kohë askush nuk mund t'i akuzojë diplomatët e SHBA-ve se po e fillojnë një luftë kundër një shteti sovran. Diplomacia e ambiguitetit e zbatuar mjeshhtërisht në Rambuje hapi rrugën për intervenimin e NATO-s të planifikuar muaj më parë dhe, paradoksisht, ishte pala serbe që me kryeneçësinë e treguar dhe besimin e plotë në Rusinë e plotësoi planin e SHBA-ve.³⁷¹

Dështimi i Konferencës së Rambujesë dhe informatat për planet e veprimeve të reja ushtarake serbe rezultuan me largimin e Misionit Verifikues të Kosovës drejt Maqedonisë përderisa edhe Misionet Diplomatike në Beograd filluan me tërheqjen e stafit të tyre diplomatik. Këto ngjarje ishin indikatorë të sigurtë se NATO do të ndërhyjë në Serbi.

SHBA-të megjithatë provuan edhe një herë me mjete diplomatike të ndalin veprimet ushtarake të Millosheviqit dhe ta bindin atë të pranojë Marrëveshjen e Rambujesë. Për këtë arsye me 22 mars 1999, vetëm dy ditë para fillimit të bombardimeve, Riçard Hollbruk udhëtoi në Beograd për ta takuar Millosheviqin. Hollbruku, pas konsultimeve me Pentagonin, Millosheviqit i dorëzoi ultimatumin se nëse nuk pajtohet me kërkesat amerikane sulmet do të jenë të menjëhershme, të forta, dhe të qëndrueshme. Më 23 mars 1999 Hollbruk u kthye në Bruksel për të informuar anëtarët

³⁷⁰ Drazen Pechar, *Diplomatic Ambiguity: From Power-Centric Practice to a Reasoned Theory*, (Zagreb: Polemos 8, 2005) fq. 163

³⁷¹ Drazen Pechar, *Diplomatic Ambiguity: From Power-Centric Practice to a Reasoned Theory*, (Zagreb: Polemos 8, 2005) fq. 168

e NATO-s se Millosheviqi nuk pranon asnjë kushtëzim. Administrata amerikane reagoi shpejtë duke bërë presion që bombardimet të fillojnë menjëherë. Në të njëjtën kohë Presidenti Clinton deklaroi publikisht se forcat tokësore amerikane nuk do të përdoren në këtë operacion ushtarak të NATO-s.³⁷² Sekretari Gjeneral i NATO-s Javier Solana urdhëroi Gjeneralin Vesli Kllark të fillojë me operacionin „Allied Force“. Pasi nuk kishte Rezolutë të Këshillit të Sigurimit për këtë veprim si arsyetim u përdor mospërbushja e dy Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për ndalimin e sulmeve ndaj civilëve shqiptarë dhe tërheqjes së forcave speciale policore serbe dhe atyre ushtarake të RFJ-së nga Kosova. Solana urdhëroi sulmet për të parandaluar katastrofën humanitare në Kosovë.³⁷³ Kështu, më 24 mars 1999 filluan sulmet ajrore të NATO-s mbi caqet në Serbi/RFJ

Pastrimi etnik i shqiptarëve nuk prodhoi rezultatin që e dëshironte sepse UÇK ende mbeti organizatë e aftë për të rezistuar. NATO nuk lëvizi nga kërkesat dhe nuk i ndali bombardimet. Përkrahja e Ruisë për RFJ-në venitej.³⁷⁴

Në fund, Millosheviqi kërkoi rrugëdalje nga një konflikt dhe krimet që i kishte nisur , për të cilat edhe u gjykua në Hagë, por për veten e tij jo për popullin e tij.

³⁷² CRS Report RL30374, Kosovo Lessons Learned from Operation “Allied Force”, by Paul E. Gallis.

Coordinator

³⁷³ Press Statement by Javier Solana 23 March 1999

³⁷⁴ Bruce R. Nardulli, *Disjointed war: military operations in Kosovo*, (Arlington: Rand 2002) fq. xiii

III.4 Operacioni *Allied Force*, ecuria e bombardimeve dhe Shqipëria gjatë krizës humanitare

Çdo operacion ushtarak ka problemet e veta dhe operacioni i NATO's "Allied Force" nuk ishte përjashtim si dhe nuk i arriti të gjitha caqet e përcaktuara. Por, me gjithë problemet që vështirësuan operacionin përfundimin ishte fitore e pastër e NATO-s. OAF ndaloi pastrimin etnikum të shqiptarëve të Kosovës dhe përjashtimin e tyre nga vendi i lindjes, detyroi tërheqjen e të gjitha forcave të RFJ-së nga territori i Kosovës detyroi autoritetet e Beogradit të pranojnë një forcë ushtarake multinacionale të huaj në Kosovë. Mund të thuhet edhe se me këto ngjarje NATO zvogëloi influencën e Millosheviqit në Serbi dhe, në një mënyrë ndihmoi në rrëzimin e regjimit të tij në vitin 2000.³⁷⁵ OAF ishte operacioni i parë ushtarak i NATO-s që nga themelimi dhe përpos tendosjeve në sistemin komandues kishte edhe tendosje në sistemin politik të organizatës në veçanti në sistemin e vendimmarrjes dhe komandimit.

Në studimin e çështjeve të intervenimeve humanitare gjenden gjithmonë dy elemente të pandara: koncepti universal i të drejtave të njeriut dhe lirive elementare dhe koncepti i sigurisë. Të kuptuarit e këtyre koncepteve dallon prej shtetit në shtet dhe derisa bashkësia ndërkombëtare të krijojë një qëndrim të qartë rreth asaj se çka është siguria, dhe për cilën siguri duhet të angazhohet dhe si, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore do respektohen diku më shumë e diku fare.³⁷⁶

Intervenimi humanitar është veprimi unilateral ushtarak me qëllim të arritjes së qëllimeve humanitare. Intervenimi i grupit të shteteve pa Rezolutën eksplicite të OKBS-së konsiderohet si veprim unilateral.³⁷⁷ Artikulli II i Kartës së Kombeve të

³⁷⁵ Bruce R. Nardulli, *Disjointed War: military operations in Kosovo*, (Arlington: Rand 2002) fqxiii

³⁷⁶ A. Grizold, *Humanitarna Intervencija-opet aktualno pitanje*, (Zagreb: Medjunarodne Studije, god III, nr 1, 2003)

³⁷⁷ Louis Henkin, *Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention*, (American Journal of International Law 1999) fq826

Bashkuara ndalon kërcënimin apo përdorimin e dhunës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të çdo shteti.³⁷⁸ Por, vetë Karta nuk i rregullon rastet kur shtetet krijojnë shkelje masive të njeriut ose gjenocid. Intervenimi humanitar arsyetohet me shpjegimin dhe analogjinë e artikullit 51 të Kartës së OKB-së që garanton të drejtë me vetëmbrojtjes nëse Këshilli i Sigurimit nuk mund të reagojë në rast agresioni apo gjenocidi.³⁷⁹ Gjatë vitit 1998 në Këshillin e Sigurimit janë miratuar dy rezoluta për Kosovën të bazuara në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, në të cilat Këshilli i Sigurimit ka konstatuar kërcënimin për paqen ndërkombëtare dhe sigurinë. NATO ka intervenuar në Kosovë për të ndaluar katastrofën humanitare të cilën e kanë pranuar Rezolutat e Këshillit të Sigurimit. Heshtja e Këshillit të Sigurimit ndaj bombardimeve të NATO-s është konsideruar si përkrahje e operacionit “Allied Force”. Disa autorë theksojnë se Rezoluta 1244/1999 faktikisht ratifikon aksionet e NATO-s dhe Këshillit të sigurimit sepse autorizohet një forcë e armatosur që mund të përdorë të gjitha mjetet” për të arritur qëllimet që nuk është tjetër përpos *post facto* lejim i fushatës ushtarake të NATO-s.³⁸⁰

Bombardimet e NATO-s zgjatën më shumë se që kishin paramenduar strategët amerikanë dhe aleatët, për rreth 78 ditë; gjatë kësaj fushate mbi 10.000 shqiptarë u vranë në Kosovë, ndërsa u depërtuan rreth 800.000. Ky element i parë i qëllimeve të NATO-s u arrit tek në fund të fushatës së bombardimeve. NATO po ashtu kishte për qëllim që të reduktojë fuqinë e forcave Serbe, por ato ju qëndruan me suksese sulmeve ajrore dhe mbetën gati në nivelin e njëjtë të paraluftës. NATO ishte e bindur se me disa ditë bombardimesh do të sillte palën serbe në tavolinën e bisedimeve dhe nuk ishte e përgatitur për fushatë të gjatë ajrore e lere më tokësore.

Pasi plani për të sjellë Millosheviqin të pranojë bisedimet para NATO-s u shfaq problem i fushatës së gjatë dhe të kushtueshme. Megjithatë disa parametra kishin vendosur në verën e vitit 1999, p.sh. SHBA-të dhe BE kishin deklaruar se nuk do të përdornin forcat tokësore. Planifikuesit e NATO-s ekskluzivisht u morën me

³⁷⁸ <http://www.un.org/eng/documents/charter> (27.11.2012)

³⁷⁹ Ruth Wedgwood, *NATO's Campaign in Yugoslavia*, (American Journal of International Law 1999)

³⁸⁰ Alain Perret, *La guerre du Kosovo-Le Fait rattrape par la droi*, (International Law Forum 1999) fq 164

mundësinë e fushatës ajrore që vetvetiu limiton rezultatet. Sepse, jo që NATO nuk kishte forcë të mposhte Millosheviqin por qëllimi ishte ta sillte atë përsëri në tavolinën e bisedimeve. Në fillim të vitit 1999 NATO miratoi Planin e sulmeve ajrore sipas fazave, faza 1 sulmet kundër armatimit ajror dhe kundërajror jugosllav, faza e dytë sulmet ajrore kundër forcave tokësore serbe në Kosovë, dhe faza e tretë nëse është e nevojshme luftimi i forcave armiqësore brenda RFJ-së.³⁸¹ Kjo strategji kishte mungesat e saj evidente, derisa në fazën e parë NATO mund të shkatërronte pikat e stacionuara dhe radarët, në fazat dy dhe tre forcat serbe ishin mobile dhe si rezultat lehtë i evitonin sulmet nga ajri. Nëse kombinojmë vendimin e Aleatëve për mos dërgimin e forcave tokësore, terrenin e papërshtatshëm në Kosovë, motin e keq, qëndrimin e komandës së NATO-s se aeroplanët luftarakë duhet të jenë larg mbrojtjes kundërajrore jugosllave, Plani i NATO-s për parandalimin e aktiviteteve të forcave serbe në terren kishte pak shans për sukses.

Në tri ditët e para të bombardimeve dy gjëra u vërejtën: Beogradi tërhoqi forca të mëdha për mbrojtje nga sulmet derisa përshkallëzoi vrasjet dhe deportimin e shqiptarëve të Kosovës. Duke parë këtë strategji Gjenerali Vesli Kllark kërkoi nga SHBA-të të vendosen në funksion helikopterët Apache , të dizajnuar për luftë posaçërisht të terreneve malore. Kërkesa e tij u aprovua por u vendos që helikopterët të vendosen në Shqipëri e jo në Maqedoni që vononte edhe më shumë veprimin e tyre. Po ashtu, Këshilli i Aleancës Veriatlantike deklaroi disa observime lidhur me Kosovën : të arrihet marrëveshje paqësore e krizës përmes bashkësisë ndërkombëtare për të promovuar stabilitet dhe siguri në vendet fqinje, me theks në Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Gjatë Operacionit Allied Force, aeroplanët e NATO-s kryen 38 400 fluturime luftarake, me 10 484 sulme. Operacioni kishte filluar si fazë e demonstrimit të forcës, por me kalimin e kohës sulmet u zgjeruan në Kosovë dhe vetë RFJ dhe Beograd. NATO përcaktoi qëllimet në përputhshmëri me deklaratat e dhëna në mbledhjen e

³⁸¹ Bruce R. Nardulli, *Disjointed War: military operations in Kosovo*, (Arlington: Rand 2002) fq. 3

jashhtëzakonshme të Paktit VeriAtlantik të mbajtur më 12 prill 1999³⁸², të përkrahur nga shefat e vendeve anëtare të NATO-s në takimin e mbajtur në Washington³⁸³ që përcaktuan kushtet për arritjen e paqes në Kosovë: 1. Ndërprerjen e të gjitha formave të dhunës, veprimeve ushtarake dhe represionit, 2. Tërheqjen e të gjitha njësisve ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova 3. Kthimin e pakusht të të gjithë refugjatëve dhe personave të shpërngulur dhe hyrjen e papenguar të organizatave humanitare. 4. Të arrihet korniza politike për marrëveshje për statusin e Kosovës në bazë të negociatave të Rambujesë në përputhshmëri me të drejtën ndërkombëtare dhe Kartës së OKB-së.³⁸⁴ Gjatë fushatës së bombardimeve filluan diskutimet në mes të Aleatëve për mundësinë e përdorimit të forcave tokësore. Spekulohej se Plani i paraqitur para Millosheviqit nga emisarët Ahtisaari dhe Çernomirdin ka mundur të pranohej më herët me kërcënimin e forcave tokësore. Mirëpo, Presidenti Clinton që në fillim e ka refuzuar këtë strategji dhe më 24 mars 1999 në fjalimin për popullin amerikan ua ka bërë me dije se nuk do të rrezikohen ushtarët amerikanë në Kosovë. Më 10 qershor, Sekretari i Përgjithshëm Javier Solana deklaroi se ka urdhëruar komandantit të përgjithshëm për Evropë ndaljen e përkohshme të bombardimeve, pas konsultimeve me Këshillin VeriAtlantik dhe pas marrjes së informatave se ka filluar tërheqja e forcave jugosllave nga Kosova. Me votimin e Rezolutës 1244/1999 u përcaktua mandati për vendosjen e forcave të NATO-s(KFOR) me përgjegjësi të ndërpresin çdo formë të armiqësisë, u vendos për demilitarizimin e UÇK-së si dhe krijimit të hapësirës së sigurt për kthimin e refugjatëve. Shpërndarja e forcave të KFOR-it po ashtu u dakordua që të bëhet në mënyrë të sinkronizuar me largimin e forcave policore dhe ushtarake serbe. Me këtë rast Sekretari Gjeneral deklaroi përfundimin e fushatës së bombardimeve pas arritjes së “Marrëveshjes së

³⁸² NATO, Statement Issued at the Extraordinary Ministerial Meeting of the North Atlantic Council at NATO HQ, Press Release M/NAC/1(99)51, 12 prill 1999

³⁸³ NATO, Statement on Kosovo Issued by the Heads of State and Government Participating in the Meeting of the North Atlantic Council in Washington D. C. on 23rd and 24th April 1999, Press Release S-1(99)62, 23 April 1999

³⁸⁴ H. Krieger (ed), *The Kosovo Conflict and International Law, an Analytical Documentation 1974-99*; Cambridge International Series, Vol 11, (Cambridge University Press 2001) fq. 287

Kumanovës”³⁸⁵. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ka përfunduar operacioni “Allied Force” dhe ka filluar operacioni “Joint Guardian” për sigurinë dhe mbrojtjen e Kosovës nga forcat e NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm Javier Sollana pas përfundimit në dokumentin “Situata në Kosovë dhe rreth saj”³⁸⁶ ka shpjeguar pse ka vendosur të urdhërojë NATON pa Rezolutë specifike të OKB-së. Në mesin e pikave kryesore Sollana ka numëruar: 1. Dështimin e RFJ-së të përmbushë Rezolutat 1160/1998 dhe 1199/1998, 2. Katastrofa e pashmangshme humanitare që i kërcënohej Kosovës që është e dokumentuar në raportin e Sekretarit Gjeneral të OKB-së Kofi Annan më 4 shtator 1998, 3. Pamundësinë e votimit unanim në Këshillin e Sigurimit për Rezolutën që do të autorizonte forcën. 4 fakti që Rezoluta 1199/1998 vërteton se përkeqësimi i situatës në Kosovë konstituon kërcënim për paqen dhe sigurinë e regjionit.³⁸⁷

Sipas Marrëveshjes së Kumanovës RFJ duhej që pa kushte të tërhiqte të gjithë ushtarët, armatimin, dhe teknikën ushtarake brenda 11 ditëve si dhe : ushtarët e rregullt, ushtarët e forcave të aviacionit, grupet e armatosura civile, grupet ushtarake, gardën nacionale, ushtrinë kufitare dhe policinë, ushtrinë rezervë, policinë ushtarake, policinë federative dhe republikane, njësitë anti-terroriste, shërbimet e informimit si dhe çdo njësi tjetër apo individ për të cilët vendosë komandanti i KFOR-it. Afati kohor ishte i përcaktuar në atë mënyrë që të mos ketë vakuum të sigurisë në Kosovë. Në pjesën e tërheqjes së trupave jugosllave Kosova u nda në tri zona jug, qendër, veri. Vetëm pasi u vërtetua se forcat serbe janë tërhequr edhe nga zona veri bombardimet janë ndalur plotësisht.

Territori i Kosovës u nda në zona të përgjegjësisë nga Aleatët: Anglia, Franca, Italia, SHB-të, Gjermania morën përsipër këtë detyrë të përkrahura nga anëtarët e tjerë të vendeve të NATO-s.

³⁸⁵ Letter from the Secretary General Addressed to the UN Secretary General, 20 June 1999; UN Doc.S/1999/702. Annex, 21 June

³⁸⁶ Statement Issued at the Extraordinary Ministerial Meeting in North Atlantic Council held at NATO HQ

³⁸⁷ Catherine Guicherd, *International Law and the War in Kosovo*, (Survival 41 summer 1999) ff. 27-28

Posaçërisht ishte interesant roli i Rusisë në kapitullimin e RFJ-së. Rusia nuk mori asnjë zonë të përgjegjesisë sepse nuk kishte marrë pjesë në bisedimet në Kumanovë. Asnjë dokument i nënshkruar nga palët nuk e parashihte ndonjë rol të Rusisë, Për këtë arsye Qeveria ruse refuzoi që forcat e saj të jenë nën komandën e NATO-s dhe propozoi zonë të posaçme ku NATO nuk do të kishte injerenca. Më 11 qershor, një ditë para hyrjes së NATO-s në Kosovë, forcat ruse të stacionuara në Bosnje dhe Hercegovinë me një aksion spektakular nëpër territorin e Serbisë hynë në Kosovë përkatësisht okupuan aeroportin e Prishtinës. Qëllimi i tyre ishte që të batin 2500 parashutistë rusë në Kosovë së bashku me armatim dhe teknikë. Mirëpo, Hungaria, Rumania, dhe Bullgaria nuk lejuan kalimin e aeroplanëve rusë nëpër hapësirën e tyre ajrore kështu që rusët hoqën dorë nga zona e tyre ekskluzive e përgjegjesisë.³⁸⁸ Incidenti i përkeqësoi raportet NAYO-Rusi që u rregulluan pastaj më 18 qershor në Marrëveshjen e Helsinkit.³⁸⁹

Dy momente të tjera kanë qenë shumë të rëndësishme për suksesin e operacionit “Allied Force”. Një është përkrahja e Republikës së Shqipërisë dhënë shqiptarëve të Kosovës si dhe fitorja e luftës mediale në mes të Aleatëve të NATO-s kundër propagandës së Beogradit.

Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë, Anastas Angjeli, në një tekst autorial shpjegoi gjendjen e rëndë që po e përjetonte Shqipëria si rezultat i krizës në Kosovë.³⁹⁰ Angjeli theksoi se deri në maj 1999 Shqipëria kishte pranuar 450.000 refugjatë nga Kosova ndërsa atëherë spekulohet se Beogradi nuk do të ndalet deri sa t’i dëbojë 700.000 shqiptarë të Kosovës në Shqipëri dhe rreth 300.000 në Maqedoni.

³⁸⁸ Prezenca ruse në Kosovë është e finalizuar në “Marrëveshjen për pjesëmarrjen ruse në forcat e KFOR-it” të arritur në qershor 1999 që parashihte një batalion apo dy batalione ruse të stacionuara në sektorin amerikan, si dhe në atë gjerman dhe francez. Numri i ushtarëve rusë ishte i reduktuar në 2616. Në sistemin komandues të KFOR-it rusët mund të ushtronin komandë vetëm mbi trupat e tyre

³⁸⁹ H. Krieger (ed), *The Kosovo Conflict and the International Law, an Analytical Documentation 1974-99*, Cambridge International Series Vol 11 (Cambridge University Press 2001) fq. 531

³⁹⁰ Anastas Angjeli, *The political impact and economic cost to Albania of the Crisis in Kosovo*, (Mediterranean Quarterly 10.3 (1999) fq7-14

Qeveria e Shqipërisë dhe Parlamenti patën votuar njëzëri që të lejojnë shfrytëzimin e hapësirës tokësore, ajrore dhe detare NATO-s në luftë me RFJ-në.

Në planin ushtarak Serbia dhe Shqipëria ishin gjithnjë në gjendje gatishmërie për shkak të Kosovës. Në vjeshtën e vitit 1997 forcat ushtarake policore serbe filluan të bëhen më të pranishme në afërsi të kufirit me Shqipërinë.³⁹¹ Përmes stërvitjeve të shpeshtuara në afërsi të kufirit dhe demonstrimeve, hapur jepnin sinjalin e prishjes së “qetësisë” në kufirin midis dy shteteve, si dhe paralajmëronin ngjarje të pritshme për shtypjen me dhunë të çdo kërkesë të shqiptarëve të Kosovës. Shteti dhe qeveria shqiptare ndiqte me vëmendje të madhe të gjitha zhvillimet. Në kuadër të ndjekjes së situatës, ushtria kishte pjesën e vet jo të vogël të përgjegjësisë. Së pari për sigurinë e kufirit. Së dyti, por jo se ishte arsye e dytë, në aspektin njerëzor, populli që vuante nga makina ushtarako-policore serbe ishte popull shqiptar. Konsiderohej shumë e mundshme se mund të kishte shpërngulje të detyrueshme, por edhe të vullnetshme të popullsisë shqiptare të Kosovës dhe Shqipëria do të ishte vend pritës. Për këtë do të duheshin masa paraprake, të mbështetura në një planifikim të kujdesshëm, në pikëpamje njerëzore, por edhe të burimeve.³⁹² Ushtria, do të ushtronte përgjegjësitë e saj dhe do të përballonte barrë të konsiderueshme, madje më shumë nga institucione të tjerë. Së treti, Shqipëria do të koordinonte kontributin e saj me organizmat ndërkombëtarë dhe në aspektin ushtarak edhe me Aleancën e NATO-s. Pikërisht koordinimi ushtarak në përputhje me vendimet që do të merrte Aleanca, do të kalonin kryesisht te Ministria e mbrojtjes dhe Ushtria. Në mënyrë të padiskutueshme,

³⁹¹ Lama Kudusi, *Kosova dhe Ushtria Çlirimtare*, Tiranë, 2005, f. 301

³⁹² Që në vitin 1992 në Shqipëri ishte krijuar organizëm i përcaktuar për t'u marrë me planifikimin e pritjes së refugjatëve nga Kosova. Qeveria e drejtuar nga Aleksandër Meksi në vitin 1992 me vendim të veçantë kishte krijuar Komitetin Ndërdikasterial për Refugjatët me përfaqësues nga disa dikastere. Ministria e Mbrojtjes ishte pjesë e Komitetit. Ishte vendosur një bashkëpunim i ngushtë me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë. U organizuan një sërë udhëtimeve në terren, koordinime e bashkëpunime me autoritetet e pushtetit lokal në qarqet e rrethet e Kukësit, Tropojës, Hasit, Dibrës, Librazhdit, etj. Detyrimet më të mëdha gjatë viteve 1992 deri në vitin 1999 i patën plotësuar strukturat ushtarake, pra ministria e mbrojtjes dhe ushtria shqiptare. Ndërkohë, në vitin 1996, për refugjatët u krijua një strukturë e posaçme në Ministrinë e Rendit Publik e të Pushtetit Lokal.

përgjegjësia politike e koordinimit e bashkëveprimit të brendshëm dhe ndërkombëtar do të ushtrohej nga lidershpi i shtetit dhe qeverisë shqiptare.³⁹³

Vitet 1998-1999 për Ushtrinë e Shqipërisë shënojnë angazhim ushtarak të përhershëm për sigurinë e kufijve, mbajtjen në kontroll të situatës, ruajtjen e popullsisë në territorin e shtetit të Shqipërisë dhe pasjen në funksionim të masave të pritjes së refugjatëve nga Kosova. Pavarësisht nga vështirësitë me të cilat përballëshin ushtria dhe njësitë ushtarake shqiptare në atë periudhë, ushtarakët shqiptarë pasqyruan realisht potenciale intelektuale e profesionale, gjendje të lartë moralo psikologjike, përvojë e vendosmëri për të bërë çdo sakrificë për interesat e mbrojtjes së vendit.³⁹⁴ Duke filluar nga fundi i vitit 1997 e në vazhdim, përfshi gjithë vitin 1998 dhe gjysmën e vitit 1999 kufiri në veri lindje të Shqipërisë ishte përherë nën kërcënim. Serbia kërkonte me çdo kusht që përmes provokimeve e incidenteve në kufi të përfshinte Shqipërinë në konflikt, duke synuar kështu ndërkombëtarizimin e problemit në kahjen e të emërtuarit si konflikt ndërshtetëror dhe të fitonte mbështetje ndërkombëtare e të kishte duart e lira në Kosovë.³⁹⁵ Por shteti shqiptar politikisht dhe nga vetë populli shqiptar nuk u bë viktimë e këtij synimi të Serbisë. Njësia ushtarake e ushtrisë shqiptare në Kukës,³⁹⁶ si dhe të gjithë njësitë e tjera që vepronin në zonën e përgjegjësive të divizionit të Kukësit treguan profesionalizëm, përkushtim, ndjenjë sakrifice, por edhe aftësi në menaxhimin e situatës. Profesionalizmi dhe aftësia luftarake, shoqëruar me vetëpërmbytje, bënë që kufiri shqiptar të mos shndërrohej në tregues i konsiderimit të konfliktit në Kosovë, si konflikt midis Serbisë dhe Shqipërisë.

Sa më sipër, Shqipëria nuk ka vepruar më vehte. Ajo është konsultuar, ka koordinuar e bashkëpunuar me faktorin ndërkombëtar. Në këtë kuadër, bashkëpunim me Aleancën e NATO-s dhe me SHBA-të ka qenë i përhershëm. Koordinimi e bashkëpunimi ushtarak midis SHBA-ve e Shqipërisë në këtë periudhë u shtri në të gjithë nivelet, në

³⁹³ Intervistë me Z. Pëllumb Qazimi, ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, Zagreb, 12.09.2012

³⁹⁴ Abazi Sulejman Dr. *Psikologjia e Ndryshimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2001, f. 138

³⁹⁵ Lama Kudus, *Kosova dhe Ushtria Çlirimtare*, Tiranë, 2005, f. 91

³⁹⁶ Divizioni i dytë i këmbësorisë

atë politik, pra ndërmjet vendimmarrësve, ashtu dhe në atë ushtarak, përfshi ministrinë e mbrojtjes e shtabin e përgjithshëm. Por, pa harruar edhe nivelin mes njësave ushtarake. Takimet dhe shkëmbimet e informacionit për gjendjen në rajon, gjendjen rreth kufirit të Shqipërisë e më gjerë, kanë qenë mëse normale e të zakonshme. Dhe kjo kishte arsytet e veta. Së pari shumë pranë Shqipërisë, madje në vazhdim të territorit të Shqipërisë, në treva shqiptare masakrohej popull shqiptar nga makina ushtarake e policore e Milosheviqit. Së dyti, në Kosovë kishte filluar një lëvizje që nuk kishte të ndalur dhe ndaj saj nuk mund të qëndrohej indiferent. Së treti, jo vetëm që populli në Kosovë po martirizohej, jo vetëm që vendosmëria për t'u çliruar nga pushtimi serb nuk kishte të ndalur, por rreziku i shtrirjes së konfliktit ishte gjithnjë e më i mundshëm. Në këto kushte për SHBA-të ishte e papranueshme dhe e pakuptueshme të mos ndërhynte. Po kështu edhe për Evropën dhe sidomos për Aleancën e NATO-s. Pra, koordinimi e bashkëpunimi midis Shqipërisë e SHBA-ve në këtë periudhë ka qenë i rregullt dhe përfshinte të gjithë aspektet e njohjes më të mirë të gjendjes e po kështu edhe vendimmarrjen për hapa praktikë në aspektin ushtarak.³⁹⁷ Nuk ka pse të fshihet. Bashkëpunimi ka qenë shumë planësh e shumë drejtimësh. Kosova e tërë po digjej. Në të kishte shpërthyer lufta kundër okupatorit. Situata humanitare përmes qindra mijëra njerëzish, fëmijë, të moshuar, gra, po linin Kosovën dhe shkonin në drejtim të Shqipërisë, Maqedonisë e gjetkë po shkallëzohej gjithnjë e më shumë, madje me pasoja të paimagjinueshme. Siguria e kufijve të Shqipërisë ishte e kërcënuar. Kështu, nuk ka asnjë dyshim se bashkëpunimi ka qenë edhe në aspektin informativ për të ndjekur e njohur të gjithë zhvillimet ushtarake në Kosovë, por edhe jashtë saj, të gjitha zhvillimet e ndryshimet e forcave ushtarake policore të Serbisë në kufi me Shqipërinë e më shumë se kaq. Këto janë mëse normale të ndodhin. Ashtu sikundër edhe ndihma logjistike përsëri është e nënkuptuar. Ndoshta detaje të tjera për këtë çështje i takojnë një kohë tjetër.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe shkëmbime zjarri në mes të forcave serbe dhe Ushtrisë Shqiptare.³⁹⁸ Patjetër që ka pasur. Ato janë shtrirë në kohë, por edhe në hapësirë. Përgjatë gjithë kufirit të Shqipërisë me Kosovën ka pasur konfrontime

³⁹⁷ Intervistë me Z. Pëllumb Qazimi, ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, Zagreb, 12.09.2012

³⁹⁸ Intervistë me Z. Pëllumb Qazimi, ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, Zagreb, 12.09.2012

ushtarake. Hapësira e përplasjeve ka prekur rrethin e Tropojës, të Hasit e të Kukësit. Në një hark kohor prej 22 muajsh shkëmbimet, konfrontimet kanë qenë prezente. Disa që mund të përmenden do të ishin 6 ballafaqime ushtarake në rajonin e Padeshit, pa përmendur betejën për Kosharen në Kosovë, 3 në Kamenicë, 3 në Zherkë, 2 në Stoberdë, 9 në Qafën e Rrushit, 3 në Dobrunë, 4 në Pogaj dhe 2 në Morinë.³⁹⁹ Në të gjitha rastet ishin forcat ushtarake serbe të parat që provokonin, që kërkonin ballafaqimin ushtarak, që shkaktonin incidentet në kufi, apo hynin në brendësi të territorit të Shqipërisë. Mandej të mos neglizhohet fakti që brenda territorit të Shqipërisë pala serbe disa herë ka bombarduar, si dhe ka minuar pjesë të tëra territori përgjatë kufirit dhe brenda territorit të Shqipërisë. Kështu, minimet përveç se kanë qenë dukuri e zakonshme në territorin e Kosovës, ato u realizuan nga ushtria serbe edhe përgjatë vijës së kufirit e brenda territorit të Shqipërisë. Cilat kanë qenë rrjedhojat, ose pasojat? Së pari, njësitë ushtarake shqiptare së bashku me popullsinë vendase i janë përgjigjur në të gjitha rastet provokacioneve e incidenteve ushtarake serbe, duke mos lejuar që lufta në Kosovë të shndërrohej në luftë ndërshtetërore midis ish Jugosllavisë e Shqipërisë. Shmangia e kësaj dukurie ishte me rrjedhoja shumë pozitive, pasi Serbia donte të rikthente rrjedhën e luftës, të tërhiqte vëmendje në favorin e vet. Por po të flitet për pasojat, atëherë duhet pranuar se ka pasur humbje jetë njerëzish e gjymtime, dëmtime në masë të bagëtive e dëmtime të banesave të qytetarëve. Jeta e qytetarëve ishte për një kohë jo të shkurtër e kërcënuar. Ndërkohë, kuptohet lehtë se ekzistenca e rajoneve të minuar, të cilët nuk ishin të paktë, ka penguar e vështirësuar jetën e banorëve. Kjo pasiguri nën kërcënimin e minave, ka vazhduar për vite të tëra pas luftës së Kosovës. Gjithashtu, çminimi i këtyre zonave ka kërkuar kohë, njerëz dhe shpenzime, angazhim të Shqipërisë, por edhe mbështetje ndërkombëtare.

Lufta për Kosovën nuk bëhej vetëm në terren por edhe në sytë e opinionit publik. Me fillimin e bombardimeve Millosheviqi përjashtoi gazetarët perëndimorë, ata që u zgjodhën të mbesin në Serbi mbaheshin të izoluar. Për gati një muaj të gjitha xhirimet televizive ishin të televizionit të Beogradit, ndërsa zyrtarët për media të NATO-s nuk

³⁹⁹ Lama Kudusi, Kosova dhe Ushtria Çlirimtare, Tiranë, 2005, f. 302-303

kishin të tregonin më shumë se numrin e fluturimeve sulmeve etj. Të fituarit e opinionit publik ishte shumë me rëndësi për Kryeministrin Britanik Toni Bler i cili kishte investuar shumë moralisht në përkrahje të kërkesave të shqiptarëve. Bler detyrën e promovimit të Kosovës në mediat angleze ia dorëzoi mikut dhe aleatit Alister Kembell i cili krijoi ekip në Londër dhe Bruksel në mënyrë që lajme nga Kosova dhe për Kosovën të ketë çdo orë.

Po ashtu, duke parë se Presidenti Clinton është në problem të brendshme kjo situatë ishte rast i rrallë që Britania e Madhe të jetë më e zëshme dhe më e dëgjuar se partnerët e saj në anën tjetër të Atlantikut. U forcua retorika dhe paraqitja e figurave kryesore në publik. Më 25 Mars Lord Robertson në një artikull në të përditshmen “Daily Mirror” kishte shpjeguar se NATO nuk ka detyrë mëme rëndësi se të mposhtë RFJ-në, Ministri Robin Cook në televizion kishte theksuar se :do të shkojmë deri në fitore të plotë. Më 11 prill Toni Bler e quajti Millosheviqin “njeri të ligë”, më 19 prill bëri thirrje që NATO duhet të qëndrojë unike. Robin Cooke bëri analogjinë e Luftës për Kosovën me Luftën kundër Frankistëve të Spanjës, sepse pjesëmarrja e anëtarëve të Partisë Labor në Luftën Civile Spanjolle ishte e madhe. Në një intervistë më 27 prill 1999 Cook kishte deklaruar se “Serbia e sotme është Spanja e dikurshme frankiste. “Jam absolutisht i bindur se po e luftojmë të ligën. Nuk ka konflikt në mes të vlerave tradicionale të të majtëve. Po e shohin lindjen e fashizmit në Evropë. Kemi parë trena që dëbojnë gra e fëmijë nga shtëpitë e tyre dhe dëbohen si në kohën e Hitlerit dhe Stalinit.⁴⁰⁰

Në të vërtetë shkuarja e Alister Kembellit në Zyrën e Mediave të NATO-s ishte vendim i Clintonit dhe Blerit. Strategjia e tij ishte e thjeshtë, duhej krijuar program televiziv me informata nga Komanda e NATO-s, Washingtoni, Gjenerali Klark apo zëvendësi i tij Gjenerali Naumann duhej së paku një herë në ditë të përgjigjeshin edhe në pyetjet me të vështira. Blair shkëlqeu në Samitin e 50 të NATO-s në Washington sepse porosia e tij ishte e qartë. Ai nuk po e shtynte një vijë të fortë për Kosovën por po “I ndryshonte rregullat se si Aleatët do t’i trajtonin konfliktet në shekullin XXI”,

⁴⁰⁰ Cook Declares War on Fascim fq. 8

pra “me një doktrinë të re të bashkësisë ndërkombëtare.”⁴⁰¹ Publicitetin e fushatës për Kosovën e përdorën edhe politikanë të tjerë si Javier Solana që deklaroi se “Në kundërshtim me kritikën që kemi fushatë ajrore ka arritur secilin qëllim që kemi pasur. Duke e parë se Aleatët janë të qëndrueshëm Millosheviqi u dorëzua më 3 qershor dhe i pranoi kushtet tona ndërsa në nuk e humbëm asnjë ushtar. Një katastrofë humanitare u evitua. Afër një milionë refugjatë mund të kthehen të sigurt në shtëpitë e tyre. Pastrimi etnik është kthyer në proces kthimi.”⁴⁰² Përfundimisht edhe njeriu ndoshta më i filmuar i kohës, Jamie Shea, zëdhënësi i NATO-s deklaroi:” Nuk mendoj se mediet mund t’i fitojnë konfliktet, por e di se një fushatë e pangjyër mund t’ua humbë konfliktin me siguri.

Ajo që opinioni e ka ditur për 78 ditë është përshkruar në këtë kapitull, dhe, në esencë, ka qenë vështirë për të qenë indiferentë ndaj asaj që po ndodhë në Kosovë në këtë periudhë. Në të njëjtën kohë emisarë nga SHBA-të dhe Rusia kanë qenë në kontakt permanent për ta bindur të ndalojë luftën dhe t’ju kthehet bisedimeve.

⁴⁰¹ International Herald Tribune 24-25 prill 1999

⁴⁰² Solana, “Nato’s Success in Kosovo”, fq. 118

KAPITULLI IV

FUNDI I INTERVENIMIT TË NATO-S DHE GJENDJA POST-NATO

IV.1. Përpyjekjet diplomatike amerikane dhe ruse për përfundimin e bombardimeve

Për të shpjeguar pse Millosheviqi ka menduar se mund t'i bëjë ballë Aleancës më të fortë global NATO-s vështirë se mund të gjendet shpjegim logjik. Por, Millosheviqi ka qenë gjithherë i fortë taktikisht dhe ka pasur në dorë aparatin shtetëror, ka pastruar Ushtrinë Jugosllave nga jo-serbët dhe ndonëse nuk ka qenë fare besimtar e ka kombinuar psikologjinë e hegjemonisë që ka populli serb me udhëheqësit e Kishës Ortodokse në krye me Patrikun Pavle.

Millosheviqi e ka refuzuar Marrëveshjen e Rambujesë për shkak të aneksit ushtarak, po ashtu shërbimi i tij inteligjent e ka udhëzuar se vetë bombardimet janë sa për të mos humbur Clintoni dhe Bleri kredibilitetin sepse në fakt do t'u kushtojnë më shumë se sa që i bëjnë dëm Serbisë⁴⁰³ Millosheviqi mendonte se me shpërnguljen e shqiptarëve do të zhdukte UÇK-në e me të edhe arsyen për të pasur punë më me ndërkombëtarët. Po ashtu, ai ishte keq i informuar se Rusia do ta ndihmonte për të ndaluar bombardimet. Me kalimin e kohës të gjitha këto supozime do të testoheshin por nuk do të sillnin rezultat. Millosheviqi përzuri deri 750.00 shqiptarë të Kosovës por ata u ndalën në Shqipëri dhe Maqedoni ,pra në prag të Kosovës. Masakrat dhe mizoritë që kryenin njësitë e tij vetëm sa e forcuan bindjen e NATO-s dhe SHBA-e në

⁴⁰³ Stephen T. Hosmer, *Why Milosevic Decided To Settle when he did*, (Arlington: RAND 2001) fq. xiv

veçanti se më nuk duhet llogaritur në Ballkan në të ardhmen. Përkrahja nga Rusia i erdhi vetëm në formë deklarative sepse Jelcini ishte më i interesuar në interesat ekonomike të Rusisë se sat ë hyjë në problemet e Ballkanit. Në fillim të bombardimeve populli serb ishte unik dhe patriotik, mirëpo vala e parë e bombardimeve nuk kishte goditur infrastrukturën dhe Serbinë, por vetëm mjetet ushtarake. Në muajin e dytë serbët filluan të kuptojnë se dy gjëra do të ndodhin: ose do të intervenojë NATO me trupa tokësore, ose UÇK do të lidhte Shqipërinë me Kosovën.

Në të njëjtën kohë që ushtria amerikane që udhëheqë NATON bombardonte Serbinë, në të njëjtën kohë kërkonte mënyra diplomatike për të gjetur zgjidhje për të sjellë Millosheviqin në tavolinën e bisedimeve. Amerikanët e kujdesshëm këtë detyrë ia dhanë diplomatit finlandez Marti Ahtisaari,⁴⁰⁴ Rusët kishin zgjedhur Viktor Çernomirdinin dhe ai e kishte pranuar detyrën. Strobe Talbot ishte diplomat me karrierë të gjatë dhe njohës i mirë i çështjeve ruse. Ai ishte i bindur se përpos suksesit që mund të arrihet te Millosheviqi me siguri do të relaksohen raportet NATO-Rusi dhe SHBA-Rusi. Millosheviqi i kishte provuar bombardimet e serbëve në vitin 1995, edhe negociatat e imponuara në Dejton. Sipas Ahtisarit tani ishte më ndryshe, bombardohesh vetë Serbia ndërsa në palëkundshmërinë e Millosheviqit kishte ndikuar edhe fakti që zgjidhja e mundshme duhet ta ketë së pari përkrahjen e shqiptarëve të Kosovës e pastaj Serbëve. Sipas shënimeve të tij, Ahtisaari së pari në tetor 1998 udhëtoi në Shkup për t'u takuar me Presidentin Gligorov dhe Ambasadorin Hill. Gligorovi ishte i brengosur sepse lufta e hapët ju konvenonte vetëm serbëve , kroatëve dhe shqiptarëve dhe se Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina do të pushonin së ekzistuari. Ambasadori Hill tregoi si vijon: Operacionet ushtarake të Serbisë në Kosovë në ditët e fundit e kanë ngushtuar UÇK-në, lëvizje kundërshtuese e shqiptarëve të armatosur. Perëndimi është i obliguar t'i japë Millosheviqit ultimatum me qëllim që Serbia të mos përdorë më dhunë në Kosovë. Edhe Millosheviqi edhe lëvizja kundërshtuese në Kosovë janë vrasës të pafytyrë dhe vetën veprimet e përbashkëta të Perëndimit dhe

⁴⁰⁴ Më 5 maj 1999 Zwwendwsi i Sekretarit tw Shtetit Strobe Talbot kishte kontaktuar Ahtisarin pwr mundwsinw e negociimit; Marti Ahtisaari, *Detyra nw Beograd*, (Prishtinw: Trend 2000) fq. 9

Rusisë mund ta parandalojnë një luftë të mirëfilltë.⁴⁰⁵ Përpos SHBA-ve dhe Rusisë dhe OKB caktoi emisarët diplomatikë për të provuar të merren vesh me Millosheviqin. Sekretari Gjeneral i OKB-së Kofi Annan kishte emëruar Ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovakisë Eduard Kukan dhe ish-Kryeministrin Suedez Karl Bildt si përfaqësues të OKB-së në proces.⁴⁰⁶ Millosheviqit duhej bërë qartë se makineria e NATO-s nuk ndalet deri sa ky t'i pranojë kushtet e negociatave e kjo do të thoshte se ishte detyrë e Rusisë të bindë Millosheviqin. Në të njëjtën kohë OKB dhe Annan ishin disi të mllëfosur që SHBA dhe Britania e Madhe e kishin nisur një proces pa Rezolutë të qartë të OKB-së. Dallimet Talbot Çernomirdin ishin gati të pakalueshme. Pala amerikane si parakusht për të biseduar për fatin e Millosheviqit kishin tërheqjen e ushtrisë, policisë dhe administratës serbe në Kosovë. OKB kishte marrë përsipër organizimin e brendshëm të Kosovës, pas tërheqjes së serbëve, OSBE rolin e ndërtimit të administratës së re, policisë etj. Tani duhej hapur rruga për Kosovën e pasluftës.

Në Samitin e G8 u miratuan 7 pika bazë që do të shërbejnë edhe në hartimin e Rezolutës 1244. Ato parime ishin:

1. Ndalja e menjëhershme dhe e vërtetueshme e dhunës dhe e shtypjes në Kosovë
2. Tërheqja e forcave ushtarake, policore, paramilitare nga Kosova
3. Vendosja e trupave efikase ndërkombëtare civile dhe ushtarake në Kosovë. Për këtë të vendosë OKB-ja
4. Ndërtimi i Administratës së përkohshme në Kosovë, sipas vendimit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së
5. Kthimi i sigurt dhe i lirë i të gjithë refugjatëve dhe i të pastrehëve në vendlindjen e tyre dhe hyrja e pakufizuar e organizatave humanitare në Kosovë
6. Fillimi i procesit politik, me qëllim që të krijohen themelet për Kosovën autonome, në bazë të Marrëveshjes së Rambujesë dhe duke i marrë parasysh kërkesat e Jugosllavisë për paprekshmërinë territoriale
7. Vendimmarrja e përgjithshme për ekonominë dhe stabilitetin e rajonit.

⁴⁰⁵ Marti Ahtisaari, *Detyra në Beograd*, (Prishtinw: Trend 2000)

⁴⁰⁶ Marti Ahtisaari, *Detyra në Beograd*, (Prishtinw: Trend 2000) fq. 39

Për Millosheviqin kryesore ishte që në proces vendimmarrës të ishte Rusia dhe që çdo dokument të bëhet përmes OKB-së ku rusët kanë më shumë ndikim. Po ashtu, Çernomirdinin ishte i bindur se edhe NATO do të pranojë një Rezolutë të tillë nëse roli i sigurisë së jashtme dhe të brendshme i Kosovës kalon në duart e tyre. Amerikanët do të pajtoheshin që pas një kohe një grup i caktuar i serbëve do të mund të ktheheshin në Kosovë të paarmatosur për detyra teknike por tërheqja e forcave të armatosura është parakusht. Në këtë takim me Talbotin, Ahtisaari kishte dhënë edhe një mendim interesant: është mirë t'u shpjegohet serbëve, apo më Millosheviqit që kjo është përpjekja e fundit për të ruajtur Kosovën pjesë të Serbisë. Çdo prolongim favorizon UÇK-në që është faktor i paparashikueshëm në këtë ekuacion. Sipas një miku tim gjysma e UÇK-së janë nazistë e gjysma tjetër stalinistë.⁴⁰⁷ Talbot ishte takuar edhe me Presidentin Ibrahim Rugova në Bon, dhe ndonëse i dinte mirë pozitën e shqiptarëve kishte nevojë edhe për një perspektivë. Talboti dallonte tri rryma kryesore të shqiptarëve. E para, ekstremistë të përfaqësuar nga UÇK-ja, që në vetë kishte një grup banditësh që kryenin terror të vërtetë. Njerëz të tillë ka në çdo pikë të nxehtë të botës. Pikërisht ekstremistët e UÇK-së, në fillim të vitit 1998, kishin provokuar përplasje me armë me policinë serbe, kishin shkaktuar një seri shpërthimesh në qytetet maqedonase, Gostivar, Kumanovë, Prilep. Ata e kuptonin vetëm gjuhën e forcës. Njerëz të tillë zakonisht shfrytëzohen dhe armatosen nga ajo palë të cilës i intereson përhapja e tensionit dhe në thelb janë marioneta. Nuk kishte asnjë kuptim të zhvilloje bisedime me ta. Rruga e dytë, ishte e lidhur me të ashtuquajturën “Qeveri e Kosovës në Mërgim” me në krye Bujar Bukoshin. Kjo “qeveri” ishte instaluar në Gjermani (Ulm) dhe kishte influencë të madhe të shqiptarëve jashtë atdheut. Pikërisht përmes kësaj “qeverie” në mërgim kalonin mjete financiare të mëdha për mbështetjen e separatistëve, e ndërmjet tyre edhe ato që nxirreshin nëpërmjet tregtisë së paligjshme të armëve dhe narkotikëve.

Dhe, në fund, rryma e tretë, ajo politike. Përkrahësit e saj ishin bashkuar rreth Lidhjes Demokratike të Kosovës me në krye Ibrahim Rugovën. Lidhja shprehej për arritjen e pavarësisë me mjete politike. Kur ekstremistët filluan të ngrenë krye dhe gjithnjë e më

⁴⁰⁷ Marti Ahtisaari, *Detyra në Beograd*, (Prishtinë: Trend 2000) fq. 60

tepër të shtyjnë popullatën drejt metodave të luftërave të pastra luftarake për zgjidhjen e problemit, autoriteti i Rugovës ra. UÇK-ja vepronte e shkëputur nga partia e tij. Ekziston mendimi se përçarja në radhët e shqiptarëve ndodhi në vitin 1998,. Si shkak formal ishin pikëpamjet e ndryshme se me çfarë metodash do të arrihet pavarësia e krahinës. Në të vërtetë shkaqet ishin më të thella. Këtu ishte lufta për të dalë në krye për rrëketë e parave, për armatimet, për narkotikët. Edhe influencë nga jashtë. Udhëheqja e Shqipërisë fqinje, mbështetej kryesisht tek UÇK-ja. Madje në UÇK mendonin se pavarësia nuk duhet arritur vetëm në Kosovë. Në përbërje të republikës së pavarur duhet të përfshiheshin të gjitha tokat në territorin e ish-Jugosllavisë, të banuara nga shqiptarët etnikë. Kjo ide i pëlqente dikujt në Tiranë. Edhe në Evropën Perëndimore joshnin “qeverinë në mërgim”. Lideri i saj B. Bukoshi ishte për vazhdimin e luftës, ndërsa bisedimet i konsideronte si akt përuljeje dhe kapitullimi të shqiptarëve. Por për dikë prej vendeve evropiane, gjithsesi, ishte i afërt edhe I. Rugova. Por, në përgjithësi, situatë në lëvizjen separatist shqiptare ishte e ngatërruar sa që askush nuk mund të thoshte se cili ka influencë e cili jo. Në këtë kohë, unë e kisha krijuar mendimin tim, që u vërtetua edhe nga takimi, Ai kishte lidhje me faktin se, shqiptarët kosovarë, nuk po e kuptonin se ç’po ndodhte në të vërtetë. Ata i drejtonin, por ata nuk e dinin ku është kufiri. Në këtë situatë, Talbot konsideronte se më i arsyeshmi paraqitej pozicioni i I. Rugovës. Në ndryshim me ekstremistët e armatosur , ky pozicion përputhej me interesat e Rusisë. Ne e dinim, ndërmjet të tjerëve edhe nga S. Millosheviqin, se I. Rugova zhvillon me të bisedime përpiket të gjejë rrugëdalje nga situatë e krijuar. Por, fatkeqësisht të gjitha këto ishin të dorës së dytë. Paqja në Ballkan varej nga vullneti i forcave anësore. NATO nuk i vinte absolutisht veshin Rugovës, ai për ta ishte material i shfrytëzuar dhe, ata vendosën atë rregull që u duhej atyre dhe jo atij e popullit të tij të shumëvujtur.⁴⁰⁸ Koha po harxhohej dhe SHBA-të po planifikonin opinionin publik për operacione tokësore. Analistët ushtarakë theksuan se: forcat ushtarake serbe nuk kanë më forcë ofensive dhe ose mbesin ku janë ose do të humbin pozicionet, serbët nuk do të fitojnë kushte më të mira të Marrëveshjes nëse vazhdojnë të luftojnë, serbët nuk kanë treguar se kanë

⁴⁰⁸ Strobe Talbot, Victor Çernomirdin, *Prapaskenat e kapitullimit të Millosheviqit*, (Tiranë: Helga’s Secrets 2014)

mundësi të mbrojtjes efikase ndaj sulmeve ajrore apo bombardimeve të dhunshme, çmimi i dëmeve nga sulmet e ardhshme do të tejkalojnë kushtet e koncesioneve që SHBSA-të dhe Aleatët po i kërkojnë. Të gjitha këto kushte mbizotërojnë në kohë të sulmeve ajrore apo kërcënimet të sulmeve të tilla kanë sjellë përfundimin e luftës në Japoni 1945, në Kore 1953, në Vietnam 1973, në Irak 1991, te Serbët e Bosnjës 1995 dhe te Serbia 1999. Në secilin rast është frika për dëmet që do të vijnë që e mbulon arsyen që buron nga dëmet e përjetuara.⁴⁰⁹

Pse Millosheviqi pranoi kushtet e Aleatëve? Sepse nuk ia arriti ta destabilizojë rajonin, nuk ja arriti të përçajë NATIO-n, kalkuloi gabimisht se bombardimet do të jenë jetëshkurtëra, nuk ja arriti të involvojë Rusinë në favor të tij. Pastrimi etnik i shqiptarëve nuk prodhoi rezultatin që e dëshironte sepse UÇK ende mbeti organizatë e aftë për të rezistuar. NATO nuk lëvizi nga kërkesat dhe nuk i ndali bombardimet. Përkrahja e Ruisë për RFJ-në venitej.⁴¹⁰

Në fund, Millosheviqi kërkoi rrugëdalje nga një konflikt dhe krimet që i kishte nisur , për të cilat edhe u gjykua në Hagë, por për veten e tij jo për popullin e tij.

⁴⁰⁹ Stephen Hosmer, *Why Milosevic Decided to Settle when he did*, (Arlington:2001 RAND) faqe xxiii

⁴¹⁰ Stephen Hosmer, *Why Milosevic Decided to Settle when he did*, (Arlington:2001 RAND) kapitulli 2 ff. 7-47

IV.2 Intervenimi i NATO-s në Kosovë 1999 dhe ndryshimi i rolit të fuqisë ushtarake në politikën e jashtme të SHBA-ve në shekullin XXI

Vënia në lëvizje dhe përdorimi i forcës ushtarake ka qenë karakteristikë e politikës ndërkombëtare posaçërisht në dekadën e parë të shekullit XXI. Kombet kanë përdorur mjetin e fuqishëm të forcës ushtarake në formën e “grushtit të shtetësisë” për të frikësuar dhe dominuar mbi vendimet e kombeve dhe vendeve të tjera.⁴¹¹ Por, çështje komplekse dhe strategjia që aplikohet ishte pjesë e studimit të gjerë rreth praktikës së përdorimit të mjeteve ushtarake për të arritur qëllimet politike.⁴¹² Një formulë e përgjithshme e përcaktimit të qëllimeve politike dhe aplikimi i forcës ushtarake për arritjen e tyre është e pamjaftueshme për të krijuar strategji të qëndrueshme politiko-ushtarake për shkak të pranisë së armikut që reagon në mënyra të ndryshme; kështu që lufta nuk është vetëm administrim i forcës por kërkon më shumë.⁴¹³ Pra, krijimi i një strategjie të përgjithshme përmbajtësore afatgjate të raportit të veprimi ushtarak drejt qëllimeve politike është gati i pamundur pasi shtetet dhe kombet janë të ndryshme.

Kjo më së miri u vërtetua në dekadën e fundit të shekullit XX në kohën e Presidentit Bill Clinton gjatë intervenimeve ushtarake amerikane në Somali (1992-1994), Haiti (1994-1995) dhe Bosnje dhe Hercegovinë 1995. Ndonëse qëllimet e politike të intervenimeve ishin të ndryshme: shpërndarja e ndihmave humanitare në Somali, ndërrimi i pushtetit dhe rikthimi i Presidentit Jean-Bertrand Aristide, zbatimi i Marrëveshjes së Dejtonit dhe vendosja e ushtrisë në vijat ndarëse të konfliktit, forcat e ushtrisë amerikane u përballuan me vështirësi që ishin jashtë domenit të përgatitjes së tyre dhe doktrinës së vendosjes së tyre jashtë kufijve në mbrojtje të interesave të

⁴¹¹ Chas Freeman, *“Arts of Power: Statecraft and Diplomacy”* (Washington DC United States Institute of Peace, 1997) fq. 3

⁴¹² Lidell Hart. *“Strategy”*. (London: Faber and Faber 1967) fq 321 dhe Richard Lock-Pullan *US Intervention Policy and Army Innovation*. (New York: Routledge 2006) fq. 1

⁴¹³ Edward Luttwak *“The Logic of War and Peace”* (Cambridge, Belknap Press, 1987) fq. 8

SHBA-ve apo të aleatëve të SHBA-ve të përcaktuara nga ish-Sekretari i Mbrojtjes Caspar Weinberger.⁴¹⁴

Këto veprime ushtarake dhe posaçërisht veprimi ushtarak “Operation Allied Force” (OAF) i NATO-s në Kosovë, nën udhëheqjen e forcave ushtarake amerikane, do të ndikojnë dhe në masë të madhe përcaktojnë doktrinën e veprimeve ushtarake pas 11 shtatorit 2001.

Fushata zgjedhore e Presidentit Bill Clinton dhe program i tij zgjedhor ishin të përqëndruara në çështjet e brendshme, zhvillimin ekonomik dhe shëndetësinë, ndërsa politika e jashtme ishte vënë në plan të dytë. Në administratën e Presidentit Clinton kishte dallime të mëdha rreth angazhimit ushtarako-diplomatik rreth krizës dhe luftërave në ish-Jugosllavi. Përderisa Sekretari i Shtetit Warren Christopher ishte për vazhdimin e politikës së analizimit të kujdesshëm të krizës dhe gjetjes së zgjidhjes përmes rrugëve diplomatike, Këshilltari për çështje të sigurisë nacionale Antony Lake dhe Ambasadorja e SHBA-ve në Organizatën e Kombeve të Bashkuara Madelin Albright, që në periudhën e OAF do të jetë Sekretare e Shtetit, përkrahnin qëndrim më radikal ku veprimi diplomatik amerikan do të kishte përkrahje të qartë ushtarake.⁴¹⁵

Intervenimi në Kosovë një kohë të gjatë ka qenë çështje e debatit për shumë analistë politikë dhe ushtarakë. Është thënë se misioni OAF ishte i tejzgjatur, i stërngarkuar, me qëllime të ndryshme të aleatëve të bashkuar në NATO dhe dallime të mëdha në mes të shteteve anëtare të NATO-s rreth vetë operacionit ushtarak. Në një moment gjatë fushatës së bombardimeve të Serbisë, që ka zgjatur 78 ditë, është shfaqur mungesa e lidershit dhe vedosshmërisë së SHBA-ve për të shkuar deri në fund në arritjen e qëllimeve politike, është shfaqur mungesa e kapaciteteve ushtarake të aleatëve evropianë në NATO, si dhe janë parë kufizimet e mbështetjes vetëm në forcat ajrore dhe diplomacinë e detyrimit.

⁴¹⁴ Sekretari i Mbrojtjes Caspar Weinberger ka paraqitur doktrinën e re për forcat ushtarake të SHBA-ve në fjalimin e tij poara Press Klubit Nacional, Nëntor 1984)

⁴¹⁵ F.Stephen Larrabee, *“US Policy in the Balkans From Containment to Strategic Reengagement”*, RAND Corporation 1998)

OAF ka rritur qëllimit e vet, refugjatët shqiptarë nga Kosova janë kthyer në Kosovë, forcat ushtarake-policore të Serbisë janë larguar nga Kosova, dhe forcat e NATO-s kanë marrë përsipër sigurinë e jashtme të Kosovës. Nëse marrim parasysh intervenimin ushtarak për arsye të çështjeve humanitare atëherë Kosova është një ndër sukseset më të mëdha të politikës së jashtme të SHBA-ve. Por, as amerikanët dhe as aleatët evropianë më nuk e kanë përdorur luftën e parë të NATO-s, që ishte intervenimi kundër forcave ushtarake të Serbisë, si model për operacionet e ardhshme ushtarake. Megjithatë, OAF paraqet një moment të rëndësishëm në qëndrimin amerikan për përdorimin e forcës ushtarake në kohën e përfundimit të Luftës së Ftohët. OAF ka demonstruar qartë presionin që krijojnë krizat humanitare botërore në politikat intervenuese të SHBA-ve si dhe në çfarë mase SHBA-të marin parasysh kriteret e zbatuara gjatë Luftës së Ftohët për përdorim të kujdesshëm të forcave ushtarake në përkrahje të qëllimeve politike të jashtme të SHBA-ve.⁴¹⁶

Në përpjekjen për të zbatuar sa më shumë kriteret e kujdesit, për të pësuar sa më pak viktima amerikane, administrata e Presidentit Clinton kishte krijuar ndasi në opinionin publik por edhe brenda forcave të armatosura.⁴¹⁷ Ky qëndrim si dhe fakti që SHBA-të kundër Serbisë vepruan multilateralisht përmes NATO-s e ndikuan në krijimin e opinionit të vendimmarrësit në SHBA se Amerika duhet të ndërrojë kursin dhe të kërkojë alternativa të tjera. Ndryshimet që kanë të bëjnë me krijimin e koalicioneve ushtarake sipas nevojës së interesave nacionale amerikane dhe relativizimi i këshillave të oficerëve të lartë të forcave të armatosura të SHBA-ve nga udhëheqësit e lartë të administratës dhe Shtëpisë së Bardhë u panë në administratën e Presidentit George W. Bush në fushatat në Avganistan dhe Irak.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohët dhe largimit të kërcënimit të një konfrontimi me armatim konvencional, apo eskalimit në nivel nuklear, me Bashkimin Sovjetik, SHBA-të filluan të shqyrtojnë mundësitë e intervenimeve më të shpeshta ushtarake

⁴¹⁶ David Hastings Dunn, *Innovation and Precedent in the Kosovo War: Impact of Allied Force on US Policy*, International Affairs: Blackwell Publishing Ltd 2009)

⁴¹⁷ Wesley Clark, *Waging Modern War Bosnia, Kosovo, and the future of conflict* New York: Public Affairs 2001

për të arritur qëllime politike. Bota e fillimit të viteve 1990 nuk ishte më bipolare por tani SHBA-të paraqitën doktrinën e Rendit të ri botëror⁴¹⁸ që krijonte botën unipolare dhe SHBA-të si forcën kryesore për krijimin e stabilitetit ndërkombëtar. Në periudhën e viteve të 90-ta të shekullit XX, forcat e armatosura të SHBA-ve kanë vepruar për arritjen e qëllimeve strategjike të politikës së jashtme të SHBA-ve më shumë se kurrënjëherë në histori. Në dhjetor të vitit 1989 forcat ushtarake amerikane kanë intervenuar në Panama , për të arrestuar Gjeneralin Manuel Noriega, në vitin 1991 forcat ushtarake amerikane, së bashku me aleatët, çliruan Kuvajtin e okupuar nga Iraku. Në dy rastet Presidenti George H. Bush ka theksuar elementin humanitar të intervenimit për të ndihmuar popujt e Panamasë dhe Kuvajtit. Dhe kjo arsyeshmëri është përdorur edhe nga Presidenti Clinton në rastin e OAF në Kosovë.

Analisti i njohur i politikës së jashtme të SHBA-ve, Dr. Seyom Brown, e kishte definuar OAF si “akt legjitim i SHBA-ve për të vepruar në emër të bashkësisë ndërkombëtare në punët e brendshme të një vendi përmes forcave ushtarake, pa lejen e qeverisë së atij vendi, kur qeveria e atij vendi ka dështuar të ruajë minimumin e rendit publik për banorët si dhe të ruajë të drejtat më elementare të njeriut dhe lirinë e tyre nga plaçkitja dhe terrori”.⁴¹⁹

Pas përpjekjeve për të arritur një marrëveshje politike me Slobodan Milosevicin, Presidenti Clinton në shkurt 1999 kishte delaruar se: “Ne nuk mundemi, dhe nuk duhet, të bëjmë gjithçka dhe të jemi kudo. Por, kur vlerat dhe interesat tona janë në pyetje, dhe aty ku mund të bëjmë ndryshim, duhet të jemi të gatshëm ta bëjmë këtë.”⁴²⁰ Poashtu, Presidenti Clinton ishte i qartë kur ju drejtua opinionit amerikan se: “nuk e kam për qëllim të dërgoj trupat tokësore për të luftuar në Kosovë”⁴²¹.

Përrjashtimi i mundësisë së përdorimit të forcave tokësore dhe përzgjedhja e forcave ajrore si mjet strategjik në OAF solli mungesën e fokusit të poërbashkët në radhët

⁴¹⁸ Fjalimi i Presidentit George H. Bush para Kongresit të SHBA-ve 11 shtator 1990

⁴¹⁹ Seyom Brown, “*The Illusion of control: force and foreign policy in the 21 century*”, Washington DC: Brookings Institute Press, 2003 fq. 30

⁴²⁰ Cituar në “*The Clinton Doctrine*” Michael T. Klare, 19 prill 1999

⁴²¹ Deklarata e Presidentit Clinton 24 mars 1999

komanduese të forcave të armatosura amerikane që u reflektuan në tensione dhe mospajtime në mes të një pjese të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të SHBA-ve dhe Gjeneralit Michael Short, që ishte Komandant i Forcave Ajrore të Aleatëve dhe Gjeneralit Wesley Clark, që ishte Komandant i Përgjithshëm i Aleancës Veriatlantike. Gjenerali Clark këtë situatë e cilësoi si mospajtim klasik në mes të mënyrës së mendimit se forcat ajrore janë për të ndihmuar përpjekjet tokësore dhe mënyrës së mendimit se forcat ajrore janë me rëndësi strategjike sepse largojnë pasojat e luftës së rëndë e të kushtueshme tokësore ⁴²²

Në fakt, Forcat Ajrore të ushtrisë amerikane kishin rritur ndikimin në radhët e forcave të armatosura të SHBA-ve për shkak të suksesit të bombardimeve me mjete të sofistikuara precize duke zvogëluar sa më shumë humbjet në radhët e ushtarëve amerikanë. Forcat Ajrore gjatë viteve 90-ta të shekullit XX kishin krijuar “strategjinë fituese” në rastin e konflikteve përmes “kontrollit të hapsirës ajrore dhe bombardimeve precize”. ⁴²³

Mënyra e veprimit të përdorimit të bombardimeve precize nga lartë dhe konfrontimit me armikun nga distanca që bënë forcat amerikane të paprekshme ishte “Mënyra e re e Luftës” që u aplikua tërësisht në rastin e Kosovës ku forcat e armatosura të SHBA-ve hynë në fazën që u quajt edhe “luftë virtuale” pasi kontrollonin gjithë hapsirën ajrore por jo edhe gjendjen në terren. ⁴²⁴

Kështu administrata e Presidentit Clinton si dhe aleatët në OAF i kufizuan veprimet ushtrake kundër Serbisë në formë të veprimeve ajrore në caqe strategjike dhe forca të ushtrisë serbe duke mos arritur qëllimin e mbrojtjes së shqiptarëve të Kosovës që u bënë viktima dhe u përjashtuan me dhunë brutale nga Kosova. Fushata ajrore e dizajnuar dhe e planifikuar si goditje e përnjëhershme që do ta paralizonte Serbinë dhe

⁴²² Wesley Clark, “*Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the future of combat*”: New York, Public Affairs, ff. 243-244

⁴²³ Buster Glosson, “*Impact of Precision on Air Combat Operations : Airpower Journal Edicioni 7 Nr 2*” 1993 fq. 9

⁴²⁴ Andrew Bacevich dhe Eliot Cohen “*War over Kosovo: Politics and Strategy in a Global Age*”: New York: Columbia University Press 2001 ff. 38-62

do ta sjellte përsëri në tavolinën e bisedimeve për të pranuar marrëveshje rreth statusit të Kosovës, të negocuar në bisedimet e Rambujesë dhe Parisit, ndryshoi qëllimin dhe fokusin. Kështu bombardimet zgjatën 78 ditë ku caqet ndryshonin shpesh edhe brenda ditës, nuk u arrit qëllimi i shkatërrimit të ushtrisë së Serbisë duke e bërë atë të parrezikshme për vendet e rajonit, ndërsa vetëm pas “diplomacisë së detyrimit” dhe me ndihmën e Ruisë u përmyll OAF dhe forcat e Serbisë u tërhoqën nga Kosova. Çështje kontestuese ishte zbatimi i protokoleve rreth komandimit të forcave të NATO-s. OAF ishte lufta e parë e NATO-s por edhe veprimi i parë në një territor jashtë vendeve anëtare të NATO-s. Udhëheqës të lartë ushtarakë të NATO-s në disa raste janë ankuar për “interferencat politike” që kanë pasur gjatë fushatës OAF, në rastet e përcaktimit të caqeve të bombardimeve si dhe në aplikimin e të ashtuquajturit “kartonit të kuq” ku vendet anëtare të NATO-s gëzojnë privilegjin që të mos angazhojnë trupat dhe resurset teknike në misionet për të cilat vlerësojnë se janë jashtë mandatit të angazhimit ushtarak apo kur ka mospajtime brenda vendit anëtar. Poashtu, ka pasur vërejtje në atë se deri në cilën masë forcat e SHBA-ve brenda NATO-s kanë pasur strukturën paralele komanduese jashtë kornizës komanduese multinacionale të NATO-s.⁴²⁵ Lista e caqeve për bombardim, në javët e para të fushatës, ka qarkulluar brenda strukturës komanduese dhe vendet anëtare të koalicionit kanë pasur vërejtjet e tyre. Sipas Gjeneralit Michael Short më së shumti vërejtje dhe intervenime ka pasur Franca.⁴²⁶ Rreth aplikimit të “kartonit të kuq” incidenti më i theksuar kishte ndodhur në fund të fushatës kur Gjenerali Mickael Jackson, komandati i forcës së NATO-s në Kosovë KFOR, kishte refuzuar urdhërin e Gjeneralit Clark, Komandantit të Përgjithshëm të NATO-s, për të ndaluar forcat ruse për të okupuar Aeroportin e Prishtinës në qershor 1999. Gjenerali Jackson para vendimit kishte konsultuar Ministrinë e Mbrojtjes së Britanisë së Madhe.

SHBA-të pa dyshim kanë pasur sistem komandues paralel me atë multinacional të NATO-s. Në raportin “After Action Report” të OAF, të publikuar në janar të vitit 2000, Departmenti i Mbrojtjes së SHBA-ve në detaje ka përshkruar strukturën e

⁴²⁵ Paul Latawski Marti A. Smith “Kosovo Crises and the Evolution of Post Cold-War European Security”: Manchester, Manchester University Press 2003 fq. 51

⁴²⁶ G. Seigle “USA claims France hindered raids”, Jane’s Defense Weekly, 27 tetor 1999

strukturës komanduese brenda komponentës amerikane në NATO. Në krye të strukturës ishte Gjenerali Wesley Clark, si Komandant i Përgjithshëm i NATO-s. Që nga viti 1951, kur Komandant i parë i Përgjithshëm i NATO-s ishte emëruar Gjenerali Dwight Eisenhower, kjo pozitë u ka takuar amerikanëve. Me rregulloren e brendshme të forcave të armatosura të SHBA-ve, i emëruari në pozitën e Komandantit të Përgjithshëm të NATO-s, që është forcë multinacionale, shërben edhe si Komandant i Komandës Evropiane të SHBA-ve, që është pozitë në sistemin nacional.⁴²⁷

Me ardhjen e administratës së Presidentit George W. Bush filloi transformimi i forcave të armatosura të SHBA-ve që ishte një përpjekje gjithëpërfshirëse e Pentagonit për krijimin e forcave të armatosura për t'u përballur me kërkësat e shekullit XXI; kjo çështje poashtu ishte një nga çështjet kyçe gjatë fushatës presidenciale të vitit 2000.⁴²⁸ Një ndër qëllimet kryesore ishte rikthimi i kontrollit civil mbi forcat e armatosura ku administrata do të përcaktonte qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të forcave ushtarake si dhe transformimin e tyre e jo anasjelltas. Poashtu, Sekretari i ri i Mbrojtjes Donald Rumsfeld theksoi qëllimin e forcave ushtarake të integruara, të gatshme për t'u dërguar kudo në botë, që do të vepronin rrufeshëm me goditje shkatërruese.⁴²⁹

Administrata e Presidentit George W. Bush kishte vendosur të rishikonte doktrinën Weinberger dhe doktrinën Powell, që definonte përdorimin e forcave ushtarake të SHBA-ve vetëm nëse janë përcaktuar saktë qëllimet e veprimit, duke i tejkaluar përvojat e Vietnamit dhe rrezikut të humbjeve në radhët e ushtarëve amerikanë. Duke e vlerësuar përvojën e vështirë dhe mospajtimet që pati Gjenerali Wesley Clark me Gjeneralët e tjerë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të forcave ushtaraket të SHBA-ve, posaçërisht në refuzimin e kërkesave për përdorimin e helikopterëve "Apache" dhe përdorimin e forcave tokësore në OAF, administrata e Presidentit Bush mori kahje

⁴²⁷ "Kosovo/Operation Allied Force After Action Report": Washington DC Department of Defense, 2000, fq. 16 e tutje

⁴²⁸ Eliot Cohen "Defending America in 21st Century": Foreign Affairs Vol 79 Nr. 6 2000

⁴²⁹ Donald Rumsfeld "Transforming the Military" Foreign Affairs Vol 81. Nr 3. 2002 fq. 28

tjetër.⁴³⁰ Ideja kryesore ishte që vendimet për vendosjen e forcave ushtarake dhe përdorimin e tyre jashtë SHBA-ve të merren nga administrata pa nevojën e këshillimit të domosdoshën me profesionistët ushtarakë që treguan dallime të mëdha gjatë operacionit OAF.. Sekretari Rumsfeld mori përsipër kontrollin e Pentagonit në vitin 2001 ndërsa efektet e doktrinës së re u panë menjëherë pas sulmeve të 11 shtatorit 2001.

Përvoja e veprimeve në Kosovë u shërbeu planifikuesve të administratës së Presidentit Bush në disa mënyra. Përpos zbatimit të fushatës ajrore me bombardimin preciz të caqeve, forcat ushtarake të SHBA-ve koordinuan veprimet në Avganistan me Aleancën Veriore, formacion ushtarak që luftonte kundër talibanëve, njësoj siç kishin bërë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1999. Poashtu, administrata e Presidentit Bush vendosi të mos përsëriste veprimet e Presidentit Clinton për refuzimin e zotimit të trupave tokësore amerikane duke marrë përsipër rrezikun e humbjeve dhe qëndrimin negativ të opinionit publik amerikan. Sekretari Rumsfeld insistonte në vendosjen e forcave tokësore në Avganistan për të ndërruar psikologjinë dhe pikëvështrimin e amerikanëve rreth luftës.⁴³¹ Ndërsa Presidenti Bush kishte theksuar se nuk dëshironte një luftë sa për kamera dhe fotografi sepse populli amerikan dëshiron një goditje të madhe.⁴³² Qëndrimet e tilla në kontekstin e gjendjes emocionale të vështirë të opinionit publik në SHBA pas sulmeve të 11 shtatorit 1991 treguan vendosshmërinë për të tejkaluar brengën e humbjeve të ushtarëve amerikanë në beteja, që kishte dominuar administratën e Presidentit Clinton dhe udhëheqësinë e ushtrisë amerikane gjatë mandateve të tij. Operacionet ushtarake të forcave ushtarake të SHBA-ve në Avganistan dhe Irak janë zhvilluar sipas strategjive të krijuara nga udhëheqësia civile në Pentagon shpesh në kundërshtim me këshillat e profesionistëve të uniformuar.

⁴³⁰ Andrew Bacevich, *"The New American Militarism"*, Oxford University Press 2005 ff. 59-61

⁴³¹ Bob Woodward, *"Plan of Attack"*: London, Simon and Schuster 2004 fq. 26

⁴³² Bob Woodward, *"Bush at War"*: London, Simon and Schuster 2003 fq. 49

Administrata e Presidentit Bush filloi me zbatimimin e doktritës që nëkuptonte parandalimin e rrezikut për sigurinë nacionale. epërsinë ndaj armiu, dhe veprimin unilateral. Kjo doktrinë u quajta edhe “Doktrina Bush” dhe u finalizua në vitin 2002. Menjëherë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, dhe pas një përkrahjeje të gjerë botërore, forcat e armatosura të SHBA-ve okupuan Avganistanin dhe rrëzuan regjimin e talibanëve, ndërsa filluan të planifikojnë ndërrimin e regjimit në Irak. Presidenti Bush kishte fituar përkrahjen ndërkombëtare për të çarmatosur Irakun nga armët e shkatërrimit masiv, kryesisht kimike, por jo edhe vendimin final të Këshillit të Sigurimit për okupimin e Irakut. Presidenti Bush këtë veprim e sqaroi duke deklaruar se “kemi larguar nga pushteti një armik të përbetuar të SHBA-ve që kishte potencial për të prodhuar armë të shkatërrimit masiv dhe pas 11 shtatorit 2001 ne nuk mund të pranojmë një rrezik të tillë”. Për Presidentin Bush lufta kundër terrorizmit ishte luftë e gjatë ndërsa armiku ishte terrorizmi, terroristët dhe përkrahësit e tyre kudo në botë.

Për këtë qëllim politika e jashtme e SHBA-ve u përqëndrua për të rishikuar raportet me vendet e rëndësishme si Rusia dhe Pakistani dhe në rajone të ndryshme botërore duke nisur një fazë të re të riaktivizimit dhe krijimit të koalicioneve ndërkombëtare të paparë që nga përfundimi i Luftës së Ftohët. Presidenti Bush këtë qëndrim e kishte theksuar qartë në frazën “ne kemi gjetur momentin tonë dhe kemi gjetur misionin tonë” që do të përsëritet edhe nga zyrtarët e tjerë të administratës së tij përgjatë dy mandateve të luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar që vazhdon edhe sot.⁴³³ Doktrina Bush theksonte “parandalimin” si formë të trajtimit të rrezikut potencial dhe përkrahja për këtë ka rrjedhur nga misionet e suksesshme ushtarake në Avganistan dhe posaçërisht në Kosovë. SHBA-të ishin të vendosura se duhet të jenë të gatshme të veprojnë ushtarakisht kudo në botë nëse rreziku për interes nacionale amerikane është kredibil. Pjesë tjetër e Doktrinës Bush ishte “epërsia ushtarake” ku SHBA-të nuk do të lejojnë asnjë shtet që të afrohet teknologjikisht apo ushtarakisht niveklit të forcave të armatosura të SHBA-ve. Edhe sot SHBA-të shpenzojnë rreth 40% të të gjitha shpenzimeve buxhetore që bëjnë të gjitha shtetet e botës për mbrojtje. Përforcimi i epërsisë ushtarake është në pajtueshmëri me dokumentin e planifikimit të mbrojtjes

⁴³³ David Hastings Dunn, *“A Doctrine Worthy of the Name, Routledge, Diplomacy and Statescraft”* 2006 fq. 4

nacionale të vitit 1992 të titulluar “Pa Rivalë” ku qartë theksohet se “qëllimi i parë është të parandalohet rilindja e rivalëve të rinjë në sferën e forcës ushtarake”⁴³⁴. Dhe pjesa e tretë themelore e Doktrinës Bush ishte “unilateralizmi”ku SHBA-të do të kërkonin me këmbëngulësi krijimin e koalicioneve për veprime ushtarake por edhe e rezervojnë të drejtën e veprimit unilateral në rast të rrezikut të interesave nacionale amerikane.

Megjithatë, aty ku ka nevojë dhe mundësi ndërtimi i aleancave dhe koalicioneve vepruese ishte i domosdoshëm, dhe ky ishte mësimi që administrata e Presidentit Bush mori nga përvoja e Kosovës. Në Kosovë, forcat e armatosura të SHBA-ve vepruan në misionin e NATO-s me përkrahje të plotë të 19 shteteve anëtare të atëhershme që morën përsipër detyrat, sukseset dhe dështimet. Si rezultat i protokoleve të veprimit secili shtet anëtar ka të drejtë të marrë pjesë në vendimmarrje, pa marrë parasysh rolin apo kapacitetet ushtarake me të cilat disponon, dhe kjo poashtu u jep mundësi që të kundërshtojnë idetë që nuk janë të pranueshme për një arsye apo tjetrën. Sekretari i Mbrojtjes William Cohen, në dëshminë para Kongresit të SHBA-ve, kishte theksuar se pa kohezionin e Aleancës veriatlantike OAF nuk do të kishte sukses.⁴³⁵ Komandanti Suprem i NATO-s, Gjenerali Wesley Clark, kishte theksuar se institucionet ndërkombëtare dhe aleancat janë një formë tjetër e fuqisë që kanë mungesat e tyre dhe kërkojnë përkujdesje, por nëse përdoren si duhet kanë rëndësi strategjike vendimtare.⁴³⁶

Dallimet në mesin e aleatëve në NATO nuk ishin nëse duhej vepruar por në mënyrën se si të veprohej. Përderisa Britania e Madhe ishte për ndërhyrje të forcave tokësore ushtarake dhe kritikonte SHBA-të për vendimin që kjo ide të mos merret parasysh, vendet e tjera evropiane ishin të gatshme të marrin pjesë vetëm në operacionet ajrore. Doktrina amerikane e veprimit parashihte përdorimin e forcës së madhe ushtarake,

⁴³⁴ R. Haass, *“The Reluctant Sheriff”*, New York, Council on Foreign Relations, 1997, fq. 53 dhe David Hastings Dunn, *“A Doctrine Worthy of the Name”*, Routledge Diplomacy and Statescraft 2006 fq. 7

⁴³⁵ Cohen i cituar, Philip Gordon dhe Jeremy Shapiro: *“Allies at odds America, Europe and the crisis over Iraq”*, New York: McGraw-Hill, 2004, fq. 34

⁴³⁶ Wesley Clark, *“An Army of one”*: Washington Monthly, 21 nëntor 2002

diplomacia evropiane preferonte rritjen graduale të presionit për t'i lënë hapsirë Beogradit për të arritur marrëveshje me sa më pak rrezik dhe humbje. Këto dallime në Evropë i krijojnë elitat udhëheqëse sepse opinion publik ishte fuqishëm në favor të veprimeve ushtarake kundër Serbisë. Sipas matjeve së opinionit publik, të bëra në fund të marsit dhe fillimit të prillit 1999 nga revista "The Economist", 58% të të anketuarve në SHBA përkrahnin sulmet ajrore kundër Serbisë, 75% në Britaninë e Madhe, 50% në Francë, 63% në Gjermani. Përkrahja për ndërhyrjen e forcave tokësore ishte 46% në SHBA, 66% në Britaninë e Madhe, 68% në Francë.⁴³⁷

Legjitimiteti i veprimit ushtarak në Kosovë poashtu ishte çështje për të cilën aleatët në NATO kishin dallime. Përderisa për SHBA-të mungesa e mandatit të OKB-së nuk duhet të parandalojë veprimet ushtarake legjitime dhe të nevojshme, Franca dhe posaçërisht Gjermania nuk dëshironin që kjo mënyrë të bëhet presedan. Sipas Konceptit Strategjik të NATO-s të vitit 1999 Aleanca Veriatlantike duhet të veprojë gjithmonë "në përputhshmëri me të drejtën ndërkombëtare" si dhe "Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka përgjegjësinë primare për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe luan rol crucial për sigurinë dhe stabilitetin e hapsirës Euro-Atlantike". Poashtu theksohet se "NATO do të kërkojë, në bashkëpunim me organizatat e tjera, të parandalojë konfliktet në rast krizash, si dhe do të kontribuojë me menaxhim efektiv, në përputhshmëri me të drejtën ndërkombëtare, duke marrë parasysh edhe mundësinë e veprimit e operacioneve si reagim ndaj krizave sipas nenit 5"⁴³⁸

Intervenimi i NATO-s në kundër Republikës Federale të Jugosllavisë nuk ishte iu sanksionuar "de jure" nga një Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së por veprimet e NATO-s kishin legjitimitet nga disa nga Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të miratuara që kërkonin ndërprerjen e armiqësive në Kosovë dhe tërheqjen e forcave ushtarake serbe dhe armatimit të rëndë nga Kosova, dhe ndërprerjen e sulmeve ndaj civilëve shqiptarë dhe fillimit të bisedimeve në mes të palëve (p.sh. Rezoluta 1160 e

⁴³⁷ Branko Caratan, "NATO i Kosovo Geneza Problema i Mogucnosti Rjesavanja Krize", Zagreb :Politicka Misao Vol 36 Nr. 2 fq. 10 dhe The Economist: "Not by bombs alone" 10 prill 1999 fq. 21.)

⁴³⁸ "The Alliance Strategic Concept", 24 prill 1999, paragrafët 15, 31).

miratuar në mars 1998 apo Rezoluta 1199 miratuar në shtator 1998). SHBA-të vendosën të ndërmarrin këtë rrugë të veprimit duke e ditur se një Rezolutë që do të kërkonte intervenim në Republikën Federale të Jugosllavisë nuk do të kishte miratimin e plotë në Këshillin e Sigurimit për shkak të kundërshtimeve të Ruisë dhe Kinës.

Në një mënyrë këto dallime u përsëritën edhe në kohën e administratës së Presidentit Bush në rastin e Irakut brenda SHBA-ve dhe aleatëve kur diskutohej operacioni ushtarak kundër forcave irakiane. Njësoj si Slobodan Millosheviçi edhe Sadam Huseini kishte injoruar një mori rezolutash të miratuara në OKB dhe SHBA-të ndërmorën veprime ushtarake kundër ushtrisë dhe regjimit irakian. I vetmi dallim ishte se në rastin e Kosovës 1999 një koncensus ishte arritur në radhët e NATO-s, ndërsa në rastin e Irakut 2003 një gjë e tillë u tregua e pamundshme dhe SHBA-të krijuan koalicion tjetër.

Këtë mënyrë të të menduarit administrata e Presidentit Bush e fuqizoi edhe më shumë pas akteve terroriste të 11 shtatorit 2001 kur vendosi që të ndjekë drejtimin e intervenimeve unilaterale në luftën kundër terrorizmit. SHBA-të u përballën me goditjen dhe humbjet më të mëdha në histori nga një sulm nga jashtë brenda territorit të SHBA-ve. Administrata e Presidentit Bush vendosi që nevoja për të vepruar shpejtë, me forcë të madhe dhe me vendosshmëri është më e rëndësishme se krijimi i aleancave vepruese multinacionale.

SHBA-të ishin teknologjikisht dhe ushtarakisht më superiore dhe planifikuesit ushtarakë vendosën se nuk ka nevojë për veprime multilateral në terren në Avganistan. Forcat ushtarake të SHBA-ve në mënyrë unilaterale vendosën se kur dhe ku do të sulmojnë si dhe me cilët aleatë; forcat speciale britaneze dhe australiane u ftuan t'u bashkohen atyre amerikane ndërsa u refuzua oferta e kancelarit gjerman Gerhard Schroeder për ofrimin e trupave gjermane. Zëvendës -Sekretari i Mbrojtjes Paul Wolfowitz, në mbledhjen e ministrave të mbrojtjes së anëtareve të NATO-s më 26 shtator 2001, theksoi se NATO nuk do të ketë rol special në veprimet ushtarake amerikane në Avganistan dhe se SHBA-të do të krijojnë aleanca të ndryshme në pjesë

të ndryshme të botës gjatë luftës kundër terrorizmit.⁴³⁹ Ndërsa Sekretari i Mbrojtjes Donald Rumsfeld, më 31 janar 2002 në paraqitjen para National Defense University, theksoi edhe më qartë se ‘në luftë mund të përfitohet nga koalicionet e atyre që kanë vullnet por nuk duhet të udhëheqen nga komitetet e ndryshme, misioni duhet ta përcaktojë koalicionin e jo koalicioni të vendosë për misionin’.

Presidenti Bush dhe administrata e tij kishin vlerësuar se pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 situata kërkonte veprime të menjëhershme pa humbur kohë në politikën ndërkombëtare apo kërresat dhe nevojat e aleatëve. Për Presidentin Bush situata ishte e qartë dhe SHBA-të duhej t’u përgjigjeshin sulmeve. Kështu më 20 shtator 2001, në paraqitjen para Kongresit të SHBA-ve ai deklaroi se Amerika ishte sulmuar dhe se kombet e tjera do të gjykohen sipas asaj se si do të sillen pas këtyre sulmeve. “Secili komb, në çdo regjion tani duhet të vendosë. Ose jeni me ne ose jeni me terroristët”, pati deklaruar Presidenti Bush.

Periodha e viteve 1990 ishte periudhë e inovacioneve strategjike në politikën e jashtme të SHBA-ve. Pas presionit e bipolaritetit administrata e Presidentit Clinton ishte e ndarë në dëshirën për të përdorur forcën qoftë për të përmbajtur dhe izoluar kërcënimet apo të promovojë intervenimet humanitare. Metoda e preferuar ishte aplikimi i fushatës së bombardimeve ajrore së bashku me diplomacinë e detyrueshme, por pa luftë të hapur sepse Clinton kishte premtuar edhe para se të zgjedhej President se nuk do të përdorte ushtarët amerikanë jashtë doktrinae Weinberger dhe Powell.

Në rastin e Kosovës dhe operacionit OAF, forcat ushtarake të SHBA-ve filluan me modelin e bombardimeve dhe presionit diplomatik ndaj Serbisë, por me kalimin e kohës u pa se kjo nuk mjaftonte. Në fakt, ishte kombinimi i veprimeve të fushatës ajrore, mobilizimi dhe kryengritja në shkallë të madhe e shqiptarëve të Kosovës dhe veprimet ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kishte filluar të operonte më me sukses Shqipëria në Kosovë përgjatë vijës kufitare, diplomacia evropiane dhe ajo ruse, dhe kërcënimi i NATO-s për ndërhyrje tokësore që e detyruan Milosevicin të kapitullojë.

⁴³⁹ Phil Gordon and Jeremy Shapiro, “*Allies at War: America, Europe and the Crises over Iraq*” fq. 63

Dallimet në mesin e gjeneralëve të ushtrisë së SHBA-ve si dhe dallimet në pikëvështrimet e aleatëve në NATO rreth rrjedhës së fushatës ajrore në Kosovë dhe caqeve që duhej të bombardoheshin patën ndikim në mënyrën se si administrata e Presidentit Bush udhëhoqi fushatat në Afganistan 2001 dhe Irak 2003 dhe mënyrën e politikës së jashtme të SHBA-ve. Këto fushata ushtarake vazhdojnë edhe sot. Administrata e Presidentit Bush imperativ e kishte fitoren me çdo kusht duke e thjeshtuar diplomacinë në vetëm një qëllim-për të arritur te fitorja.⁴⁴⁰ Për këtë arsye administrata e Presidentit Bush vendosi që operacionet ushtarake t'i udhëheqë jashtë kornizës multilaterale të organizatave si NATO.

Poashtu, në krijimin e institucioneve të përkohshme administrative si në Afganistan e posaçërisht në Irak administrata e Presidentit Bush vendosi që të ketë rolin kryesor duke anashkaluar këshillat e aleatëve si dhe instrumentet e OKB-së. Presidenti Bush kishte vizituar Kosovën në vitin 2001 ku ishte takuar me udhëheqësit e UNMIK-ut (Misionit të OKB-së në Kosovë) si dhe liderët politikë të Kosovës. Presidenti Bush ishte i shokuar me prezencën letargjike të UNMIK-ut dy vite pas përfundimit të luftës si dhe qëndrimin indiferent të Shefit të atëhershëm të misionit UNMIK Hans Haekkerup. Presidenti Bush kishte vlerësuar se Evropa në Kosovë kishte dërguar diplomatët “e harxhuar” në vend të më të mirëve dhe më të shkathtëve dhe se këtë nuk do ta lejonte më.⁴⁴¹

Intervenimi në Kosovë dhe operacioni OAF ishte operacioni i parë i NATO-s jashtë territorit të vendeve anëtare dhe si i tillë rirreshtoi raportet brenda vendeve anëtare si dhe raportin e forcave të armatosura të SHBA-ve dhe vendeve të tjera të NATO-s. Ndikimi i këtij operacioni në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XXI në doktrinën e veprimit të forcave ushtarake të SHBA-ve dhe ndërlidhjen edhe më të madhe me diplomacinë amerikane, dhe në përgjithësi politikën e jashtme të SHBA-ve, është vërejtur gjatë mandatit të Presidentit Bush dhe luftës kundër terrorizmit global.

⁴⁴⁰ Johanna McGreary, “6 reasons why so many allies want Bush to slow down” Time 3 shkurt 2003 fq. 27

⁴⁴¹ Condoleezza Rice, “No Higher Honor, A memoir of my years in Washington”, (New York:Crown Publishers 2011) fq. 121

Suksesi i intervenimit në Kosovë, pa pasoja për ushtarët amerikanë, me gjithë pengesat rreth legjitimitetit të përdorimit të forcës kundër RFJ-së, problemeve të brendshme në sistemin komandues të NATO-s, parandalimin e përhapjes së konfliktit në vendet e tjera të rajonit në Ballkan, manovrimin të suksesshëm të raporteve me Rusinë, ishte sukses i politikës së jashtme të SHBA-ve dhe modelit të diplomacisë së përkrahur nga forcat e armatosura.

Operacioni “Operation Allied Force”, i çlirimit të Kosovës nga Serbia 1999 ngjajshëm me operacionin “Operation Desert Storm”, të çlirimit të Kuvajtit nga Iraku 1991, përpos rritjes së rolit të SHBA-ve në raportet gjeostrategjike ndërkombëtare ka sjellur edhe ballafaqimin përfundimtar me “sindromin e Vietnamit”, që ka përcjellur politikën e jashtme të SHBA-ve ,forcat e armatosura dhe shoqërinë amerikane me dekada.

Efekti më i rëndësishëm që ka pasur intervenimi i SHBA-ve në Kosovë në zhvillimin e politikës e jashtme të SHBA-ve, dhe përdorimin e forcës ushtarake amerikane për të arritur qëllimet politike, është rezultati pozitiv dhe fakti se në Kosovë është arritur sukses i plotë në aspektin e përmbushjes së caqeve ushtarake dhe politike të përcaktuara par fillimit të OAF. Ky sukses ka ndihmuar në ngritjen e besimit brenda administratës së Presidentit George W. Bush për mënyrën e veprimit unilateral në luftën kundër terrorizmit global, në ngritjen e besimit brenda shoqërisë amerikane për t’u sakrifikuar edhe jashtë kufijve të SHBA-ve në mbrojtje të të tjerëve, si dhe në akceptimin e përgjegjesisë që kanë SHBA-të si fuqia e vetme botërore në fillim të shekullit XXI.

IV.3 SHBA-të, intervenimi i NATO-s, perspektiva për Shqipërinë dhe Kosovën

Fundi i fushatës së bombardimeve dhe hyrja e forcave paqëruajtëse të NATO-s në Kosovë përpos lirisë për shqiptarët e Kosovës dhe ndaljes së konfliktit i cili kishte premisat për t'u zgjeruar në konflikt më të gjerë që do të përfshinte përpos Kosovës dhe Serbisë edhe Maqedoninë dhe Malin e Zi solli edhe hapjen e perspektivës për ndryshime në këtë pjesë të Ballkanit. Një vit më vonë, në tetor të vitit 2000, Millosheviqi do të tërhiqet nga pushteti pas protestave të dhunshme të opozitës në Serbi, Mali i Zi do të vazhdojë në kërkesën për shtet të pavarur që do të arrihet më 26 maj 2006, Maqedonia do ndryshojë qasjen ndaj shqiptarëve, pas përfundimit të konfliktit në vitin 2001, dhe do të riorganizojë institucionet sipas “Marrëveshjes së Ohrit”.

Ndërsa Shqipëria dhe Kosova filluan të bëjnë hapat konkretë për avancimin e pozitës ndërkombëtare dhe gjeostrategjike në rajon. Në fund të dhjetëvjetëshit 1999—2009 Shqipëria do të bëhet anëtare e plotë e Aleancës Veriatlantike, ndërsa Kosova shtet i pavarur dhe sovran dhe për të dy vendet do të hapet perspektiva e integritimit evropian. Ngritja e statusit të Shqipërisë dhe Kosovës në këtë dekadë janë rezultat i agjendës së SHBA-ve dhe aleatëve për këtë pjesë të Ballkanit si dhe përcaktimit politik të brendshëm të përgjithshëm në Shqipëri dhe në Kosovë për të arritur standardet e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian.

Pas përfundimit të fushatës “OAF” Aleanca Veriatlantike ishte shumë e ndryshme nga NATO në fillim të vitit 1991, para konfliktit në ish-Jugosllavi. Koncepti Strategjik i NATO-s, i aprovuar në vitin 1999 ndryshonte shumë nga ai i vitit 1991. Në rastin e intervenimit kundër RFJ-së NATO kishte dëshmuar për herë të parë se është në gjendje që përmes forcës ushtarake të arrijë paqen dhe të ruajë atë përmes forcave paqëruajtëse. Në këto forca paqëruajtëse rol zbatues, por edhe komandues, kishin jo vetëm anëtarët e plotë të Aleancës por edhe aleatët e Aleancës nga programi

“Partnership for Peace”, Partneriteti për Paqe. Zgjerimi i NATO-s drejt Lindjes ishte synim i SHBA-ve. Presidenti Bill Clinton, në vizitën e tij të parë evropiane në cilësinë e Presidentit të SHBA-ve në takim me udhëheqësit e NATO-s në Bruksel, konfirmoi qëndrimin se NATO duhet të jetë e hapur për anëtarët e ri duke ftuar shtetet që të bashkohen në programin “Partneriteti për Paqe”, që është hapi para anëtarësimit në NATO.⁴⁴²

Zgjerimi i NATO-s ishte pjesë e doktrinës Clinton “engagement and enlargement”, e cila në Evropën Lindore dhe Juglindore solli ndryshime gjeopolitike dhe angazhimin e drejtpërdrejtë politik dhe ushtarak të SHBA-ve. Në fakt, procesi i ndryshimeve kishte filluar edhe menjëherë

Në vitin 1991, më 7 dhe 8 nëntor liderët e NATO-s në Samitin e Romës miratuan Konceptin e Ri Strategjik për periudhën e pas “Luftës së Ftohtë” dhe Deklaratën e Romës për Paqe dhe Bashkëpunim. Më 20 dhjetor u zhvillua takimi inagurues i Këshillit të Bashkëpunimit të Veriatlantik me pjesëmarrje të Ministrave të Jahtëm dhe përfaqësuesve të gjashtëmbëdhjetë vendeve të NATO-s dhe nëntë vende të Evropës Qendrore e Lindore. Në këtë kohë Bashkimi Sovjetik efektivisht pushoi së ekzistuari.

Më 10 prill 1992, u zhvillua takimi i parë i Komitetit Ushtarak të NATO-s në sesion Bashkëpunimi me Shefat e Mbrojtjes dhe Shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të shteteve të Evropës qendrore e lindore. Më 2 shtator 1992 Këshilli i Atlantikut të Veriut ra dakort për masat që mundësonin që burimet e NATO-s të bëheshin të vlefshme për mbështetjen e përpjekjeve të Komunitetit Evropian, Këshillit të Sigurimit e të Bashkëpunimit në Evropë dhe OKB-së për vendosjen e paqes në ish Jugosllavi.

Më 10-11 janar 1994, në një takim në Brukselit u deklarua Partneriteti për Paqe dhe u ftuan të gjithë vendet partnere të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut dhe vendet anëtarë të KSBE-së të afta e me vullnet për t'u përfshirë të bashkuar me Partneritetin për Paqe. Më 12-16 shtator 1994 trembëdhjetë vende të NATO-s dhe

⁴⁴² Joyce P. Kaufman, *NATO and the Former Yugoslavia*, (Maryland: Rowman and Littlefield 2002), ff. 211-212.

vende partnere morrën pjesë në stërvitjen e parë të përbashkët të Partneritetit për Paqe, e cila u zhvillua në Poloni.

Në vitin 1995, më 21 shtator, Këshilli i Atlantikut të Veriut aprovoi një “Studim për Zgjerimin e NATO-s” duke nënvizuar kërkesat për vendet që do donin të bashkoheshin me Aleancën.

Në vitin 1996, më 10 dhjetor, në një takim në Bruksel, ministrat e jashtëm të NATO-s un pajtuan të zhvillojnë një samit në korrik 1997 për të ftuar “një ose dy” vende kandidatë për t'u anëtarësuar në NATO.

Në maj të vitit 1997, në Samitin e Madridit, u ftuan zyrtarisht për anëtarësim Hungaria, Polonia dhe Republika Çeke që zyrtarisht u anëtarësuan në Samitin e Uashingtonit në prill të vitit 1999 gjatë kohës së konfliktit në Kosovë. Me gjithë kundërshtimet e Ruisë, zgjerimin e vazhdoi edhe Presidenti i radhës i SHBA-ve, George Bush, i cili në fushatën parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale të vitit 2000, kishte shprehur qëndrimin e tërheqje së forcave ushtarake amerikane nga misionet paqëruajtëse në Ballkan dhe anëtarësimin të shteteve Baltike në Aleancën Veriatlantike. Në Samitin e Pragës, të mbajtur në nëntor 2002, udhëheqësit e NATO-s zyrtarisht ftuan shtatë vende që do t'i bashkangjiteshin Aleancës deri në vitin 2004: Bullgarinë, Estoninë, Latvinë, Lituaninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë.

Në Samitin e Pragës në mënyrë eksplicite u përcaktua fushëveprimi i NATO-s në të ardhem. Veprimi ushtarak sipas doktrinës “Out of area”, ku Aleanca Veriatlantike vepron edhe jashtë hapsirës së vendeve anëtare, ishte sprovuar në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kosovë. Në këtë samit përfaqësuesit e organizatës joqeveritare “The US Committee on NATO”, që ishte mjaft aktive në procesin e zgjerimit të NATO-s, propozuan që SHBA-të të nënshkruajnë një marrëveshje parteriteti me tri vendet që aspirojnë anëtarësimin, Shqipërinë, Kroacinë, dhe Maqedoninë. SHBA-të kishin nënshkruar një marrëveshje të ngjajshme me vendet Baltike, Estoninë, Latvinë dhe Lituaninë, në vitin 1998. Marrëveshja u quajt “Karta e Adriatikut” dhe u nënshkrua më 2 maj 2003 në Tiranë nga Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, Colin Poëell, Ministri i Jashtëm i Shqipërisë Ilir Meta, Ministri i Jashtëm i Kroacisë Tonino Picula,

dhe Ministrja e Jashtme e Maqedonisë Ilinka Mitreva. Qëllimi kryesor i Kartës ishte gatishmëria e tri vendeve për integrim të plotë në institucionet evropiane dhe ato tranatlantike politike, ekonomike, të sigurisë dhe të mbrojtjes. Sekretari Poëll kishte theksuar se SHBA-të do të bëjnë çdo gjë të mundshme që popujt e Shqipërisë, Kroacisë, dhe Maqedonisë të arrijnë potencialin e tyre dhe së bashku të përfundojnë rrugëtimin për në Evropë.⁴⁴³ Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 ndaj SHBA-ve, dhe qëndrimit të Presidentit Bush se “lufta kundër terrorizmit do të jetë e gjatë dhe do të zhvillohet kudo ku janë organizatat terroriste që veprojnë kundër SHBA-ve”, ndryshoi edhe pikëvështrimi i përfaqësuesve të vendeve anëtare të NATO-s. Pas Samitit të Pragës “out of area” ishte e gjithë bota dhe pa identifikuar ndonjë regjion të caktuar apo shtet, liderët e NATO-s u zotuan se “do të përballen me të gjitha sfidat që kërcënojnë sigurinë, popullatën dhe territorin e vendeve anëtare pa marrë parasysh se prej nga burojnë ato kërcënime”.⁴⁴⁴

Kështu trupat e NATO-s në operacionet vepruese dhe përkrahëse do të vendosen në Avganistan, si forcë paqeruajtëse e operacionit “International Security Assistance Force” ISAF, Pakistan por edhe Indonezi dhe Filipine. Shqipëria i është bashkangjitur “Koalicionit Ndërkombëtar në Luftën Globale Kundër Terrorizmit” më 10 janar 2002, në takim të Londrës. Fillimisht, Shqipëria dërgoi një njësi elite komando nën komandën turke në ISAF, ndërsa në mars 2003 një ekip i ndërlidhjes u dërguan në USCENTCOM, komandën qendrore amerikane. Në qershor të vitit 2003 një kompani e njësisë elite komando ishte kontigjenti i parë që dërgohej në këtë operacionin “Iraqi Freedom”.

Në Samitin e Stambollit, të mbajtur në qershor 2004, liderët e NATO-s vendosën të përmbyllin misionin SFOR në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe inkurajuan Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë që të vazhdojnë me reformat e nevojshme të forcave ushtarake drejt anëtarësimit të plotë në NATO.⁴⁴⁵ Në Samitin e Rigës, të mbajtur në nëntor 2006, NATO ftoi Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë që zyrtarisht të bëhen

⁴⁴³ Fjalimi i Sekretarit Powell në ceremoninë e nënshkrimit <http://www.usinfo.gov> (13 korrik 2013)

⁴⁴⁴ Lawrence S. Kaplan, *NATO divided, NATO united*, (Westport: Praeger Publishers, 2004,) ff. 146-147).

⁴⁴⁵ (<http://www.nato.int/docu/pr/2004/p04-096e.htm>) (17 korrik 2013)

anëtare të Aleancës Veriatlantike nëse deri në samitin e radhës i përmbushin të gjitha detyrimet nga Plani Akcional i Anëtarësimit në NATO⁴⁴⁶ dhe ftoi Bosnjen dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zit të bëhen pjesë e programit “Partneriteti për Paqe”.⁴⁴⁷ Në Samitin e Bukureshtit, të mbajtur në prill 2008 Shqipëria dhe Kroacia zyrtarisht u ftuan të bëhen anëtare të NATO-s prej vitit 2009, ndërsa Greqia bllokoi hyrjen e Maqedonisë për shkak të mospajtimeve rreth emërtimit zyrtar të këtij vendi. Në Samitin e Strasbough-Kehl, të mbajtur në prill 2009, Shqipëria mori pjesë për herë të parë si anëtare e plotë e Aleancës Veri Atlantike e përfaqësuar nga Presidenti Bamir Topi dhe Kryeministri Sali Berisha.⁴⁴⁸

Shqipëria në periudhën nga kërkesa zyrtare e deri të anëtarësimi i plotë në Aleancën Veriatlantike kaloi në disa faza turbulente që vënë në sprovë të madhe institucionet shtetërore. Pozicioni i Shqipërisë ndaj Aleancës së NATO-s që në fillimet e aplikimit, paraqet ngjajshmëri, por edhe vecanti krahasuar me vendet e tjerë të rajonit. Ajo kërkoi shumë shpejt, pas rrëzimit të regjimit komunist, pranimin në Aleancën e NATO-s. Deklarimi publik i dëshirës për t'u bashkuar me Aleancën u bë në vitin 1992. Po këtë vit Shqipëria u bashkua me Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut. Në vitin 1994, marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n u zgjeruan kur ajo u bë pjesë e Partneritetit për Paqe. Rruga e Shqipërisë për në NATO nuk ka qenë e shkurtër.⁴⁴⁹ Ajo ka zgjatur për gati 17 vite. Në muajin nëntor 1991, në një mbledhje të OSBE-së (atëherë KSBE) në Pragë, është regjistruar kontakti i parë zyrtar midis një delegacioni të lartë të MPJ të Shqipërisë me zyrtarë të lartë të Aleancës së NATO-s pjesëmarrës në atë mbledhje. Në dhjetor 1991 është krijuar Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) me synimin e zgjerimit të bashkëpunimit me vendet e ish bllokut lindor dhe në qershor 1992 Shqipëria ka aplikuar dhe është pranuar zyrtarisht në këtë Këshill. Në dhjetor 1992 Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha ka vizituar e NATO-s në Bruksel, vizitë e parë kjo e një zyrtari shqiptar dhe është pritur nga Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Manfred Verner. Ndërkohë, në 19 mars 1993

⁴⁴⁶ (<http://www.nato.int/docu/update/2006/11-november/e1129d.htm>) (17 korrik 2013)

⁴⁴⁷ (<http://www.nato.int/docu/update/2006/11-november/e1129e.htm>) (22 korrik 2013)

⁴⁴⁸ (http://www.nato.int/cps/en/SID-DAD5643A-919C2CBA/natolive/nees_52834.htm) (22 korrik 2013)

⁴⁴⁹ Shih Gazeta Ushtria, *NATO, hapi i parë i një rruge të gjatë*, 6 prill 2009

vjen për vizitë zyrtare në Shqipëri Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Manfred Verner, i cili mbajti një fjalim mesazh në Parlamentin e Shqipërisë ku ndër të tjera theksoi “Unë kam ardhur të ofroj dorën e bashkëpunimit Shqipërisë”. Aleanca jonë dhe institucionet e tjera perëndimore ju ofrojnë mbështetje politike dhe materiale për të vazhduar në këtë rrugë“. Në muajin maj të vitit 1993 Shqipëria pranohet anëtar i asocuar i Asamblesë së Atlantikut të Veriut.

Në janar të vitit 1994 Aleanca e Atlantikut të Veriut prezantoi Dokumentin ftesë të Partneritetit për Paqe, duke e përcaktuar atë si program të drejtpërdrejtë dhe praktik për të transformuar marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe shteteve jo anëtare, kryesisht të “Bllokut Lindor“, që nuk përfshiheshin në “ombrellën e sigurisë“ sipas artikullit të pestë të saj. Shqipëria është ndër vendet e para të Evropës Juglindore që aplikoi zyrtarisht për anëtarësim në Aleancë. Në 23 shkurt 1994 Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha nënshkroi në përputhje me synimin strategjik të integritit në strukturat Euroatlantike Dokumentin Kuadër të Pfp, duke u bërë zyrtarisht anëtare e Nismës së Partneritetit për Paqe (Pfp).

Në përputhje me formulën NATO/Pfp, brenda një kohe të shkurtër u nënshkruan një varg dokumentesh zyrtare për të vënë mbi baza institucionale bashkëpunimin. Në 20 prill 1994, Parlamenti i Shqipërisë ratifikoi Dokumentin Themelor të Pfp duke zyrtarizuar e institucionalizuar marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n. Në vijim të kësaj ecurie, më 3 qershor 1994 u krijua Shoqata e Atlantikut të Veriut në Shqipëri, në të cilën morrën pjesë rreth 80 intelektualë, politikanë të gjithë spektrit politik, njerëz të media, etj. President i Shoqatës u zgjodh Alfred Mojsiu. Më 22 shtator 1994, Shqipëria paraqiti në Aleancën e NATO-s Dokumentin e Prezantimit të Shqipërisë në Pfp, ku deklaroi kapacitetet dhe infrastrukturën e mundshme për bashkëpunimin si vend partner me Aleancën Veriatlantike

Më 25 janar 1995 u miratua Programi i parë Individual i Partneritetit për Paqe (IPP) në kuadër të Pfp, duke vazhduar periodikisht përgatitjen e Programit Individual të Partneritetit për cdo vit (1995-2006), me përjashtim të vitit 1998, ku për arsyet e krizës shqiptare të vitit 1997, u hartua dhe zbatua një IPP emergjence dhe i veçantë

për Shqipërinë.⁴⁵⁰ Më 9 qershor 1995 Shqipëria u përfshi zyrtarisht në procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit për Paqe (PARP). Ky proces krijoi kushte për të përfituar nga përvoja e NATO-s në fushën e planifikimit të mbrojtjes. Duke marrë pjesë në ciklet e PARP-it, Shqipëria shkëmben informacion me Aleancën për çështje të një spektri të gjerë: politikën e mbrojtjes; kontrollin demokratik të forcave të armatosura; strukturat ushtarake që Shqipëria ofron në dispozicion të NATO/PfP; planet përkatëse financiare. Pjesëmarrja e Shqipërisë në ciklet dyvjeçare të PARP-it, megjithë vështirësitë dhe mangësitë financiare dhe ato të koordinimit brenda vendit, ka qenë me përfitime sidomos në fushat e planizimit, transparencës në planizim dhe buxhetim, rritjen e kontributeve në operacionet PfP, rritjen e ndërveprimit në stërvitje e operacione së bashku me struktura të NATO-s, etj.

Në vitin 1996, NATO ndërmori për herë të parë një proces ambicioz studimi rreth mundësisë së zgjerimit të Aleancës. Ajo u përfshi në një djalog intensiv për të vlerësuar përmbushjen nga ana e vendeve partnere të pesë parimeve të studimit për zgjerimin e Aleancës. Shqipëria mori pjesë në dy raundet e para të dialogut. Mandej pati ndërprerje për arsye të krizës të vitit 1997. Kriteret e studimit mbi zgjerimin konsideronin si shumë të rëndësishme stabilitetin dhe zhvillimet e brendëshme, standartet e zgjedhjeve, marrëdhëniet me fqinjët, etj.

Në maj 1996 vizitoi zyrtarisht Shqipërinë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana. Ndërsa më 7 korrik dhe 11 tetor 1996, në selinë e NATO-s në Bruksel u zhvilluan përkatësisht sesioni i parë dhe i dytë i Dialogut Individual NATO-Shqipëri. Në këtë format takimi, është diskutuar edhe mbi perspektivën e zgjerimit të Aleancës. Zhvillimet negative të brendëshme në Shqipëri në vitin 1997 pamundësuan pjesëmarrjen në raundin e tretë të Dialogut Individual NATO-Shqipëri, duke mos e përfshirë në procesin e zgjerimit të Aleancës që u vendos në Madrid. Por, në 30 maj 1997, Shqipëria është pjesëmarrëse në takimin e Sintra-s të Portugalisë, i cili përfaqëson takimin e parë të EAPC-së (Këshilli i Partneritetit Euroatlantik), i cili zëvendësoi NACC-në (Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut). Me rëndësi

⁴⁵⁰ Dr. Sulejman Abazi, *Psikologjia e Ndryshimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë*, (Tiranë: Toena 2001), fq. 237

në këtë moment është kërkesa dhe vullneti i palës shqiptare që Aleanca të ndihmonte në ringritjen e instrumentit ushtarak shqiptar duke patur parasysh kërkesat e vetë Aleancës.

Në qershor të vitit 1998 NATO, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, hapi zyrtarisht Qendrën e Kooperimit të NATO-s, udhëhequr nga Paolo Tonegutti, për të realizuar objektivat e programit Partneriteti për Paqe. Zyra e NATO-s në Tiranë ofroi këshilla e asistencë teknike në zbatimin e IPP-së dhe të PARP-it dhe në këtë veprimtari përfshiheshin edhe këshilla ndaj autoriteteve qeveritare, si dhe koordinimni i asistencës së huaj në vend.

Gjatë vitit 1999 në Shqipëri kanë qëndruar 28 ekipe të ndryshme për të trajnuar strukturat ushtarake të të vendit në rrugën e transformimit. Gjatë periudhës 1997-2000 ushtarakët shqiptarë morën pjesë në një numër stërvitjesh me forcat e tjera shumëkombëshe si në SHBA në korrik 1997 në operacionin “Cooperative Nugget 97”, në Itali në shtator 1997 në operacionin “Esperia 97”, në Greqi në shtator 1997 në operacionin “Prometeu 97”, në SHBA në qershor 1998 në operacionin “Cooperative Osprey 98”, në Itali në qershor 1998 në operacionin “Cooperative Dragon 98”, në Maqedoni në qershor 1998 në operacionin “Cooperative Best Effort 98”, në Shqipëri në gusht 1998 në Bizë të Tiranës, në Maqedoni në shtator 1998 në manovra ushtarake, në Greqi në qershor 1999 në operacionin “Prometeu 99”, në Shqipëri në qershor 2000 në operacionin “Cooperative Dragon 2000”.⁴⁵¹ Forcat e Armatosura të Shqipërisë kontribuan në krijimin e Brigadës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore “SEEBRIG” në vitin 1999. Një vit më herët, më 26 shtator 1998, Ministrat e Mbrojtjes së Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë, Italisë, Maqedonisë, Rumanisë dhe Turqisë, së bashku me SHBA-të dhe Slloveninë si pjesëmarrës në cilësinë e vëzhguesve, nënshkruan Marrëveshjen shumëkombëshe për paqe në Evropën Juglindore. Qëllimi i SEEBRIG-ut ishte mundësia e vënies në dispozicion të OKB-së ose OSBE-së, në mision të udhëhequr nga NATO apo Bashkimi Evropian, për të

⁴⁵¹ Dr. Sulejman Abazi, Psikologjia e Ndryshimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, (Tiranë: Toena 2001,) ff. 241-243

parandaluar konfliktete apo në misione paqëruajtëse.⁴⁵² Trazirat e vitit 1997, mungesa e stabilitetit në vend në dy vitet e ardhshme dhe posaçërisht lufta e hapur në Kosovë 1998-1999 forcuan bindjen te elitat politike dhe te opinioni publik se çështja e sigurisë së Shqipërisë është çështje jo vetëm e brendshme, që mund të zgjidhet me doktrinën vendore dhe me potencialet vendore, por është çështje e ndërlidhur me situatën e re gjeopolitike në rajon. Për këtë arsye kërkohet ridefinimi i strategjisë së mbrojtjes së vendit. Pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s kundër RFJ-së dhe hyrjes së forcave tokësore në Kosovë në Shqipëri praktikisht përfundoi një lloj “gjendjeje e jashtëzakonshme” që ekzistonte që nga viti 1997. Qeveria e Shqipërisë vendosi të formulonte dokumentet e para strategjike që do të jenë bazë e strategjisë së përgjithshme të sigurisë dhe mbrojtjes. Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi “Strategjinë Kombëtare të Sigurisë së Shqipërisë” e cila u dekretua nga Presidenti i Shqipërisë në janar të vitit 2000.

Në tetor të 1999, pra në periudhën kur krijohet Strategjia për Forcat e Armatosura, Shqipëria mori dokumentin “Membership Action Plan” (Planin Akcional të Anëtarësimit) nga NATO që ishte hapi i parë konkret drejt anëtarësimit në Aleancën Veriatlantike. MAP paraqet një numër rregullash dhe kriteresh në fushën e reformave të forcave të armatosura, proceseve politike dhe demokratike që vendet aspiruese për anëtarësim në NATO duhet të plotësojnë. Në mars të vitit 2000, një ekip i Ministrisë së Mbrojtjes në krye me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Gjeneral Pëllumb Qazimin, së bashku me ekspertët amerikanë në Uashington finalizuan programin e reformimit të forcave të armatosura të Shqipërisë. Ministri i Mbrojtjes Pandeli Majko, gjatë vizitës në SHBA në fund të vitit 2001, pranoi planin e përgjithshëm të vlerësimit të mbrojtjes së Shqipërisë. SHBA-të u zotuan se do të përkrahin plotësisht këtë program dhe një ekip i kontraktorëve u dërgua në Tiranë në vitin 2002 për të zbatuar atë.⁴⁵³

⁴⁵² Aldo Bumçi, *Defense and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives, Security Sector Reform in Albania*, fq. 22

www.dcaf.ch/content/download/36677/528571/file/Albania.pdf (11 gusht 2013)

⁴⁵³ Dhimitër Binaj, *An Analysis of the United States-Albanian Security Relations in the light of the war on terrorism*, (Naval Postgraduate School Monterrey California, 2004), fq. 60.

Në prill të vitit 2002 Shqipëria pranoi pakon “Partnership Goal” që kishte 51 detyrime për t’u përmbushur nga Programi Partneriteti për Paqe ku 31 detyrime ishin drejtpërdrejt të lidhura me MAP. Po në këtë vit, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura paraqiti para Ministrisë së Mbrojtjes “Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë” që u miratua nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë më 25 korrik 2002 dhe u dekretua nga Presidenti më 9 gusht 2002. Strategjia ishte dokument udhërrëfyes për të ardhmen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për dekadën në vijimin. Sipas planifikuesve numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar në kohën e paqes së Forcës së Ardhsme 2010 duhej të jetë 16.500 vetë, ndërsa numri i personelit në njësitë rezervë rreth 20.000 vetë. Poashtu, zhvillimi i Forcave të Armatosura do të hynte në një proces të transformimit dhe reformimit me qëllim të modernizimit të njësive, ndërsa në vitin 2010 qëllimi ishte që alokimi i fondeve për mbrojtjen e vendit të arrinte në 2% të GDP nga 1,2% sa ishte në vitin 2002.⁴⁵⁴ Strategjia përkufizoi konceptet operationale si parime dhe rregulla që drejtojnë Forcat e Armatosura të Shqipërisë në zbatimin e misioeve të tyre në përputhje me parimet e NATO-s të përcaktuara në Samitin e Uashingtonit që përfshijnë konceptin e vëtmëbrojtjes dhe mbrojtjes reciproke. Në planin e zbatimit të Strategjisë theksohet zhvillimi i doktrinës ushtarake të ndërveprueshme me NATO-n, ndërsa Shtabi i Përgjithshëm do të funksionojë si shtab planifikimi sipas standardeve të NATO-s (J1-J9). Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të stërviteshin dhe aftësoheshin për të vepruar në raste të ndryshme të rrezikut dhe të përgatiten për integrim në NATO. Synim i Forcave të Armatosura ishte të arrihej niveli i aftësisë operationale për të marrë pjesë në operationet shumëkombëshe të NATO-s, brenda dhe jashtë Shqipërisë, para anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në NATO. “Strategjia Ushtarake” përcaktonte raportet civile-ushtarake, rolin e Shtabit të Përgjithshëm, forcave tokësore, ajrore, detare si dhe kornizën ligjore të veprimit të Forcave të Armatosura, kontrollin civil përmes Parlamentit. I gjithë procesi i reformave të Forcave të Armatosura të Shqipërisë u finalizua me hyrjen e Shqipërisë si anëtare e plotë në NATO në Samitin e Buskureshtit. Forcat e Armatosura iu nënshtruan reformës nën doktrinën që Shqipëria

⁴⁵⁴ Ministria e Mbrojtjes-Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, *Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë*, (Tiranë: Drejtoria e Informacionit dhe Shtypit, 2002) ff. 9-15

është “de facto anëtare e NATO-s” dhe eskportuese e sigurisë pasi forcat e armatosura të Shqipërisë ishin pjesëmarrëse aktive të misioneve ndërkombëtare paqësore gjatë periudhës së kërkesës për anëtarësim të plotë në NATO. Njësitë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë ishin pjesëmarrëse në operacionet “ISAF”, “Iraqi Freedom”, “ALTHEA” në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe “MINURCAT” në Republikën Qendrore Afrikane dhe në Çad. Në fushën e sigurisë Shqipëria ka marrë rolin e saj në regjion dhe është partner i rëndësishëm i SHBA-ve, ndërsa me anëtarësimin e plotë në NATO dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura konform standardeve të Alencës Veriatlantike Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm të jashtëzakonshme në sigurimin e integritetit shtetëror dhe territorial.

Menjëherë pas çlirimit të Kosovës dhe vendosjes së forcave të NATO-s, për të siguruar territorin e Kosovës, dhe Misionit të OKB-së UNMIK për të vendosur institucionet kalimtare në Kosovë filloi të normalizohej jeta. Por, në planin politik kërkesa e shqiptarëve mbeti e njëjtë si gjithë-Kosova e pavarur sa më parë. U deshën gjashtë vite nga implementimi i Rezolutës 1244/1999, që Këshilli i Sigurimit të OKB-së të pranojë këshillën e Sekretarit të Përgjithshëm Kofi Annan për fillimin e procesit politik që do të zgjidhte problemin e Kosovës, në të vërtetë statusin final të saj. Takimet në mes të delegacioneve shqiptare dhe serbe filluan më 20 shkurt në Vjenë. Takimi parë delegacioneve kishte të bënte me përkufizimin e temave që do të diskutoheshin si :decentralizimi, të drejtat e pakicave dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore të pakicës serbe, obligimet financiare, borxhet, privatizimi, dhe kush do të menaxhojë me pasuritë dhe industrinë e Kosovës. Tema e statusit politik nuk u hap në këto bisedime. Bisedimet në Vienë zgjatën pesë muaj dhe vetëm vërtetuan dallimet që kanë shqiptarët dhe serbët për gati të gjitha çështjet. Beogradi do të pranonte gjithçka përpos pavarësisë ndërsa Prishtina asgjë përpos pavarësisë për Kosovën. Gjatë raundeve të bisedimeve, të cilat për ndërkombëtarët kishin karakter teknik, u negocuan aspekte të lartpërmendura dhe kjo ishte faza mars-qershor 2006. Faza e dytë, korrik-shtator 2006 ishte e dedikuar për të diskutuar statusin final dhe parashihte takimin e Kryeministrave Agim Çeku dhe Vojislav Koshtunica. Pas raportimit nga ky

takim planifikohej të hapej faza e finalizimit të negociatave me një propozim për statusin final të Kosovës diku në muajin dhjetor 2006.⁴⁵⁵

Raundet e fundit të negociatave filluan më 21 shkurt 2007 dhe zgjatën deri më 10 prill 2007 për të arritur te përfundimi se nuk ka marrëveshje. Ahtisaari paralajmëroi se do të bëjë gati versionin e tij të Planit për Kosovën të cilin do t'ia paraqiste Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Krerët serbë ishin fuqimisht kundër çdo version të Planit që do të përmbante elemente të pavarësisë për Kosovën. Presidenti serb Boris Tadiq përsëriti idenë për t'i dhënë Kosovës “autonomi me përgjegjësi të mëdha”, ndërsa Kryeministri serb Koshtunica deklaroi se Planin e Ahtisaarit do ta ndalojë “vetoja historike” e Rusisë dhe se do të kishte ende negociata.⁴⁵⁶ Planin e kanë përkrahur krerët shqiptarë të Kosovës me ritheksimin e qëllimit për pavarësi të plotë për Kosovën, këtu kishin edhe përkrahjen e BE-së, NATO-s, dhe SHBA-ve.⁴⁵⁷

Në bazë të raundeve të bisedimeve u krijua Plani i Ahtisaarit pala shqiptare fitoi shumicëne kërkesave të saj. Plani poashtu parashihte të drejta të mëdha për pakicat joshqiptare në Kosovë deri në masë që ato duhet medoemos të jenë të reprezentuara në Parlament dhe në secilën Qeveri të Kosovës. Në dokument nuk flitej në mënyrë eksplicite për pavarësinë e Kosovës por as për kontinuitetin e integritetit territorial të Serbisë. Sipas Planit të Ahtisaarit në faza të ndryshme parashihej bartja e kompetencave të UNMIK-ut te institucionet e Kosovës. Në hyrjen e Planit Ahtisaari kishte shkruar se Kosova duhet të jetë shtet i pavarur mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare.⁴⁵⁸ Serbia e refuzoi planin sepse parashihte pavarësinë për Kosovën, por as shqiptarët e Kosovës nuk ishin të kënaqur sepse parashihej prezenca

⁴⁵⁵ Quercia Paolo, *Kosovo na klackalici*, (Beograd: Limes Plus 1/2007, 2007) fq. 57

⁴⁵⁶ www. SET. Times.com, *Ahtisaari kaze kako je nezavisnost jedini odgovor za Kosovo* (28.03.2007)

⁴⁵⁷ Nëns sekretari Nikollas Burns deklaroi se Washingtoni shpreson se Këshilli i Sigurimit do të jetë në gjendje të miratojë një Rezolutë të re për Kosovën në prill ose në maj 2007. Presidenca gjermane e BE-së deklaroi se BE “fuqimisht” përkrahë zgjidhjen e propozuar nga Ahtisaari. Sekretari për politikë të jashtme dhe siguri të NATO-s Javier Sollana si dhe Sekretari i Përgjithshëm Jap De Hof Shefer poashtu përkrahën Planin http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/articles/2007/05/21/reportage-01 (21.07.2012)

⁴⁵⁸ Ahtisari's report to Secretary General Ban Ki-Moon on the plan can be found at http://un.org/Docs/sc/unsc_presandgs_letters07.htm (21.07.2012)

mbikqyrëse ndërkombëtare. Sipas Planit, në Kosovë do të krijohet Zyrja Ndërkombëtare Civile “ICO” që do të mbikqyrte zbatimin e Planit mandate i së cilës vendosej nga Grupi Ndërkombëtar Drejtues “International Steering Group” në të cilin do të merrnin pjesë SHBA-të, Franca, Gjermania, Rusia, Italia, Britania e Madhe, vendet e BE-së, Komisioni Evropian dhe NATO. ICO do të merrte përsipër krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që në plan afatgjatë do të mundësonte largimin e NATO-s gradualisht nga Kosova.⁴⁵⁹ Poashtu, Kosova do të kontrollonte gjithë hapsirën ajrore mbi territorin e saj, që është atribut i shteteve të pavarura.⁴⁶⁰

Me gjithë përkrahjen që kishte ky Plan, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dështuan gjashtë propozime për një Rezolutë që do ta bënte të plotëfuqishëm. Me propozimin e Presidentit francez Nicholas Sarkozy, në Samitin G8 në qershor 2007, zgjidhja e problemit të Kosovës iu dedikua Grupit treanëtarësh SHBA-Rusi-BE dhe përfaqësuesve të tyre Frank Isner, Aleksandar Botsan Harçenko dhe Wolfgang Ishinger. Propozimi i Sarkozisë mëtonte të shpëtonte bisedimet duke mbajtur Rusinë në proces por edhe vendosi afatin kohor 120 ditësh për treshen për të qetësuar shqiptarët e Kosovës. Pas bisedimeve brenda këtij afati kohor gati që palët nuk lëvizën nga qëndrimet e tyre. Thjeshtë ekzistonin tri mundësi: që Kosova të mbetet pjesë e Serbisë, të shpallë pavarësinë, ose të ndahet në pjesën shqiptare dhe atë serbe. Në shkurt të vitit 2008 përfundoi edhe mandate i treshes pa rezultat që do të perkrahnin edhe OKB-ja. Shqiptarët e Kosovës, të përkrahur fuqishëm nga SHBA-të, më 18 shkurt 2008 e shpallën pavarësinë në Kuvendin e Kosovës. Këtë akt të Kuvendit të Kosovës nuk e anuloi shefi i atëhershëm UNMIK-ut Joakim Ryker, ndërsa të gjitha vendet pro pavarësisë së Kosovës, në krye me SHBA-të filluan ta njohin një nga një Kosovën e pavarur si shtetin më të ri në botë. Qeveria serbe dhe Rusia u treguan të pafuqishme për të parandaluar ngjarjet që ishin bërë gati më herët. ICO mbikëqyri Kosovën për tri vite dhe pastaj raportoi se të gjithë parametrat e paraparë me Planin e Ahtisaarit, të futura në Kushtetutën e Kosovës, janë përmbushur dhe Republika e Kosovës tani ishte plotësisht e pavarur. Kosova ende nuk është pranuar nga të gjitha

⁴⁵⁹ Marc Weller, *Negotiating the Final Status of Kosovo*, (Challiot Paper No114) fq. 52

⁴⁶⁰ Po aty ff. 47-49

vendet e BE-së dhe nga OKB, por me kohë ka treguar se ka afinitete shtetëndertuese, krimet ndëretnike u zvogëluar menjëherë pas fitores së pavarësisë sepse ai ishte qëllimi i shqiptarëve të Kosovës. Ky qëllim nuk u arrit pa ndihmën e pakursyer të SHBA-ve që edhe në rastin e Shqipërisë e posaçërisht në rastin e Kosovës treguan se gjatë gjithë kohës nuk kanë vepruar taktikisht por me strategji për të forcuar këto dy vende dhe për t'u dhënë perspektivë të re: Shqipëria në NATO, ndërsa Kosova shtet i pavarur dhe de facto në NATO.

PËRFUNDIME

Qëllimi kryesor analizues në këtë disertacion përmbahet në elaborimin e ndikimit amerikan në përfundimin e konflikteve pranë Kosovës dhe Shqipërisë, pra në ish-Jugosllavi, krijimit të marrëveshjeve paqësore, stabilizimit dhe transformimit të rajonit përgjatë veprimit njëzetvjeçar diplomatik, politik dhe ushtarak në Evropën Juglindore.

Hipoteza kryesore e këtij punimi ka qenë e bazuar në një presupozim se SHBA-të morën rolin udhëheqës të proceseve politike në rajonin e Evropës Juglindore në vitin 1993 pasi Bashkimi Evropian dhe instrumentet e tij nuk ishin në gjendje të frenojnë tendencat nacionaliste për shtrirje të konflikteve përtej kufijve të shteteve të dala nga Jugosllavia. Me anë të veprimeve ushtarake dhe diplomatike, që kanë qenë vendimtare për përfundimin e konflikteve, duke kërkuar gjithnjë zgjidhje paqësore, duke u përpjekur të stabilizojnë rajonin dhe duke formësuar proceset e tranzicionit në ish-Jugosllavi dhe shtetet e dala nga kjo Federatë si dhe në Shqipëri, SHBA-të, me këto metoda që kompletin njëra-tjetrën, kanë ndikuar edhe në veprimin e Qeverive të shteteve të reja, të krijuara më dezintegrimin e Jugosllavisë, por edhe vendeve të tjera të rajonit. Me analizën e hipotezës është bërë përpjekja për ta vërtetuar atë dhe për të vërtetuar se zhvillimet e politikës së SHBA-ve kanë ndikuar në rajon, por edhe kanë ndryshuar në rastet jashtë rajonit, gjithnjë si pasojë e mësimave nga angazhimi në rajonin e Evropës Juglindore.

Hipoteza themelore është vërtetuar në tërësi si tezë që qëndron pasi pas hulumtimit të fakteve historike, primare të deklasifikuara, sekondare si shkrime autobiografike të pjesëmarrësve autentikë të ngjarjeve të dekadës 1989-1999 e shumë artikujve të studjuesve të tjerë arrihet në përfundim se roli i SHBA-ve nuk ishte i rastësishëm, por ishte strategji e planifikuar për të shtrirë ndikimin politik dhe ushtarak në Evropën Juglindore. Politika e SHBA-ve ndaj Shqipërisë dhe posaçërisht ndaj Kosovës përgjatë procesit që ka rezultuar me pavarësinë e saj ishte e determinuar nga interesat nacionale të SHBA-ve, në radhë të parë, dhe ndryshimeve globale ndërkombëtare pas

përfundimit të periudhës së ndarjes në blloqe në vitin 1989. SHBA-të, për të mbrojtur interesat e tyre gjeostrategjike ndihmuan Shqipërinë në demokratizimin e saj, ndërsa në rastin e Kosovës kanë përdorur të gjitha instrumentet e politikës së jashtme: diplomacinë në nivel bilateral, nivel multilateral, nivel preventiv, sanksionet ekonomike dhe politike, diplomacinë të përkrahur me kërcënim force, intervenimin ushtarak, pjesëmarrjen në mision paqësor, rekonstruimin postkonfliktual të vendit, ndartimit të institucioneve shtetërore, dhe në fund njohjen e shtetit të Kosovës. Faktet historike vërtetojnë edhe degëzimet e hipotezës themelore. Në rastin e parë, po të ishte më aktive administrata e Presidentit George H. Bush që në fillim të dezintegritimit të Jugosllavisë konfliktet e përgjakshme që pasuan kanë mundur të evitohen. Në rastin e dytë, ishte ndërrimi i kursit të politikës së jashtme të SHBA-ve, nën udhëheqjen e Presidentit Bill Clinton që me veprime diplomatike të përkrahura me forcë ushtarake arriti të krijojë stabilitet në rajon si dhe rritjen e ndikimit gjeopolitik dhe gjeostrategjik të SHBA-ve që vazhdon edhe në ditët e sotme. Lidhshipi amerikan në Bosnjë dhe Hercegovinë si dhe suksesi i operacioneve luftarake në Kosovë, ishin baza e ndryshimeve demokratike në Kroaci, pas vdekjes së Presidentit Tudjman si dhe në Serbi, me mposhtjen e Presidentit Millosheviq. Në këtë periudhë Evropa ishte ende e ndarë dhe pa politikë të jashtme unike, posaçërisht me largimin e kërcënimit të BRSS-së disa vende ishin të interesuara që të zvogëlojnë edhe ndikimin e SHBA-ve në Evropë. Rusia, si trashëgimtare e BRSS-së në këtë periudhë kishte hyrë në krizë ekonomike, institucionale dhe sociale. Për të ndërruar këtë gjendje, Presidenti Clinton e zhvilloi strategjinë që përfshinte: forcimin e Evropës, transformimin e NATO-s dhe zgjerimin e kësaj organizate me anëtare të reja (pra edhe Shqipërinë), përfshirjen e Rusisë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Ky qëndrim konceptual i administratës së Clintonit u formulua në strategjinë “Enlargement and Engagement”.

Në rastin e tretë, Presidenti George Bush nuk bëri fare ndryshime në strategjinë e “intervenimeve humanitare” por i përfundoi punët. Ai e njohu Kosovën si shtet të pavarur, Malin e Zi poashtu, ndikoi fuqishëm që Shqipëria dhe Kroacia të pranohen në NATO si dhe ruajti stabilitetin politik në Maqedoni dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Presidenti Bush i kishte pëlqyer idea e “intervenimeve humanitare” të Clintonit vetëm për shkak se ishin kryer pa Rezolutë të OKB-së. Krijimin e koalicioneve ushtarake

sipas nevojave të misioneve dhe qëllimeve ushtarake do të jenë doktrina vepruese e Presidentit Bush në arenën ndërkombëtare. Në rastin e katërt, SHBA-të me Presidentin Obama i shtuan rëndësinë rajonit të Evropës Juglindore si pjesë të pakalueshme e projekteve energjetike që vijnë nga Kaukazi dhe Azia Qendrore, duke lënë anash Rusinë dhe projektet e saj energjetike. Pa asnjë dyshim edhe administrata që do të vijë pas Presidentit Obama për këtë shkak do ta ruajnë balansin dhe do t'i mbrojnë dhe ndihmojnë aleatët në këtë pjesë të Evropës, ku hyjnë edhe Shqipëria dhe Kosova.

Gjatë analizës dhe metodologjisë së punës në këtë punim kam inkorporuar metodat integrale që aplikohen në hulumtimet historike, por që inkorporojnë edhe dimensione të tjera informatash. Jam munduar të përdorë sa më shumë metodën deskriptive, paanshmërinë, paraqitjen e fakteve si të tilla dhe shpjegimet e ngjarjeve duke filluar nga shkaqet e tyre e deri te pasojat, metodën e analizimit të fakteve, metodën e dëshmimit apo kundërshtimit të tezave të ndryshme, metodën e sintezës. Pasi edhe vetë kam qenë pjesëmarrës i ngjarjeve, posaçërisht që kanë të bëjnë me SHBA-të dhe Kosovën jam munduar që të jap atë që e kam parë dhe e kam përjetuar njëkohësisht duke bërë analizat e tyre dhe duke i shpjeguar në kontekstin kohor dhe të zhvillimeve të atëhershme shoqërore. Jam përpjekur të analizoj dhe përshkruaj ngjarjet dhe proceset në të gjithë kapitujt në mënyrë kronologjike dhe sa më të kuptueshme qoftë të dokumenteve zyrtare, të takimeve, të konferencave ndërkombëtare, të përshkrimit të akterëve kryesorë dhe të vetë kohës të cilën e kam jetuar e që është treguar vendimtare për të ardhmen e Shqipërisë dhe Kosovës. Jam përpjekur që me anë të analizave komparative t'i krahasoj të gjeturat dhe t'i paraqes qëndrimet e palëve nganjëherë duke përdorur edhe njohuritë mbi ambiciet personale të akterëve që ndikojnë në proceset e përgjithshme.

Në fund kam konkluduar se për Shqipërinë dhe Kosovën, dekada 1989-1999 dhe angazhimi strategjik i SHBA-ve në përkrahje të shqiptarëve, ishte dekada më e rëndësishme sepse promovoi pluralizmin demokratik, lirinë e shprehjes, lirinë e popullit në fund të fundit të shqiptarët të cilët ishin të shtypur apo dominuar nga të huajt për një kohë të gjatë. Perspektiva që i është hapur Shqipërisë dhe Kosovës, me

ndihmën e pakursyer amerikane, është rast unik në historinë e popullit shqiptar dhe shansë për të përparuar që nuk guxon të humbet .

BIBLIOGRAFIA

I. Dokumente arkivore të botuara dhe të hapura për publikun

1. <https://history.state.gov/historicaldocuments/> - Në këtë faqe janë të publikuara të gjitha dokumentet e deklasifikuara apo të hapura për publikun, që janë lejuar të botohen nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve.
2. <http://www.clintonlibrary.gov/visit-us.html> - Në këtë faqe janë të publikuara të gjitha dokumentet e deklasifikuara apo të hapura për publikun, që janë lejuar të botohen nga Presidenti Bill Clinton.
3. <http://bush41library.tamu.edu/archives/> - Në këtë faqe janë të publikuara të gjitha dokumentet e deklasifikuara apo të hapura, që janë lejuar të botohen nga Presidenti Gerorge H. Bush.
4. <http://www.foia.cia.gov/collection/bosnia-intelligence-and-clinton-presidency> - Në këtë faqe janë të publikuara të gjitha dokumentet e deklasifikuara apo të hapura që janë lejuar të botohen nga autoritetet e CIA-s.
5. <http://fpc.state.gov/c18185.htm> - Në këtë faqe janë të publikuara të gjitha dokumentete e deklasifikuara apo të hapura që janë lejuar të botohen nga autoritetet e Kongresit të SHBA-ve.
6. <http://www.state.gov/r/pa/prs/dpb/> - Në këtë faqe janë të publikuara të gjitha komunikatat për shtyp dhe konferencat për shtyp që janë lejuar të botohen nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve.
7. <http://www.loc.gov/> - Në këtë faqe janë të publikuara botimet e shumëta nga lëmitë që mbulojnë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikën e jashtme të SHBA-ve.

8. <http://www.bksh.al/> - Në këtë faqe janë të publikuara botime të shumëta nga lëmitë që mbulojnë marrëdhëniet brenda shqiptare dhe të Shqipërisë me vendet e tjera.

II. Intervistat me pjesëmarrësit autentikë të ngjarjeve

Intervistë me Jusuf Buxhovin, Sekretar i Parë i Lidhjes Demokratike të Kosovës

Intervistë me Gjeneralin Pëllumb Qazimi, ish-Komandant i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; në kohën e konfliktit në Kosovë udhëheqës i Sektorit për Zbulim dhe Kundërzbulim në sektorin verior, verilindor dhe lindor të Republikës së Shqipërisë

Intervistë me Michael McClellan, udhëheqësin e parë të Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë me karakter diplomatik

III. Literatura

Ahrens, Geert Hinrich, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Tiranë: Toena 2010

Ahtisaari, Martti, *Detyra në Beograd*, Prishtinë: Trend, 2008

Albright, Madeleine A *Memoir Madam Secretary* New York: Miramax Books 2001

Antonic, Slobodan, *Zarobljena zemlja: Srbija za vlade Slobodana Milosevica*, Beograd: Otkrovenje, 2002

Bacevich, Andrew, *American Empire*, Harvard: University Press 2010

Badsey Stephen, Latawski Paul, *Britain, NATO and the lessons of the Balkan Conflicts 1991-1999*, London: Frank Cass Publishers 2004

Ball, Laurie, *United States Diplomacy in Kosovo Final Status Talks: A Case Study in Multilateral Negotiations With Principle Negotiations*, WWS 547, May 12, 2009

- Banac, Ivo *Raspad Jugoslavije* Zagreb: Derieux, 2001
- Baze, Mero, *Realitete Shqiptaro-Amerikane*, Tiranë, Koha, 1997
- Biberaj, Elez, *Shqipëria në Tranzicion*, Tiranë: AIIS, 2011
- Bilandzic, Dusan, *Hrvatska Moderna Povijest*, Zagreb:Golden Marketing, 1999
- Bilt, Karl, *Zadatak Mir*, Beograd: Radio B92, 1999
- Binaj, Dhimitër *An Analysis of the United States-Albanian Security Relations in the light of the war on terrorism*, Naval Postgraduate School Monterrey California: 2004
- Biserko, Sonja *Yugoslavia's Implosion - Fatal attraction of Serbian Nationalism*, Belgrade: Zagorac 2012
- Blum, William, *Killing Hope*, London: Zed Books, 2004
- Bogdani, Mirela dhe Loughlin John, *Albania and the European Union*, New York: IB Turis and Co, 2007
- Brzezinski, Zbigniew *Second Chance: Three Presidents and the Crisis of American Superpower*, New York: Basic Books 2008
- Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike 1*, Prishtinë: Faik Konica, 2009
- Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike 2*, Prishtinë: Faik Konica, 2009
- Cehuljic, Lidija, *Clinton i novi svjetski poredak*, Zagreb: Politicka kultura, 2001
- Chandler, David, *From Kosovo to Kabul and Beyond-Human Rights and International Intervention*, London: Pluto Press 2006
- Chollet, Derek *The Road to Dayton Accords*, New York: Palgrave MacMillan 2005
- Clark, Howard, *Civil Resistance in Kosovo*, London: Plutobooks 2000
- Clinton, Bill, *My Life*, Alfred A. Knope, New York, 2004

- Ćosić, Dobrica *“Piščevi zapisi 1952-1968*, Beograd: Filip Višnjić, 2000
- Cox, Michael dhe Stokes, Doug, *Politika e Jashtme e SHBA-ve*, Tiranë: IDK, 2008
- Daalder Ivo dhe O’Hanlon Michael, *Winning Ugly-NATO’s War to Save Kosovo*, Washington DC: Brookings Institution Press, 2000
- Daalder, Ivo dhe Lindsay, James *America Unbound-The Bush Revolution in Foreign Policy*, Washington DC: Brookings Institution Press, 2003
- Daskalovski, Zidas dhe Bieber, Florian, *Understanding the War in Kosovo*, London: Frank Cass Publishers, 2005
- Degzhiu, Muharrem, *Shqipëria në luftë (1939-1944)*, Tiranë: Globus R 2001
- Demi, Leonard, *Shqipëria dhe Diplomacia Amerikane*, Tiranë: Guttenberg, 2009
- Dervishi, Kastriot, *Sigurimi i Shtetit*, Tiranë: 55, 2012
- Djukić, Slavoljub *“Izmedju slave i anateme: Politička biografija Slobodana Miloševića”*, Beograd: Filip Višnjić 1994
- Dobbins, James, *America’s role in nation-building: from Germany to Iraq*, Rand Publications, 2003
- Dobson, Alan P. dhe Steve Marsh, *US Foreign Policy since 1945*, London: Routledge 2006
- Dugolli, Bujar, *1 Tetori i kthesës*, Prishtinë: Fakulteti i Filozofisë, Departmenti i Historisë, 2013
- Duka, Valentina, *Histori e Shqipërisë 1912-2002*, Tiranë: Kaltrina-KH, 2007
- Dzeletovic Ivanov, Pavle, *SS-Divizija Skënderbeg*, Beograd: Nova Knjiga 1987
- Elsie, Robert, *Fjalori Historik i Shqipërisë*, Tiranë: Uegen, 2011
- Elsie, Robert, *Fjalori Historik i Kosovës*, Tiranë, Skanderbeg Books, 2011
- Ferguson, Niall, *Kolos-Uspon i pad Americkog imperija*, Zagreb: Profil, 2011
- Fevziu, Blendi, *100 vjet*, Tiranë: UET, 2012

- Fouskas Vassilis, *Zones of Conflict-US Foreign Policy in the Balkans and the Greater Middle East*, London: Pluto Press 2003
- Frashëri, Kristo, *Mbi historinë e Ballit Kombëtar*, Tiranë: Guttenberg 2012
- Gaber, Slavko dhe Kuzmanić, Tonci “*Kosovo-Srbija-Jugoslavija*”, Lubjanë: Krt 1989
- Galeazzo Ciano, Astrit Cani, *Shqipëria (Ditari 1937-1943)*, Tiranë: Albinform 1994
- Glenny, Misha *The Fall of Yugoslavia*, London: Penguin 1993
- Glenny, Misha, *The Balkans 1804-1999*, London: Granta Books, 2000
- Goldman, Minton F. *Revolution and Change in Central and Eastern Europe: Political, Economic and Social Challenges*”, New York: M.E. Sharpe, 1997
- Guskova, Jelena, *Jugoslovenska kriza i Rusija*, Beograd: Institut za medjunarodnu politiku i privredu, 1996
- Guy, Nicola, *Lindja e Shqipërisë*, Tiranë: Pegi, 2012
- Hadri, Arbër, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2012
- Haliti, Xhavit, *Kështu e bëmë luftën*, Prishtinë: Orbis, 2013
- Hendrickson, Ryan, *Diplomacy and the War at NATO*, Columbia: University of Missouri Press, 2006
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi IV, Tiranë: Toena, 2009
- Holbrooke, Richard *To end a War-Završiti Rat*, Sahinpasic 1998
- Hosmer, Stephen, *Why Milosevic decided to settle when he did*, Arlington: RAND Corporation, 2001
- Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave - Krimet e luftës në Kosovë*, Tiranë: Botime Korbi, 2002
- Imami, Petrit “*Srbi i Albanci kroz vekove*”, (Beograd: Samizdat FreeB92, 1999), 323.

Ivo Daalder “*Getting to Dayton –The Making of America’s Bosnian Policy*”, New York: Brookings 2000

Jens Schmitt, Oliver dhe Frantz, Eva Anne, *Historia e Shqiptarëve*, Tiranë: Marin Barleti 2012

Jens Schmitt, Oliver, *Kosova Histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha, 2012

Jens Schmitt, Oliver, *Shqiptarët një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*, Tiranë: Guttenberg, 2012

Jović, Borisav *Poslednji dani SFRJ*, Beograd: Politika 1995

Jovic, Borisav, *Poslednji dani SFRJ*, Beograd: Politika 1995

Judah, Tim “*The Serbs: History, Myth and Deconstruction of Yugoslavia*”, New Heaven, London, Yale University Press, 1997

Judah, Tim *Kosovo What everyone needs to know* Oxford: University Press, 2008

Judah, Tim *Kosovo: War and Revenge*, Yale: University Press 2000

Kaba, Hamit, *Shqipëria në rrjedhën e luftës së ftohtë*, Tiranë: Botimpex 2007

Kadijevic, Veljko, *Moje vidjenje raspada*, Beograd: Politika 1993

Kadijević, Veljko, *Moje vidjenje raspada*, Beograd: Politika 1993

Kaufman, Joyce P., *NATO and the Former Yugoslavia-Crisis, Conflict, and the Atlantic Alliance*, Lanham: RL Publishers 2002

Ker-Lindsay, James, *Kosovo-The Path to Contested Statehood in the Balkans*, New York: Palgrave MacMillan, 2009

Kos-Stanisic, Lidija, *Vojne Komponente Americke Vanjske Politike*, Zagreb:Polemos, 2000

Kovacevic, Zivorad, *Amerika i raspad Jugoslavije*, Beograd: Filip Visnjic 2007

Krasniqi Afrim, Stani Lazër, *Rënia e Demokracisë-Shqipëria në muajt janar-qershor 1997*, Tiranë: Eurorilindja 1998

- Latawski, Paul dhe Smith, Martin, *The Kosovo Crisis and the evolution of post-Cold War European Security*, New York: Palgrave, 2003
- Lucas, Peter, *Misioni Amerikan në Shqipëri*, Tiranë: Bota Shqiptare, 2008
- Magas, Branka *The Destruction of Yugoslavia: Tracking the Break-up 1980-92*, London: Verso 1993
- Malcolm, Noel *Bosnia-A short History*, New York: University Press 1994
- Malcolm, Noel *Kosovo a short history* London: Pan Books 2002
- Malnar, Dario , *SHBA-ja dhe Kosova*, Prishtinë: KOHA, 2013
- Mamula, Branko , *Slučaj Jugoslavija*, Podgorica: CID 2000
- Mamula, Branko, *Slucaj Jugoslavija*, Podgorica: CID 2000
- Merovci, Adnan, *Në hap me Rugovën*, Prishtinë: Iliri, 2012
- Michael Ignatieff, Michael *Virtual War, Kosovo and Beyond*, New York: Metropolitan Books, 2000
- Milo, Paskal, *Ditari i një Ministri të Jashtëm-Konflikti i Kosovës*, Tiranë: Toena, 2009
- Milo, Paskal, *Kosova nga Rambuje në Pavasrësi*, Tiranë: Toena, 2009
- Morozzo della Rocca, Roberto, *Shqipëria-Rrënjët e krizës*, Tiranë: Shtëpia e Librit, 2000
- Nardulli Bruce, Perry Walter, Pirnie Bruce, Gordon John, dhe McGinn John, *Disjointed War-Military Operations in Kosovo 1999*, Arlington: RAND, 2002
- Nathanaili, Petrit, Boriçi Gjon, *Ex Yougoslavie entre la violence et la paix : 1987-1999*, Tiranë: Geer 2007
- Nathanaili, Petrit, *Disa çështje të pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë (1944-1946)*
- Nathanaili, Petrit, *Historia e Botës Moderne*, Tiranë: Ilar 2007
- Nathanaili, Petrit, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga origjina e deri më sot*, Tiranë, 2009

- Norris, John, *Collision Course - NATO, Russia, and Kosovo*, Westport: Greenwood Publishing Group Inc, 2005
- Owen, David *Balkan Odyssey*, London: Victor Gollanz, 1995
- Partos, Gabriel *Albania: Conflict Prevention and Crisis Management*, London: International Security Information Service, 1997
- Perović, Latinka "Zatvaranje kruga-ishod rascepa 1971-1972", Sarajevo: Svijetlost: Sarajevo 1991
- Person, Owen, *Albania as a Dictatorship and Democracy*, New York: CIB, 2006
- Peter Bartl, *Albanien*, Regensburg: Pustet, 1995
- Pettifer James dhe Vickers Miranda, *Shqipëria*, Tiranë: Toena, 1998
- Pettifer James dhe Vickers Miranda, *Çështja shqiptare*, Tiranë: Bota Shqiptare, 2007
- Polovic, Jadranka, *Uloga Americke politike u stabilizaciji regije i oblikovanju tranzicijskih procesa na jugoistoku Europe*, Zagreb: Sveuciliste u Zagrebu, Fakultet Politickih Znanosti, 2012
- Presidenti Rugova*, Prishtinë: Presidenca e Kosovës, 2007
- Primakov, Jevgenij, *Godine u visokoj politici*, Beograd: IGA "M" 2002
- Qazimi, Pëllumb, *Albania - the Military and Foreign Influence 1912-1991*, Zagreb: Tipomat 2012
- Rakipi, Albert, *Shqipëria në Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë: AIIS 2013
- Rakipi, Albert, *Shqipëria njëzet vjet pas rënies së komunizmit*, Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare 2012
- Rakipi, Albert, *Weak States and Security: Rethinking the Balkan Post-Cold War Agenda Security*, Tiranë: Albanian Institute for International Studies, 2008
- Ramet, Sabrina P. *Balkan Babel-Disintegration of Yugoslavia from death of Tito to the fall of Milosevic*, Boulder: Westview Press, 2002

- Ramet, Sabrina P., *Central and Southeast European Politics since 1989*, Cambridge: University Press 2010
- RAND Corporation, *NATO's Air War for Kosovo*, Arlington: RAND, 2001
- Samimi, Vasmi, *Nëna Kosovë Shqipëria e vërtetë (1938-1943)*, Tiranë: Afërdita 1995
- Silajdzic, Haris, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*, Tiranë: Dituria 1999
- Silber, Laura dhe Little, A. "Yugoslavia: The Death of a nation Harmondsworth: Penguin 1995
- Strobe Talbott , *Strobe The Russia Hand*, New York: Random House 2002
- Shala, Blerim, *The Diplomatic War for Kosova: A dialogue with Ambassador Christopher Hill*, Prishtinë: Zëri, 2003
- Talbott, Strobe, *The Russia Hand*, New York, 2002
- Trotsky, Leon *The Balkan Wars 1912-1913*, New York: Monad Press, 1980
- The Independent International Commission on Kosovo, *Kosovo, International Response, Lessons Learned*, Oxford: University Press 2000
- Vukadinović, Radovan *Sigurnost na Jugoistoku Europe*, Varazdin: Interland, 1999
- Vukadinovic, Radovan, *Americka politika na jugoistoku Evrope*, Zagreb: Politicka Misao, 1998
- Vukadinovic, Radovan, *US Policy and Independence of Kosovo*, Zagreb: Politicka kultura, 2008
- Weller, Marc "Shtetësia e Kontestuar", Prishtinë: Koha, 2011
- Wesley Clark *Waging Modern War*, New York: Public Affairs 2001
- Wintz, Mark, *Transatlantic Diplomacy and the use of military force in the post-cold war era*, New York: Palgrave Macmillan, 2010

Zela, Granit, *Politika e Jashtme Amerikane pas Luftës së Ftohtë 1989-2009*,
Tiranë: Botimet Emal, 2011

Zhulati, Ilia, *Qëndrimi i SHBA-ve kundrejt shtetit shqiptar (prkth)*, marrë nga
Washington Printing Office 1980

Çernomirdin, Viktor dhe Talbott, Strobe, *Kujtime-Prapaskenat e kapitullimit të
Millosheviqit*, Tiranë: HS, 2009

IV. Mediat

CNN International, London

New York Times, New York

Washington Post, Washington DC

BBC, London

Rilindja Demokratike, Tiranë

Albanian Times, Tiranë

RTSH, Tiranë

Politika, Beograd

Nasa Borba, Beograd

Abstrakt

Rënia e Murit të Berlinit (1989) dhe më pastaj edhe shpërbërja e BRSS-së (1991) krijuan kushtet për një botë njëpolare me SHBA-të si lidere dhe fituese të Luftës së Ftohët. Për Evropën Juglindore përfundimi i luftës në mes të blloqeve solli ndryshime, por jo edhe pa dhunë. Ndryshimet demokratike në Shqipëri filluan në vitin 1991 me vështirësi të mëdha, por me ndihmën e pakursyeshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, arritën që nga një vend me sistem monist të krijojnë një sistem pluralist demokratik. Të gjitha zhvillimet dhe ndryshimet socio-ekonomike që pasuan, me ndërrimin e mënyrës së qeverisjes, hapjes së tregut të Shqipërisë për investime, por edhe për përfitues të paskrupullt ndërkombëtarë dhe vendorë, shikuar nga perspektiva e sotme, duken si hapa të natyrshëm ta një shoqërie që kalon nga komunizmi në demokraci parlamentare dhe ekonomi të tregut të lirë. Pozita strategjike e Shqipërisë si çelës i hyrjes në Detin Adriatik ka qenë gjithnjë synim i komponentës ushtarake të Departmentit të Mbrojtjes së SHBA-ve respektivisht Aleancës Veriatlantike NATO, ndërsa demokratizimi i Shqipërisë dhe eliminimi i komunizmit ka qenë synim i Departmentit të Shtetit. Të dy këto degë të administratës amerikane, pa marrë parasysh ndërrimet në Shtëpinë e Bardhë, kanë qenë mbrojtëse dhe drejtuese të Shqipërisë edhe në periudhat e vështira vetëshkatërruese të saj, siç ishte përmbysja në kufi të luftës civile në vitin 1997. SHBA-të, pa dyshim se kishin interesat e veta strategjike afatgjate në investimin e tyre në Shqipëri, por ajo që mori Shqipëria në periudhën nga rënia e komunizmit e deri në ditët e sotme është transformimi shoqëror dhe institucional, transformimi i strukturave të sigurisë dhe anëtarësimi në aleancën më të fortë ushtarake, në NATO, dhe më me rëndësi partneritetin strategjik me SHBA-të që nuk varet nga zhvillimet politike as në SHBA e as në Shqipëri.

Në anën tjetër Kosova ishte pjesë e shtypur nga Jugosllavia që po shpërbëhej me luftë civile (1991-1995). Edhe më herët në Kosovë ushtrohej dhuna dhe represioni policor dhe ushtarak si rezultat i hegjemonisë shoviniste serbe e cila i nisi të katër konfliktet

ushtarake në Jugosllavi. Me ndihmën e SHBA-ve shqiptarët e Kosovës të parët themeluan partitë politike anti-komuniste në Evropën Juglindore dhe u nisën të homogjenizuar dhe të unifikuar në kërkim të të drejtës legjitime për të jetuar të lirë dhe të pavarur, së pari me mjetet politike dhe jo të dhunshme e më vonë edhe me luftë të hapur kundër makinerisë ushtarake dhe policore serbe. Por, të gjitha veprimet ishin në koordinim me përfaqësuesit e politikës së jashtme amerikane e më vonë edhe me ata të Departmentit të Mbrojtjes. SHBA-të për të ndalur gjenocidin ndaj popullit shqiptar vunë në lëvizje për herë të parë në histori aleancën e NATO-s për të intervenuar ushtarakisht kundër Republikës Federale të Jugosllavisë me motivin e intervenimit humanitar për të mbrojtur shqiptarët e Kosovës nga shkatërrimi dhe për të parandaluar një luftë të re ballkanike. SHBA-të e njihnin mirë problemin e Kosovës dhe kërkesat e shqiptarëve sepse ato i kishte artikuluar në mënyrë të shkëlqyeshme me vite në Washington, Bruksel, Berlin, Londër, Romë dhe Prishtinë, Presidenti historik i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova. Trinomi i tij i famshëm liri, pavarësi, demokraci ishte i kuptueshëm për amerikanët që aspirojnë dhe mbrojnë të njëjtat vlera. Pas intervenimit ushtarak dhe çlirimit të Kosovës, SHBA-të u angazhuan fuqimisht në ndërtimin e institucioneve demokratike, ishin sponsor i fuqishëm i kërkesës së shqiptarëve të Kosovës për pavarësi gjatë bisedimeve të statusit final, ishin ndër vendet e para që e njohën Republikën e Kosovës si dhe e mbrojtën këtë vendim në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Demokratizimi i Shqipërisë dhe i Kosovës, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe arritja e shtetësisë së Kosovës kurrë nuk do të mund të ndodhnin pa unitetin brendashqiptar, sakrificën dhe këmbënguljen në kërkesat e tyre të drejta dhe pa ndihmën e pamohueshme të SHBA-ve përgjatë gjithë periudhës së zhvillimeve dramatike të dhjetëvjetëshit të shekullit të kaluar. Prandaj, përafrimi i Shqipërisë dhe Kosovës në të gjitha fushat si dhe ruajtja e aleancës strategjike me SHBA-të janë esenciale për ecjen përpara të popullit shqiptar në shekullin XXI.

ABSTRACT

The fall of Berlin Wall (1989) and subsequent dissolution of USSR (1991) had created conditions for a unipolar world with USA as the leader and victorious after the Cold War. For South-East Europe end of war between two blocks brought changes, but not without violence. Democratic changes in Albania began in 1991 with huge difficulties, but with enormous aid by the USA a new democratic pluralist system was created in place of one-party system. All of the socio-economic changes and developments that followed, with the change of governance, opening of Albanian market for foreign investments as well as international and local cheaters, viewed from today's perspective, seem as necessary steps that a society must pass to go from communism to parliamentary democracy and free trade system. Geostrategic position of Albania, that holds the key to Adriatic Sea, has always been a goal of the military component of the Department of Defense of the US and NATO, while toppling communism was the goal of the Department of State. Both branches of US administration, regardless of the changes at the White House, have been defenders and directors of Albania even in its self-destructing difficult periods such as the unrests that almost turned to civil war in 1997. US have for sure had their strategic interests in long-term investment in Albania; however what Albania gained since the fall of communism until now is complete social and institutional transformation, transformation of security structures and full membership in world's strongest military alliance, in NATO, and more importantly a strategic partnership with the US that is not dependent on political changes in the US or Albania.

On the other side, Kosovo was an oppressed territory in Yugoslavia that was being dismantled through civil war (1991-1995). Even before Kosovo was subjected to police and military violence caused chauvinist Serb ambitions of hegemony that instigated all four wars in Yugoslavia. With the aid of USA, Albanians of Kosovo

were the first ones to form anti-communist political parties in the region of South-East Europe and united began to demand their legitimate rights to live free and independent, firstly through political and non-violent means and later through open war against Serbian military and police machinery. However, all moves were coordinated with representatives of American foreign policy and later with representatives of the Department of Defense. In order to stop the genocide against Albanians of Kosovo the US put in motion for the first time in history the NATO Alliance to intervene militarily against Yugoslavia under the motive of humanitarian intervention and saving Albanians from destruction as well as preventing a new Balkan war. The US were well aware of the demands of Kosovo Albanians as they were articulated brilliantly in Washington, Brussels, Berlin, London, Rome, and Prishtina by Kosovo's historical President Dr. Ibrahim Rugova. His famous three notions of freedom, independence, and democracy were very well understandable by Americans that aspire and defend the same values. After military intervention and liberation of Kosovo, US were heavily involved in the creation of Kosovo's new democratic institutions, US were a huge sponsor of the demand of Kosovo for full independence at the process of final status talks, US were one of the first countries to recognize Kosovo's independence and defended this decision and the International Court of Justice in the Hague.

Democratisation of Albania and Kosovo, membership of Albania into NATO and achievement of statehood of Kosovo would have never happened without interAlbanian unity, sacrifice, and persistence in their just demands and unquestionable aid by the US throughout dramatic developments of the last decade of previous century. Therefore, growing closer in all areas for Albania and Kosovo as well as guarding the strategic alliance with the US are essential for Albanian nation in moving forward in XXI century.